



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

RAPORT AUDITIMI
Auditim Financiar dhe Përputhshmërie

Mbi zbatimin e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë në Ministrinë e Kulturës, Tiranë, për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2019.

Përgatitur nga data 26.03.2020 deri më 30.03.2020.

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit nr. 62/1, datë 21.01.2020, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi është kryer nga:

- 1- Znj. A. J (*përgjegjës grupi*),
- 2- Znj. V. G, anëtar
- 3- Znj. I. I, anëtar
- 4- Znj. S. J, anëtar,
- 5- Z. A. K, anëtar dhe
- 6- Z. D. P, anëtar

Auditimi ka filluar më 21.01.2020

Auditimi ka përfunduar më 20.03.2020



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

<i>Nr</i>	<i>Përmbatja</i>	<i>Faqe</i>
I.	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	
II.	HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)	9 - 12
	a. Objektivat dhe qëllimi.	
	b. Identifikimi i çështjes	
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
	d. Përgjegjësitë e audituesve	
	e. Kriteret e vlerësimit	
	f. Standardet e auditimit	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12 - 13
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	
1.	Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit	13 - 52
2.	Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave	52 - 63
3.	Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare	63 - 74
4.	Auditimi i llogarive vjetore	74 - 101
5.	Prokurimet e fondeve publike	102 - 134
6.	Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit	134 - 156
7.	Mbi zbatimin e rekomandimeve të mëparshme	156 - 173
V.	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT	173 - 175



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

I/a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Ministrinë e Kulturës (MK), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme, ndër të tjera, çështjeve që lidhen me:

1. Njohjen me aktivitetin ekonomiko-financiar të saj dhe organizimin e funksionimit sipas rregulloreve të miratuara,
2. Vlerësimin dhe funksionimin sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe
3. Auditimin e pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2018 dhe 2019 si dhe transaksionet financiare për gjithë periudhën objekt auditimi.

Në kushtet e pandemisë globale të COVID 19, edhe auditimi në terren nga grupi i auditimit është ndërprerë, për të vijuar puna on-line nëpërmjet sistemit Revzone dhe komunikimit elektronik (me e-mail) me subjektin. Aktet e konstatimit me nr. 1 – 6 janë dërguar gjithashtu me e-mail në adresën zyrtare të Sekretarit të Përgjithshëm të MK-së, më datë 21.03.2020.

Me e-mailin e datës 26.03.2020, Sekretari i Përgjithshëm, znj. E. C. është shprehur se institucioni e ka të pamundur t'i shqyrtojë akt-konstatimet dhe të jap përgjigjet përkatëse brenda periudhës njëjavore, të përcaktuar, pasi në bazë të vendimit nr. 243 dt. 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore”, edhe Ministria e Kulturës ka ndërmarrë masat e nevojshme për parandalimin e sëmundjes infektive “Covid-19”, duke vijuar punën on-line.

Me shkresën nr.62, datë 02.04.2020 të Kryetarit të KLSH-së, afati për kthimin e përgjigjes nga subjekti mbi akt konstatimet, u shty deri më datë 20.04.2020, datë kur edhe erdhën observacionet (me email). Ndërsa në formë shkresore u protokolluan në KLSH me nr. 62/4, date 24.04.2020.

Projekt Raporti i Auditimit u dërgua me shkresën nr. 62/6, datë 30.04.2020, me e-mail dhe po me e-mail erdhën dhe observacionet (me shkresën nr. 1916/1, datë 28.05.2020).

I/b. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	U konstatuan problematika dhe mangësi në procedurat e prokurimit, që lidhen me hartimin e fondit limit, përzgjedhja e procedurës, tipi i kontratës, kërkesat e veçanta kualifikuese, etj, në procedurën me objekt “Blerje pajisje të teknologjisë së skenës dhe material ne funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP”, të trajtuara më hollësisht në RPA.			Ministria e kulturës në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, Në çdo procedure prokurimi, hartimi i fondit limit të mirë argumentohet, përzgjedhja e procedurës, tipi i kontratës, kërkesat e veçanta kualifikuese, të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTA R	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
				ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës me qëllim rritjen e konkurrencës nëpërmjet pjesëmarrjes të sa më shumë operatorëve ekonomik për mirë përdorimin e fondeve publike me, efektivitet, eficientë dhe ekonomicitet.
2.	Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2018 (mbartur si pasojë edhe në pasqyrat e vitit 2019) konstatohet se është bërë një pakësim llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” në shumën 60,369,399 lekë për një amortizim që nuk i përket kësaj llogarie. Në kushtet e detyrimit për zbatim të UMFE nr. 8/2018 për përgatitjen e pasqyrave financiare 2018, MK duhet të raportonte zërat e aktiveve me vlerën neto, si rezultat është gjendur në situatën e vlerës së mbetur negative, për shkak të një amortizimi të akumuluar të zërit 218 “Inventar ekonomik” më të lartë se kosto historike. Në shënimet shpjeguese shoqëruese të pasqyrave financiare të vitit 2018 nuk ka asnjë informacion në lidhje me këtë pakësim, as për mënyrën e përlllogaritjes së tij dhe as problematikën që ka shoqëruar raportimin. Veprimi i mësipërm cënon besueshmërinë në reflektimin e vlerës neto të llogarisë 218 “Inventar ekonomik” dhe të shënimeve shpjeguese dhe bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, Kreu 3.7 Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale. Pika 85.			MK, në linjë hierarkike, NA, NZ dhe personeli I përfshirë të marrin masa: - për evidentimin e saktë të arsyeve dhe aktiveve të cilën nuk janë amortizuar sipas normave të lejuara kontabël dhe të lidhin rezultatet e nxjerra me aktivet përkatës, konform parimeve kontabël dhe dispozitave ligjore; - për evidentimin e gjithë problematikave që shoqërojnë raportimin financiar në shënimet shpjeguese të tij, duke evituar mbartje të tyre në vitet në vazhdim.
3.	Gjatë auditimit u konstatua se në zbatim të Urdhrit përkatës të Ministrit për vitin 2018/2019, janë ngritur Komisionet e Inventarizimit. Për vitin 2018 procesi i inventarizimit të gjithë aktiveve të MK ka përfunduar jashtë datës së përcaktuar, dhe përtej raportimit të pasqyrave të aparatit të MK në Degën e Thesarit. Për vitin 2019 është kryer vetëm inventarizim i aktiveve në magazinë Rezultatet e inventarizimit në dy			MK, në linjë hierarkike, NA, NZ dhe personeli I përfshirë, të marrin masat që në proceset e inventarizimit të rradhës, të përfundojnë numërimi sasior dhe cilësor i të gjithë aktiveve, brenda afatit të raportimit të pasqyrave financiare. Rezultatet e inventarizimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	vitet nën auditim nuk janë formuluar në një relacion. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”.			duhet të dokumentohen me një relacion përkatës.
4.	Nga auditimi rezultoi shkelje e disiplinës buxhetore për vitin 2019, sa i takon marrjes së një angazhimi prej 199,659,817 lekë me tepër, pa pasur fonde buxhetore në dispozicion, nëpërmjet procedurave në kundërshtim me bazën ligjore në fuqi			Në vijim, të shmanget plotësisht përdorimi i praktikave të celjes së angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, për më tepër duke përdorur mënyra jo të duhura teknike dhe ligjore, si tranferimin e perkohshëm të një angazhimi aktual, në një periudhë të ardhshme deri në legjitimimin e tij me Akt Normativ. Për të gjitha rastet e konstatuara në të ardhmen, të aplikohen sanksionet e parashikuara në Kreun IX, neni 71 të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
5.	Nga kryerja e testimeve në Modulin e Pagesave të SIFQ, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin e parashikuar ligjor, 30 ditë. Konkretisht, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditë duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, respektivisht: -gjatë vitit 2018, 122 fatura, mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit, me një vlerë totale prej 31,739,503 lekë, dhe -gjatë vitit 2019, 647 fatura mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit, me një vlerë totale prej 198,740,330 lekë, duke sjellë :			Me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura, në cdo rast NZ duhet të paraqes në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së, dhe jo ndryshe. Për cdo rast në vijim, që do të konstatohet ndryshe, të evidentohen



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTA R	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	a. Tejkallim të afateve që parashikon Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar, neni 52, ku specifikohet se Nëpunësi zbatues i njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së), dhe si pasojë b. Duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (të prapambetura)			përgjegjësitë dhe për personat përgjegjës për shkaktimin e vonesave të aplikohen sanksionet e parashikuara në Kreun IX, neni 71, të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar

I/c. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Opinion mbi përputhshmërinë (i pakualifikuar me theksim të çështjes)

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrisë së Kulturës, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të MK-së, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

Nga auditimi u rezultoi se, në opinionin tonë, aktiviteti i MK-së, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme, por për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes”.

Baza për opinionin e përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur gjithashtu mbi gjykimin profesional të audituesit. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Theksimi i çështjes:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave në MK nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë hallkat e përfshira, dhe strukturat e varësisë në mënyrë që:

- praktika të çeljes së projekteve “pa përshkrim” të mos përsëriten në të ardhmen dhe MK në çdo rast, për projektet e mëdha të investimeve, të përgatis propozimet dhe t’i paraqes për vlerësim në Ministrinë përgjegjëse për financat, brenda muajit dhjetor dhe jo më vonë se një muaj përpara fillimit të procesit buxhetor

- të merren masa që të respektohet disiplina buxhetore dhe të shmangen risqet për krijimin e detyrimeve të prapambetura, duke treguar kujdes të mos tejkalohet afati 30 ditor i likuidimit të faturave, në përputhje me kërkesat e nenit 52 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”;

- të merren masa që të respektohet disiplina buxhetore, duke u treguar kujdes maksimal në mos çeljen e angazhimeve buxhetore në mungesë të fondeve të parashikuara, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura në përputhje me VKM nr.50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe të planit të veprimit” si dhe me Udhëzimin nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për NJQP që përdorin SIFQ”

- theksojmë nevojën që Ministria e Kulturës në rolin e Autoritet Kontraktor, në çdo procedure prokurimi, të tregojë kujdesin e duhur në përlllogaritjen e fondit limit, në përcaktimin e procedurës, në tipin e kontratës së përzgjedhur, në hartimin e dokumentave standarde të tenderit, në vendosjen e kriterëve për kualifikim dhe kriterëve të veçanta, në zbatimin dhe ekzekutimin e kontratës, në funksion të përmbushjes së parimit të konkurrencës dhe parimeve të eficiencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit të fondeve publike.

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pakualifikuar me theksim të çështjes)

Ne audituam pasqyrat financiare të MK-së, më datë 31.12.2019, të cilat përbëhen nga Pozicioni Financiar, Performanca Financiare, Pasqyra e Fluksit të Arkës, Fondet neto, Investimet e Aktivitet Afatgjatë si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar të auditimit, me theksim të çështjes. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes”.

Theksimi i çështjes:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i MK-së i përfshirë, sa i takon procesit të inventarizimit pasi rezultoi se, në kushtet e detyrimit për përgatitjen e pasqyrave financiare, MK është gjendur përpara reflektimit të një gabimi të mbartur ndër vite në lidhje me amortizimin e akumuluar të aktiveve, si pasojë më së shumti e mos regjistrimit fillestar të aktiveve të inventarit ekonomik bazuar në dokumentacionin e duhur kontabël përpara vitit 2012; reflektuar kjo në mungesën e llogaritjes së amortizimit për disa vite. Si pasojë nga auditimi rezultoi se, vlera e amortizimi të akumuluar e inventarit ekonomik, është më e lartë se vetë kosto historike e tyre (në shumën 60,369,999 lekë). Për të bërë sistemin, MK ka pakësuar llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione” në shumën 60,369,399 lekë për një amortizim që nuk i përket kësaj llogarie, duke rritur kështu më pa të drejtë jetën e dobishme të këtij aktivi dhe duke rrezikuar të çënojë besueshmërinë e pasqyrave financiare në lidhje me vlerën neto të aktiveve.

Për këtë, theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e MK-së, në linjë hierarkike për evidentimin e saktë të arsyeve dhe aktiveve, që nuk janë amortizuar sipas normave të lejuara kontabël dhe të lidhin rezultatet e nxjerra me aktivet përkatës, konform parimeve kontabël dhe dispozitave ligjore. Gjithashtu theksojmë nevojën që në proceset e radhës së inventarizimit të përfundohet numërimi sasior dhe cilësor i të gjithë aktiveve, brenda afatit të raportimit të pasqyrave financiare.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i MK-së është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MK-së me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

a. Objektivat dhe qëllimi.

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare. Gjithashtu, lidhur ky qëllim me aspektin e përputhshmërisë ligjore dhe rregullative të këtyre transaksioneve, mundësohet një qasje më e gjerë e analizimit të aktivitetit të këtij institucioni në tërësi. Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimit i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

Gjithashtu ky auditim ka për qëllim edhe kryerjen e auditimit të përputhshmërisë (pajtueshmërisë) me qëllim përcaktimin nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si psh me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; si dhe nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

b. Identifikimi i çështjes

Në Ministrinë e Kulturës mbajtja e kontabilitetit për vitin 2018 dhe 2019, është bërë në bazë të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ndërsa, struktura, funksionimi dhe mbyllja e llogarive vjetore është bërë në bazë të Vendimit të KM nr. 248, datë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësive që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998” dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, dt. 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”. Për vitin 2018 nuk është vepruar konform formateve të miratuara në Udhëzim e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

Ministria e Kulturës, në përputhje me drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

- Harton, programon dhe zhvillon politikat kombëtare të kulturës, të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritetit kulturor në familjen, evropiane dhe botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë .
- Harton dhe bashkërendon punën për politikat në fushën e artit e të kulturës nëpërmjet edukimit të popullsisë, rjetësimit të vlerave dhe trashëgimisë kulturore, nxitjes së investimeve, publike dhe private, në këta sektorë, monitorimit të mënyrës së përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, edukimit në kulturë, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe vijimësisë së traditës së harmonisë fetare në kulturën shqiptare, si dhe të bashkëpunimit rajonal.
- Harton politikat, mbrojtëse dhe promovuese, për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore, si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike nëpërgjithësi, si dhe për të promovuar arritjet e kulturës shqiptare e për të rritur konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve.
- Harton politika për ekzistencën e Shqipërisë si një partner aktiv në organizatat ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale, në fushën e artit e të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet aderimit në institucionet përkatëse.
- Udhëheq, programon dhe mbështet veprimtaritë, kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike dhe letrare, brenda vendit, si dhe përfshirjen e ballafaqimin e vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara dhe ato bashkëkohore dhe për krijimin e një hapësire dialogu mbarëshqiptar dhe të diversitetit kulturor.
- Nëpërmjet strukturave të varësisë realizon regjistrimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera, të lidhura me të, nga subjektet,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

persona fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike e shkencore.

– Kryen funksione dhe veprimtari të tjera në përputhje me ligjin.

c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Drejtimi i MK^{së} është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

d. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MK^{së}, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

e. Kriteret e vlerësimit:

- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

- Vendimit të KM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësive që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998”,

- UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, dt. 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”.

- VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, i ndryshuar; \ VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin e punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës” i ndryshuar;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

- Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar
- VKM nr. 507, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të MK-së”
- etj

f. Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar të KLSH, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

MK në përputhje me Kushtetutën, kuadrin ligjor në fuqi, drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore ushtron aktivitetin e saj në këto fusha:

- Hartimin, programimin dhe zhvillimin e politikave kombëtare të kulturës, të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritetit kulturor në familjen, evropiane dhe botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë.
- Hartimin dhe bashkërendimin e politikave në fushën e artit e të kulturës;
- Hartimin e politikave mbrojtëse dhe promovuese, për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike nëpërgjithësi, si dhe për të promovuar arritjet e kulturës shqiptare e për të rritur konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve
- Hartimin e politikave për ekzistencën e Shqipërisë si një partner aktiv në organizatat ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale, në fushën e artit e të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet aderimit në institucionet përkatëse.
- Udhëheqjen, programimin dhe mbështetjen e veprimtarive kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike dhe letrare, brenda vendit, si dhe përfshirjen e ballafaqimin e vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara dhe ato bashkëkohore dhe për krijimin e një hapësire dialogu mbarëshqiptar dhe të diversitetit kulturor.
- Realizimin e regjistrimit, mbikëqyrjes dhe monitorimit të respektimit të të drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera, të lidhura me të, nga subjektet, persona fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike e shkencore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Ministria e Kulturës, për periudhën objekt auditimijm administroi dhe menaxhoi fondet publike në tre programe buxhetore:

1. Programi “Planifikim Menaxhim Administrim”
2. Programi “Trashëgimia Kulturore”
3. Programi “Arti dhe Kultura”

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- a. Objekt i këtij auditimi është rregullshmëria dhe përputhshmëria e operacioneve financiare të MK-sëpërgjatë vitit 2018 dhe vitit 2019
- b. Qëllimi i auditimit: Garantimi i sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MK-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit

Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i aktivitetit të MK-sëme qëllim dhënien e opinionit, është shtrirë sipas drejtimevetë programit të auditimit.

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT TË BUXHETIT

Baza ligjore për auditimin e programimit dhe realizimit të treguesve buxhetorë:

- Ligji nr. 10244, datë 25.02.2010
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016
- Ligji nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”
- VKM nr.80, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2017-2019”
- UMF nr. 4, datë 29.02.2016 “Për përgatitjen e PBA 2017-2019”
- UMF nr. 10, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e PBA-së 2018-2020”
- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standare të zbatimit të buxhetit”
- Udhëzimi nr. 2, date 06.02.2012 “Për procedurat standare të zbatimit të buxhetit”

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit në MK u mbshtet mbi: Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.109 datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave, nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Plotësues nr.2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”i ndryshuar, paragrafi V “Monitorimi” si dhe Udhëzimi nr.22 datë 17.11.2016 “Për Procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Ministria e Kulturës, në përputhje me drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2018 ka hartuar, programuar dhe zhvilluar politikat kombëtare të kulturës, të trashëgimisë kulturore.

Programet për të cilat kjo ministri ka administruar fondet vitin 2018 janë:

1. Programi “Planifikim Menaxhim Administrim”
2. Programi “Trashëgimia Kulturore”
3. Programi “Arti dhe Kultura”

a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Për vitin 2018 detajimi i buxhetit është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë.

Buxheti i akorduar në fillim të vitit 2018 është rishikuar gjatë vitit me aktin normativ nr.1 datë 26.07.2018 si dhe me aktin normativ nr.2 datë 19.12.2018 dhe ka pësuar ndryshime të cilat paraqiten sipas tabelës më poshtë:

në 000/lekë

Programet	Artikulli	Buxheti fillestar 2018	shtesa/pakesime sipas AN.1	shtesa/pakesime sipas AN.2	Buxheti I Rishikuar 2018
Planifikim, Menaxhimi dhe Administrimi	Shpenzime personeli	115,276	(7,000)	(1,000)	107,276
	Shpenzime Korrente	45,000	-	-	45,000
	Shpenzime Kapitale	-	-	-	-
	Totali	160,276	(7,000)	(1,000)	152,276
Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	Shpenzime personeli	280,624	15,135	-	295,759
	Shpenzime Korrente	154,448	-	-	154,448
	Shpenzime Kapitale	200,000	(7,000)	-	193,000
	Totali	635,072	8,135	0	643,207
Arti dhe Kultura	Shpenzime personeli	541,600	3,500	(3,000)	542,100
	Shpenzime Korrente	222,949	-	-	222,949
	Shpenzime Kapitale	450,000	-	(210,000)	660,000
	Totali	1,214,549	3,500	207,000	1,425,049
TAVANET MK	Shpenzime personeli	937,500	11,635	(4,000)	945,135
	Shpenzime Korrente	422,397	-	-	422,397
	Shpenzime Kapitale	650,000	(7,000)	210,000	853,000
	TOTALI	2,009,897	4,635	206,000	2,220,532

Sipas Aktit Normativ nr.1, rezultoi se, shpenzimet e personelit u shtuan rreth 18,635 mijë lekë nga totali i fondeve të kërkuara nga ana e MK prej 31,352 mijë lekë pasi tavanet për paga nuk i mbulonin nevojat e MK sipas strukturave në fuqi, (nga ku vlera prej 11,635 mijë lekë u plotësua nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe pjesa tjetër prej 7,000 mijë lekë u plotësua nga fondet e lira që deklaroi Ministria e Kulturës në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante nga DAP për gjashtëmujorin e parë të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

vitit 2018). Ndërsa shpenzimet kapitale u pakësuan në vlerën prej 7,000 mijë lekë në Programin e Trashëgimise dhe Muzeve.

Sipas Aktit Normativ nr.2 rezultoi se, shpenzimet e personelit u pakësuan me 1,000 mijë lekë në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim, si dhe me 3,000 mijë lekë në programin e Artit dhe Kulturës nga deklarimi i fondeve të lira të MK si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante nga DAP për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2018). Gjithashtu u avancua plani i investimeve me vlerë 210,000 mijë lekë për projektin me kod M120763 “Rikonstruksion TKOB” në programin Arti dhe Kultura me qëllim përmbushjen e prioritetëve të sistemit të kulturës.

Nga auditimi rezultoi se, krahas rishikimeve të Buxhetit fillestar për vitin 2018, buxheti ka pësuar ndryshime gjatë vitit edhe si rezultat i përfitimit të fondeve buxhetore me VKM, apo edhe nga rishpërndarjet e fondeve midis shpenzimeve korrente, cilat paraqiten në mënyrë tabelare si më poshtë:

në 000/lekë

Programet	Artikulli	Buxheti fillestar I rishikuar	shtesa/pakesime (nga VKM, transferime)	Plani Perfundimtar 2018
Planifikimi, Menaxhim dhe Administrim	Shpenzime personeli	107,276	(17,000)	90,276
	Shpenzime korrente	45,000	23,402	68,402
	Shpenzime Kapitale	-	-	-
	Totali	152,276	6,402	158,678
Trashëgimia dhe Muzeve	Shpenzime personeli	295,759	(5,418)	290,341
	Shpenzime korrente	154,448	20,887	175,335
	Shpenzime Kapitale	193,000	-	193,000
	Totali	643,207	15,469	658,676
Arti dhe Kultura	Shpenzime personeli	542,100	(21,578)	520,522
	Shpenzime korrente	222,949	61,327	284,276
	Shpenzime Kapitale	660,000	-	660,000
	Totali	1,425,049	39,749	1,464,798
TAVANET MK	Shpenzime personeli	945,135	(43,996)	901,139
	Shpenzime korrente	422,397	105,616	528,013
	Shpenzime Kapitale	853,000	-	853,000
	Totali	2,220,532	61,620	2,282,152

Referuar 3 programeve që menaxhon MK, gjatë vitit 2018, buxheti ka pësuar këto ndryshime:

1. Programi Planifikim, Menaxhim dhe Administrim

Përsa i përket transferimeve, shpenzimet e personelit u pakësuan në vlerën prej 17,000 mijë lekë gjatë vitit 2018, si rezultat i krijimit të fondeve të lira nga mosplotësimi i vendeve vakante nga DAP për vitin 2018 duke i transferuar në shpenzime korrente me qëllim shlyerjen e detyrimeve për vendimet gjyqësore të formes së prerë të krijuara gjatë viti 2018. Gjithashtu shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 6,302 mijë lekë si rezultat i VKM nr.538 datë 19.09.2018 “Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Kulturës” me qëllim kryerjen e pagesave të kuotave të antarësimit në Observatorin Evropian të Medias, detyrime të prapambetura për vitet 2006-2013, si dhe në vlerën prej 100 mijë lekë referuar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

kërkesave të paraqitura nga Aparati i MK në mbështetje të VKM nr.929 datë 17.11.2010, i ndryshuar “Për përdorimin e Fondit të Veçantë”

2.Programi Trashëgimia dhe Muzetë

Për këtë program, shpenzimet e personelit u pakësuan në vlerën prej 5,418 mijë lekë gjatë vitit 2018, si rezultat i krijimit të fondeve të lira nga mosplotësimi i vendeve vakante të institucioneve të varësisë, të cilat u transferuan në shpenzimet korrente me qëllim përdorimin e tyre kryesisht për shlyerjen e vendimeve gjyqësore të formes së prerë dhe për realizimin e aktiviteteve në kuadër të vitit mbarëkombëtar të Skënderbeut. Gjithashtu shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 14.000 mijë lekë nga VKM nr.186 datë 29.03.18 "Për një shtesë fondi, si viti mbarëkombëtar I Gjergj Kastriot Skenderbeut" si dhe në vlerën prej 1,461 mijë lekë referuar kërkesave të paraqitura nga institucionet e Trashëgimisë në mbështetje të VKM nr. 929 datë 17.11.2010 i ndryshuar “Për përdorimin e Fondit të veçantë” i ndryshuar

3.Programi Arti dhe Kultura

Referuar transferimeve, shpenzimet e personelit u pakësuan në vlerën prej 21,578 mijë lekë gjatë vitit 2018, si rezultat i krijimit të fondeve të lira nga mosplotësimi i vendeve vakante të institucioneve të varësisë, duke u transferuar në shpenzimet korrente me qëllim përdorimin e tyre për shlyerjen e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe për realizimin e kalendarve artistik në kuadër të vitit mbarëkombëtar të Skënderbeut. Shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 38,000 mijë lekë si rezultat i VKM nr.186 datë 29.03.18 "Për një shtesë fondi, si viti mbarëkombëtar I Gjergj Kastriot Skenderbeut" dhe në vlerën prej 1,749 mijë lekë referuar kërkesave të paraqitura nga institucionet e Artit në mbështetje të VKM nr.929 datë 17.11.2010 “Për përdorimin e Fondit të veçantë” i ndryshuar.

Përsa i takon ndryshimeve të planit , Ministria e Kulturës ka paraqitur reflektimet edhe në planin e produkteve në sasi dhe në vlerë mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020

Konstatim 1:

Nga auditimi rezultoi se, përgjatë vitit 2018, për Ministrinë e Kulturës, janë çelur projekte të reja në vlerën 175,201,525 mije leke, të cilat duke u detajuar nën titullin “pa përshkrim projekti”, nuk kanë kaluar në procedurat e miratimit të investimeve publike si dhe nuk rezultojnë të jenë në listën e investimeve të miratuara në projektbuxhetin e vitit 2018¹.

Konstatohet se, këto projekte, nuk janë përfshirë as në Listën e Investimeve Publike 2019-2021 si projekte investimi të miratuara me projektbuxhetin e vitit 2019, ku duhet të ishin paraqitur si projekte investimi në vazhdim.

¹ Sipas VKM nr. 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve, projektet e investimeve duhet të paraqiten si pjesë përbërëse e kërkesave buxhetore, në kuadër të përgatitjes së PBA-së. NJQQ përgatisin propozimet për projektet e mëdha të investimeve, në çdo kohë dhe i paraqesin për vlerësim në Ministrinë përgjegjëse për financat, Brenda muajit dhjetor dhe jo më vonë se një muaj përpara fillimit të procesit buxhetor, sipas përcaktimit në nenin 22, t ë ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Konkretisht, rezultoi se, me shkresën nr. 7105/2, datë 18.04.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, me subjekt “Çngurtësimi i fondit”, është miratuar çngurtësimi i fondeve në vlerën 181.200 mijë lekë dhe duke u çelur projekte, pa iu nënshtruar procedurave të investimeve publike në programin 8220 “Trashëgimia kulturore dhe muzetë” si më poshtë:

1-Projekti me kod M120781 “Projekti i restaurimit dhe riformulimi i linjës muzeale në Muzeun Historik Kombëtar” Tiranë në vlerën 40,000 mijë lekë

2-Projekti me kod M120782 “Projekti i restaurimit dhe rehabilitimit të hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve” në vlerën 15,000 mijë lekë.

3-Projekti me kod M120783 “Ura e Kollorces 4 km në juglindje të Gjirokastrës” në vlerën 5,000 mijë lekë

4-Projekti me kod M120784 “Restaurim banesa e vëllezërve Frashri” në vlerën 6,000 mijë lekë

5- Projekti me kod M120785 “Restaurim muzeu i Sinjës Dibër” në vlerën 1,500 mijë lekë

6- Projekti me kod M120786 “Restaurim Kisha e Shën Mërisë Gjirokastrë” në vlerën 22,500 mijë lekë

7- Projekti me kod M120787 “Restaurim Kisha e Shën në vlerën 20,000 mijë lekë

8- Projekti me kod M120788 “Restaurim Kisha e Shën në vlerën 33,300 mijë lekë

9- Projekti me kod M120790 “Restaurim Kisha e Shën në vlerën 11,000 mijë lekë

10-Projekti me kod M120791 “Restaurim Kisha Manastiri i Shën Mërisë Faza 1- Sarandë”, në vlerën 26,900 mijë lekë.

Sipas Para 66, të Udhëzimit nr. 2, datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, nëse në listën e investimeve të detajuara nga njësitë e qeverisjes qendrore, **ka objekte të reja nga lista e paraqitur në momentin e miratimit të projekt buxhetit të vitit, Nëpunësi i Parë Autorizues e përfshin në listën përfundimtare vetëm kur objekti ka kaluar në procedurat e miratimit të investimeve publike.**

Në lidhje me sa më sipër, në kushtet e pandemisë të shkaktuar nga COVID 2020, MK me email-in e datës 01.06.2020 nga Sekretari i Përgjithshëm i MK-së, ka dërguar observacionet mbi këtë pikë ku shprehet se: “Ministria e Kulturës çdo fillim viti ka përfshirë në listën përfundimtare të investimeve vetëm ato investime të cilat kanë kaluar në procedurat e miratimit të investimeve publike, përjashtim bëri viti 2018 meqenëse për angazhimet për vitin e Skenderbeut, Ministrisë së Kulturës nuk iu akordua shtesë fondi për investime dhe duke parë rëndësinë që paraqisnin këto projekte në kuadrin e këtij viti përkujtimor u shpërnda ky fond për të cilin dhe u mbajt i ngrirë”.

Përgjigjia e grupit të auditimit:

Në kushtet kur MK e ka pranuar konstatimin tonë, ky observacion merret në konsideratë dhe rekomandimi qëndron dhe është i pranuar nga vetë subjekti, për tu mbajtur parasysh që të tregohet kujdesi i duhur për raste në të ardhmen.

Konstatim 2:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Në kuptimin e VKM 50, date 05.02.2014, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara në një ligj/marrëveshje/vendim gjykate të formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo ligj.

Në këtë kuptim, grupi i auditimit kreu teste për të identifikuar gjithë pagesat e kryera për vitin 2018, me datën e urdhër shpenzimit mbi 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së furnitorit².

Nga kryerja e testeve në Modulin e Pagesave të SIFQ, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin ligjor. Konkretisht, **janë likuduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton** Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, respektivisht:

-gjatë vitit 2018, 122 fatura, mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit, me një vlerë totale prej 31,739,503 lekë, dhe

-gjatë vitit 2019, 647 fatura mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit, me një vlerë totale prej 198,740,330 lekë,

duke sjellë :

a. Tejkallim të afateve që parashikon Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar, neni 52 (ku specifikohet se Nëpunësi zbatues I njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së), dhe si pasojë

b. Duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (të prapambetura)

Në lidhje me sa më sipër, në kushtet e pandemisë të shkaktuar nga COVID 2020, MK me email-in e datës 01.06.2020 nga Sekretari i Përgjithshëm i MK-së, janë dërguar observacionet mbi këtë pikë ku shprehet se: *“Vlen të theksohet se duke marr shkas nga neni 52 që parashikon Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, (ku specifikohet se Nëpunësi zbatues i njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale), Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar (DBMF) bën likuidimin e praktikave menjëherë pas marrjes në dorëzim të tyre dhe për praktikave të dorëzuara me vonësë pranë kësaj drejtorie, kërkon shkresë përcjellëse, me qëllim ndarjen e përgjegjësisë. Ndërsa për institucionet e varësive që janë konstatuar fatura të paguara mbi afatin e parashikuar 30 ditor janë dërguar tërheqje vëmendje dhe marrje masash”. DBMF ndjek dhe monitoron obligimet e kontratave për aparatin dhe njësitë shpenzuese të regjistruara në thesar rast pas rasti nëpërmjet Modullit të Pagesave të SIFQ. Por Kontrolli dhe monitorimi për respektimin e disa prej angazhimeve të tjera është relativisht proces i vështirë nëpërmjet SIFQ për shkak të: a)nisur nga natyra e vecantë e kryerjes së shpenzimeve përsa i përket projekteve artistike të mbështetura nga ana e MK, detyrime të cilat faturohen nga ana e subjektit fitues ndaj MK në momentin e kryerjes së aktivitetit por si rezultat i dorzimit të praktikave me*

² U përdor Moduli I Pagesave I gjeneruar nga sistemi SIFQ



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

vonesë në zyrën e financës nga ana e këtyre subjekteve projekt fitues kalojnë afatin e parashikuar 30 ditor të pagesës së tyre. Sapo këto praktika dorëzohen në zyrën e financës, ato kalojnë për likuidim menjëherë e si rrjedhojë nuk qëndrojnë as në listën e detyrimeve të prapambetura. b) Gjithashu duhet thënë se Moduli SIFQ nuk ofron një format TIP për regjistrimin e detyrimeve nga ku mund të evidentohen në cdo kohë se nga ana e njësive shpenzuese ka fatura të papaguara të cilat kanë kaluar afatin e parashikuar 30 ditor në rast se këto të fundit nuk raportojnë se ka të tilla.

Përgjigjia e grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pasi shqyrtoi obseravcionet konstaton se, bie dakord me MK-në sa i takon ndarjes së përgjegjësisë mes njësive shpenzuese që dorëzojnë faturat pas afatit të parashikuar. Pikërisht për këtë nevojitet të aplikohen sanksionet e parashikuara në Kreun IX, neni 71, të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar, si masa të nevojshme për mos përsëritjen e këtyre rasteve.

Sa i takon mos ofrimit nga ana e SIFQ-it të një formati TIP për regjistrimin e detyrimeve nga ku mund të evidentohen në cdo kohë se nga ana e njësive shpenzuese ka fatura të papaguara të cilat kanë kaluar afatin e parashikuar 30 ditor në rast se këto të fundit nuk raportojnë se ka të tilla, ky observacion merret parasysh.

Konstatim 3:

Nëse I referohemi shkresë së MK / Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, me nr.181/1 prot, date 16.01.2018, rezulton se MK raporton vlerën e detyrimeve për vendime gjyqësore për t’u shlyer gjatë vitit 2017 në shumën 40,418,861 lekë (të gjitha i takojnë likuidimit për largime të padrejta nga puna), nga të cilat raporton të likuiduara 38,255,779 lekë, duke rezultuar kështu në një vlerë prej 2,163,082 lekë si detyrim i pashlyer më datë 31.12.2017. Nga testimet në Modulin e Pagesave të SIFQ të vitit 2018, sa i takon mospërfshirjes së disa faturave të palikuiduara ende (mbi 30 ditë), rezultoi se nuk është raportuar si detyrim i prapambeturshuma prej 15,884,686 lekë (**Ankesi 1**), më 31.12.2017

Pavarësisht konfirmimit të vlerave (të cilat grupi i auditimit i ka marrë nga Moduli i pagesave të SIFQ në Ministrinë e Financave), konstatohet se përgjithësisht nuk kontrollohet dhe monitorohet respektimi i angazhimeve **edhe** nëpërmjet SIFQ-it sikundër e parashikon Vendimi nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të planit të veprimit”. Këto mospërputhje vijnë pikërisht si pasojë e mungesës së mosrakovrimit mes njësive që raportojnë detyrimet e prapambetura.

Referuar shumave të parashikuara në PBA 2018-2020 (Shtojca 1/A) rezulton se për shpenzime për detyrime dhe kompensime ligjore janë parashikuar në total për vitin buxhetor 2018, shuma prej **22,400 mijë lekë** të shpërndara në programin “Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë” 12,400 mijë lekë, në programin “Arti dhe Kultura” 3,000 leke dhe në programin “Planifikimi dhe menaxhim” detyrimi prej 7,000 lekë (të gjitha këto vetëm për kompensime legale **për largime të padrejta nga puna** dhe jo ndryshe sikundër na rezultojnë). Në këto kushte konstatohet se, nuk është kontrolluar dhe monitoruar respektimi i angazhimeve **nëpërmjet SIFQ-it**, sikundër e parashikon Vendimi nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

detyrimeve të prapambetura të planit të veprimit”. Këto mospërputhje vijnë pikërisht si pasojë e mungesës së mosrakodrimit mes njësive që raportojnë detyrimet e prapambetura.

Përvec sa më sipër nga kryqezimi i informacionit rezultoi se MK me urdhër shpenzimin e datës 01.11.2018, është likuiduar një faturë për likuidim kuotash për anëtarësimin në Observatorin Evropian të Medias sipas një marrëveshjeje ndërqeveritare që ne vitin 2016. Prej atëherë është bërë vetëm një pagesë (ajo e vitit 2006) ndërsa gjitha shuma e akumuluar prej rreth 48,000 Eur (përfshirë edhe kamatë vonesat prej Euro 20,316) ose 6,228,992 lekë rezulton e papaguar prej vitit 2007 deri më 2018 kur edhe rezulton të jetë likuiduar.

Nga auditimi rezulton se kjo shumë është deklaruar për herë të parë si detyrim I prapambetur në raportimin periodic të detyrimeve të prapambetura të 9 mujorit, 2018 (referuar shkresës nr. 7888, datë 12.10.2018) dhe likuidimi I saj është bërë me VKM nr. 538, datë 19.09.2018. Edhe nga Moduli i Pagesave të SIFQ rezulton se “Data e Furnitorit” është plotësuar gabim (sipas datës së urdhër shpenzimit dhe sipas dates kur ka lindur detyrimi).

Ndërsa nga auditimi për vitin 2019 rezultoi se, në **PBA e viteve 2019-2021** në programin Art dhe Kulturë, Ministria e Kulturës ka planifikuar sipas tabelës së mëposhtme investimin për projektin “Restaurimi, rikonstruksioni, riformulimi i Linjës muzeore në Muzeun Historik” vlera totale e të cilit është 1,929,924,367 lekë nga ku diferenca e mbetur do të mbulohej me tavanet e viteve në vazhdim të miratuar rishtazi.

në lekë

Emertimi i projektit te investimit	Parashikimi per v.2019	Parashikimi per v.2020	Parashikimi per v.2021
Restaurimi, rikonstruksioni, riformulimi i Linjes muzeore ne Muzeun Historik		258,063,000	492,500,000

Ajo që vihet re është se në fakt ky projekt është lënë mënjanë dhe në PBA 2020-2022, referuar edhe tavaneve të miratuara tre vjecare 2020-2022, Ministria e Kulturës hoqi nga plani afatmesëm projektin e investimit të Muzeut Historik Kombëtar dhe vendosi në PBA e viteve 2020-2022 planifikimin e investimit për “Restaurimin, Rikonstruksionin e Galerisë Kombetare të Arteve” me argumentin që vlera për këtë investim prej 1,366,280,000 lekë ishte relativisht më e ulët se ajo për Muzeun, konkretisht sipas tabelës më poshtë :

në lekë

Emertimi i projektit te investimit	Parashikimi per v.2019	Parashikimi per v.2020	Parashikimi per v.2021



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapsirave ne Muzeun e Arteve te bukra (Galerisë Kombetare të Arteve)	271,280,000	492,500,000	492,500,000

Përsa më lart, për diferencën e mbetur pa u mbuluar me tavanet e miratuara 2020-2022, janë kërkuar fonde shtesë prej 110,000,000 lekë. Vëmë re se në total vlera e projektit është 1,336,289 mijë lekë për të cilat janë parashikuar për të tre vitet e njëpasnjëshëm në PBA-së. Nisja e investimeve (madje likuiduar fondet e projektit) dhe më pas ndërprerja e tyre për tu zëvendësuar me të tjera projekte, tregon për planifikimi të pa sakta, jo të shëndosha dhe që rrezikojnë të mbartin pasojat më efekt menaxhim jo efektiv të fondeve të buxhetit të shtetit.

b. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Nga auditimi rezultoi se MK ka kryer rialokime fondesh mes njësive shpenzuese në SIFQ, pas datës 15.11.2018, në kundërshtim me sa parashikon neni 48, I ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar, ku parashikohet se e drejta e njësive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të cdo viti buxhetor. Kështu nga auditimi rezultoi se, janë bërë rialokimet e mëposhtme, kunë përfundim:

- është kredituar llogaria e Aparatit me total prej 2,061 mijë lekë me debitime njësive të varësisë, si dhe
- kredituar llogaria e MHK për 230 mijë lekë dhe debituar njësi varësie, si vijon:

Njesia	SIFQ 5882351 dt 22.11.18
Instituti i Monumenteve te Kultures	(70,000)
DRKK Berat	(80,000)
DRKK Korçe	(80,000)
Muzeu Historik Kombetar	230,000
Total	-

Njesia	SIFQ 5883293 dt 26.11.18
Parku Kombetar Bylis	(410,000)
Agjensia Sherbimit Arkeologjik	(260,000)
Aparati MK	670,000
Total	-

Njesia	SIFQ 5899293 dt 26.12.2018
DRKK Dures	(485,000)
Aparati MK	485,000
Total	-



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Njesia	SIFQ 5888297 07.12.18
Biblioteka Kombetare	(257,000)
Aparati MK	257,000
Qendra Muzeumeve Berat	(150,000)
Muzeu Gjethi	(112,600)
Aparati MK	262,600
Total	-

Njesia	SIFQ 5891292 dt 18.12.18
DRKK Berat	(213,366)
DRKK Shkoder	(50,000)
Agjensia Sherbimit Arkeologjik	(280,000)
Aparati MK	543,366
Total	-

Njesia	SIFQ 5897293 20.12.18
Teatri Komb. Eksperimental "K.Spahivogli"	600,000
Aparati MK	(600,000)
Q K V Folklorike	(100,000)
Aparati MK	100,000
Total	-

c. Realizimi i planit të buxhetit.

Më poshtë prezantojmë **realizimin e buxhetit për 12-mujorin e vitit 2018** referuar Planit Përfundimtar të vitit 2018, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë:

në 000/lekë

Nr.	Programet	Plani 12 mujorit 2018		Realizimi 12 mujorit 2018		Realizimi ne (%) i buxhetit vjetor ndaj Planit përfundimtar te vitit 2018
		Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
1	Planifikim, Menaxhim, Administrim	158,678	6.95%	157,307	6.97%	99.14%
2	Trashëgimia Kulturore dhe Muzete	658,676	28.86%	650,356	28.81%	98.74%
3	Arti dhe Kultura	1,464,798	64.18%	1,449,824	64.22%	98.98%
	Totali	2,282,152	100%	2,257,487	100%	98.92%

Siç vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se buxheti në total është realizuar në masën 2,257,487 mijë lekë (ose rreth 98.92 % ndaj planit të 12-mujorit 2018). Referuar planit vjetor rreth 64.18 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Arti dhe Kultura” në vlerën 1,464,798 mijë lekë, nga të cilat realizuar 1,449,824 mij lekë (ose realizuar 98,98% ndaj planit përfundimtar).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Programi "Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë" shpenzimet e të cilit zënë rreth 28.86 % , në vlerën 658,676 mijë lekë, janë realizuar në masën 98.74 % (ose 650,356 mijë lekë)

Programi “Planifikim, Menaxhim, Administrim” zë rreth 6.95% të planit të shpenzimeve ose 158,678 mijë lekë, nga të cilat realizuar 157,307 mijë lekë (ose 99,14%).

Pra siç shikohet nga tabela në krahasim me ligjin fillestar plani ka ndryshuar në tre programet.

- Ndryshimet përfaqësojnë ndryshimet e planit të buxhetit nga akordimi i Fondit të Veçantë, ndryshimet në zbatim të VKM si dhe Aktit Normativ nr. 1 dt 26.7.2018 dhe nr 2 të vitit 2018.

Gjithashtu realizimi i buxhetit për vitin 2018 është parë edhe sipas zërave ekonomike nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

në 000/lekë

Gr.	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2018		Realizimi 12 mujorit 2018		Realizimi në (%) i buxhetit vjetor ndaj Planit perfundimtar të vitit 2018
			Në mijë lekë	Struktura në %	Në mijë lekë	Struktura në %	
12	600-601	Shpenzime Personeli	901,139	39.49%	892,257	39.52%	99.01%
12	602-606	Shpenzime Korrente	528,013	23.14%	513,434	22.74%	97.24%
12	230-231	Shpenzime Kapitale	853,000	37.38%	851,796	37.73%	99.86%
	Totali		2,282,152	100%	2,257,487	100%	98.92%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se buxheti është realizuar në masën 98.92 % ndaj planit për 12-mujorin e 2018.

Shpenzimet e personelit të cilat zënë rreth 39,52% të totalit të shpenzimeve në MK, janë realizuar në masën 99.01% ose 892,257 mijë lekë.

Shpenzimet korrente që zënë rreth 22.74% , janë realizuar në masën 513,434 mijë lekë ose 97.24%; ndërsa shpenzimet kapitale me peshë specifike prej 37.73% janë realizuar në masën 99,86% ose 851,796 mijë lekë.

Program et	Shpenzime korrente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	Ministria	Thesari	Dif. TH-M	Ministria	Thesari	Dif. TH-M	Ministria	Thesari	Dif. TH-M
Plan. Menaxh. Admin	157 307	157 307	-			-	157 307	157 307	-
	457 744	457 744	-	192 612	192 612	-	650 356	650 356	-



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Trashëgimia Kulturore									
Arti dhe Kultura	790 640	790 640	-	659 184	659 184	-	1 449 824	1 449 824	-
TOTAL MINISTRIA	1 405 691	1 405 691	-	851 796	851 796	-	2 257 487	2 257 487	-

Sipas Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë dhe sipas raportimit të bërë nga Ministria shpenzimet e realizuara nga të ardhurat jashtë limitit janë realizuar në masën 59 774 mijë lekë, referuar edhe raportit të vlerësimit të performancës nga Ministria e Financave, si më poshtë:

Shpenzimet korrente më të detajuara, janë realizuar përkatësisht si më poshtë:

- Artikulli 602 është realizuar në masën 98.6 %, fond që është përdorur kryesisht për realizimin e shërbimeve të domosdoshme nga ana e institucioneve të MK, si shpenzime të ruajtjes dhe sigurisë për institucionet e artit dhe trashëgimisë, shpenzime të mirmbajtjes, shpenzime (udhetime dhe dieta) për përballimin e lëvizjeve të specialistve të fushës në objekte që janë në kujdestari të institucioneve të MK etj.

- **Artikulli 604 është realizuar në masën 96 %.** Mosrealizimi i këtij zëri në masën e 10,000 mijë lekë ka ardhur si rezultat i mos përdorimit të plotë të fondit të dhënë me VKM nr.186 datë 29.03.18 "Për një shtesë fondisi viti mbarëkombëtar i Gjergj Kastriot Skë nderbeut",

- Artikulli 605, fond që është përdorur për pagesën e kuotizacioneve në bazë të marrëveshjeve që ka MK me organizata ndërkombëtare, si Creative Europe, Europa Citezen, Traduci etj.

Përsa i takon investimeve për vitin 2018, Ministria e Kulturës është përqëndruar përkatësisht në këto projekte:

1-Projekti Teatri i ri Turbina, me dy skena, dhe platforma multi funksionale arti, i cili filloi në vitin 2016 dhe përfundoi në vitin 2018.

2-Rikonstruksioni i Teatrit të Operës dhe Baletit, në proces.

Projekti ka startuar në vitin 2017 dhe vijon punimet edhe për vitin 2019. Nga vlera totale e këtij investimi u realizua deri në fund të vitit 2018 rreth 49 % e vlerës së projektit. Me qëllim që finalizimi i rikonstruksionit të godinës së TKOB të përfundonte në vitin 2019 por njëkohësisht të vijohet edhe me blerjen e pajisjeve të kësaj godine, MK-së, me Aktin Normativ nr.2 dt 19.12.2018, iu shtua një fond prej 210,000 mijë lekë, me qëllim lirim të fondeve të planifikuara për vitin 2019 për blerjen e pajisjeve të TKOB.

3-Hartimi i Projektit për Rikonstruksionine Muzeut Historik Kombëtar.

Projekt i përfunduar me sukses në vitin 2018 por diferenca e mbetur prej 5,000 mijë lekë është planifikuar të likujdohet me buxhetin e vitit 2019.

4-Hartimi i Projektit për Galerinë e Arteve ka përfunduar brenda vitit 2018.

5-Investime në fushën e trashëgimisë kulturore si nderhyrjet në 9 objekte si kisha, muze dhe banesa, projekte të cilat kanë përfunduar dhe janë realizuar rreth 100%.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Për programin “Planifikim Menaxhim Administrim”. Realizimi i produkteve nga përdorimi i fondeve të planifikuara për këtë program është realizuar qëllimi dhe janë realizuar objektivat e politikës së tij. Kështu janë realizuar produktet performanca e të cilave paraqitet si më poshtë:

- “Miratimi i legjislacionit dhe akteve ligjore në zbatim të tij” që matet me numrin e akteve të miratuara, është realizuar plotësisht sipas nivelit të planit të rishikuar për vitin 2018. Vëmë re që gjatë vitit ka pasur një rivlerësim të planit të produkteve si nga ana sasiore ashtu edhe për sa i përket shpenzimeve, duke reflektuar kështu ndryshimet që janë bërë në planin e shpenzimeve me AN nr. 1 në Korrik 2018.
- “Zgjidhje e konflikteve me të tretët dhe shmangie e detyrimeve të prapambetura”, që matet me numrin e vendimeve gjyqësore të shlyera, vërejmë që gjatë vitit 2018, Ministria e Kulturës ka mirëadministruar fondet e akorduara në ligjin e buxhetit, duke likuiduar 80% nga vlera totale e detyrimeve të prapambetura.
- “Zbatimi i legjislacionit në fuqi për aparatin e MK dhe institucionet e varësisë” që matet me numrin e auditimeve të kryera, është realizuar në masën 100% kundrejt planit vjetor.
- “Marrëveshje bilaterale të nënshkruara dhe aplikime për thithje fondesh në programe komunitare”, që matet me numrin e marrëveshjeve të nënshkruara, është realizuar në masën 100% kundrejt planit vjetor.
- “Administrata funksionale” është realizuar në masën 100% të nivelit të planifikuar të rishikuar vjetor.

Për fondet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

në 000/leke

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2018		Realizimi 12 mujorit 2018		Realizimi në (%) i buxhetit vjetor ndaj Planit perfundimtar te vitit 2018
				Ne mije leke	Strukturuara ne %	Ne mije leke	Strukturuara ne %	
12	01110	600-601	Shpenzime Personeli	90,276	56.89%	89,780	57.07%	99.45%
12	01110	602-606	Shpenzime Korrente	68,402	43.11%	67,527	42.93%	98.72%
12	01110	230-231	Shpenzime Kapitale	-	0.00%	-	0.00%	
		Totali		158,678	100%	157,307	100%	99.14%

Për sa i përket **Produktit G** “Miratimi i legjislacionit dhe akteve ligjore në zbatim të tij” është realizuar pothuajse plotësisht sipas planit të ndryshuar për 12-mujorin e 2018. Gjatë vitit 2018 një nga objektivat kryesor për MK ka qënë:

-Realizimi i Planit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2018, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.37, datë 24.1.2018 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik, të projektakteve”

Në total ishin parashikuar për tu miratuar në Këshillin e Ministrave 20 akte. Nga këto akte, 4 janë miratuar në Këshillin e Ministrave ndërsa 16 akte në fazë hartimi dhe/ose bashkërendimi me strukturat përkatëse të Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të linjës



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Produkti H “Administratë Funksionale” është realizuar në masën 100 % referuar planit të ndryshuar për 12-mujorin e 2018. Një tjetër objektivi i këtij viti ka qënë dhe ngritja e kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese për stafin e MK me qëllim përmbushjen me cilësi të detyrave funksionale. Në këtë aspekt stafi i MK-së, përgjatë vitit 2018 ka realizuar në total një numër prej 22 trajnimesh.

Për **Produktin I** “Zgjidhje e konflikteve me të tretët dhe shmangie e detyrimeve të prapambetura”, gjatë 12-mujorit të vitit 2018 janë krijuar detyrime kryesisht si rezultat i vendimeve gjyqësore të formës së prerë

Për **Produktin J** “Zbatim të legjislacionit në fuqi për aparatin e MK dhe institucionet e varësisë”, në planin vjetor të ndryshuar, Sektori i Auditit të Brëndshëm, kishte planifikuar 11 misione auditimi me bazë sistemi të cilat janë realizuar në masën 100% bazuar në procedurat e auditimit të rregulluara në aktet në fuqi si dhe në praktikat më të mira të fushës, me qëllim garantimin e një efëçence sa më të lartë. Sipas auditimeve me bazë sistemi për vitin 2018, janë dhënë gjithsej 50 rekomandime kryesisht për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të organizimit të kontrollit të brendshëm, të cilat janë pranuar nga titullarët e institucioneve dhe i janë përcaktuar dhe afatet e realizimit të tyre. Vlen për tu theksuar se për vitin 2018 nuk janë evidentuar gjetje me dëm ekonomik si dhe nuk ka patur çështje të dërguara për investigim financiar.

Ndërsa për **Produktin K** “Marrëveshje bilaterale të nënshkruara dhe aplikime për thithje fondesh në programet komunitare”, Ministria Kulturës në vitin 2018 ka nënshkruar pesë marrëveshje konkretisht:

1. Marrëveshje bashkëpunimi me Rajonin e Pulias për konkretizimin e projektit “Shokë dhe engjej-Drejt Oficinave të Kulturës”, në kuadër të financimit të Parkut të Artit nënshkruar me datë 06.03.2018.
2. Protokolli i bashkëpunimit bazuar në “Deklaratën e përbashkët për bashkëpunim dhe partneritetin strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës”, e datës 11 janar 2014, lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, nënshkruar me datë 18.06.2018.
3. Program bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës së Malit të Zi për periudhën 2018-2020, nënshkruar me datë 03.07.2018
4. Marrëveshje për ngritjen e qëndrës kulturore Kineze në Shqipëri, nënshkruar me datë 05.11.2018
5. Marrëveshje me Palazzo Spinnelli në Firenze, nënshkruar në shtator 2018

Në programin “**Trashëgimia Kulturore**” është realizuar promovimi, ruajtja, konservimi, restaurimi i objekteve dhe fondeve muzeore si dhe edukimi përmes trashëgimisë dhe aktiviteteve në funksion të saj. Këto objektiva gjatë vitit 2018 janë arritur nëpërmjet realizimit të produkteve si më poshtë:

“Objekte të restauruara dhe të mirëmbajtura”, me një kosto faktike prej 400 milion lekë, ku:

U mundësua restaurimi i 10 objekteve, monumente kulture si dhe hartimi i projektit për Restaurimin dhe Riformulimin e linjës muzeore në Muzeun Historik Kombëtar –Tiranë, projekti i Restaurimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

dhe rehabilitimit i hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve, si dhe blerje pajisjesh kompjuterike për të plotësuar me të gjithë aksesoret e nevojshëm, biletaritë në disa muze apo monumente kulture të vizitueshëm me biletë.

Ka përfunduar puna për resaturimin e Kishës së Shën Mërisë në Ristoz, Korçë, Faza e III-të, të Kishës së Shën Mërisë Peshkëpi e Sipërme-Gjirokastrë, restaurim Kisha e “Shën Apostujve” Hoshtevë, Zagori, Restaurim i kishës së Shën Nikollit-Lezhë Kisha e Shën Thanasit, Muzeu Etnografik, Kalaja e Shkodrës, Kalaja e Lezhës, Kishat e Voskopojës dhe Kishat e Vithkuqit, Muzeu Arkeologjik, etj.

“Muze parqe të mirëmbajtura ” me një kosto faktike prej 190.2 milion lekë, ku:

- ✓ Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”, përveç performancës lidhur me vizitueshmërinë, ka realizuar dhe aktivitete të tjera me qëllim publikime të objekteve të trashëgimisë kulturore, si: janë organizuar ekspozita e konferenca si ekspozita “Urtësi sot e mot”, ekspozita e fotografit Angjelin Nënshati, “Dëshmitar midis dy kohëve, ekspozita e autores italiane Moira Ricci etj.
- ✓ Muzeu Historik Kombëtar, gjatë vitit 2018, ka realizuar një sërë veprimtarish me karakter promovues, edukues në të gjithë pavionet e këtij muzeu si dhe restaurimi i një sërë objekteve të trashëgimisë kulturore pjesë e fondit të muzeut si dhe përfundimi i katalogut “Thesare nga Muzeu Historik Kombëtar”. Në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut janë kryer një sërë vizitash dhe aktivitete nga nxënësit e shkollave 9-vjeçare të qytetit, si dhe ekspozita lidhur me figurën e Heroit Kombëtar dhe epokës së lavdishme të tij.
- ✓ Muzeu kombëtar “Gjethi” është fokusuar në objektivat kryesore për promovimin e vlerave historiko-kulturore që mbart ky institucion, si dhe pritjen e vizitorëve, me qëllim njohjen dhe ndërgjegjësimin e brezit të ri mbi të kaluarën komuniste.
- ✓ Janë zhvilluar aktivitete në përkujtim të figurave të shquara dhe ngjarjeve të rëndësishme historiko-kulturore të krahinës së Korçës dhe të Shqipërisë në Muzeun e Arsimit Korçë.
- ✓ Realizimi i aktiviteteve me karakter promovues, edukues në Qendrën Kombëtare të Muzeumeve Berat, në muzetë kombëtare “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” dhe Etnografik, Krujë, Muzeu Pavarësia Vlorë.
- ✓ Realizimi i punimeve restauruese të parqeve të Butrintit dhe Apolonisë.

“Aktivitete, veprimtari kulturore”, me një kosto faktike prej 43 milion lekë. Gjatë vitit 2018 janë organizuar një seri veprimtarish lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të ekspozuara ose të sjellë pranë publikut apo dhe të ekspozuara në ambientet e Ministrisë së Kulturës si:

- ✓ Projekte me thirrje si “Traditë Art Kulturë”, projekti “, Festivali Ndërkombëtar Folklorik “Aulona Inter Folk Festival” në Vlorë, festivali i 15-të Mbarëkombëtar i Instrumentistëve të vegjël popullorë zhvilluar në Fushë Arrëz, projekti “Java e Ali Pashës”.
- ✓ Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Popullore Qytetare, realizuar në Elbasan më 9-10 mars.
- ✓ Projekti i Festivalit Përmeti Multikulturor 2018, u organizua në qytetin e Përmetit në datat 21-22-23 Qershor 2018. Në këtë festival morën pjesë 9 grupe me 140 artistë pjesëmarrës nga të cilët 15 fëmijë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

- ✓ U organizua Festivali i 15-të Mbarëkombëtar i Instrumentistëve të vegjël popullorë në qytetin e Fushë Arrëzit në datat 18, 19, 20 maj, zhvilluar nga Shoqata Eko-Turistike, Pukë. Morën pjesë 140 artistë të vegjël nga të gjithë trevat shqiptolëse.
- ✓ Projekti “Java e Ali Pashës”, zhvilluar në Tepelenë në datat 25-28 Maj , ku morën pjesë 100 artistë nga të cilët 25 fëmijë.
- ✓ Realizimi i Ekspozitës me koleksionet e znj. Patricia Nugee, në Muzeun Historik Kombëtar me rastin e “Vitet Mbarëkombëtar të Gj.K. Skënderbeut”
- ✓ Aktivitete në kuadër të programit “Miku i Monumentit”, janë zhvilluar nga Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale.

“Objekte të inventarizuara”, me një kosto faktike prej 10.5 milion lekë. Gjatë vitit 2018 rezultojnë të regjistruara në Bazën e të dhënave shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore gjithsej 77,192 objekte.

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

në 000/lekë

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2018		Realizimi 12 mujorit 2018		Realizimi në (%) i buxhetit vjetor ndaj Planit përfundimtar të vitit 2018
				Në mije leke	Strukturuara në %	Në mije leke	Strukturuara në %	
12	08220	600-601	Shpenzime Personeli	290,341	44.08%	285,760	43.94%	98.42%
12	08220	602-606	Shpenzime Korrente	175,335	26.62%	171,984	26.44%	98.09%
12	08220	230-231	Shpenzime Kapitale	193,000	29.30%	192,612	29.62%	99.80%
		Totali		658,676	100%	650,356	100%	98.74%

Sipas tabelës vëmë re se buxheti është realizuar në masën 98.74 % ndaj planit të 12-mujorit 2018. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 44.08 % të totalit dhe janë realizuar në 98.42 % ndaj planit të 12-mujorit 2018. Shpenzimet korrente zënë rreth 26.62 % të totalit dhe janë realizuar në masën 98.09 % ndaj planit të 12-mujorit 2018. Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 29.30 % të totalit dhe janë realizuar në masën prej 99.80 % ndaj planit të 12- mujorit 2018. Detajimi i fondeve pr këtë program sa i takon llogarisë 230-231 detajohet si vijon:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Emërtimi i projektit	Plani	Realizimi
Muzealizimi Muzeut Gjethi	4,501	4,501
TVSH - Rehabilitimi i Manastirit të Shën Mërisë për përdorim muzeal dhe rrethinat e sitit arkeologjik të Apolonisë	5,845	5,845
Blerje Pajisje, Aparati MK	1,254	1,254
Projekti i Restaurimit dhe Rifolmulimi i linjës muzeore në Muzeun Historik Kombëtar-Tiranë	35,000	35,000
Projekti i Restaurimit dhe rehabilitimit i hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve	14,800	8,928
Restaurim “Banesa Vëllezërve Frashëri”	5,994	5,991
Restaurim “Muzeu i Sinjës” - Dibër	1,484	1,484
Restaurimi i Kishës së Ristozit Mborje Korçë, faza III	3,896	3,891
Restaurimi Kisha Shën Mërisë Peshkëpi e Sipërme-Gjirokastrë	24,127	24,114
Restaurimi me objekt Kisha e Shën Apostujve, Hoshteve -Zagori	19,199	19,195
Restaurim i Kishës së Shën Nikollit (vend varrimi i Skënderbeut) - Lezhë	33,241	33,241
Restaurim me objekt Kisha e Shën Thanasit-Leshnicë-Sarandë	10,113	10,046
Restaurim Kisha Manastirit të Shën Merise Mesopotam Faza I - Sarandë	24,127	24,114
Restaurim me objekt Ura e Kollorçës, 4 km në juglindje të Gjirokastrës, Lazarat	4,980	4,980
Restaurim Ura Nivanit, Nivan-Ndëran, Zagori, Gjirokastrë	2,356	2,356
Blerje pajisje, Muzeu Kombëtar i artit Mesjetar Korçë,	239	156
Blerje pajisje, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë Vlore	111	110
Blerje pajisje, Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Gjethi”	111	107
Blerje pajisje, DRKK Durres	222	149
Blerje pajisje, Qendra Muzeumeve Berat	17	17
Blerje pajisje, DRKK Gjirokastrë	17	17
Blerje pajisje, Parku Kombëtar Apoloni	17	17
Blerje pajisje, DRKK Vlore	111	111
Regjistrimi i pasurive kulturore kombëtare në qendrën e regjistrimit fizik on-line	1,164	1,164
TOTALI	193,000	186,660

3.Programi ”ART DHE KULTURA”

Në programin “**Arti dhe Kultura**” janë realizuar projekte artistike kulturore të cilët kanë siguruar gjithëpërfshirje në jetën social kulturore, në veçanti ato projekte të cilat kanë në fokus krijimtarinë artistike, edukimin dhe zhvillimin e audiencave si dhe integrimin gjinor. Ky objektivi është arritur nëpërmjet realizimit të produkteve, si më poshtë:

- ✓ “Investime të reja në skenat bashkëkohore” me një kosto faktike prej 659 milion lekë. Ka përfunduar dhe është inauguruar Teatri i ri Turbina, me dy skena dhe platforma multifunksionale arti, si edhe është në proces Rikonstruksioni i Teatrit të Operës dhe Baletit.
- ✓ Veprimtari të realizuara me fondet e programit art kulturë sipas prioriteteve dhe integritetit gjinor” me një kosto faktike prej 108.2 milion lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

- ✓ Aktivitete artistike të realizuara në 9 institucionet qendrore të Artit dhe Kulturës me një kosto faktike prej 364 milion lekë

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

Në mijë lekë

Gr.	Program i	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2018		Realizimi 12 mujorit 2018		Realizimi në (%) i buxhetit vjetor ndaj Planit perfundimtar te vitit 2018
				Në mijë lekë	Strukturuara në %	Në mijë lekë	Strukturuara në %	
12	08230	600-601	Shpenzime Personeli	520,522	35.54%	516,717	35.64%	99.27%
12	08230	602-606	Shpenzime Korrente	284,276	19.41%	273,923	18.89%	96.36%
12	08230	230-231	Shpenzime Kapitale	660,000	45.06%	659,184	45.47%	99.88%
		Totali		1,464,798	100%	1,449,824	100%	98.98%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 98.98% ndaj planit për 12-mujorin e 2018. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 35.54 % të totalit dhe janë realizuar në masën 99.27 % ndaj planit për 12 mujorin e 2018. Shpenzimet korrente zënë rreth 19.41 % të totalit dhe janë realizuar në masën 96.36 % ndaj planit për 12 mujorin e 2018. Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 45.06 % të totalit dhe janë realizuar në masën 99.88 % ndaj planit për 12 mujorin e 2018.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në katër produkte si vijon:

Produktin (A): Investime të reja të skenave teatrore bashkëkohore Në lidhje me Investimet dhe ndërtime të reja të skenave bashkëkohore, rikonstruksione infrastrukturore në nivel qendror dhe vendor në institucionet e artit dhe kulturës si dhe hapësira të reja rikualifikimi;

- Teatri i ri Turbina, me dy skena, dhe platforma multi funksionale arti (Inauguruar 2018)

- Rikonstruksioni i Teatrit të Operës dhe Baletit, në proces.

Produkti (B): Veprimtari të realizuara me institucionet e art-kulturës. Në institucionet e artit janë zhvilluar aktivitete të shumta artistike, në gjinitë dhe fushat respektive. Institucionet e artit, përveç kalendarit sezonal të miratuar me Bord Artistik, kanë bashkëpunuar disa eventeve në partneritet ndërinstitutional, Ambasada, Institucione homologe, etj.

Produkti (C): Veprimtari të realizuara me fondet e programit art-kulture. Në qendër të këtij produkti është zhvillimi i platformave dhe modeleve të reja kulturore për zhvillimin e skenës së pavarur dhe nismave të brendshme të veçanta, duke përzgjedhur dhe propozuar politika dhe mekanizma favorizuese që kanë në fokus promovimin e industrive kulturore. Ky produkt vjen si rezultat i mbështetjes së projekteve në dy drejtime:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Projekte me thirrje: Për vitin 2018 janë vlerësuar dhe mbështetur nga një Kolegjim i posaçëm në MK, rreth 82 projekte fituese nga Ministria e Kulturës, mes 300 projekteve konkurruese në vlerën Total 45.000.000 lekë; dhe

Projekte të Brendshme: Drejtoria, ka udhëhequr dhe ka hartuar rreth 40 praktika - projekte të posaçme në kuadër të kalendarëve dhe bashkëpunimit kulturor në nivel institucional dhe ndërinstytucional

Produkt D : Përfaqësime në programe dhe evenimente ndërkombëtare., ku Drejtoria mban marrëdhënie periodike me institucionet dhe subjektet ndërkombëtare ku prezantohet arti shqiptar dhe artisti shqiptar (si psh. Bienale e Venecias, Bienalja e Mesdheut, Rezidenca Artistësh etj), si dhe krijon kontakte të reja dhe propozon hapësira kulturore dhe artistike që mund të prezantohen në të ardhmen;

VITI 2019

Ministria e Kulturës, në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2019 ka hartuar, programuar dhe zhvilluar politikat kombëtare të kulturës, të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritetit kulturor në familjen evropiane dhe botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Programet për të cilat kjo ministri ka administruar fondet për 8 mujorin e vitit 2019 janë:

1. Programi “Planifikim Menaxhim Administrim”
2. Programi “Trashëgimia Kulturore”
3. Programi “Arti dhe Kultura”

Për vitin 2019 detajimi i buxhetit është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë.

Buxheti i akorduar në fillim të vitit 2019 ka pësuar ndryshime gjatë vitit si rezultat i përfitimit të fondeve buxhetore nga VKM, nëpërmjet rishpërndarjeve të fondeve dhe Akteve Normative sipas tabelës më poshtë:

në 000/lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Programet	Artikulli	Buxheti Fillestar	Fondi I Vecante	Shtesa referuar ligjit 8097 dt 21.03.1996	Shtesa me VKM	Shtesa/Pakesi me nga Akti Normativ	Transferime	Plani me ndryshime
Planifikimi, Menaxhim dhe Administrim	Shpenzime personeli	115,276	-	-	-	-	(11,000)	104,276
	Shpenzime korrente	45,000	600	54	-	-	11,000	56,654
	Shpenzime Kapitale	-	-	-	-	-	-	-
	Totali	160,276	600	54	-	-	-	160,930
Trashëgimia dhe Muzete	Shpenzime personeli	298,924	-	-	-	-	(7,402)	291,522
	Shpenzime korrente	218,267	1,300	-	15,120	1,146	7,402	243,235
	Shpenzime Kapitale	5,000	-	-	30,000	30,000	-	65,000
	Totali	522,191	1,300	-	45,120	31,146	-	599,757
Arti dhe Kultura	Shpenzime personeli	546,800	-	-	-	-	(37,841)	508,959
	Shpenzime korrente	236,600	1,600	-	10,000	-	37,841	286,041
	Shpenzime Kapitale	700,000	-	-	-	20,000	-	720,000
	Totali	1,483,400	1,600	-	10,000	20,000	-	1,515,000
TAVANET MK	Shpenzime personeli	961,000	-	-	-	-	(56,243)	904,757
	Shpenzime korrente	499,867	3,500	54	25,120	1,146	56,243	585,930
	Shpenzime Kapitale	705,000	-	-	30,000	50,000	-	785,000
	Totali	2,165,867	3,500	54	55,120	51,146	-	2,275,687

Buxheti ka pësuar këto ndryshime referuar programeve të MK:

1. Programi Planifikim, Menaxhim dhe Administrim

Shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 600 mijë lekë nga fondi i veçantë dhe 54 mijë lekë referuar ligjit nr.8097 datë 21.03.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, i ndryshuar.

Gjithashtu shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 11,000 mijë lekë nga krijimi i fondeve të lira si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante nga DAP për aparatën e MK, me qëllim përdorimin e tyre për mbulimin shpenzimeve administrative dhe për shlyerjen vendimesh gjyqësore etj.

2. Programi Trashëgimia dhe Muzetë

Për këtë program, shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 1.300 mijë lekë nga fondi i veçantë, në vlerën prej 15,120 mijë lekë nëpërmjet VKM nr.678 datë 16.10.2019 “Për një shtesë fondesh, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, për financimin e aktiviteteve që do të organizohen me rastin e 75-vjetorit të Çlirimit të vendit”, si dhe në vlerën prej 1,146 mijë lekë nga Akti Normativ nr.2 datë 02.10.2019 për përballimin e shpenzimeve të 100-të vjetorit të parlamentarizmit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Gjithashtu këto shpenzime u shtuan në vlerën prej 7,402 mijë lekë nga krijimi i fondeve të lira si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante në institucionet e varësisë, për mbulimin e shpenzimeve administrative për institucionet e varësisë si dhe për realizimin e projekteve me qëllim përmbushjen e prioritetëve të sistemit të Kulturës.

Përsa i përket shpenzimeve kapitale, u shtuan në vlerën prej 30,000 mijë lekë nëpërmjet VKM nr.496 datë 16.07.2019 "Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e 2019 për caktimin e organit përgjegjës për përdorimin e fondeve të mbledhura nga donator të ndryshëm për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti për Restaurimin e Muzeut “Mësonjëtorja e Parë Shqipe”. Ndërsa me Aktin Normativ nr.2 datë 02.10.2019, Ministrisë së Kulturës iu shtua tavani prej 30,000 mijë lekë përdorimin e financimit të huaj në vitin 2019.

3.Programi Arti dhe Kultura

Shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 1.600 mijë lekë nga fondi i veçantë, në vlerën prej 10,000 mijë lekë nëpërmjet VKM nr.678 datë 16.10.2019 *”Për një shtesë fondesh, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, për financimin e aktiviteteve që do të organizohen me rastin e 75-vjetorit të Çlirimit të vendit”* si dhe në vlerën prej 37,841 mijë lekë nga krijimi i fondeve të lira si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante në institucionet e varësisë, për mbulimin e shpenzimeve administrative për institucionet e varësisë si dhe për realizimin e projekteve me qëllim përmbushjen e prioritetëve të sistemit të Kulturës.

Gjatë vitit 2019 krahas ndjekjes së planit me qëllim përgjigjes së nevojave të sistemit të kulturës, rëndësi të veçantë i është dhënë dhe zbatimit të buxhetit si nga Aparati i MK dhe nga institucionet e varësisë për realizimin e objektivave dhe produkteve të planifikuara për Kulturën.

Më poshtë prezantojmë realizimin e buxhetit për 12-mujorin e vitit 2019, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë:

-Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve

në 000/lekë						
Nr.	Programet	Plani 12 mujorit 2019		Realizimi 12 mujorit 2019		Realizimi në (%) ndaj Planit perfundimtar të vitit 2019
		Ne mijë leke	Struktura në %	Ne mijë leke	Struktura në %	
1	Planifikim, Menaxhim, Administrim	160,930	7.17%	147,271	6.92%	91.51%
2	Trashëgimia Kulturore dhe Muzete	569,757	25.37%	522,928	24.57%	91.78%
3	Arti dhe Kultura	1,515,000	67.46%	1,458,502	68.52%	96.27%
	Totali	2,245,687	100.0%	2,128,700	100%	94.79%



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Siç vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti në total është realizuar në masën 94.79% ndaj planit vjetor. Referuar planit vjetor rreth 67.46 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Arti dhe Kultura” buxheti i të cilit është realizuar në masën 96.27%, ndjekur nga programi "Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë" shpenzimet e të cilit zënë rreth 25.37% , të cilat janë realizuar në masën 91.78% si dhe rreth 7.17% të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Planifikim, Menaxhim, Administrim” buxheti i të cilit është realizuar në masën 91.51% .

-Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomike

në 000/lekë

Gr.	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2019		Realizimi 12 mujorit 2019		Realizimi ne (%) ndaj Planit perfundimtar te vitit 2019
			Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
12	600-601	Shpenzime Personeli	904,757	40.29%	890,932	41.85%	98.47%
12	602-606	Shpenzime Korrente	585,930	26.09%	486,103	22.84%	82.96%
12	230-231	Shpenzime Kapitale	755,000	33.62%	751,665	35.31%	99.56%
	Totali		2,245,687	100%	2,128,700	100%	94.79%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti në total është realizuar në masën 94.79% ndaj planit për 12-mujorin e 2019 nga ku:

-Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 40.29% të totalit të planifikuar dhe janë realizuar në masën 98.47% ndaj planit vjetor dhe pjesa tjetër e mosrealizimit ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante.

-Shpenzimet korrente zënë rreth 26.09% të totalit të planifikuar dhe janë realizuar në masën 82% ndaj planit vjetor nga ku përkatësisht:

Këto shpenzime janë përdorur kryesisht për realizimin e shërbimeve të domosdoshme nga ana e institucioneve të MK, si shpenzime operative (për ujë, drita, postë, telefon), shpenzime të mirmbajtjes, shpenzime (udhëtime dhe dieta) për përballimin e lëvizjeve të specialistve të fushës në objekte që janë në kujdestari të institucioneve të MK, për pagesën e projekteve artistike, për pagesën e kuotizacioneve në bazë të marrëveshjeve që ka MK me organizata ndërkombëtare etj. Realizimi për 12-mujorin nuk është në nivelet e pritshme si rezultat edhe situatës së krijuar nga tërmeti i 26- nëntorit.

-Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 33.62% të totalit të planifikuar dhe janë realizuar në masën 99.56% ndaj planit vjetor.

Përsa i takon investimeve për vitin 2019, Ministria e Kulturës është përqëndruar përkatësisht në këto projekte:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

1-Rikonstruksioni i Teatrit të Operës dhe Baletit, në proces

Projekt që ka startuar që në vitin 2017, ka vijuar punimet për vitin 2019 dhe me qëllim përmbushjen e prioritetëve të qeverisë pritet të mbyllet plotësisht në vitin 2020.

Nga vlera totale e këtij investimi prej 1,125 milion lekë, deri në fund të vitit 2019 është realizuar 995.3 milion lekë ose 88 % e vlerës së këtij projekti.

2-Blerje pajisje për Teatrin e Operës dhe Baletit

Nga vlera totale e këtij investimi prej 320.3 milion leke, deri në fund të vitit 2019 është realizuar 269.3 milion lekë ose 84% e vlerës së këtij projekti dhe pjesa e mbetur është planifikuar të mbyllet në vitin 2020.

3-Hartimi i Projektit për Rikonstruksionin e Muzeut Historik Kombëtar

Projekt me vlerë totale 40 milion lekë që startoi në vitin 2018 nga ku u realizua 35 milion lekë, dhe diferenca e mbetur prej 5 milion lekë u realizua në vitin 2019

4-Restaurim i Muzeut "Mësonjëtorja e parë Shqipe"

Fondi për këtë investim iu shtua Ministrisë së Kulturës me VKM nr.496 dt 16.07.2019 "Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e 2019 për caktimin e organit përgjegjës për përdorimin e fondeve të mbledhura nga donator të ndryshëm për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti " projekt i cili u finalizua plotësisht

1.Programi: “PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM”

Ky program ka për qëllim mbështetjen juridike, financiare dhe me burime njerëzore për zhvillimin e artit dhe kulturës përmes instrumentave ligjorë, institucional e financiarë si dhe objektiv krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës. Për fondet e këtij programi, konstatohet planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

në

000/lekë

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2019		Realizimi 12 mujorit 2019		Realizimi në (%) ndaj Planit perfundimtar te vitit 2019
				Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
12	01110	600-601	Shpenzime Personeli	104,276	64.80%	99,029	67.24%	94.97%
12	01110	602-606	Shpenzime Korrente	56,654	35.20%	48,242	32.76%	85.15%
12	01110	230-231	Shpenzime Kapitale					
		Totali		160,930	100.00%	147,271	100.00%	91.51%

Nga të dhënat rezulton se buxheti është realizuar në masën 91.51% ndaj planit vjetor, nga ku shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 64.80% të totalit dhe janë realizuar në masën 94.97% ndaj planit vjetor. Shpenzimet korrente zënë rreth 35.20% të totalit dhe janë realizuar në masën 85.15% ndaj planit vjetor.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në dy produkte si planifikimi dhe realizimi i të cilave, rezultojnë si më poshtë:

Për sa i përket **produktit me kod 91201AA “Akte ligjore/nënligjore të miratuara”** është kostuar duke ngarkuar shpenzimet e personelit të aparatit të MK, shpenzime të cilat realizohen me qëllim hartimin dhe miratimin e akteve të reja ligjore dhe nënligjore në përputhje me programin e qeverisë dhe detyrimeve që rrjedhin nga MSA sipas fushës së veprimtarisë së MK.

Ky produkt ishte planifikuar për 12-mujorin e vitit 2019 të realizohej në sasinë prej 57 akte referuar Programit Përgjithshëm Analitik të Projektakteve miratuar me vendimin nr.764, datë 27.12.2018. Kurse **produkti me kod 91201AB “Staf i trajnuar”** është kostuar duke ngarkuar shpenzimet operative të aparatit të MK, shpenzime të cilat justifikohen për ngritjen e kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese të stafit të MK, me qëllim përmbushjen me cilësi të detyrave funksionale për realizimin e objektivave të Sistemit të Kulturës.

2. Programi: “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË”

Programi Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë është një nga programet e Ministrisë së Kulturës i cili synon ruajtjen e integruar të tërësisë së vlerave të trashëgimisë kulturore, mbrojtjen dhe promovimin e saj si dëshmi i vlerave të trashëguara nga e kaluara, si shprehje e identitetit kombëtar dhe si pasuri e traditës kolektive.

Trashëgimia Kulturore përbëhet nga vlera materiale të luajtshme dhe të paluajtshme (dëshmi të arkitekturës, peizazhit, arkeologjisë) dhe vlera jo materiale që përbëjnë dijen dhe përvojën shpirtërore (ritet, zakonet, zejet tradicionale, folklori dhe gjuha) të krijuar dhe transmetuar nga populli përgjatë shekujve.

Ky program zbatohet nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës në Ministrinë e Kulturës si dhe nëpërmjet 20 institucioneve në varësi të saj (si Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Muzetë Kombëtarë, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, DRTK, Parqet Arkeologjike, etj.) në mbrojtjen, promovimin, edukimin dhe menaxhimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, zhvillimin e rrjetit të muzeve kombëtarë dhe lokalë, parqeve arkeologjike dhe lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit efikas dhe efektiv të burimeve financiare shtetërore dhe bashkëpunimeve me organet e qeverisjes vendore, partnerë ndërkombëtarë dhe PPP si dhe rritjen e aksesit të publikut në funksion të turizmit kulturor.

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

në 000/lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2019		Realizimi 12 mujorit 2019		Realizimi ne (%) ndaj Planit perfundimtar te vitit 2019
				Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
12	08220	600-601	Shpenzime Personeli	291,522	51.17%	286,967	54.88%	98.44%
12	08220	602-606	Shpenzime Korrente	243,235	42.69%	201,784	38.59%	82.96%
12	08220	230-231	Shpenzime Kapitale	35,000	6.14%	34,177	6.54%	97.65%
		Totali		569,757	100.00%	522,928	100.00%	91.78%

Sipas tabelës vëmë re se buxheti është realizuar në masën 91.78% ndaj planit të 12-mujorit 2019. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 51.17% të totalit dhe janë realizuar në 98.44% ndaj planit vjetor. Shpenzimet korrente zënë rreth 42.69% të totalit dhe janë realizuar në masën 82.96% ndaj vjetor. Shpenzimet kapitale zënë rreth 6.14% të totalit dhe janë realizuar në masën 97.65% ndaj planit vjetor.

3. Programi ”ART DHE KULTURA”

Ky program ka qëllim edukimin, zhvillimin dhe promovimin e skenës artistike dhe vlerave kulturore kombëtare dhe ka objektiv rritjen e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike. Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

në 000/lekë

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2019		Realizimi 12 mujorit 2019		Realizimi ne (%) ndaj Planit perfundimtar te vitit 2019
				Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
12	08230	600-601	Shpenzime Personeli	508,959	33.59%	504,936	34.62%	99.21%
12	08230	602-606	Shpenzime Korrente	286,041	18.88%	236,078	16.19%	82.53%
12	08230	230-231	Shpenzime Kapitale	720,000	47.52%	717,488	49.19%	99.65%
		Totali		1,515,000	100%	1,458,502	100%	96.27%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 96.27% ndaj planit për 12-mujorin e 2019. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 33.59% të totalit dhe janë realizuar në masën 99.21% ndaj planit vjetor 2019. Shpenzimet korrente zënë rreth



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

18.88% të totalit dhe janë realizuar në masën 82.53% ndaj planit vjetor. Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 47.52% të totalit dhe janë realizuar në masën 99.65% ndaj planit vjetor.

Fondet buxhetore janë realizuar si më poshtë:

Produkti: Investime të reja të skenave teatrore bashkëkohore

Në lidhje me Investimet dhe ndërtime të reja të skenave bashkëkohore, rikonstruksione infrastrukturore në nivel qendror dhe vendor në institucionet e artit dhe kulturës si dhe hapësira të reja rikualifikimi;

- Rikonstruksioni i Teatrit të Operës dhe Baletit, në përfundim procesi.

Produkti: Veprimtari të realizuara me institucionet e art-kulturës

Bazuar në objektivin 4 vjeçar të PBA, për rritjen e interesit të masave ndaj programeve kulturore dhe industrive krijuese duke përmirësuar shërbimet në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike, shprehemi për një trend rritës të këtyre aktiviteteve. Drejtoria, koordinon dhe përpunon të dhënat statistikore mujore, për nr. e premierave, shfaqjeve, projekteve, audiencës për këto institucione, të cilat i raporton edhe në rrugë zyrtare pranë KM dhe INSTAT.

Një tjetër sfidë dhe prioritet institucional i Ministrisë së Kulturës, ku **Kultura** nuk është vetëm një plotësim shpirtëror por një domosdoshmëri e përditshme e të rinjve dhe audiencave të gjera. Investimet kulturore po vijnë të kenë prioritet në rikualifikim dhe rikonceptim të institucioneve qendrore të artit dhe kulturës, që synojnë të ndikojnë drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së jetës dhe në edukimin e grup moshave të ndryshme. *Edukimi masiv* me art e kulturë synon ndërhyrjen në kurrikulat e shkollës nga njëra anë, duke përfshirë në çdo institucion arti linjën pedagogjike dhe edukative nga ana tjetër.

Edukimi artistiksi një nga politikat më të rëndësishme e vë theksin në vëmendjen që i duhet kushtuar kësaj politike që ndikon jo vetëm në përmirësimin e statusit të jetesës të çdo pjesëtari në komunitet, por veçanërisht edukimit cilësor nga brezi i më të vegjëlve e përgjatë gjithë edukimit arsimor, të cilët do të jenë edhe konsumatorë të produktit artistik në të ardhmen.

Në këët program menaxhohen shumë projekte të cilat për efekt të ndërprerjes së auditimit në terren si pasojë e pandemisë të COVID 19, nuk arritën të auditoheshin por do të jenë subjekt i një auditimi tjetër nga KLSH.

Konstatim 1:

Nga auditim rezultoi se është shkelur disiplina buxhetore në 4 raste të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, pasi urdhrat e prokurimit janë regjistruar në SIFQ mbi 5 ditë vonesë, në kundërshtim me:

a. nenin 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar³,

b. nenin 144 të udhëzimit nr. 2, datë 06/02/2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; si dhe

³Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që operojnë direct në SIFQ, për ekzekutimin e buxhetit të tyre dhe raportimin financiar regjistrojnë në këtë system, **Brenda 5 ditëve** pune nga data e nënshkrimit të tij, **kundrejt urdhrat të prokurimit**.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

b. paragrafin 17 të Udhëzimit nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme që përdorin Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë”⁴, ku parashikohet se:

Koncretisht rezultoi se, 4 urdhra prokurimi⁵ në shumën totale prej 2,598,194 lekë, nga të cilat 1 urdher prokurimi në shumën 817,754 lekë për vitin 2019 dhe 3 urdhra në shumën 1,780,440 lekë për vitin 2018, janë dorëzuar me vonesë në Struktura e zbatimit të buxhetit në varesi të Nepunësit Zbatues të MK-së, përtej afatit 5 ditor të parashikuar në Udhëzim, **dhe si pasojë është bërë gjithashtu me vonesë:**

- regjistrimi i tyre në SIFQ, nga struktura e zbatimit të buxhetit të varësi të NZ; si dhe
- miratimi përfundimisht i transaksionit në librin e kontabilitetit nga struktura përgjegjëse e thesarit në degë, e cila njëkohësisht inicion bllokimin e fondeve për shpenzim (regjistrimin e angazhimit në SIFQ).

⁴“Struktura e zbatimit të buxhetit në varesi të Nepunësit Zbatues të njesisë respektive **regjistrojnë menjehere në sistemin SIFQ kontratën** (referencat, vlerën totale të kontratës, vlerën e kontratës që parashikohet të likujdohet gjatë vitit korrent, grafikun e shlyerjes së kontratës, referencat e operatorit ekonomik) **ose urdhrin e prokurimit** për blerjet e vogla sipas rastit. Pas miratimit në SIFQ nga nepunësi zbatues dhe nepunësi autorizues i njesisë brenda pesë ditëve pune nga nënshkrimi i tyre, dokumentacioni fizik si me siper, paraqitet në gjuhën shqipe (në rastin e kontratave të lidhura në gjuhë të huaj) bashkë me njoftimin përditues zyrtar për shpalljen e fituesit, në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë. Nepunësi i thesarit kryen kontrollin dokumentar në prani të përfaqësuesit të njesisë dhe ben të vlefshëm përfundimisht transaksionin në librin e kontabilitetit të SIFQ. Moszbatimi i afatit të mesipërm mund të shkaktojë vonesë në likuidimin e pagesës nga sistemi i thesarit. Penalitetet kontraktuale të shkaktuara nga kjo vonesë janë në ngarkim të njesisë respektive.”

5

Kontrata	Vlera me TVSH	Nr (Urdher Prokurimi)	Data (Urdhet Prokurimi)	Data e kontrates	Data në SIFQ	Tejkaluar afati (ditë)
kontrata nr.2826/4,dt.06.05.2019,Mbikqyrje punime për objektin Blerje paisjeve të teknologjise se skenes TOB	817,754	228	26-Apr-19	06-May-19	10-May-19	9
Kontrata nr. 3602/7, dt 04.06.2018, Sherbimi I mirembajtjes se godinës së MK"	780,000	324	24-May-18	04-Jun-18	04-Sep-18	98
Kontrata nr. 2449/9, dt 10.05.2018 "Shërbimi I mirembajtjes së printerave dhe fotokopjeve të Ministrisë së Kulturës për vitin 2018"	454,680	218	11-Apr-18	10-May-18	28-Aug-18	134
Kontrata nr. 3057/6, dt 10.05.2018 "Blerje pjese kembimi per automjetet ne perdorim te MK"	545,760	284	03-May-18	10-May-18	06-Aug-18	90
Total vlera nga te cilat:	2,598,194					
Viti 2018	817,754					
Viti 2019	1,780,440					



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Konstatim 2:

Nga auditimi rezultoi shkelje e disiplinës buxhetore **për vitin 2019**, sa i takon marrjes së një angazhimi prej 199,659,817 lekë me tëpër, pa pasur fonde buxhetore në dispozicion.

Më datë 20.08.2019 është celur Thesar, angazhimi për kontratën nr. 5349, datë 31.10.2016 (në vazhdim) me “A...” shpk, për rikonstruksimin e TOB (projekti M120763) në shumën 350,000,000 lekë e ndarë në dy celje:

-Shuma 199,659,817 lekë, dhe

-Shuma 150,340,183 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Grupi i auditimit përlogariti tepricën e fondeve të angazhuara për këtë projekt, pas cdo likuidimi⁶, nga ku na rezultoi se, pas likuidimit të datës 09.07.2019 për shumën prej 50,909,699 lekë, për llogari të furnitorit, teprica e celur për projektin në fjalë, rezultoi 157,377,307 lekë. Pas kësaj, më datën **20.08.2019**, MK ka celur në SIFQ angazhimin për diferencën e kontratës prej 350,000,000 lekë në një kohë kur teprica e celur ishte 157,377,307 lekë (sa përlogaritur më lart), pra ka celur angazhimin pa pasur fonde të mjaftueshme (**celja tejkalon angazhimin me 192,622,693 lekë**).

⁶Tabela: Sido të ishte skenari nëse angazhimido të celej sipas procedurave standarde buxhetore (pa u spostuarnë PBA 2021)



Viti 2019	Rikonstrukcion TKOB	Pajisje TKOB	Tavanet	Likuidime (Rikonstrukcion)	Fonde ne dispozicion
PBA	509,437,000	190,563,000	700,000,000		509,437,000
12.02.2019				1,821,039	507,615,961
21.02.2019	(234,437,000)	234,437,000	700,000,000		273,178,961
05.03.2019				33,540,328	239,638,633
09.04.2019 (celst angazhimi)	-	(320,250,000)	700,000,000	31,918,610	207,720,023
13.05.2019				27,035,187	180,684,836
12.06.2019	103,800,000	(103,800,000)	700,000,000		284,484,836
02.07.2019				76,197,830	208,287,006
09.07.2019				50,909,699	157,377,307
20.08.2019 (celst angazhimi)	(350,000,000)	-	700,000,000		(192,622,693)
29.08.2019				95,774,431	(288,397,124)
11.09.2019					
AN nr. 2, dt 02.10.2019	200,000,000	-	900,000,000		(88,397,124)
25.10.2019	(281,900)	-	900,000,000		(88,679,024)
12.11.2019					(88,679,024)
22.11.2019				20,465,922	(109,144,946)
23.12.2019				110,554,407	(219,699,353)
AN. Nr. 11, dt 24.12.2019	(129,518,100)	(50,200,000)	720,281,900		(349,217,453)
Ndryshime	(60,437,000)	80,437,000			
Plani I ndryshuar	449,000,000	271,000,000		448,217,453	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Grupi i auditimit kërkoi informacion me të detajuar për sa më sipër, ku në përfundim rezultoi se angazhimi prej 350,000,000 lekë në fakt është celur në dy transhe si vijon:

- Shuma 150,340,183 lekë (angazhim për vitin korent pasi vetem kaq ka pasur gjendje); ndërsa
- Diferenca prej 199,659,817 lekë (350,000,000 lekë – 150,340,183 lekë), është celur me **pa të drejtësi** angazhim për vitin 2021, pa ndjekur procedurat standarte të buxhetit deri sa “është legjitimuar” me Aktin Normativ nr. 2, datë 02.10.2019, ku u miratua shtesë fondi prej 200,000,000 lekë. Ky angazhim ka qendruar në SIFQ, me statusin “i rezervuar” deri me datën 06.11.2019 dhe më pas është ç’rezervuar.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me procedurat e zbatimit të buxhetit të shtetit (miratuar kontrata pa pasur fonde buxhetore) si dhe në kundërshtim me sa dikton Udhëzimi nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për NJQP që përdorin SIFQ”, si dhe VKM nr.50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjise për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të planit të veprimit”, duke u ndërmarrë angazhime pa pasur fonde buxhetore, dhe më pas **duke u legjitimuar** sa më sipër me akte normative, sikundër ka ndodhur konkretisht me AN nr. 2 që ka plotësuar angazhimet e ndërmarra më herët.

Përfundime për vitet 2018 dhe 2019:

1- Të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit përgjithësisht janë sipas formateve të përcaktuara në paragrafin 49, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016

- Përgjithësisht janë respektuar afatet e paraqitjes së raporteve të monitorimit të përcaktuar në udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016

- Raporti i Monitorimit për vitin 2018, është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës.

- Në aneksin nr.4 “Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit”, të përcaktuar në udhëzimin e mësipërm, niveli i treguesve të performancës/produkteve nuk është plotësuar në sasi sipas njësive të tyre të matjes

2-Nga auditimi rezultoi se, përgjatë vitit 2018, për Ministrinë e Kulturës, janë çelur projekte të reja në vlerën 175,201,525 mije leke, të cilat duke u detajuar nën titullin “pa përshkrim projekti”, nuk kanë kaluar në procedurat e miratimit të investimeve publike si dhe nuk rezultojnë të jenë në listën e investimeve të miratuara në projektbuxhetin e vitit 2018⁷

3-Nga kryerja e testimeve rezultoi se, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor sipas Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” respektivisht:

⁷ Sipas VKM nr. 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve, projektet e investimeve duhet të paraqiten si pjesë përbërëse e kërkesave buxhetore, në kuadër të përgatitjes së PBA-së. NJQQ përgatisin propozimet për projektet e mëdha të investimeve, në cdo kohë dhe i paraqesin për vlerësim në Ministrinë përgjegjëse për financat, Brenda muajit dhjetor dhe jo më vonë se një muaj përpara fillimit të procesit buxhetor, sipas përcaktimit në nenin 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

-**gjatë vitit 2018**, 122 fatura, mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit, me një vlerë totale prej 31,739,503 lekë, dhe
 -**gjatë vitit 2019**, 647 fatura mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit, me njëvlerë totale prej 198,740,330 lekë,
 duke sjellë:

- a. Tejkallim të afateve që parashikon Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar, neni 52 (ku specifikohet se Nëpunësi zbatues I njësisë shpeznuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së), dhe si pasojë
- b. Duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (të prapambetura)

4- Nga auditim rezultoi se është shkelur disiplina buxhetore në 4 raste të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, pasi urdhrat e prokurimit janë regjistruar në SIFQ mbi 5 ditë vonesë, në kundërshtim me:

- a. nenin 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar⁸,
- b. nenin 144 të udhëzimit nr. 2, datë 06/02/2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; si dhe
- b. paragrafin 17 të Udhëzimit nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme që përdorin Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë”, ku parashikohet se:

Koncretisht rezultoi se, 4 urdhra prokurimi⁹ në shumën totale prej 2,598,194 lekë, nga të cilat 1 urdher prokurimi në shumën 817,754 lekë për vitin 2019 dhe 3 urdhra në shumën 1,780,440 lekë

⁸Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që operojnë direct në SIFQ, për ekzekutimin e buxhetit të tyre dhe raportimin financiar regjistrojnë në këtë system, Brenda 5 ditëve pune nga data e nënshkrimit të tij, **kundrejt urdhrat të prokurimit.**

⁹

Kontrata	Vlera me TVSH	Nr (Urdher Prokurimi)	Data (Urdhet Prokurimi)	Data e kontrates	Data në SIFQ	Tejkalluar afati (ditë)
kontrata nr.2826/4,dt.06.05.2019,Mbikqyrje punime per objektin Blerje paisjeve te teknologjise se skenes TOB	817,754	228	26-Apr-19	06-May-19	10-May-19	9
Kontrata nr. 3602/7, dt 04.06.2018, Sherbimi I mirembajtjes se godines se MK"	780,000	324	24-May-18	04-Jun-18	04-Sep-18	98
Kontrata nr. 2449/9, dt 10.05.2018 "Shërbimi I mirmbajtjes së printerave dhe fotokopjeve të Ministrisë së Kulturës për vitin 2018"	454,680	218	11-Apr-18	10-May-18	28-Aug-18	134
Kontrata nr. 3057/6, dt 10.05.2018 "Blerje pjese kembimi per automjetet ne perdorim te MK"	545,760	284	03-May-18	10-May-18	06-Aug-18	90
Total vlera nga te cilat:	2,598,194					



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

për vitin 2018, janë dorëzuar me vonesë. Struktura e zbatimit të buxhetit në varesi të Nepunësit Zbatues të MK-së, përtej afatit 5 ditor të parashikuar në Udhëzim, **dhe si pasojë është bërë gjithashtu me vonesë:**

- regjistrimi i tyre në SIFQ, nga struktura e zbatimit të buxhetit të varësi të NZ; si dhe
- miratimi përfundimisht i transaksionit në librin e kontabilitetit nga struktura përgjegjëse e thesarit në degë, e cila njëkohësisht inicion bllokimin e fondeve për shpenzim (regjistrimin e angazhimit në SIFQ).

5– Nga auditimi rezultoi shkelje e disiplinës buxhetore për vitin 2019, sa i takon marrjes së një angazhimi prej 199,659,817 lekë me tëpër, pa pasur fonde buxhetore në dispozicion.

Për sa më sipër, grupi i auditimit ka mbajtur akt konstatimin nr. 2, datë 20.03.2020, dërguar me e-mail në ardesën zyrtare të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, znj. E.C. Dërgimi me email është dakordësuar mes palëve në kushtet e pandemisë globale COVID 19.

Në përgjigje të akteve të konstatimit të KLSH-së Ministria e Kulturës ka dërguar me e-mail observacionet.

- *Për projektraportin e dërguar në MB, kanë ardhur observacionet me email-in e datës 01.06.2020, ku sa i përket rialokimit të fondeve buxhetore tej afatit ligjor subjekti obseravon sa vijon: “Krahas buxhetit modest që ka MK, cdo përpjekje për rialokim fondesh bëhet me qëllimin e mirëmenaxhimit të cdo qindarke që rezulton fond i lirë për të plotësuar ato nevojat të cilat nuk janë mundur të parashikohen më herët si dhe për rastin e gjetjes në fjalë vlen të thuhet se viti 2018 është viti i parë i aksesit të MK në Modulin SIFQ për transferimin e fondeve mes njërive shpenzuese brenda për brenda të njëjtit artikull, brenda një programi dhe si rredhojë sikurse dhe ju e keni evidentuar viti 2019 nuk ka transferime të tilla”.*

Përgjigjia e grupit të auditimit:

Grupi i auditimit vlerësoi dhe analizoi argumentat e sjella dhe gjykon se në kushtet kur raste të tilla nuk janë përsitur më gjatë vitit 2019, këto observacione të pronaohen pjesërisht sa i takon vlerësimit për marrjen e masave (veçanërisht kur zërat nuk paraqiten material), e për këtë grupi i auditimit i qëndron rekomandimit, pasi kujdesi mbi disiplinën buxhetor duhet të jetë në fokus.

- *Sa i takon observacionit mbi Marrje përsipër e angazhimeve pa pasur fonde në dispozicion, MK argumenton se: “Ministria e Kulturës për projektin “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansamblit Popullor” kishte parashikuar mbulimin e kësaj kontrate me fonde nga buxheti i shtetit dhe fonde nga financimi i huaj konkretisht Grantit Grek por pas përpjekjeve të vazhdueshme të Ministrisë së Kulturës ky fond nuk u bë aktiv nga Ambasada Greke.*

Viti 2018	817,754					
Viti 2019	1,780,440					



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Pikërisht vlera që do mbulohej nga Fondi Grek nuk ishte obliguar në MK dhe për efekt sistemi SIFQ janë bërë kto regjistrime si dhe duke marr shkas që Ministria e Kulturës në pamundësi të lëvrimit të Grantit Grek nga Ambasada Greke për të përmbyllur veprën sikurse ishte planifikuar ka kërkuar rishikim buxheti mbi projektin e TKOB”.

Përgjigjia e grupit të auditimit:

Grupi i auditimit analizoi argumentat e sjella dhe thekson se janë pikërisht këto argumenta mbi të cilat mbështetet edhe konstatimi i KLSH-së, që do të thotë se e pranojmë observacionin, por ky obseravcion nuk sjell fakte të reja që të ndryshojnë qëndrimin e grupit. Grupi i auditimit i qëndron konstatimit se ka shkelje të disiplinës buxhetore dhe se duhet treguar kujdes në rastet në vazhdim qysh në proceset e planifikimit buxhetor.

Titulli i gjetjes nr. 1	Mbi celjen e disa projekteve pa kaluar ne procedurat e investimeve publike
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, përgjatë vitit 2018, për Ministrinë e Kulturës, janë çelur projekte të reja në vlerën 175,201,525 mijë leke, të cilat duke u detajuar nën titullin “<u>pa përshkrim projekti</u>”, nuk kanë kaluar në procedurat e miratimit të investimeve publike si dhe nuk rezulton të jenë në listën e investimeve të miratuara në projektbuxhetin e vitit 2018. Konstatohet se, këto projekte, nuk janë përfshirë as në Listën e Investimeve Publike 2019-2021 si projekte investimi të miratuara me projektbuxhetin e vitit 2019, ku duhet të ishin paraqitur si projekte investimi në vazhdim. Konkretisht, rezultoi se, me shkresën nr. 7105/2, datë 18.04.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, me subjekt “Çngurtësim fondi”, është miratuar çngurtësimi I fondeve në vlerën 181.200 mijë lekë dhe duke u çelur projekte, pa iu nënshtruar procedurave të investimeve publike në programin 8220 “Trashëgimia kulturore dhe muzetë” si më poshtë: 1-Projekti me kod M120781 “Projekti i restaurimit dhe riformulimi I linjës muzeale në Muzeun Historik Kombëtar” Tiranë në vlerën 40,000 mijë lekë 2-Projekti me kod M120782 “Projekti i restaurimit dhe rehabilitimit të hapësirave ne Galerinë Kombëtare të Arteve” në vlerën 15,000 mijë lekë. 3-Projekti me kod M120783 “Ura e Kollorces 4 km në juglindje te Gjirokastrës” në vlerën 5,000 mijë lekë 4-Projekti me kod M120784 “Restaurim banesa e vëllezërve Frashri” në vlerën 6,000 mijë lekë 5- Projekti me kod M120785”Restaurim muzeu i Sinjës Dibër” në vlerën 1,500 mijë lekë 6- Projekti me kod M120786 “Restaurim Kisha e Shën Mërisë Gjirokastrë” në vlerën 22,500 mijë lekë 7- Projekti me kod M120787 “Restaurim Kisha e Shën në vlerën 20,000 mijë lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	8- Projekti me kod M120788 “Restaurim Kisha e Shën në vlerën 33,300 mijë lekë 9- Projekti me kod M120790 “Restaurim Kisha e Shën në vlerën 11,000 mijë lekë 10-Projekti me kod M120791 “Restaurim Kisha Manastiri i Shën Mërisë Faza 1- Sarandë”, në vlerën 26,900 mijë lekë.
Kriteri:	- Sipas VKM nr. 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve, projektet e investimeve duhet të paraqiten si pjesë përbërëse e kërkesave buxhetore, në kuadër të përgatitjes së PBA-së. NJQQ përgatisin propozimet për projektet e mëdha të investimeve, në cdo kohë dhe I paraqesin për vlerësim në Ministrinë përgjegjëse për financat, Brenda muajit dhjetor dhe jo më vonë se një muaj përpara fillimit të procesit buxhetor, sipas përcaktimit në nenin 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar. - Sipas Para 66, të Udhëzimit nr. 2, datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” , <i>nëse në listën e investimeve të detajuara nga njësitë e qeverisjes qendrore, <u>ka objekte të reja</u> nga lista e paraqitur në momentin e miratimit të projekt buxhetit të vitit, Nëpunësi i Parë Autorizues e përfshin në listën përfundimtare vetëm kur objekti ka kaluar në procedurat e miratimit të investimeve publike.</i> "
Ndikimi/Efekti:	Shkelje e disiplinës buxhetore
Shkaku:	Mos zbatim i procedurave ligjore
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Ministria e Kulturës të marr masa që praktika të tilla të celjes së projekteve “pa përshkrim” të mos përsëriten më në të ardhmen. Në cdo rast projektet e investimeve duhet të paraqiten si pjesë përbërëse e kërkesave buxhetore, në kuadër të përgatitjes së PBA-ve përkatëse. Institucioni duhet të përgatis propozimet për projektet e mëdha të investimeve, në cdo kohë dhe t’i paraqes ato për vlerësim, në Ministrinë përgjegjëse për financat, brenda muajit dhjetor dhe jo më vonë se një muaj përpara fillimit të procesit buxhetor.
Afati për zbatim:	Në vazhdim

Titulli i gjetjes nr. 2	Mbi tejkalimin e afatit 30 ditor të likuidimit të faturave
Situata:	Nga kryerja e testimeve në Modulin e Pagesave të SIFQ, rezultuan <u>shkelje të disiplinës buxhetore</u> sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin ligjor. Konkretisht, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, respektivisht: -gjatë vitit 2018, 122 fatura, mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit, me një vlerë totale prej 31,739,503 lekë, dhe -gjatë vitit 2019, 647 fatura mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit, me një vlerë totale prej 198,740,330 lekë, duke sjellë : a. Tejkallim të afateve që parashikon Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar, neni 52, ku specifikohet se Nëpunësi zbatues i njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së), dhe si pasojë b. Duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (të prapambetura)
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar, neni 52
Ndikimi/Efekti:	risqe për krijimin e detyrimeve të reja (të prapambetura)
Shkaku:	Shkelje e disiplinës buxhetore
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura, në cdo rast NZ duhet të paraqes në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së, dhe jo ndryshe. Për cdo rast në vijim, që do të konstatohet ndryshe, të evidentohen përgjegjësitë dhe për personat përgjegjës për shkaktimin e vonesave të aplikohen sanksionet e parashikuara në Kreun IX, neni 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar.
Afati për zbatim:	Në vazhdim

Titulli i gjetjes nr. 3	Tejkallim i afatit 5 ditor për regjistrimin e urdher prokurimeve ne SIFQ
Situata:	Nga auditim rezultoi se <u>është shkelur disiplina buxhetore</u> në 4 raste të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, pasi urdhrat e prokurimit janë regjistruar në SIFQ mbi 5 ditë vonesë, në kundërshtim me: a. nenin 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, b. nenin 144 të udhëzimit nr. 2, datë 06/02/2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; si dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	c. paragrafin 17 të Udhëzimit nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme që përdorin Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë”. Konkretisht, rezultoi se janë dorëzuar përtej afatit 5 ditor të parashikuar 4 urdhra prokurimi në shumën totale prej 2,598,194 lekë, nga të cilat: për vitin 2019, 1 urdher prokurimi në shumën 817,754 lekë; dhe për vitin 2018, 3 urdhra në shumën 1,780,440 lekë, dhe si pasojë është bërë gjithashtu me vonesë regjistrimi i tyre në SIFQ, nga struktura e zbatimit të buxhetit të varësi të NZ.
Kriteri:	a. nenin 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku parashikohet senjësitë e qeverisjes së përgjithshme, që operojnë direkt në SIFQ, për ekzekutimin e buxhetit të tyre dhe raportimin financiar regjistrojnë në këtë system, Brenda 5 ditëve pune nga data e nënshkrimit të tij, kundrejt urdhrin të prokurimit. b. neni 144 të udhëzimit nr. 2, datë 06/02/2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; si dhe c. paragrafin 17 të Udhëzimit nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme që përdorin Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë ku parashikohet se, “Struktura e zbatimit të buxhetit në varesi të Nepunësit Zbatues të njesisë respektive regjistron menjehere në sistemin SIFQ kontratën (referencat, vlerën totale të kontratës, vlerën e kontratës që parashikohet të likujdohet gjatë vitit korrent, grafikun e shlyerjes së kontratës, referencat e operatorit ekonomik) ose urdhrin e prokurimit për blerjet e vogla sipas rastit. Pas miratimit në SIFQ nga nepunësi zbatues dhe nepunësi autorizues i njesisë brenda pesë ditëve pune nga nënshkrimi i tyre, dokumentacioni fizik si me siper, paraqitet në gjuhën shqipe (në rastin e kontratave të lidhura në giuhë të huaj) bashkë me njoftimin përditues zyrtar për shpalljen e fituesit, në strukturën përgjegjëse për thesarin në dege. Nepunësi i thesarit kryen kontrollin dokumentar në prani të përfaqësuesit të njesisë dhe ben të vlefshëm përfundimisht transaksionin në librin e kontabilitetit të SIFQ. Moszbatimi i afatit të mesipër mund të shkaktojë vonesa në likuidimin e pagesës nga sistemi i thesarit. <u>Penalitetet kontraktuale të shkaktuara nga kjo vonesë janë në ngarkim të njesisë respektive.</u>”
Ndikimi/Efekti:	Shkelje e disiplinës buxhetore
Shkaku:	Mos respektim i bazël ligjore në fuqi
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Me qëllim disiplinimin e shpenzimeve buxhetore, Ministria e Kulturës si njësi qeverisjes së përgjithshme, që operon direkt në SIFQ, gjatë ekzekutimit të buxhetit dhe raportimit financiar duhet të regjistrojë në këtë sistem kontratën ose urdhrin e prokurimit (në rastet e blerjeve me vlerë të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	vogël), brenda 5 ditëve pune nga data e nënshkrimit të tij. Për cdo rast në vijim, që do të konstatohet ndryshe, të evidentohen përgjegjësitë dhe për personat përgjegjës për shkaktimin e vonesave të vlerësohen dhe në varësi të vlerësimit të aplikohen sanksionet e parashikuara në Kreun IX, neni 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar.
Afati për zbatim:	Në vazhdim

Titulli i gjetjes nr. 4	Rialokime fondesh që tejkalojnë afatin ligjor
Situata:	Nga auditimi rezultoi se MK ka kryer rialokime fondesh mes njësive shpenzuese, pas datës 15.11.2018 , në kundërshtim me sa parashikon neni 48, I ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar, ku parashikohet se e drejta e njësive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të cdo viti buxhetor. Kështu nga auditimi rezultoi se, janë bërë rialokimet e mëposhtme, ku në përfundim: - është kredituar llogaria e Aparatit me total prej 2,061 mijë lekë me debitime njësitë e varësisë, si dhe - kredituar llogaria e MHK për 230 mijë lekë dhe debituar njësi varësie,
Kriteri:	Neni 48, I ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar,
Ndikimi/Efekti:	Shkelje e disiplinës buxhetore
Shkaku:	Mos respektim i afateve ligjore
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Në kushtet kur e drejta e njësive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të cdo viti buxhetor, Ministria e Kulturës të tregojë kujdesin e duhur ndaj rialokimit të fondeve pas kësaj date, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore.
Afati për zbatim:	Në vazhdim

Titulli i gjetjes nr. 5	Marrje përsipër e angazhimeve pa pasur fonde në dispozicion
Situata:	Nga auditimi rezultoi <u>shkelje e disiplinës buxhetore për vitin 2019</u> , sa i takon marrjes së një angazhimi prej 199,659,817 lekë me tepër, nga sa miratuar fonde buxhetore në dispozicion. Konkretisht, më datë 20.08.2019 është celur në SIFQ, angazhimi për kontratën nr. 5349, datë 31.10.2016 (në vazhdim)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	me shpk, për rikonstrukcionin e TOB (projekti me kod M120763) në shumën 350,000,000 lekë. Grupi i auditimit përllogariti tepricën e fondeve të angazhuara për këtë projekt, pas cdo likuidimi, ku rezultoi se, pas likuidimit të datës 09.07.2019 për shumën prej 50,909,699 lekë, për llogari të furnitorit, teprica e celur për projektin në fjalë, ishte 157,377,307 lekë. Pas kësaj, më datën 20.08.2019, MK ka celur në SIFQ angazhimin për diferencën e kontratës prej 350,000,000 lekë në një kohë kur teprica e celur ishte 157,377,307 lekë (sa përllogaritur më lart), pra <u>celja tejkalon angazhimin me 192,622,693 lekë.</u> Grupi i auditimit kërkoi informacion me të detajuar për sa më sipër, ku në përfundim rezultoi se angazhimi prej 350,000,000 lekë në fakt është celur në dy transhe si vijon: - Transhi i parë për shumën 150,340,183 lekë¹⁰ (angazhim për vitin korent pasi vetëm kaq ka pasur gjendje); ndërsa - Transhi i dytë për diferencën prej 199,659,817 lekë (350,000,000 lekë – 150,340,183 lekë), është celur me pa të drejtë si angazhim për vitin 2021, pa ndjekur procedurat standarte të buxhetit deri sa “është legjitimuar” me Aktin Normativ nr. 2, datë 02.10.2019, ku u miratua shtesë fondi prej 200,000,000 lekë. Ky angazhim ka qëndruar në SIFQ, me statusin “i rezervuar” deri me datën 06.11.2019 dhe më pas është ç’ rezervuar. Kjo procedurë e ndjekur, është në kundërshtim me procedurat e zbatimit të buxhetit të shtetit (miratuar kontrata pa pasur fonde buxhetore) si dhe në kundërshtim me sa dikton Udhëzimi nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për NJQP që përdorin SIFQ”, si dhe VKM nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjise për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të planit të veprimit”, pasi duke u gjetur mënyra (qoftë edhe teknike) të ndërmarrjes së angazhimeve pa pasur fonde buxhetore, angazhime këto të cilat në rastin konkret janë legjitimuar më pas me akt normativ, rrezikon të vendos institucionin përpara riskut të krijimit të detyrimeve të prapambetura
Kriteri:	Udhëzimi nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për NJQP që përdorin SIFQ”, si dhe VKM nr.50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjise për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të planit të veprimit”; Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Shkelje e disiplinës buxhetore
Shkaku:	Shkelje e bazës ligjore në fuqi
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Në vijim, të shmanget plotësisht përdorimi i praktikave të celjes së angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, për më tepër duke



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	përdorur mënyra jo të duhura teknike dhe ligjore, si tranferimin e perkohshëm të një angazhimi aktual , në një periudhë të ardhshme. Në kushtet kur, sa më sipër është sistemuar brenda periudhës objekt auditimi, theksojmë nevojën që për të gjitha rastet e konstatuara në të ardhmen, të vlerësohen dhe nëë varësi të vlerësimit të aplikohen sanksionet e parashikuara në Kreun IX, neni 71 të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
Afati për zbatim:	Në vazhdim

ç. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.

Krahas Buxhetit të akorduar për vitin 2019, Ministria e Kulturës ka realizuar shpenzime dhe nga të ardhurat jashtë limitit për të tre programet e MK përkatësisht:

në 000/lekë

Programi	Art 600	Art 601	Art 602	Art 604	Art 605	Art 606	Totali
01110			400	8,040			8,440
08220	717	158	17,702	143		184	18,904
08230			643	13,894	17,892		32,430
Total	717	158	18,745	22,078	17,892	184	59,773

Referuar tabelës rreth 50 % e shpenzimeve nga të ardhurat jashtë limitit janë kryer nga Programi Arti dhe Kultura në vlerën prej 32,430 mijë lekë nga institucionet:

-Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

-Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”.

Këto shpenzime janë kryer për mbështetjen dhe realizimin e projekteve artistike me qëllim promovimin e artit dhe kulturës. Ndërsa Programi i Trashëgimisë dhe Muzeve ka realizuar shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit në vlerën prej 18,904 mijë lekë nga institucionet si :

-Muzeu Historik Kombëtar.

-Instituti i Monumenteve të Kulturës.

-Zyra e Administrimit dhe Koordinimit Butrint

Gjithashtu, programi Planifikim, Menaxhim dhe Administrim ka realizuar shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit në vlerën prej 8,440 mijë lekë kryesisht për realizimin e Projektit Creative Europe, marrëveshje kuadër mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për Creative Europe, e nënshkruar në qershor të vitit 2014. Sipas kësaj marrëveshjeje granti përbëhet nga shuma e financimit të BE (50%) dhe 50% e mbetur që e vendos shteti palë.

Granti i akorduar nga BE përdoret për të financuar:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

- botime dhe broshura ilustruese e promovuese per Creative Europe.
- Evente rajonale te ndryshme/blerje pajisjesh etj
- Honorare per ekspertet/asistente te programit

Ky zë nuk arriti të shikohej dhe auditohej nga grupi i auditimit pr shkak të ndërprerjes së auditimit në terren si pasojë e pandemisë globale të COVID 19, dhe kjo çështje mund të jetë subjekt i një auditimi tjetër.

2. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE

Në zbatim të VKM nr.507 dt.13.09.2017 “Për përcaktimin e Fushës së përgjegjësisë shtetërore të MK”, Urdhër I Kryeministrit nr.164 dt.05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MK”, u krijua Struktura dhe Organigrama e Re e Ministrise se Kultures e cila shfuqizoi VKM nr.844 dt.27.09.2013 “Për përcaktimin e Fushës së përgjegjësisë shtetërore të MK” dhe Urdhërin e Kryeministrit nr.187 dt.18.10.2013 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MK” është miratuar Misioni dhe Vizioni i Ministrise se Kultures [MK].

Misioni i Ministrisë së Kulturës është: hartimi, programimi dhe zhvillimi i politikave kombetare te kultures; Hartimi dhe bashkerendimi i punes per politikat e artit dhe kultures; Hartimi i politikave mbrojtese dhe promovuese per trashegimine kulturore (materiale dhe shpirtore); Hartimi i politikave per ekzistencen e Shqiperise si nje partner aktiv ne organizatat nderkombetare; Udheheq, programon dhe mbeshtet veprimtarite kombetare dhe nderkombetare me qellim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore; Respektimi i rregjistrimit, mbikqyrjes dhe monitorimit te respektimit te te drejtave te autorit dhe te drejtave te tjera lidhur me to.

1/a Nga auditimi konstatohet se MK për vitet 2018 e 2019, funksionon sipas Strukturës dhe Organikës së përcaktuar me Urdhër të Kryeministrit nr.164 dt.05.10.2017 me 91 persona, pozicionuar si më poshtë:

A.Funksione Politike- Ministër, Asistent Ministër (2 persona), Kabineti (7 persona), Zv/Ministër (1 person)

B. Funksione Administrative- Sekretar i Përgjithshëm (1 person), Drejtor i Përgjithshëm (3 persona), Drejtor Drejtorie (3dr x 3pers/ 9 persona), Përgjegjës Sektori (10 persona), specialistë dhe të tjerë (57). Kjo VKM dhe ky Urdhër kanë shfuqizuar Urdhërin nr.66 dt.07.04.2016 me 80 persona në Strukturë. Pra *ristrukturimi i MK është shoqëruar me zgjerim të numrit të pozicioneve në strukturë me 11 persona; krijimin e dy Drejtorive - “Drejtoria e Prokurimit, Koncesioneve dhe PPP” (1+6 persona) si dhe “Drejtoria e të Drejtës së Autorit” [DDA](1+5 persona). Po e pasqyrojmë në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:*

Nr.	Loji i Klasifikimit	U.66/2016	U.164/2017	DIFERENCA(+)
1	Funksion Politik	10(1+9)	11(1+10)	1
2	Funksion Administrativ	70(1+69)	80(1+79)	10
	TOTALI	80	91	11

Përpunuar nga Grupi i Auditimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Ndryshimi në formë dhe përmbajtje (rikompozim) i Strukturës dhe Organigramës në MK, është shoqëruar me zgjerim të pozicioneve të punës dhe si pasojë edhe me rritjen e numrit të personelit administrativ me 10 persona dhe atij politik me 1 person. Kjo procedurë është realizuar mbështetur në Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësit civilë” i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi I Punës I Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar (për personelin administrativ) dhe Ligjin nr.90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore” (për kabinetin e Ministrit).

1/b. Ndryshimet në Strukturë nuk janë shoqëruar me lirim të punonjësve nga marrëdhëniet e punës (si rezultat i suprimimit të vendit të punës), por lirimet kanë qenë me kërkesë për *pezullim të përkohshëm të Statusit të nëpunësit civil*, konform kjo Ligjit nr.152/2013 i ndryshuar neni 55 “Pezullimi me kërkesë të nëpunësit”. U verifikuan nga ana jonë të gjitha praktikatat e kësaj procedure për vitet 2018 dhe 2019. Situata paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.viti	Dorëheqje	Lirim nga detyra/përfundim kontrate	Lëvizje brenda Institucionit	Pezullim nga shërb.civ	Pension	Transferim i përhershëm
2018	5	2/0	1	0	0	0
2019	11	14/1	4	5	1	1
Totali	16	17	5	5	1	1

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Pra procesi i ristrukturimit në MK nuk ka sjelle suprimim të pozicioneve të punës.

1.c Emërimet dhe Lëvizjet në MK pasqyrohen si më poshtë:

Nr.Viti	Pranim në shërb.civ	Me kontratë	Lëvizje paralele	TND/të tjerë	Ekz.V.Gjyq	Ngritje në detyrë
2018	14	3	1	4(2/2)	-	2
2019	2	4	1	5(4/1)	1	2
Total	16	7	2	9	1	4

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

* *Procedura e Emerimit apo dhe e Levizjeve paralele* bazohet në Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar me ligjin nr.178/2014, Ligjin nr.41/2017 dhe behet në koordinim me Departamentin e Administratës Publike [DAP] sipas udhëzimeve të këtij ligji: Çdo fillim viti në DAP deëgohet shkresa me vendet vakante dhe kërkesat për punësim (sipas nevojës së Institucionit). Nga verifikimi i procedurave të realizuara për vitet 2018 dhe 2019, rezulton se nga ana e MK ka patur korrektësi në zbatim të tyre konform Ligjit 152/2013, **neni 20** “Parimet e pranimit në shërbimin civil”, **neni 21** “Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil”, **neni 22** “Pranimi në shërbimin civil”, **neni 23** “Emërimi në shërbimin civil”, **neni 24** “Periudha e provës” si dhe “Lëvizja Paralele dhe Ngritja në Detyrë” si dhe **nenet 25-31**; gjithashtu **neni 2** “Ky ligj zbatohet për çdo nëpunës (në vazhdim “nëpunës civil”), që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

(duke radhitur rastet përjashtimore)”; **neni 5** “Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil”; **neni 7, pika 3/a** “DAP-i ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë nga institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e përgjegjësiave të tij”; **neni 7, pika 4** “Çdo institucion, që punëson nëpunës civilë, si dhe çdo funksionar publik dhe nëpunës civil, që kanë kompetenca menaxheriale vendimmarrëse ose që kanë informacione në këtë fushë, janë të detyruar të bashkëpunojnë me DAP-in”;

** Procedura e punësimit me kontratë pune rezulton të jetë realizuar konform hapësirave të përcaktuara në Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi I Punës I Republikës së Shqipërisë” Ndryshuar me ligjet: nr. 8085, datë 13.3.1996; nr.9125, datë 29.7.2003; nr. 10 053, datë 29.12.2008; nr. 136/2015, datë 5.12.2015, **neni 19** (Ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.3.1996) (Ndryshuar me ligjin nr. 9125, datë 29.7.2003) **pika 1** “Punëdhënësi punëson në mënyrë të drejtpërdrejtë punëmarrësin”; **pika 2** “Punëdhënësi, për të punësuar punëmarrësin, mund të përdorë shërbimet e zyrave shtetërore të punësimit ose të agjencive private të punësimit”; **neni 20** “Kanë të drejtë të lidhin kontratë pune: **pika 1** personat që gëzojnë zotësi të plotë për të vepruar sipas dispozitave të Kodit Civil; **pika 2** personat me zotësi të kufizuar, por të autorizuar shprehimisht ose në heshtje për të kryer punë nga përfaqësuesi i tyre ligjor” si dhe VKM Nr.60, datë 31.01.2018 “Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.*

Duke iu referur Objektivit të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar **neni 1** “Ky ligj ka për qëllim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike”, Grupi i Auditimit konkludoi si më poshtë:

1. Në MK ka përputhshmëri të pozicionit të punës (referuar përshkrimit të punës) me kualifikim profesional të personelit administrativ, rezultuar kjo nga verifikimi që iu bë dosjeve të personelit, emëruar në vitet 2018 e 2019, konform **Ligjit nr.152/2013** (ndryshuar) dhe **Ligjit nr. 7961/1998** (ndryshuar).

2. MK ka planifikuar në Strukturë dhe emëruar studentë të ekselencës konform **VKM nr. 766**, datë 26.12.2018 “Për Punësimin e Studentëve të Ekselencës në Institucionet e Administratës Shtetërore, Pjesë të Shërbimit Civil, për vitin 2019” (*5 studentë të ekselencës*)

3. Konstatim: Nga analiza e detajuar që Grupi i Auditimit I bëri Strukturës së Re dhe Organigramës së MK sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.164 dt. 05.10.2017: Nuk janë planifikuar në Strukturë dhe as punësuar persona me statusin e “Grupit të vecantë” ku përfshihen: persona me aftësi të kufizuara, jetimë, komunitetit romë etj. si personel administrativ apo të kabinetit të ministrit, në kundërshtim kjo me **Ligjin nr. 152/2013** “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar **neni 5** “Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil”; **Ligjin nr.93/2014** “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara” **neni 1/a** “përcaktimi i të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta persona në kushte të barabarta me të tjerët”; **neni 2 pika a** “të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; **pika b** “të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri”; **neni 4 pika a** “mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë”; **pika b** “barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta”; **pika ë** “realizimi progresiv, sipas të cilit Qeveria ndërmerri masa për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin maksimal, që e lejon burimet e disponueshme, pa cënuar të drejtat e fituara, të cilat janë në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”; **Ligjin nr.15/2019** dt.13.03.2019“Për Nxitjen e Punësimit” **neni 3 pika 4** “Grupe të veçanta” janë punëkërkes të disavantazhuar në tregun e punës (17 kategori sociale); **neni 20** “Punësimi i personave nga grupet e veçanta” **pika 1/a** “Çdo punëdhënës duhet të punësojë një person që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, për 25 punonjësit e parë të ndërmarrjes” dhe **pika 1/b** “nga një person shtesë, sipas grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, për çdo 50 punonjës të tjerë të ndërmarrjes mbi parashikimet e bëra në shkronja “a” të kësaj pike”; **pika 2** “Punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave, sipas pikës 1, të këtij neni, derdh një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit, në masën e 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi,...”; **pika 3** “Punëdhënësit marrin masat e nevojshme për plotësimin e vendeve të lira të punës me personat që i përkasin grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji”; **Ligjin nr. 7961**, datë 12.7.1995 “Kodi I Punës I Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar **neni 20** “Kanë të drejtë të lidhin kontratë pune” **pika 2** personat me zotësi të kufizuar, por të autorizuar shprehimisht ose në heshtje për të kryer punë nga përfaqësuesi i tyre ligjor”; Për sa trajtuam më lartë grupi I auditimit konkludon se Struktura përgjegjëse e MK ka treguar papërgjeshmëri në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore të cilat përcaktojnë Strukturën dhe organikën si dhe dimensionin e politikave institucionale.

Observacioni i Drejtorisë së Mirë-administrimit të Burimeve Njerëzoreve, Aseteve dhe Shërbimeve, dërguar me email të datës 01.06.2020, për shkak të situatës së pandemisë së shkaktuar prej COVID19 paraqiten si më poshtë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave

Konstatimi 3. Në lidhje me planifikimin në strukturë apo të punësuar persona me statusin e “grupit të veçantë” shprehem sa vijon:

a) Referuar nenit 22 “Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, bëhet nëpërmjet një konkurimit të hapur”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, kjo procedurë organizohet dhe zhvillohet nga njësi përgjegjëse që është Departamenti i Administratës Publike. Gjithashtu, bazuar në VKM-në nr. 243, datë 18.03.2015 i ndryshuar me VKM nr. 746, datë 19.12.2018, parashikohet një kriter favorizues për grupet e vecanta për rastet kur kandidatët renditen me pikë të barabarta. Konkretisht në rast se njëri prej kandidatëve përfshihet në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, atëherë ai përzgjidhet i pari në raport me kandidatin tjetër.

b) Referuar nenit 20 “Punësimi i personave nga grupet e veçanta” të ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, shprehimisht thuhet se: çdo punëdhënës duhet të punësojë 1- person që i përket grupeve të përcaktuara, për 25 punonjës dhe nga 1- person shtesë sipas grupeve të përcaktuara në këtë ligj , për cdo 50 punonjës. Ju bëjmë me dije se, numri i punonjësve administrativ në strukturën organizative të MK-së është 9 punonjës si dhe për stafin politik është 9 punonjës.

Si e tillë, Ministria e Kulturës nuk e plotëson këtë raport numerik për punësimin e personave nga grupet e veçanta, për personelin administrative apo politik.

Referuar nenit 9, të ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”

Ju vëmë në dijeni se Neni 9 Ndërmjetësimi për punësim dhe përputhja me vendin e punës

1. Ndërmjetësimi për punësim dhe përputhja me vendin e punës synon gjetjen e një vendi të përshtatshëm pune për punëkërkuuesin, formimi, aftësitë e cilësitë e të cilit përputhen me kërkesat e deklaruara nga punëdhënësi për këtë vend pune, si dhe ndërmjetësime për programet aktive të tregut të punës.

2. Ndërmjetësimi për punësim dhe përputhja me vendin e punës përfshin edhe shërbime këshilluese për punëdhënësit, me qëllim që të punësojnë kandidatët më të përshtatshëm, sipas kërkesave të tyre dhe në kohën e duhur, si dhe ndërmjetësime për programet aktive të tregut të punës. Në rastin e një punëkërkuuesi, të parashikuar në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, procesi i ndërmjetësimit shoqërohet me vlerësim të detajuar të punëkërkuuesit, këshillim për punëdhënësit dhe të vendit e të proceseve të punës të vlefshme në tregun e hapur të punës.

3. Ndërmjetësim për punësim vlerësohet edhe rasti kur, në zbatim të marrëveshjeve ose lejeve të posaçme për punë, mundësohet punësimi i punëkërkuësve shqiptarë jashtë vendit dhe i të huajve brenda vendit.

Neni 20 Punësimi i personave nga grupet e veçanta 1. Çdo punëdhënës duhet të punësojë: a) një person që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, për 25 punonjës të parë të ndërmarrjes; dhe b) nga një person shtesë, sipas grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, për çdo 50 punonjës të tjerë të ndërmarrjes mbi parashikimet e bëra në shkronja “a” të kësaj pike.

KREU IV KONKURRIMI

VENDIM Nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar me VKM nr. 746, datë 19.12.2018



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

13. Kandidatët me pikë të barabarta renditen sipas këtyre kriterëve: a) Në rast se njëri prej kandidatëve përfshihet në kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, atëherë ai përzgjidhet i pari në raport me kandidatin tjetër; b) Në rast se kandidatët janë të gjinive të ndryshme, atëherë renditja bëhet duke u renditur i pari kandidati që i përket gjinisë më pak të përfaqësuar në grupin për të cilin konkurrohet. Gjinia më pak e përfaqësuar përcaktohet nga njësia përgjegjëse; c) Në rast se nuk mund të aplikohet asnjëra nga alternativat e mësipërme, atëherë renditja e kandidatëve me pikë të barabarta bëhet nëpërmjet shortit.

Kërkesa të përgjithshme të pranimi në shërbimin civil, një ndër kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësoj kandidati, pika “ç”, është të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

Neni 22 Pranimi në shërbimin civil 1. Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur

KREU II PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

1. Procedura e pranimi në shërbimin civil organizohet vetëm për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë organizohet në mënyrë të ndarë për grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe për çdo grup të pozicioneve të administrimit të posaçëm.

2. DAP-i organizon procedurën e pranimi për të gjitha pozicionet e kategorisë ekzekutive për administratën shtetërore, ndërsa njësitë përgjegjëse në institucionet e pavarura/njësitë e qeverisjes vendore organizojnë procedurën për institucionet respektive.

3. DAP-i për pozicione pune që i përkasin institucioneve rajonale/vendore të ministrive apo të institucioneve të varësisë mund të organizojë procedurën e pranimi për secilin grup të pozicioneve të administrimit të posaçëm apo për grupin e administrimit të përgjithshëm edhe mbi baza qarku. LIGJ Nr. 15/2019 PËR NXITJEN E PUNËSIMIT Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të

Neni 20 Punësimi i personave nga grupet e veçanta

1. Çdo punëdhënës duhet të punësojë: a) një person që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, për 25 punonjësit e parë të ndërmarrjes; dhe 10 b) nga një person shtesë, sipas grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, për çdo 50 punonjës të tjerë të ndërmarrjes mbi parashikimet e bëra në shkronja “a” të kësaj pike.

2. Punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave, sipas pikës 1, të këtij neni, derdh një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit, në masën e 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, për çdo muaj, për çdo person që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, që ai duhet të kishte punësuar, sipas këtij neni.

Procedura dhe mënyra e derdhjes së kontributit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive.

Shërbimi civil

Neni 21 Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil. Për pranimin në shërbimin civil, një kandidat duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme si më poshtë:

a) të jetë shtetas shqiptar; b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur; ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse; d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje; dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji; e) të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës.

Neni 22 Pranimi në shërbimin civil 1. Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapu

Qëndrimi i grupit të auditimit lidhur me këtë pikë: duhet t’ju sjellim në vëmendjen tuaj se konstatimi ynë ka të bëjë me:

1. mospërfaqësimin në strukturë të kategorisë “grupe të vecanta” ku të klasifikuarit e parë persona me aftësi të kufizuar përfaqësohen nga një numër i konsiderueshëm në shoqërinë tonë krahasuar me klasifikime të nënrenditura saj, të cilët plotësojnë kërkesat e përgjithshme për punësim. Ashu si kategoria “ekselent” edhe kjo kategori duhet të gjente përfaqësim në strukturën organizative të institucionit tuaj, ku krahas 7 (shtatë) kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil të përcaktuara në nenin 21 ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, njoftimit t’i bashkangjitej në publikim edhe kriteri “person me aftësi të kufizuar”, duke pasqyruar transparencë dhe vëmendje institucionale ndaj kësaj kategorie nga njëra anë si dhe inkurajuar dhe ndërgjegjësuar këtë kategori për një qëndrim mosdriskiminues dhe mbështetës të institucioneve shtetërore nga ana tjetër. Kjo realizohej nga ana e menaxherëve të nivele më të ulta deri tek ai më i larti duke analizuar dhe studiuar të gjitha proceset e punës për një përshtatshmëri të pozicionit të punës me dëmtimin që ka individit (duke mos e diferencuar atë vetëm për këtë fakt), duke qenë se ky proces është konform ligjeve në fuqi të Republikës së Shqipërisë (cituar në mënyrë të detajuar më lart nga ana jonë).

2. Referuar pretendimit tuaj lidhur me interpretimit juridik dhe social që i bëni nenit 20, pika 1/a, pika 1/b, pika 2 dhe pika 3 të ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, grupi jonë i auditimit ju sjell në vëmendje se ju (si institucion shtetëror) duhet t’i vlerësoni si kriter të aspektit moral dhe social, dhe jo si kriter numerik pasi kjo vlen për subjektet private që kanë pavarësi ligjore lidhur me kriteret e punësimit. Observacioni juaj për këtë pikë **nuk merret në konsideratë nga Grupi i auditimit.**

1/d. Për vitet 2018 dhe 2019 nuk kanë filluar procese gjyqësore, pasi Struktura e Re dhe Organigrama e MK nuk janë shoqëruar me suprimime të pozicioneve të punës.

1/e. Për vitet 2018 dhe 2019 janë zbardhur dy vendime të formës së prerë (të procëseve të hershme) të Gjykatës së Apelit për ish punonjës të larguar nga puna para 2018, nga të cilat për njërin është bërë riemërim në vitin 2019, tjetri në vitin 2020.

1/f. Struktura e Re dhe Organigrama e MK sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.164 dt.05.10.2017, përmban 91 vende pune nga të cilat 15 vende janë vakante. Nga ana e MK janë zbatuar procedurat e njoftimit në DAP për vendet vakante cdo fillim viti, konform **Ligjit nr. 152/2013** “Për Nëpunësin Civil” **neni 7 pika 3/a,b** dhe **pika 4** “Çdo institucion, që punëson nëpunës civilë,.../.... janë të detyruar të bashkëpunojnë me DAP-in”.

Ecuria e vendeve vakante në MK sipas vitete jepet si më poshtë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Nr	Viti	Raportuar DAP (fillim viti)	Gjendja fund viti	Nr i të punësuarve
1	2018	21	11	10
2	2019	17 (11+6)	13	4

Shënim: në tabelë nuk janë përfshirë shifrat e të punësuarve në kabinet

Referuar tabelës konkludojmë se:

✱ Viti 2018 ka filluar me 21 vende vakante raportuar në fillim viti në DAP konform procedurave që përcakton Ligji nr.152/2013; janë punësuar gjatë vitit 2018 konform këtij ligji 10 punonjës dhe kanë mbetur 11 vende vakante.

✱ Viti 2019 ka filluar me 17 vende vakante ku 11 janë të mbartura nga viti 2018 dhe 6 vende kanë dalë gjatë përfundimit të procesit të ristrukturimit apo proceseve të ndryshme administrative, konform Urdhërit nr.164 dt.05.10.2017 I cili e përcakton në mënyrë definitive Strukturën e MK me 91 punonjës.

1/g. Nga ana e Grupit të Auditimit u verifikuan listë pagesat e viteve 2018 e 2019 si dhe disa dosje personeli (përzgjedhur në mënyrë rastësoe), ku rezultoi se ka përputhshmëri të kualifikimit profesional (kategoria e masterit) me përlllogaritjen e pagës për secilin punonjës (të përzgjedhur me dosjet) konform kjo **VKM nr Nr. 545, datë 11.08.2011** (i përditësuar) “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë/Nëpunësve..../...Institucioneve në Varësi të Ministrave të Linjës dhe Administratën e Prefektit”, lidhur kjo me pagesat e mbartësve të titujve (post master);

1/h. Në MK gjen zbatim po ashtu edhe **VKM nr.717 datë 23.06.2009** (përditësuar 2018) “Për pagat e Punonjësve mbështetës të Institucioneve Buxhetore dhe të Nëpunësve të disa Institucioneve Buxhetore”, ku punonjësit e MK klasifikohen në Grupin 1 (nga niveli I Institucionit); Ndarja e punëve sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, bëhet sipas lidhjes nr.III, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij; Zbatimi i kësaj shtese, bëhet sipas 5 etapave. Shtesën e vështirësisë në MK e kanë përfituar 6 punonjës. Nga auditimi I praktikave të tyre rezulton se janë zbatuar 5 etapat e përcaktuara në VKM nr. 717 datë 23.06.2009 (përditësuar). Kjo praktikë përmban: ▪ Kërkesën e Drejtorisë së Burimëve Njerëzore (bashkangjitur edhe kërkesën e punonjësit pretendues) drejtuar Drejtorisë së Shëndetit Publik, të cilat përcaktojnë vendet e punës, të vështira e të dëmshme për shëndetin e punëmarrësve, si dhe shkallën e vështirësisë e dëmshmërisë, për çdo vend pune; ▪ Kërkesën e Titullarit drejtuar për miratim ministrisë përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë (MSHMS) dhe të punësimit; ▪ Pas marrjes së miratimit sipas pikës së mësipërme, miratimin e Titullarit të MK për shtesën punonjësit pretendues (tani përfitues); ▪ si dhe dy pika të tjera për raste të vëçanta.

1/i. Tabela përmbledhëse e llog.600 e 601 për MK, bazuar në Situacionet e Shpenzimeve Janar - Dhjetor për vitet 2018 e 2019.

VITI	PLANI THESAR		REALIZIMI THESAR		DIFERENCA		NUMRI I PUNONJESVE	
	Llog.600	Llog.601	Llog.600	Llog.601	Llog.600	Llog.601	Plan	Fakt



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT


Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

2018	77,721,000	12,555,000	77,449,76112,329,963	271,239	225.037	91	77
2019	89,176,000	15,100,000	85,252,61913,775,731	3,923,381	1,324,269	91	77

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga të dhënat në tabelë vihet re se këta zëra janë realizuar respektivisht: Llog. 600 në masën 99.6 % dhe Llog. 601 në masën 98.2 % për vitin 2018; Llog. 600 në masën 95.6 % dhe Llog.601 në masën 91.2% të fondeve buxhetore.

- Nga ana e Institucionit na u bë me dije se fondet e pagave të papërdorura që i përkasin vendeve vakante, i janë kthyer buxhetit të shtetit konform kjo Udhëzimit nr.8 dt.09.03.2018 të MFE “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. (kjo nuk u arrit të verifikohet nga ana jonë për shkak të situatës së papritur që u krijua, pasi nevojiteshin shkresat ku alokohen fondet e papërdorura të MK për zëra të tjerë ku mund të nevojiteshin fonde).
- Diferencat në vlerë për Llog.600 dhe Llog.601 të secilit vit ushtrimor (2018 & 2019), përfaqësojnë diferencat e llogarive respektive të pagave dhjetor të vitit paraardhës me atë pasardhës të cilat paguhen në Janar, si dhe vlerat e përtfuara nga ditët e paguara me raport, ditët e papaguara (nga masat disipinore).
- Listë prezencat bashkëngjitur listë pagesave (borderotë), kishin mungesë të përsëritur të firmave të nëpunësve zbatues (trajtuar tek sistemi I firmave dhe kontrollit të dokumentacioneve – pika MFK).






KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Viti	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nentor	dhjetor
struktura	91	91	91	91	91	91	91	91	91	91	91	91
2018	77	65	65	65	65	77	77	77	77	77	77	77
2019	77	77	77	77	77	77	77	77	77	77	77	77

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Tabela e mësipërme pasqyron numrin e personelit present për secalin vit kundrejt numrit të tyre sipas përcaktimit në Strukturën e Re.



Pra për dy vite radhazi MK ka numër të konsiderueshëm vendesh vakante, për të cilat është njoftuar DAP konform përcaktimeve ligjore në fuqi. Gjendja vazhdon të jetë e pandryshuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Titulli i Gjetjes 1	<i>Efektet sociale të ristrukturimit të MK që ndikon në performancën institucionale</i>
Situata:	Nga analiza e detajuar mbi Strukturën e re dhe Organigramën e MK, sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.164 dt. 05.10.2017 rezultoi se, as nuk janë planifikuar në strukturë dhe si pasojë as nuk janë punësuar persona me statusin e “Grupit të vecantë” ku të përfshihen: persona me aftësi të kufizuar, jetimë, komunitetit romë etj. si personel administrativ apo të kabinetit të ministrit, sikundër e dikton ligji nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi I Punës I Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar
Kriteri:	Ligji Nr.10296, datë 8.7.2010 “PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN” Kreu II neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues” Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar neni 5 “Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil”; Ligjin nr.93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara” neni 1/a “përcaktimi i të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta persona në kushte të barabarta me të tjerët”; neni 2 pika a “të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; pika b “të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri”; neni 4 pika a “mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë”; pika b “barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta”; pika ë “realizimi progresiv, sipas të cilit Qeveria ndërmerr masa për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin maksimal, që e lejojnë burimet e disponueshme, pa cënuar të drejtat e fituara, të cilat janë në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit” neni 3 pika 4 “Grupe të veçanta” janë punëkërkues të disavantazuar në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	<i>tregun e punës (17 kategori sociale);neni 20 “Punësimi i personave nga grupet e veçanta” pika 1/a “Çdo punëdhënës duhet të punësojë një person që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, për 25 punonjësit e parë të ndërmarrjes” dhe pika 1/b “nga një person shtesë, sipas grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, për çdo 50 punonjës të tjerë të ndërmarrjes mbi parashikimet e bëra në shkronja “a” të kësaj pike”; pika 2 “Punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave, sipas pikës 1, të këtij neni, derdh një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit, në masën e 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi,”; pika 3 “Punëdhënësit marrin masat e nevojshme për plotësimin e vendeve të lira të punës me personat që i përkasin grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji” Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi I Punës I Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar neni 20 “Kanë të drejtë të lidhin kontratë pune” pika 2 personat me zotësi të kufizuar, por të autorizuar shprehimisht ose në heshtje për të kryer punë nga përfaqësuesi i tyre ligjor”</i>
Ndikimi	Eshtë cënuar parimi i shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike,
Shkaku	Gjatë procesit të ristrukturimit nuk është treguar vëmendje dhe përgjegjshmëri për të planifikuar dhe punësuar personel nga kategori sociale të cilësuar si “Grupe të vecanta”.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi	MK të analizojë, vlerësojë dhe ri-dimensionojë strukturën e saj edhe në funksion të “grupeve të vecanta”, duke mbajtur në konsideratë sa më sipër që në fazën e planifikimit e deri në punësimin e tyre, pa cënuar në asnjë rast parimet e barazisë meritokracinë, dhe duke eliminuar/minimizuar diskriminimin.
Afati i Zbatimit	Në vazhdimësi

3. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE E MONETARE

a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës në lekë dhe në valutë.

Sipas Programit të Auditimit nr. 62/1, datë 20.01.2020, është audituar ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe inventarizimi i pronës, për vitin 2018 dhe 2019.

Për auditimin e kësaj pike, grupi i auditimit është mbështetur në:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar
- VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin e punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës” i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”

Nga auditimi me zgjedhje për periudhën objekt auditimi, për veprimet e kryera nëpërmjet bankës rezultoi se, në përgjithësi veprimet kontabël janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nënligjore. Regjistrimi dhe kontabilizimi në ditar është bërë i rregullt dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e njëjtë me nxjerrjen e llogarisë në fund të viteve ushtrimore. Veprimet e kryera janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarët përkatës. Pagesat e kryera me urdhër shpenzimi, në përgjithësi janë të shoqëruara me dokumente të rregullta justifikuese. Të gjithë urdhër shpenzimet e përzgjedhur janë plotësuar në përputhje me kërkesat e formatit të përcaktuar nga Ministria e Financave.

Nga auditimi me zgjedhje sipas vlerës më të madhe të likujduar, por dhe diversitetit të emërimit, i 68 Urdhër shpenzimeve për vitin 2018 me vlerë 735,266,834 ose 72% të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” me lëvizje debitore në vlerën totale 1,026,159,652 lekë, dhe i 40 urdhër shpenzimeve të vitit 2019 me vlerë 347,708,308 lekë, u konstatua se lista e mëposhtme e urdhër shpenzimeve nuk ka dokumente të plotë justifikues:

1. USH nr. 228, datë 07.05.2018 janë dhënë paradhënie personelit për udhëtim jashtë vendit sipas Autorizimit të NA me nr. 2668, datë 18.04.2018. Brenda paktikës nuk gjendet bashkëngjitur faturat justifikuese të akomodimit në hotel dhe llogaritja e dietave në mbështetje të orarit të udhëtimit. Mungon urdhri nr. 212 datë 06.04.2018.
2. USH nr. 258 datë 21.05.2018 mbi likujdimin e vlerës 60% të kontratës për projektin “Festivali Mik” në vlerën 720,000 lekë,
3. Projekti “Album fotografik Homeland” në USH nr. 671, datë 30.10.2018, likujduar në shumën 600,000 lekë, 60% e vlerës së kontratës, ka bashkëlidhur vetëm kontratën
4. Ush nr. 781, datë 27.11.2018 “Hartimi i projektit Restaurimi, Rikonstruksioni dhe riformatimi i linjës muzeore në Muzeun H” likujdim me vlerën 23,979,000 lekë ka bashkëlidhur dokumente pjesore, si procesverbal të marrjes në dorëzim të shërbimit me nr. 7322/5, datë 15.10.2018; faturë tatimore shitjeje nga Atelier 4 me nr. 125, datë 13.11.2018 për likujdimin e fazës së parë, 60% të kontratës nr. 5983/13, datë 27.08.2018 dhe fletë hyrje në MK nr. 2, datë 26.11.2018 për projekt idenë mbi rikonstruksionin.. në MHK, në fletë hyrje cilësohet mungesa e dokumentit 07, raport mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis. Mungon dokumentacioni i plotë, duke humbur gjurma e auditimit: urdhër prokurimi,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

procesverbali i njoftimit të fituesit, kontrata e lidhur midis Autoritet kontraktor dhe Kontraktuesin, urdhri i Ministrit mbi ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim dhe dokumentacioni i dorëzuar nga bashkimi i konsulentëve.

5. Ush nr. 782, datë 27.11.2018 “Hartimi i projektit Restaurimi, Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve” ka bashkëlidhur dokumentacion pjesor: procesverbal i marrjes në dorëzim të dokumentacionit të projektit nr. 7542/6, datë 8.11.2018 dhe fatura e operatorit Atelier 4, me nr. 126, datë 13.11.2018 shërbim sipas kontratës nr. 6855/16, datë 27.09.2018, faza e parë, 60% e e kontratës, pas miratimit të projekt idesë, fletë hyrje në magazinë si mall në ruajtje me fletë hyrje nr. 1, datë 26.11.2018. Mungojnë dokumentacioni: Urdhër prokurimi, njoftimi i fituesit, njoftimi i kontratës, kontrata e lidhur me operatorin, projekt idea e dorëzuar me shkresën nr. 2291, datë 29.10.2018 me dokumentacionin përkatës, urdhri i Ministrit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim.
6. Ush nr. 844, datë 12.12.2018 me objekt “Riparim makine” në vlerën 146,280 lekë nuk ka bashkëlidhur urdhrin e prokurimit, ftesën për ofertë, procesverbalin e fituesit, kontratën e lidhur.
7. Ush nr. 645, datë 09.09.2019 me objekt “Projekti “Fondi për mbështetjen e krijimtarisë letrare për fëmijë”” në shumën 187,000 lekë ka bashkëlidhur vetëm kontratën e lidhur, por mungojnë Urdhri nr. 320, datë 30.05.2019, vendimi i jurisë, listëpagesa shtator, raporti i monitorimit.
8. Ush nr. 724, datë 09.10.2019 me objekt “Hartimi i projektit Restaurimi, rikonstruksioni dhe riformatimi i linjës muzeore në Muzeun Historik Kombëtar” me vlerë 4,960,000 nuk ka asnjë dokument bashëngjitur.
9. 10. dhe 11. USH nr. 813 dhe 829, datë 28.10.2019 dhe USH nr. 839, datë 31.10.2019 me objekt “Gjopa për deklarim të vonuar” dhe Deklarime të vonuara, me vlera 30,000, 26,054 dhe 29,998 lekë, nuk kanë dokumente bashkëngjitur.
12. USH nr. 803, datë 25.10.2019 me objekt “Pagesë për projektin “Mbrëmë i pëshpërita një ylli”” në vlerën 150,000 lekë nuk ka dokumente bashkëngjitur.
13. Projekti “Aktiviteti artistik në kuadër të vitit Kombëtar të Skënderbeut në datën 18 Nëntor 2018” likujduar në llogarinë 602 vlera 521,668, me uSH nr. 643, datë 22.10.2018.
14. USH nr. 43, datë 02.03.2018 “Projekti Bialja e arkitekturës 2018, kuratorët” me vlerë 2,832,300 lekë nuk është i shoqëruar nga kontrata dhe urdhri autorizues
15. USH nr. 48 datë 02.03.2018 “Stenda Lajpcik” me vlerë 820,750 lekë nuk ka dokumente justifikues të plotë
16. USH nr. 106, datë 29.03.2018 “Projekti Shqipëria e bukur” me vlerë 900,000 lekë, nuk ka dokumente bashkëlidhur
17. USH nr. 133, datë 06.04.2018 “Projekti Promovimi i artistëve bashkëkohore” në vlerën 360,000 nuk ka dokumente bashkëlidhur
18. USH nr. 135, datë 10.04.2018 “Projekti Art House 2018” 840,000 lekë nuk ka dokumente bashkëlidhur
19. Sipas USH nr. 615, datë 30.08.2019 është likujduar “Rehabilitimi i TOB” në vlerën 1,096,793 lekë, pas mbajtjes së garancisë së punimeve në vlerën 5% të faturimit të radhës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Fatura tatimore e operatorit nr. 49, datë 29.08.2019 rezulton në vlerën 97,090,274 lekë dhe për të në uSh është bërë likuidim pjesor. Bashkëlidhur vetëm situacioni punimeve dhe fatura tatimore, memo drejtuar NA. Në të gjithë urdhër shpenzimet me këtë objekt mungon kontrata e lidhur me BOE, si dhe dy fatura të operatorit ekonomik për vitin 2018, likuiduar në dhjetor 2018, janë të pafirmosura nga përfaqësuesi i MK.

Në lidhje me këtë gjetje, MK ka bërë observime të projekt raportit të auditimit për të cilën shprehet: “Për USH 228 datë 07.05.2018 theksohet se janë dhënë paradhënie për udhëtim jashtë vëndit dhe nuk gjenden dokumenta bashkëlidhur, ju sqarojme se me këtë USH është bërë tërheqje valute nga banka për 7030 euro dhe kjo shumë është bërë hyrje në arkën e valutës (euro) me MA nr. 19, datë 10.05.2018. Dokumentat justifikuese për shërbimet e kryera ndodhen në dokumentacionin e arkës në euro.

Për USH nr 258 datë 21.05.2018 për likuidimin e vlerës 60% të kontratës për projektin “Festivali Mik” në vlerën 720.000 lekë, ju sqarojmë se kontrata likuidimin e shumës të projekteve e ka në dy faza: 60% paradhënie para fillimit të projektit dhe 40% pas përfundimit të projektit me paraqitjen e të gjithë dokumentacionit justifikues të zhvillimit të projektit. Për këtë qëllim dokumentat ndodhen në USH nr 587, datë 27.09.2018 me të cilin është bërë 40% i kontratës.

I njëjti shpjegim vlen dhe për urdhër shpenzimet e mëposhtme: USH nr 671 datë 30.10.2018, USH nr 803 datë 25.10.2019, USH nr 48 datë 02.03.2018, USH nr 106 datë 29.03.2018, USH nr 133 datë 06.04.2018, USH nr 135 datë 10.04.2018, Ush 781 datë 27.11.2018, Ush nr 782 datë 27.11.2018

Për USH nr 645 datë 09.09.2019 me object “Projekti “Fondi për mbështetjen e krijimtarisë letrare për fëmijë “ ku theksohet se mungojnë dokumentat ju sqarojme se likuidimi i shumës totale të projektit është kryer me USH nr 642, USH nr 643, USH nr 644, USH nr 645 sipas bankave përkatese ku kanë patur llogarinë personat dhe dokumentacioni i plotë ndodhet në njërin nga U SH-të (është një praktikë dhe kontratat janë për secilin person). ”

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:

Në USH nr. 228, datë 07.05.2018 megjithëse është bërë llogaritja në dokumentet bashkëlidhur mandateve të arkës, ende mungon urdhri nr. 212 datë 06.04.2018; Për USH nr. 258, datë 21.05.2018, USH nr. 671 datë 30.10.2018, USH. nr 803 datë 25.10.2019, USH. nr 48 datë 02.03.2018, USH. nr 106 datë 29.03.2018, USH. nr 133 datë 06.04.2018, USH. nr 135 datë 10.04.2018, Ush. 781 datë 27.11.2018, Ush nr. 782 datë 27.11.2018 nuk ka asnjë dokument justifikues, megjithëse është likuidim pjesor i një kontrate; Për Ush nr. 645, datë 09.09.2019 me objekt “Projekti “Fondi për mbështetjen e krijimtarisë letrare për fëmijë”” në shumën 187,000 lekë ka bashkëlidhur vetëm kontratën e lidhur, por mungojnë Urdhri nr. 320, datë 30.05.2019, vendimi i jurisë, listëpagesa shtator, raporti i monitorimit, të cilat nuk kanë bazë ligjore për mungesën e tyre në këtë USH dhe arsyen e përfshirjes së tyre në njërin nga urdhrat e shpenzimeve, të pacilësuar saktësisht nga sektori i financës. Si përfundim gjetja dhe rekomandimi për këtë çështje do të vijojnë të qëndrojnë në raportin përfundimtar të auditimit.

Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve për vitin 2018 u konstatua se likuidimi i urdhër shpenzimeve është kryer në masën 35% të tyre në muajin dhjetor, ndërsa në muajt e tjerë konstatohet një



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

ekzekutim në masën mesatare 6%. Për vitin 2019 likuidimet e kryera në muajin dhjetor përbëjnë 23% të shpenzimeve të gjithë vitit, me një mesatare të muajve të tjerë prej rreth 11%. Nga 108 urdhër shpenzime të audituara 19 prej tyre, ose 18% nuk kanë dokumente të plotë bashkëlidhur, në kundërshtim me UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Pika 34 “Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumenta origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në: Pika a. Dokumenta autorizues dhe b. Dokumenta vërtetues dhe Pika 36, “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Nga auditimi i ditarit të bankës u konstatua se janë kryer lëvrime në drejtim të llogarisë bankare të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Romë, në vlerat 2,956,539 lekë dhe 3,529,856 lekë përkatësisht për vitin 2018 dhe 2019 me objekt “Transferta për punonjës të Znj. L.M”. Këto transferta janë mbështetur në marrëveshjen e lidhur midis dy ministrive, MEPJ dhe MK, marrëveshje me nr. 77, datë 11.02.2016 në protokollin e MK.

Sipas ligjit nr. 23, datë “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”, Neni 31, Personeli i misioneve diplomatike, Pika 2 “Në personelin e misioneve diplomatike mund të përfshihen nëpunës të emëruar nga Ministri i Punëve të Jashtme, në bazë të një marrëveshjeje me institucionet e tjera, për të kryer detyra në fushën ekonomike, juridike, kulturore, shkencore, të mbrojtjes, sigurisë dhe në çdo fushë tjetër, për një kohë të përcaktuar. Gjatë kohës së shërbimit në përfaqësinë diplomatike, këta nëpunës gëzojnë të njëjtin status me diplomatët dhe, pas përfundimit të këtij shërbimi, rikthehen në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion të barasvlershëm me të. Procedurat për emërimin dhe trajtimin financiar të tyre do të rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Shpenzimet për këtë kategori nëpunësish përballohen nga institucioni dërgues.”

Deri më sot nuk është miratuar ende një VKM që rregullon procedurën e emërimit dhe trajtimin financiar të këtyre punonjësve, megjithëse është një detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 23/2015, Neni 31, Pika 2.

Sipas këtij ligji marrëveshja e lidhur midis MEPJ dhe Institucionit tjetër, duhet të parashikojë:

- a) Pozicionin që do të mbajë punonjësi
- b) Afatin e punësimit
- c) Të drejtat dhe detyrimet e punonjësit
- d) Detyrimin e ministrisë për rikthimin në pozicionin e mëparshëm apo të barazvlefshëm me të.

Sipas marrëveshjes së lidhur midis dy ministrive, pozicioni i punës do të jetë “Sekretar i parë”, koha e përcaktuar për të kryer detyrën në misionin diplomatik është 3 vjet, por nuk cilësohen se kush do të jenë detyrat e të drejtat e punonjësit të angazhuar. Pas përfundimit të kësaj marrëveshjeje, nuk është proceduar me kthimin në pozicionin e mëparshëm, por me ripërtëritje të saj me një mandat tjetër 3 vjeçar, në marrëveshjen nr. 697/3, datë 05.02.2019 në protokollin e MK. Sipas saj, në detyrat e MEPJ, Pika 3 parashikohet dhe rinovim i mëtejshëm i saj, duke bërë që ky pozicion pune, të vazhdojë për një afat të gjatë. Konstatohet se ky pozicion pune me status diplomatik ka një afat përtej afatit 3 vjeçar. Për mandatin e parë të pozicionit Sekretar i Parë është dhënë miratimi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

me Urdhrin e Ministrit të MEPJ nr. 54, datë 23.02.2016 “Për emërim në detyrë”. Në vijim të marrëveshjes së rinovuar nuk kemi në dispozicion një riemërim nga Ministri i MEPJ, në kundërshtim me Ligjin nr. 23/2015, Neni 41 “Emërimi dhe mbarimi i detyrës në misionet diplomatike dhe postet konsullore”, Pika 1 dhe 2: “Diplomatët e karrierës emërohen në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë nga Ministri i Punëve të Jashtme, pasi kanë marrë gradën e parë diplomatike “Atashe”. *Diplomatët e karrierës qëndrojnë me shërbim në të njëjtin mision diplomatik ose post konsullor, si rregull, 3 vjet.*”

Sipas VKM nr.546, datë 11.8.2011 “Për përcaktimin e pagave dhe shtesave mbi pagë të punonjësve tëpërfaqësive diplomatike të republikës së shqipërisë...” paga mujore e personelit diplomatik, Sekretar i parë është në shumën 675 euro, 40% shtesë për përfaqësim, si dhe një kompensim për koston e jetesës, përkatësisht prej 260 euro/USD për vendet e grupit të dytë, ku bën pjesë Ambasada e RSH në Romë. Kështu paga bruto e një pozicioni të tillë pune konsiston në shumën 1,205 euro në muaj, ose 14,460 euro në vit.

Sipas marrëveshjes, shuma që i lëvrohet Ambasadës së RSH në Romë cdo vit nga MK, duhet të jetë në vlerën 30,000 euro në vit. Nga krahasimi i pagës bruto vjetore me këtë fond konstatohet se shuma prej 15,540 euro do të përdoret për shpenzime të tjera të ushtrimit të funksioneve të punonjësit në detyrë. Nga ditarët e bankës u konstatuan transfertat në vlerat 15,000 euro; 22,500 euro dhe 27,500 euro përkatësisht për vitet 2017, 2018, 2019, në bazë të urdhrave të Ministrit të MK nr. 460, datë 06.07.2017; nr. 213, datë 10.04.2018 dhe nr. 128, datë 27.02.2019 me objekt “Për mbulimin e shpenzimeve të pagave, sigurimeve dhe shpenzimeve të tjera për ushtrimin e funksionit” për vitet përkatës.

Nga raportimet financiare të dërguara nga Ambasada e RSH në Romë, kundrejt kërkesës së MK nr. 555, datë 24.01.2019 dhe shkresës së Ambasadës nr. 1346, datë 31.01.2019 konstatohet se në vitin pasardhës ka mbartje pjesore të fondit të lëvruar nga MK. Vlera e lëvruar nga MK është përdorur për shpenzime page, shpenzime udhëtimi dhe dieta, shpërblym familjar, komisione bankare dhe shpenzime të banesës së punonjësit.

Megjithëse Ministria e Kulturës për periudhën në auditim, ka kryer transfertat bankare në shumën 6,486,395 lekë, në MK nuk ka raporte të punës, apo produktet të tjera të dërguara në drejtim të saj, si dokument justifikues për këtë shpenzim. Ky veprim bie në kundërshtim me UMFE nr. 30, Datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Pika 34 “Regjistrimi i veprimeve ekonomike bazohet në: Dokumenta vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, tëveprimeve ekonomike”. dhe Marrëveshjen e lidhur midis dy ministrive, Seksioni “Komunikimi”: “Znj. M. do të ushtrojë funksionin e saj në bazë të detyrave të marra nga titullari i përfaqësive diplomatike dhe nga Titullari i MK, si dhe raporton në MEPJ dhe MK. Çdo anashkalim i këtij detyrimi përbën shkelje të disiplinës”.

Në vijim të saj, konstatohet se rinovimi i Marrëveshjes me nr. 697/3, datë 05.02.2019 është në kundërshtim me paragrafin e Marrëveshjes nr. 77, datë 11.02.2016: “Pas mbarimit të periudhës 3 vjeçare, *bazuar në rezultatet e punës dhe më pëlqimin e palëve, marrëveshja mund të rinovohet edhe për një mandat tjetër*”, pasi në MK nuk ka të dhëna dokumentare mbi rezultatet e punës së këtij punonjësi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Nga auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë, për periudhën objekt auditimi rezultoi se, regjistrimet kontabël në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë të rregullt, bazuar në dokumentet justifikuese dhe çdo muaj është bërë kuadrimi i ditarit të arkës me gjendjen e librit të arkës. Të gjitha mandat-arkëtimet dhe mandat-pagesat janë të firmosur nga dy palët, janë plotësuar në përputhje me kërkesat e formatit të përcaktuar në urdhrin e Ministrit të Financave dhe mbështeten në dokumentet justifikues ligjorë. Pagesat janë kryer duke u mbështetur në dokumentacionin justifikues, bashkëngjitur urdhër pagesës. Veprimet kontabël janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore. Gjendja e arkës në valutë në fund të çdo viti, paraqitet zero.

Nga auditimi i veprimeve me arkë u konstatua se, janë dhënë paradhënie personelit për shërbime jashtë vendit, të mbartura prej vitit 2002-2012, për të cilat nuk janë bërë mbylljet brenda vitit ushtrimor. Kështu në fund të vitit 2018 paradhënie të pambyllura nga personeli kapin vlerën 10,028,556 lekë, të mbartura prej vitit 2002-2012. Megjithatë gjatë vitit 2018 u konstatua një ndryshim jo material i këtij zëri, nuk u konstatua një afat i caktuar nga Nëpunësi zbatues i MK për shlyerjet e paradhënieve. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me UMFE nr. 30, Datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Pika 66, *Paradhënia shlyhet menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar nga Nëpunësi Zbatues, duke paraqitur dokumente justifikuese për shpenzimet e kryera tek Nëpunësi Zbatues ose i deleguari i tij. Kur paradhënia nuk shlyhet në afatin e caktuar, bëhet menjëherë ndalimi nga paga e punonjësit. Paradhënia tjetër nuk jepet pa u shlyer ajo që është dhënë më parë.*

Sipas udhëzimit nr. 22 datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, date 14.12.2011 të këshillit të ministrave “për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, Pika 5, “Cdo punonjës, i cili dërgohet me shërbim jashtë vendit, bazuar në shkresën autorizuese të titullarit, kur shërbimi financohet tërësisht nga buxheti i institucionit, *ka të drejtë të marrë në formë paradhënie likuiditeti (cash-i) atë pjesë të shpenzimeve që nuk levrohet nëpërmjet llogarisë së institucionit.* Pra, si rregull, punonjësi merr në formë paradhënie nga institucioni në momentin e nisjes vetëm shpenzimet e dietave ditore dhe ose pagesa e hotelit. Të gjitha shpenzimet e tjera të percaktuara sipas pikes 4 të vendimit, ai mund ti marrë në formë likuiditeti në momentin e nisjes, *vetëm kur nuk është e mundur transferimi nepermjet llogarise bankare nga institucioni tek perfituesi.*

Në perfundim të shërbimit, punonjësi dorëzon të firmosur prane zyrës së financës së njësisë, Urdhër-Shërbimin duke i bashkëngjitur atij autorizimin e titullarit të institucionit qëndror, ose të deleguarit të tij, dhe të gjithë dokumentet përkatëse që vertetojnë shpenzimet e kryera për realizimin e shërbimit jashtë vendit. Urdhër-Shërbimi paraqitet sipas formatit nr.2, bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Në përputhje me përcaktimet e pikave 8 dhe 9 të vendimit të sipercituar, punonjësit që dërgohen jashtë vendit dhe kanë kryer shpenzime transporti dhe akomodimi, *paguhen nga buxheti vetëm kundrejt dokumenteve përkatëse*, sikurse janë biletat e transportit dhe faturat e hotelit. Në kuptim të këtij udhëzimi, ne rastet kur udhëtimi kryhet me avion, si bilete transporti njihet edhe boarding pass-i. Në cdo rast, shpenzimet telefonike dhe shpenzimet e transportit urban nuk mbulohen nga buxheti i shtetit”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

b. Saktësia dhe rregullat e veprimeve të kryera në magazinë.

Mbështetur në dokumentacionin e magazinës, fletë hyrjet dhe fletë daljet, kartelat limit, librin e magazinës dhe ditarin analitik të lëvizjes së vlerave materiale, u konstatua se lëvizja e mallrave, materialeve e inventarëve nëpërmes magazinës, është shoqëruar me urdhra dorëzimi dhe dokumentacionin mbështetës. Nga auditimi i dokumentimit u konstatua se janë zbatuar drejt kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin” dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Fletë hyrjet e mallrave dhe materialeve janë dokumentuar brenda afatit ligjor dhe të shoqëruara me dokumente mbështetëse nga furnitori, ndërsa fletë daljet ishin të shoqëruara me dokumente mbështetëse si urdhra dorëzimi, procesverbale, etj. Kontabilizimi i veprimeve të magazinës është i azhurnuar për çdo veprim ekonomik, hyrje, dalje, si për aktivet e qëndrueshme dhe për aktivet qarkulluese.

c. Inventarizimi i pronës shtetërore.

Nga auditimi u konstatua se MK nuk ka përfunduar procesin e inventarizimit përpara mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2018, në bazë të të cilit të reflektohet gjendja fizike e aktiveve, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, Pika 74, ku citohet... “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.” Gjatë auditimit u konstatua se është ngritur grupi i punës në bazë të Urdhrit të Ministrit nr. 879, datë 27.12.2018, i cili duhet të përfundonte procesin e inventarizimit brenda datës 18.01.2019. Në përbërje të Komisionit të inventarizimit të përbërë prej 4 punonjësish, janë 2 specialistë të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe ky komision nuk ka një kryetar. Ky komision në fund të detyrës së ngarkuar ka përfunduar procesin jashtë datës së përcaktuar në urdhër, dokumentuar në Memon drejtuar Nëpunësit Autorizues me nr. 3393, datë 23.05.2019. Rezultatet e inventarizimit nuk janë përfunduar me një relacion përkatës. Komisioni nuk ka bërë një përmbledhje në një relacion përshkrues të gjendjes faktike dhe ruajtjes së aktiveve në magazinë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar Neni 7 Inventari i aktiveve dhe detyrimeve Pika 1. “Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës se tyre mbështetëse” dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të qeverisjes së përgjithshme”, Kreu 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, Pika 30 “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet”. Veprimi i mësipërm bie gjithashtu në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli II Rregulla Të Përgjithshme Për Pasqyrat Financiare Vjetore “Pasqyrat financiare vjetore janë dokumentet përmbledhëse financiare që përgatiten në mbështetje të të dhënave të kontabilitetit dhe të inventarit që paraqiten pas mbylljes së çdo ushtrimi vjetor.”

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të MK, u konstatua se institucioni ka një regjistër elektronik për aktivet afatgjatë, por amortizimi akumuluar nuk është plotësuar për të gjithë vitet radhazi dhe data e hyrjes së aktiveve nuk pasqyrohet e plotë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu Rregjistri i aktiveve të njërive të sektorit publik, Pika 26... “Cdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Pika 30... “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”

Në regjistrin e aktiveve për llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” nuk është bërë reflektimi i pakësimit me vlerën 60,369,399 lekë, si rezultat ka mospërputhje midis vlerës neto të raportuar në pasqyrën me format 7/b dhe këtij regjistri në vlerën 60,369,399 lekë.

Në kushtet kur hyri në fuqi UMFE nr. 8/2018 MK duhet të raportonte zërat e aktiveve me vlerën neto, si rezultat është gjendur në situatën e vlerës së mbetur negative, për shkak të një amortizimi të akumuluar të zërit 218 “Inventar ekonomik” më të lartë se kosto historike. Sipas Sektorit të Financës kjo ka ardhur si rezultat i mosreflektimit të saktë të aktiveve që përbënin llogarinë 218 “Inventarit ekonomik”. Këto aktive nuk janë pasqyruar të plotë, për shkak të mungesës dokumentare të mbajtjes së tyre prej vitit 2012, ato nuk janë reflektuar në pasqyra, duke u shoqëruar me problematikë në llogaritjen e amortizimit të akumuluar.

Në vijim MK ka bërë veprime rregulluese të pakësimit të koston historike të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” në shumën 60,369,399 lekë.

Pakësimi i llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” në shumën 60,369,399 lekë për një amortizim që nuk i përket kësaj llogarie bie në kundërshtim me parimin kontabël të përkatësisë, me UMFE nr. 8, Pika 36: Baza e llogaritjes vjetore të amortizimit për aktivet afatgjata materiale (mbi të cilat aplikohet përqindja përkatëse e amortizimit vjetor mbi bazë grupimi) duhet të jetë e barabartë me: 1. Vlerën kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhës ushtrimore; 2. Shtesën e koston së blerjes dhe koston së përmirësimit dhe rinovimit të kategorive përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore; si dhe 3. Zbritjen e vlerës kontabile neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit apo të humbura për kategorinë përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me SKK5, “Aktivet



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” Amortizimi është shpërndarja sistematike e vlerës së amortizueshme të një AAM-je ose një AAJM-je përgjatë jetës së tij të dobishme, Jeta e dobishme është: (a) periudha gjatë të cilës një aktiv pritët të përdoret nga njësia. Amortizimi në shumën 60,369,399 lekë zvogëlon me jetën e dobishme/ periudhën që aktivi “Ndërtesa dhe Konstruksiione” do të përdoret nga MK.

Për vitin 2019, në zbatim të urdhrit të Ministrit nr. 7525, datë 30.12.2019 “Mbi kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve në magazinë për vitin 2019” është përfunduar procesi i inventarizimit të aktiveve në magazinë dhe është dokumentuar me Memo drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm me nr. 7525/1, datë 17.01.2019. Për vitin 2019 nuk është kryer një proces i plotë i verifikimit fizik dhe cilësor të gjithë aktiveve në administrim të MK.

Titulli i gjetjes nr. 1	Mungesa e dokumenteve justifikuese
Situata:	1. Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve për vitin 2018 u konstatua se, likuidimi urdhër shpenzimeve është kryer në masën 35% të tyre në muajin dhjetor, ndërsa në muajt e tjerë konstatohet një ekzekutim në masën mesatare 6%. Për vitin 2019 likuidimet e kryera në muajin dhjetor përbëjnë 23% të shpenzimeve të gjithë vitit, me një mesatare të muajve të tjerë prej rreth 11%. Nga 108 urdhër shpenzime të audituara për të dy vitet, 19 prej tyre, ose 18% nuk kanë dokumente të plotë bashkëlidhur, në kundërshtim me UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Pika 34 dhe Pika 36. 2. Ministria e Kulturës për periudhën në auditim, ka kryer transferta bankare në shumën 6,486,395 lekë në Ambasadën e RSH në Romë, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur midis MK dhe MEPJ me nr. 77, datë 11.02.2016. Në të është parashikuar përfshirja e një punonjësi në personelin e misionit diplomatik, si koordinator i MK për çështjet kulturore. Gjatë auditimit u konstatua se në MK nuk ka raporte të punës të punonjësit në fjalë, apo produktet të tjera, si dokumente justifikues. Ky veprim bie në kundërshtim me UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Pika 34, por dhe me Marrëveshjen e lidhur midis dy ministrive, Seksioni “Komunikimi”: “Punonjësi do të ushtrojë funksionin e saj në bazë të detyrave të marra nga titullari i përfaqësisë diplomatike dhe nga Titullari i MK, si dhe raporton në MEPJ dhe MK. Çdo anashkalim i këtij detyrimi përbën shkelje të disiplinës”. Në vijim të saj, konstatohet se rinovimi i Marrëveshjes me nr. 697/3, datë 05.02.2019 është në kundërshtim me paragrafin e Marrëveshjes nr. 77, datë 11.02.2016: “Pas mbarimit të periudhës 3 vjeçare, bazuar në rezultatet e punës dhe më pëlqimin e palëve, marrëveshja mund të rinovohet edhe për një mandat tjetër”, pasi në MK nuk ka të dhëna dokumentare mbi rezultatet e punës së



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	<i>këtij punonjësi.</i>
Kriteri:	UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e dokumenteve justifikuese në shpenzimet e kryera nga MK
Shkaku:	Mungesa e zbatimit të dispozitave ligjore
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	1. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar/ Sektori i Financës të marrë masa në plotësimin e të gjithë dokumentacionit shoqërues të çdo urdhër shpenzimi, në funksion të justifikimit të plotë të librave të ditarëve, duke lejuar kontrollin e mëvonshëm. 2. Për shpenzimet e kryera në drejtim të Ambasadës së RSH në Romë, MK të marrë masa në lidhje me dokumentimin e punës së kryer nga përfaqësuesi i saj, si dhe të bazojë marrëveshjet e lidhura të këtij lloji mbi rezultate të dokumentuara. Në kushtet e mungesës së tyre të vijoje me ndërprerjen e vazhdimësisë së marrëveshjes.

Titulli i gjetjes nr. 2	Mungesa e procesit rigoroz të inventarizimit
Situata:	Gjatë auditimit u konstatua se në zbatim të Urdhrit përkatës të Ministrit për vitin 2018/ 2019, janë ngritur Komisionet e Inventarizimit. Për vitin 2018 procesi i inventarizimit të gjithë aktiveve të MK ka përfunduar jashtë datës së përcaktuar në urdhër, dokumentuar në Memon drejtuar Nënpunësit Autorizues me nr. 3393, datë 23.05.2019 dhe përtej raportimit të pasqyrave të aparatit të MK në Degën e Thesarit. Për vitin 2019 është kryer vetëm inventarizim i aktiveve në magazinë dhe përfundimet janë dokumentuar në Memon drejtuar NA me nr. 7525/1, datë 17.01.2019. Rezultatet e inventarizimit në dy vitet nën auditim nuk janë formuluar në një relacion. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar Neni 7, Pika 1, Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeversijes së përgjithshme”, Kreu 3.1, Pika 30 dhe me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli II , Pika 1.1.
Kriteri:	Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar Neni 7, Pika 1, Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeversijes së përgjithshme”, Kreu 3.1, Pika 30 dhe me VKM NR. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli II , Pika 1.1.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Ndikimi/Efekti:	Kryerjepjesore dhe jashtë afatit të raportimit financiar, të procesit të inventarizimit të aktiveve
Shkaku:	Mungesa e zbatimit të dispozitave ligjore
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	MK, në linjë hierarkike, NA, NZ dhe personeli i përfshirë, të marrin masat që në proceset e inventarizimit të rradhës, të përfundohet numërimi sasior dhe cilësor i të gjithë aktiveve, brenda afatit të raportimit të pasqyrave financiare në funksion kjo edhe të rritjes së saktësisë dhe besueshmërisë së pasqyrave financiare. Rezultatet e inventarizimit në cdo rast duhet të dokumentohen me një relacion përkatës.

4. Auditimi i llogarive vjetore.

- a. *Auditimi i bilancit kontabël dhe plotësimi pasqyrave financiare.*
- b. *Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve.*
- c. *Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.*
- d. *Auditimi i pasqyrës së fluksit të mjeteve financiare.*

a. Auditimi i bilancit kontabël dhe plotësimi pasqyrave financiare

Në Ministrinë e për Evropën dhe Punët e jashtme mbajtja e kontabilitetit për vitin 2018, është bërë në bazë të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ndërsa, struktura, funksionimi dhe mbyllja e llogarive vjetore është bërë në bazë të Vendimit të KM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësisve që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998” dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

I. Nga auditimi u konstatua se:

Pasqyrat financiare vjetore të MK për vitin 2018 janë plotësuar në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. dhe përbëhen nga:

1. Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar;
2. Formati 2- Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
3. Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare;
4. Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

5. Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
6. Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
7. Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto.
8. Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave

Pasqyrat financiare të vitit 2018 dhe vitit 2019 janë depozituar në Degën e Thesarit Tiranë përkatësisht me shkresat nr. 1882, datë 19.03.2019, “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2018” duke respektuar afatet ligjore. *Pasqyrat financiare të vitit 2018 janë miratuar nga Nëpunësi autorizues i MK.*

b. Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Për vitin 2018 konform UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Pika 25. Pasqyrat financiare vjetore të MK përbëhen nga:

- ☐ Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar;
 - ☐ Formati 2- Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
 - ☐ Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare;
 - ☐ Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto;
 - ☐ Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
- Pika 26. *Pasqyrat financiare vjetore shoqërohen nga disa pasqyra statistikore të cilat janë:*
- ☐ Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
 - ☐ Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto.
 - ☐ Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Pika 27. *Formatet e pasqyrave financiare dhe statistikore miratohen me këtë udhëzim dhe janë paraqitur në aneksin 2 bashkëlidhur.*

Formatet e miratuara që shoqërojnë llogarinë vjetore të aparatit të vitit 2018, janë plotësuar si më poshtë:

Në këtë pasqyrë përfshihen të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2018, në vlerën 355,243,250 lekë, analizuar si më poshtë:

- Në postin 71 “Të ardhura jo tatimore” shuma 23,617,801 lekë dhe përfshihen (7109) të ardhura nga sponsorizimet.
- Në postin 76 “Të ardhura financiare” shuma 77,835 janë të ardhurat nga këmbimet valutore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

- Në postin 72 “Grante Korrente” shuma 331,547,614 lekë paraqet transfertat nga buxheti i shtetit (7200) për MK në vlerën 298,871,456 lekë, Financimi i pritshëm nga buxheti (7206) në vlerën 9,071,173 lekë përputhet me llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, (7207) sponsorizime nga ORD në vlerën 23,604,985 lekë.

Pasqyra 2 “Performanca financiare” është plotësuar si më poshtë:

Tabela nr. 1: “Pasqyra e performancës financiare të ushtrimit 2018 për aparatin e MK”

Në lekë

Nr. Llogarie	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	Viti 2018	Viti 2017	Ndryshimi	Në %
A	TE ARDHURAT	355,243,250	337,959,397	17,283,853	5%
71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	23,617,801	28,347,097	-4,729,296	-17%
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore	23,617,801	28,347,097	-4,729,296	-17%
76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	77,835	0	77,835	
766	Nga kembimet valutore	77,835		77,835	
72	V.GRANTE KORENTE	331,547,614	309,612,300	21,935,314	7%
720	1.Grant korent I Brendshem	331,547,614	309,612,300	21,935,314	7%
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	298,871,456	294,656,273	4,215,183	1%
7206	Financim I pritshem nga buxheti	9,071,173	7,764,268	1,306,905	17%
7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)	23,604,985	7,191,759	16,413,226	228%
B	SHPENZIMET	329,486,105	330,523,634	-1,037,529	0%
600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	79,719,941	73,721,483	5,998,458	8%
6001	Paga, personel I perhershëm	79,719,941	69,983,314	9,736,627	14%
6002	Paga personel I Perkohshëm		3,738,169	-3,738,169	-100%
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	12,693,748	11,561,896	1,131,852	10%
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	12,693,748	11,561,896	1,131,852	10%
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	59,857,841	66,762,404	-6,904,563	-10%
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	4,344,502	3,400,217	944,285	28%
6022	Sherbime nga te trete	7,438,904	12,307,960	-4,869,056	-40%
6023	Shpenzime transporti	4,995,068	5,267,090	-272,022	-5%
6024	Shpenzime udhetimi	12,920,458	7,633,635	5,286,823	69%
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	1,977,720	645,720	1,332,000	206%
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	9,516,940	22,789,302	-13,272,362	-58%
6029	Shpenzime te tjera operative	18,664,249	14,718,480	3,945,769	27%
	V.TRANSFERIME KORENTE	185,094,366	164,011,494	21,082,872	13%
604	1.Transferime korente te brendshme	154,889,121	160,188,094	-5,298,973	-3%
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	154,889,121	160,188,094	-5,298,973	-3%



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

605	2.Transferime korente me jashte	29,925,245	2,687,760	27,237,485	1013%
6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare	29,925,245	2,687,760	27,237,485	1013%
606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	280,000	1,135,640	-855,640	-75%
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	280,000	1,135,640	-855,640	-75%
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	-7,879,791	14,466,357	-22,346,148	-154%
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDES(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)	25,757,145	7,435,763	18,321,382	246%

Burimi: MK, Përpunuar nga grupi i auditimit

Shpenzimet e konstatuara gjatë vitit 2018 kapin vlerën 329,486,105 lekë. analizuar si më poshtë:
Llog. 600 “Paga e shpenzime personeli” për 79,719,941 lekë, në këtë post janë paraqitur pagat e personelit, gjatë vitit ushtrimor 2018, përgjatë muajve shkurt 2018-dhjetor 2018.

Llogaria 601 “Kontribute të Sigurimeve Shoqërore” për 12,693,748 lekë,që paraqet shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi.

Llogaria 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” për 59,857,841 lekë që paraqet shpenzimet për blerje mallrash dhe shërbimesh të analizuar si më poshtë:

Llog. 6020 “Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme” për 4,344,502 lekë e cila paraqet shpenzimet që institucionet kanë kryer për blerje tonerash në vlerën 2,198,903 lekë, materialesh pastrimi në vlerën 549,600 lekë, materialesh elektrike në vlerën 812,400 lekë dhe kancelari në vlerën 783,599 lekë gjatë vitit 2018.

Llog. 6022 “Shërbime nga të tretët”për shumën 7,438,904 lekë përfaqëson shpenzimet që institucionet tona kryejnë realizuar me shërbime nga të tretët energji elektrike në vlerën 1,854,540 lekë, ujë në vlerën 63,857 lekë, postë në vlerën 363,095 lekë, komunikim në vlerën 1,736,037 lekë, komisione bankare në vlerën 113,570 lekë dhe shërbim roje në vlerën 3,307,805 lekë.

Llog. 6023 “Shpenzime transporti” për shumën 4,995,068 lekë përfaqësojnë shpenzime për automjetet e institucioneve si karburant në vlerë 2,002,275 lekë, pjesë këmbimi dhe riparime mjetesh në vlerën 950,456 lekë, sigurim i automjeteve dhe shërbime të ndryshme në vlerën 806,971 lekë, Diferenca “shërbime pastrimi” në vlerën 1,235,366 lekë, regjistruar gabim, jo në llogarinë përkatëse shtatëshifrore.

Llog. 6024 “Shpenzime udhëtimi” për shumën 12,920,458 lekë përfaqësojnë shpenzimet për pagesën e biletave të udhëtimit të punonjësve që largohen me punë jashtë vendbanimit në vlerën 10,136,325 lekë dhe dietave dhënë punonjësve në vlerën 2,784,133 lekë.

Llog. 6025 “Mirëmbajtje të zakonshme” për shumën 1,977,720 lekë janë shpenzimet që janë bërë për mirëmbajtje dhe riparime të zakonshme të AQT-ve të tyre në vlerën 777,720 lekë dhe mirëmbajtje godinë në vlerën 1,200,000 lekë.

Llog. 6027 “Shpenzime për detyrime për kompensime legale” për shumën 9,516,940 lekë janë shpenzimet që janë bërë për shpenzimet gjyqësore dhe likuiduar përgjatë vitit 2018.

Llog. 6029 “Shpenzime të tjera Operative” për shumën 18,664,249 lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kritereve të klasifikimit buxhetor, si: shpenzime për pritje përcjellje në vlerën 837,371 lekë, energji elektrike paguar për TOB në vlerën 3,530,685 lekë, transferta për Znj. Leida Mirakaj Sekreatre e Parë në Ambasadën në Romë për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

sektorin e Kulturës në vlerën 2,947,500 lekë, etj. Nga krahasimi i llogarisë sintetike 6029 me llogaritë analitike konstatohet një diferencë prej 77,832 lekësh.

Llog. 63 me vlerën – 7,879,791 lekë, ndikon në Fondin Bazë, dhe në rezultatin e MK.

c. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të balanceve rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Pasqyra e pozicionit financiar me tregues të reduktuar për grupet e llogarive të aktivit paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 2: “Gjendja e aktivit në fund të vitit 2018 për aparatin e MK”

Në lekë

Nr. Llog	Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2017	Ndryshimi	Në %
A	A K T I V E T	2,660,802,054	1,991,208,139	669,593,915	34%
	I.Aktivet Afat shkurtra	192,592,881	152,210,650	40,382,231	27%
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	87,057,109	62,600,903	24,456,206	39%
520	Disponibilitete ne Thesar	87,057,109	62,600,903	24,456,206	39%
	2.Gjendje Inventari qarkullues	23,778,401	15,898,610	7,879,791	50%
31	Materiale	18,401,713	13,204,612	5,197,101	39%
32	Inventar I imet	5,376,688	2,693,998	2,682,690	100%
	3.Llogari te Arketueshme	42,252,577	39,581,583	2,670,994	7%
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	10,028,556	9,991,527	37,029	0%
468	Debitore te ndryshem	23,152,848	23,152,848	0	0%
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	9,071,173	6,437,208	2,633,965	41%
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	39,504,794	34,129,554	-34,129,554	-100%
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	39,504,794	34,129,554	5,375,240	16%
	II.Aktivet Afat gjata	2,468,209,173	1,838,997,489	629,211,684	34%
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	91,759,507	43,434,714	48,324,793	111%
202	Studime dhe kerkime	91,759,507	43,434,714	48,324,793	111%
21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,229,642,071	747,271,172	482,370,899	65%
210	Toka, Troje, Terrene	261,298,634	248,524,634	12,774,000	5%
212	Ndertesa e Konstruksione	861,657,448	325,056,865	536,600,583	165%
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	17,847,104	22,608,880	-4,761,776	-21%
215	Mjete Transporti	6,838,286	11,035,014	-4,196,728	-38%



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

218	Inventar ekonomik	82,000,599	140,045,779	-58,045,180	-41%
	4.Investime	1,146,807,595	1,048,291,603	98,515,992	9%
231	Per Aktive Afatgjata materiale	1,146,807,595	1,048,291,603	98,515,992	9%
B	PASIVET(DETYRIMET)	149,875,815	114,515,925	35,359,890	31%
	I.Pasivet Afat shkurtra	149,875,815	114,515,925	35,359,890	31%
	1. Llogari te Pagueshme	149,875,815	114,515,925	35,359,890	31%
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	24,633,654	19,793,454	4,840,200	24%
42	Detyrime ndaj personelit	6,123,261	4,299,048	1,824,213	42%
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	626,577	473,489	153,088	32%
435	Sigurime Shoqerore	2,051,555	1,473,427	578,128	39%
436	Sigurime Shendetsore	269,780	191,244	78,536	41%
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	68,118,445	40,804,788	27,313,657	67%
467	Kreditore te ndryshem	14,871,140	14,336,100	535,040	4%
4341	Operacione me shtetin(detyrime	33,181,403	33,144,375	37,028	0%
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	2,471,421,445	1,876,692,214	594,729,231	32%
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	2,510,926,239	1,876,692,214	634,234,025	34%
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,337,300,189	820,924,848	516,375,341	63%
12	Rezultatet e mbartura	1,061,310		1,061,310	
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	25,757,145	7,435,763	18,321,382	246%
14		1,146,807,595	1,048,331,603	98,475,992	9%
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	2,660,802,054	1,991,208,139	669,593,915	34%

Burimi: MK, përpunuar nga grupi i auditimit

Sipas pasqyrave financiare vjetore për vitin 2018 në Aktivin e Bilancit Kontabël rezultojn se:
 - Më datë 31.12.2018 “Aktivet afatgjata” zënë 93 % të vlerës totale të aktivitetit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 7% të totalit.

Aktivet e Qëndrueshme sipas zërave të llogarive përbëhen nga:

Tabela nr. 3: “Gjendja e AQT në fund të vitit 2018 për aparatin e MK”

Në lekë

Nr.	Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2017	Ndryshimi	Pesha specifike
Total	II.Aktivet Afat gjata	2,468,209,173	1,838,997,489	629,211,684	100%
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	91,759,507	43,434,714	48,324,793	4%
202	Studime dhe kerkime	91,759,507	43,434,714	48,324,793	
21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,229,642,071	747,271,172	482,370,899	50%
210	Toka, Troje, Terrene	261,298,634	248,524,634	12,774,000	33%



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

212	Ndertesa e Konstruksione	861,657,448	325,056,865	536,600,583	43%
214	Instalime teknike, makineri e paisje	17,847,104	22,608,880	-4,761,776	3%
215	Mjete Transporti	6,838,286	11,035,014	-4,196,728	1%
218	Inventar ekonomik	82,000,599	140,045,779	-58,045,180	19%
	4. Investime	1,146,807,595	1,048,291,603	98,515,992	46%
231	Per Aktive Afatgjata materiale	1,146,807,595	1,048,291,603	98,515,992	

Burimi: MK, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga krahasimi i të dhënave të regjistrit të aktive, me regjistrimin në kontabilitet në llogarinë 231 dhe 218 kontatohet se janë blerë pajisje në vlerat 354,640 lekë; pajisje kompjuterike në vlerë 899,340 dhe blerë pajisje rafte në vlerën 446,400 lekë, në vlerë totale 1,700,380, për të cilat kontabilizimi është kryer fillimisht në llogarinë e shpenzimeve për investime në proces 231 dhe në fund të periudhës është bërë debitimi i llogarisë 215 të aktivit përkatës. Në regjistrin e aktiveve nuk është bërë reflektimi i këtyre pajisjeve të blera përgjatë vitit 2018.

Llogaria 231 “Investime për rritjen e aktiveve afatgjata” në fund të vitit ushtrimor 2018 konstatohet të jetë në vlerën 1,146,807,595 lekë dhe përbën 46% të totalit të aktiveve afatgjata. Kjo llogari përfaqëson aktive të qëndrueshme ende në proces dhe që nuk janë në funksionim dhe nuk janë kapitalizuar. Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto bëhen funksionale dhe kapitalizohen në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara.

Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” ka pësuar një rritje përgjatë vitit 2018 në vlerën 48,324,793 lekë, nga të cilat projekti i Muzeut Historik Kombëtar është regjistruar në vlerën 39,960,000 lekë dhe projekti i Galerisë së Arteve është regjistruar në vlerën 14,880,000 lekë dhe vlera 6,515,207 përfaqëson amortizimin e akumuluar të kësaj llogarie. Nga krahasimi i likuidimeve të kryera, konstatohet se në lidhje me projektin e Muzeut Historik Kombëtar, përsa i përket vitit 2018, është likuiduar shuma totale 35,000,000 lekë, konkretisht në urdhër shpenzimet nr. 781 dhe 946. Nga gjendja analitike e kësaj llogarie, konstatohet se në përbërje të saj është ende projekti “Teatrit kombëtar të fëmijëve dhe odeoni i QNK” në vlerën 42,913,004 lekë, i cili amortizohet në këtë llogari, pa u zbatuar si projekt.

Llogaria 210 “Toka, Troje dhe Terrene” ka pësuar një rritje në vlerën 12,774,000 lekë, si rezultat i kalimit në administrim të Repartit ushtarak nr. 3042 Sauk të MK, me qëllimin, për tu përdorur për ndërtimin e “Qendrës së Artit dhe të Zejeve”.

Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione” është rritur me vlerën 536,600,583 lekë kundrejt vitit 2017. Rritja konsiston në regjistrimi në kontabilitet të Godinës së Teatrit Skena e re në vlerën 479,629,493 lekë, Laboratorit të filmit në vlerën 15,624,924 lekë dhe Godinës së Repartit ushtarak nr. 3042 Sauk në vlerën 371,099 lekë.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” është ulur në vlerën -4,761,776 lekë, si rezultat I amortizimit të vjetor 2018 në vlerën 4,521,776 lekë dhe transferimit kapital në vlerën 240,000 lekë.

Llogaria 215 “Mjete transporti” është ulur në vlerën -4,196,728 lekë, si rezultat I amortizimit vjetor në vlerën 2,583,583 lekë dhe transferimit kapital në njësi të varësisë në vlerën 1,613,145 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” është ulur në vlerën 58,045,180 lekë, si rezultat i amortizimit vjetor në vlerën 3,749,362 lekë, blerjeve gjatë vitit pa pagesë në vlerën 26,186,266 lekë (sistemi i biletarisë dhe blerjet gjatë vitit) dhe pakësimit të kostos historike, si rezultat i transferimit kapital të sistemit të dixhitalizimit, kasave fiskale të akumuluar prej disa vitesh dhe bërë transferim në njësitë e varësisë në vitin 2018, në vlerën 80,482,084 lekë (përbëhet kryesisht nga kalimi kapital bërë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit).

Sipas procesverbalit të mbajtur në datë 05.12.2013 midis dy specialistëve të financës Znj. A. S dhe M. B gjatë marrjes së detyrës (aktualisht përgjegjëse sektori në Sektorin e Financës), konstatohet se në zërin e inventarit ekonomik ka patur aktive në shumën 52,923,000 lekë, për të cilat nuk ka patur dokumentacion justifikues.

Aktivet Afatshkurtra në fund të vitit 2018, rezultojnë me gjendje në vlerën 192,592,881 lekë dhe sipas zërave paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 4: “Gjendja e Aktive afatshkurtra në fund të vitit 2018 për aparatin e MK”

Në lekë

Nr.	Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2017	Ndrysh 2018-2017	Pesha specifike 2018
A	A K T I V E T	2,660,802,054	1,991,208,139	669,593,915	7%
	I.Aktivet Afat shkurtra	192,592,881	152,210,650	40,382,231	100%
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	87,057,109	62,600,903	24,456,206	
520	Disponibilitete në Thesar	87,057,109	62,600,903	24,456,206	45%
	2.Gjendje Inventari qarkullues	23,778,401	15,898,610	7,879,791	12%
31	Materiale	18,401,713	13,204,612	5,197,101	
32	Inventar I imet	5,376,688	2,693,998	2,682,690	
	3.Llogari te Arketueshme	42,252,577	39,581,583	2,670,994	22%
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	10,028,556	9,991,527	37,029	
468	Debitore te ndryshem	23,152,848	23,152,848	0	
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	9,071,173	6,437,208	2,633,965	
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	39,504,794	34,129,554	-34,129,554	21%
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	39,504,794	34,129,554	5,375,240	

Burimi: MK, përpunuar nga grupi i auditimit

Sipas UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 49. Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme. Pasqyrimi në vlerën 87,057,109 lekë në fundvitin 2018, përbëhet nga sponsorizimet nga ORD të cilat trashëgohen në vitin në vazhdim në vlerën 17,877,354 lekë dhe nga gjendja e mjeteve në ruajtje sipas llogarisë 466 që rezulton në vlerën 68,118,445, në vlerën totale 85,995,799 dhe 1,061,310 lekë sponsorizimet e papërdorura nga viti 2017.

Dhe Pika 50 e udhëzimit. Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkangjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet). Në llogaritë vjetore të vitit 2018 ka një aktrakordim me thesarin për “Kreditorët për mjete në ruajtje”, llogari e cila në pozicionin financiar të datës 31.12.2018 reflekton vlerën 68,118,445 lekë. Rritja prej vitit 2017 konsiston në vlerën 27,313,657 lekë, për mbajtjen e garancisë së punimeve.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet në vlerën 9,071,173 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka MK ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2017, përkatësisht për pagat në vlerën 6,123,261 lekë, për tatim taksa në vlerën 626,577 lekë, për sigurime shoqërore në vlerën 2,05,555 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 269,780 lekë, të cilat paguhen në vitin në vijim. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 421, 431, 435 dhe 436.

Klasa 3 “Gjendja e inventarit”, në fund të vitit 2018, rezulton në vlerën 23,778,401 lekë dhe ndaj totalit të Aktiveve Qarkulluese zë 12%. Në krahasim me vitin 2017, është rritur në vlerën 7,879,791 lekë, nga rritja e zërit “Materiale” si rezultat i blerjeve dhe hyrjeve në magazinë në vlerën 5,197,101 lekë më shumë se një vit më parë dhe nga rritja e zërit “Inventar i imët” si rezultat i blerjeve në vlerën 2,682,690 lekë më shumë se një vit më parë. Diferenca 7,879,791 përkon me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit.

Llog. 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 10,028,556 lekë, përbëhet nga paradhënie në euro dhe \$ punonjësve, të pambyllura ende edhe në 2018, që mbarten në 2019. Këto pasqyrojnë detyrimet e punonjësve përgjatë viteve 2002-2012 për paradhëniet në valutë dhe ende të pambyllura.

Llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 23,152,848 lekë përfaqëson detyrime të subjekteve private dhe ish punonjësve. Kjo llogari në vitin 2018 ka qëndruar e pandryshuar kundrejt vitit 2017.

Llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në vlerën 39,504,794 lekë përfaqëson detyrime për fatura të palikujduara për blerjet materiale, shërbime dhe investime të kryera. Ka si kundërparti llogaritë 401 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, 404, 467 “Kreditorë të ndryshëm”, përkatësisht në vlerat 13,128,879 lekë, 11,504,775 lekë dhe 14,871,140 lekë.

Nga auditimi i gjendjes debitore të llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogarinë sintetike dhe ato analitike.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2018, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 149,875,815 lekë, rritur në vlerën 35,359,890 lekë kundrejt vitit 2017. Në këtë rritje ndikimin më të lartë e ka patur llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Fondi i konsoliduar përbëhet nga llogaritë 101 “Fondi bazë” në vlerën 1,337,300,189 lekë, nga llogaria 12 “Rezultati i mbartur” në vlerën 1,061,310 lekë që paraqet sponsorizimet e mbartura nga vitet e kaluara, dhe llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 25,757,145 lekë, që paraqet sponsorizimet e vitit 2018 në shumën 17,877,354 lekë dhe ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 7,879,791 lekë.

Tabela nr. 5: “Fondi i konsoliduar për vitin 2018”

Në lekë

D	FONDI I KONSOLIDUAR:	2,510,926,239	1,876,692,214	634,234,025	34%
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,337,300,189	820,924,848	516,375,341	63%
12	Rezultatet e mbartura	1,061,310		1,061,310	
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	25,757,145	7,435,763	18,321,382	246%
14		1,146,807,595	1,048,331,603	98,475,992	9%
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	2,660,802,054	1,991,208,139	669,593,915	34%

Burimi: MK

Rakordimi me pasqyrat e tjera financiare:

Formati 4- “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto”;

Kjo pasqyrë jep informacionin mbi gjendjen dhe ndryshimin e aktiveve dhe fondeve neto të MK për vitin raportues.

Sipas rreshtave, në këtë pasqyrë financiare janë evidentuar:

Në rubrikën I, evidentohen shumat përkatëse për gjendjen e fondeve/aktiveve neto në fillim të periudhës ushtrimore, për çdo zë të pasqyruar në kolonat nga 1 deri në 5, në shumën totale 820,924,848 lekë i përbërë nga fondi bazë dhe grantet kapitale.

Në rubrikën II, evidentohen për çdo zë të pasqyruar në kolonat nga 1 deri në 5, ndryshimet në aktivet/fondet neto, që rrjedhin nga: burime të brendshme në shumën 1,055,767,366 lekë nga fondi bazë dhe 610,810,630 lekë nga rezultati i shtrimit si dhe burime të jashtme në shumën 23,423,395 lekë nga rezultati i vitit ushtrimor.

Në fund të pasqyrës, pasqyrohet totali i fondeve të veta (si shumë e rubrikës I dhe rubrikës II), për çdo zë të pasqyruar në kolonat nga 1 deri në 5 në shumë fillestare 1,876,692,214 lekë dhe shumë në fund të vitit 2018 prej 2,510,926,239 lekë.

Totali i fondeve të vet të kësaj pasqyre është i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Formati 5- *“Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore”*.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme përmbajnë informacion sqarues, përveç atij që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve neto/fondeve neto. Dhënia e tyre është bërë sipas formatit të përcaktuar nga Ministria e Financave dhe krahas tij pasqyrat shoqërohen dhe me një relacion tjetër shpjegues.

Sipas pikës 85 të UMFE nr. 8 ... *“Shënimet shpjeguese japin informacion në lidhje me:... problemet e ndryshme që mund të kenë rezultuar gjatë përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave financiare”*, por në asnjë nga këto shënime shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra nuk ka detaje në lidhje me problematikën që ka shoqëruar invenarin ekonomik të MK, për të cilin janë kryer veprime kontabël në lidhje me amortizimin e akumuluar, i cili tejkalonte koston historike.

Formati 6- *“Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre”*;

Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre, sipas rreshtave, përbëhet nga:

Rubrika I *“Shpenzimet për investime”*, përbëhet nga zëra si: shpenzime për aktive afatgjata materiale, me gjendje fillestare në shumën 1,048,291,603 lekë dhe gjendje në fund të vitit me vlerën 1,146,807,595 lekë.

Rubrika II *“Burimet për investime”* përbëhet nga grante të huaja kapitale për pjesëmarrje në investimet në të tretë në shumën fillestare 1,048,331,603 lekë dhe vlerë përfundimtare 1,146,807,595 lekë.

Rubrika III *“Balanca”* përfaqëson diferencën mes rubrikës II dhe rubrikës I në shumën 1,061,310 lekë, që përputhet me rezultatin e mbartur të vitit 2017.

Formati 7- *“Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto”*.

Pasqyra statistikore e Formatit 7/a mbi gjendjen dhe ndryshimet e AAGJ me kosto historike është plotësuar si më poshtë:

Gjendja fillestare e AAGJ rezulton në vlerën 941,681,206 lekë

Shtesat përgjatë vitit 2018 kanë ardhur si rezultati blerjeve me pagesë në shumën 552,165,887, ku blerjet kryesore rezultojnë në zërin ‘Ndërtime dhe Konstruksione’, shtesa pa pagesë nga jashtë sistemit në shumën 36,197,395 lekë në zërin “Inventari ekonomik”, shtesa nga brenda sistemit në shumën 822,500 lekë, lëvizje brenda aktiveve në shumën 240,000 lekë.

Pakësimet e koston historike kapin shumën 82,335,229 lekë, si pakësime të tjera në të cilën ka ndikuar kryesisht pakësimi në koston historike të zërit “Inventari ekonomik” në shumën 80,482,084 lekë. Ky pakësim nuk i përket nxjerrjeve jashtë përdorimit dhe as shitjeve, por transferimit kapital në njësitë e varësisë. Në lidhje me të nuk ka shpjegime informuese në shënimet shpjeguese.

Gjendja në fund të periudhës ushtrimore të mbyllur, paraqitet në shumën 1,448,771,759 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Tabela nr. 6: Formati 7/b Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (me vlerën neto) për vitin 2018:

Në lekë

E M E R T I M I	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Amorti zim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amorti zim Akumuluar	Teprica Neto
c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
I. AAGJ/JO MATERIALE	43,434,714	0	43,434,714	54,840,000	6,515,207	0	0	98,274,714	6,515,207	91,759,507
Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			0					0	0	0
Studime dhe kerkime	43,434,714		43,434,714	54,840,000	6,515,207			98,274,714	6,515,207	91,759,507
Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme			0					0	0	0
II. AAGJ/ MATERIALE	898,246,492	150,975,320	747,271,172	534,585,782	30,249,053	142,704,628	60,369,399	1,290,127,646	120,854,974	1,169,272,672
Toka,troje,Terene	248,524,634		248,524,634	12,774,000				261,298,634	0	261,298,634
Pyje,Kullota Plantacione	0		0					0	0	0
Ndertime e Konstruksione	445,219,233	120,162,368	325,056,865	495,625,516	19,394,332	60,369,399	60,369,399	880,475,350	79,187,301	801,288,049
Instalime teknike,makineri,paisje,vegl a pune	32,302,054	9,693,174	22,608,880		4,521,776	240,000		32,062,054	14,214,950	17,847,104
Mjete transporti	15,705,563	4,670,549	11,035,014		2,583,583	1,613,145		14,092,418	7,254,132	6,838,286
Inventar ekonomik	156,495,008	16,449,229	140,045,779	26,186,266	3,749,362	80,482,084		102,199,190	20,198,591	82,000,599
TOTALI (I + II)	941,681,206	150,975,320	790,705,886	589,425,782	36,764,260	142,704,628	60,369,399	1,388,402,360	127,370,181	1,261,032,179

Burimi: MK

Formati 7/b Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (me vlerën neto), sipas rreshtave, përfaqëson:

Rubrika I “aktive afatgjata jomateriale”, e cila përfshin studime dhe kërkime paraqitet me tepricë në fillim në shumën 43,434,714 lekë dhe tepricë në fund në shumën 91,759,507 lekë, me amortizim të akumuluar në shumën 6,515,207 lekë.

Rubrika II “aktive afatgjata materiale”, e cila përfshin zëra si: toka, troje, pyje, ndërtime e konstruksione, mjete transporti, dhe inventar ekonomik, paraqitet me Tepricë fillestare 898,246,492 lekë dhe Tepricë përfundimtare në shumën 1,169,272,672 lekë. Në të konstatohet se amortizimi i akumuluar kap vlerën 127,370,181 lekë, ku peshën specifike më të lartë e ka zëri “Ndërtime dhe Konstruksione” në shumën 79,187,301 lekë, ose 62%. Amortizimi i këtij zëri paraqitet me vlerë të fillestare të mbartur prej vitit 2017 në shumën 120,162,368 lekë, ka pësuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

pakësim si amortizim që i përket vitit 2018 në shumën 60,369,399 lekë dhe ka pësuar rritje për shtesat/blerjet e bëra gjatë vitit në shumën 19,394,332 lekë, duke bërë që amortizimi i akumuluar i këtij zëri deri në fund të vitit 2018 të paraqitet në shumën 79,187,301 lekë. Pakësimi i amortizimit prej 60,369,399 lekë nuk ka shpjegim në shënimet shpjeguese.

Sipas Sektorit të Financës në vitin 2013 nuk ka patur inventar fizik të aktiveve si dhe as regjistër për aktivet ku llogaritet amortizimi.

Amortizimi i aktiveve deri në daljen e Udhezimit të ministrisë së Financave Nr 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2017” është pasqyruar në aktiv pasqyrave financiare në LLog 219 me minus dhe aktivet pasqyroheshin me vlerën fillestare.

Sipas udhëzimit të mësipërm vlera e aktiveve në bilanc do të pasqyrohet me vlerën neto. Deri më datë 31.12.2017 vlera e akumuluar e amortizimit përbëhej nga shuma 150,975,320 lekë. Nga llogaritja që u bë sipas rregjistrimit të aktiveve rezultonte që amortizimi është llogaritur më tepër se duhej në shumën 60,369,399 lekë, si rezultat për këtë u bë sistemim, pra u pakësua amortizimi i llogaritur tepër, analitikisht sipas pasqyrës së mëposhtme:

Tabela: “Diferenca e amortizimit në pasqyrat financiare me regjistrin analitik të aktiveve të MK”

Në lekë

Emërtimi	Nr llog	Amortizimi i akumuluar 31.12.2017	Amortizimi 2018	Amortizimi i akumuluar 31.12.2018
Amortizimi Fakt ne bilanc 2017		150.975.320		
Aktivet jo mater	202		6,515,207	6,515,207
Makina	215	4,670,549	2,583,583	7,254,132
Inv Ek Komp	218	4,586,826	1,725,503	6,312,329
Inv Ek	218	492,524	2,023,859	2,516,383
Ndert	212	59,792,969	19,394,332	79,187,301
Instalime	214	9,693,174	4,521,776	14,214,950
Inv Ek Komp Viteve K	218	9,369,879		9,369,879
Ne Mag Në Perd	218	2,000,000		2,000,000
Sistemim	60,369,399	90,605,921	36,764,260	127,370,181

Burimi: MK

Në pasqyrën 7/b amortizimi i akumuluar i ndërtesës është 120,162,368 lekë, kurse sipas ditarit të aktiveve është 59,792,969 lekë, pra me një diferencë më shumë 60,369,399 lekë, e cila është pasqyruar në pakësimet e amortizimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Sipas UMFE nr. 8, Pika 33. “*Aktivet afatgjata materiale paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike, minus amortizimin e akumuluar. Në lidhje me rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, si bazë ligjore do të shërbejnë Vendimet e Këshillit të Ministrave, ku mbi bazën e aktit të rivlerësimit, njësitë duhet të realizojnë regjistrimet në kontabilitet.*”

Në lidhje me këtë gjetje, në observacionet e projekt raportit të auditimit, MK ka komentuar:

“Lidhur me regjistrin e aktiveve ju sqarojme se sipas procesverbalit 05.12.2013 paraqitur tek ju per marrjen e dorëzimit të detyrës në MK nuk ka patur inventar fizik per asnje aset. Prandaj për këtë arsye është hasur vështirës i në evidentimin dhe përpilimin e këtij regjistri i në baze të dokumentacionit të magazines. Sqarojme se në pasqyrën 7/b amortizimi i akumuluar i ndertesës është 120,162,368 leke kurse sipas ditarit të aktiveve është 59,792,969 lekë, pra me një diferencë me shumë 60,369,399 e cila është pasqyruar në pakesimet e amortizimit. Pra, ky sistemim nuk rendon llog. 212 “Ndertime dhe konstruksione”. Shuma 60,369,399 lekë nuk mund të paraqitet në regjistrin e aktiveve, pas i është ky regjister që saktëson shumën e amortizimit sipas gjendjes faktike të aseteve. Gjatë vitit 2020 janë përpiluar edhe njëherë listat e aseteve sipas programit të sistemit të orakullit dhe në bashkëpunim me MF do të regjistroheshin në këtë sistem gjë që do të saktësojë më tej të dhënat e këtyre aseteve.”

Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH:

Gjatë auditimit janë marrë në konsideratë komentet e sektorit të financës së MK, por nuk ka ndryshuar fakti i mungesës së një evidentimi përkatës të aseteve dhe amortizimit konkret, duke çuar MK në një sistemim kontabël të pa bazuar në dispozitë ligjore. Si vijim gjetja dhe rekomandimi i KLSH do të trajtohen në raportin përfundimtar të auditimit.

Formati 8- “Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave”

Kjo pasqyrë ka të reflektuar informacionin në total, për çdo kategori të punonjësve, në lidhje me fondin e pagave bruto gjithsej në shumën 79,719,941, kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në shumën 12,693,748 lekë, dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi në shumën 6,470,569 lekë. Numri i punonjësve në fillim të periudhës ka qenë 98 punonjës dhe në fund të periudhës 143 punonjës. Kjo pasqyrë është e rakorduar me të dhënat e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare.

e. Auditimi i pasqyrës së fluksit të mjeteve financiare.

Formati Nr. 3 “Pasqyra e flukseve monetare” tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të ministrisë, të shkaktuar nga kryerja e aktivitetit financiar të një viti ushtrimor.

Në *Rubrikën I*, që pasqyron flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e shfrytëzimit të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, totali i flukseve të mjeteve monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e shfrytëzimit është i barabartë me shumën e totalit të zërave: akordim fondesh buxhetore për shpenzime korrente, arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor dhe pagesa për detyrime e shpenzime korrente, në vlerën 8,281,265 lekë. Ka mospërputhje me aktrakordin me thesarin.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Nënrubrika “Akordim fondesh buxhetore për shpenzime korrente” që përfaqëson flukset monetare hyrëse që rrjedhin nga akordimet e fondeve buxhetore për shpenzime korrente, nuk është e rakorduar me të dhënat e thesarit.

Nënrubrika “Arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor” përbëhet nga shuma e zërave si: sponsorizime nga të tretë në shumën 28,637,736 lekë. Në këtë nënrubrikë nuk janë pasqyruar të hyrat nga mjetet në ruajtje në shumën 32,729,687 lekë.

Nënrubrika “Pagesa për detyrime të shpenzime korrente” përbëhet nga shuma e zërave si: pagesa për detyrime të shpenzime nga vitet e kaluara në shumën 400,000 lekë, për detyrime të shpenzime të vitit ushtrimor në shumën 333,110,975 lekë, dhe pagesat për mjetet në ruajtje në shumën 5,416,030 lekë.

Rubrika II, që pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e investimeve përbëhet nga zëra si: akordim fondesh buxhetore për shpenzime kapitale në shumën 720,688,008 lekë dhe pagesa për detyrime dhe investime të vitit ushtrimor në shumën 687,232,650 lekë.

Rubrika III, që pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga transfertat dhe transaksionet e tjera përbëhet nga zëra si: transferime në buxhet të fondeve të papërdorura në shumën 5,017,936 lekë dhe lëvizje të brendshme të transfertave të tjera në shumën 12,260,484 lekë. Në pasqyrimin e bërë në këtë rubrikë konstatohet se nuk përputhet shuma e pasqyruar me aktrakordin e thesarit dhe transferimin e fondeve të papërdorura përgjatë vitit 2018 i cili rezulton të jetë 12,260,484 lekë, të cilat janë pasqyruar gabim në zërin “Lëvizje të brendshme të transfertave të tjera”, duke deduktuar se shuma e pasqyruar në të dy zërat “Transferime në buxhet të fondeve të papërdorura” dhe “Lëvizje të brendshme të transfertave të tjera” të jenë të gabuara. Gjithashtu në këtë rubrikë nuk janë pasqyruar të ardhurat dytësore të MK të transferuara në buxhet. Në vijim ka mospërputhje në pagesat për shpenzime korrente për vitin 2018 në shumën 26,475,251 lekë raportuar më shumë, pasi është reflektuar në pasqyrë në shumën 333,510,975 lekë, ndërkohë që në aktrakordin me thesarin rezulton shuma 307,035,724 lekë. Ka mospërputhje në vlerën e pasqyruar në këtë pasqyrë të pagesave për investime të vitit aktual, pasi në pasqyrë rezulton shuma 687,232,650 lekë, ndërkohë që në aktrakordin me thesarin figuron shuma 719,962,334 lekë, pra 32,729,684 lekë raportuar më pak.

Teprica e likuiditeteve në fund të vitit rakordon me llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” të pasqyrës së pozicionit financiar në shumën 87,057,109 lekë.

Në lidhje me këtë gjetje, në observacionet e projekt raportit të auditimit, MK ka komentuar: “Në lidhje me auditimin e pasqyrës të flukseve të mjeteve financiare për rubrikën III, sqarojmë se shuma 26.475.251 leke nuk është raportuar më shumë. Kjo shumë pasqyron shpenzimet e kryera nga kapitulli 06 (sponsorizime). Në evidencë janë paraqitur shpenzimet nga buxheti për shumën 307.035.724 lekë dhe shpenzimet nga sponsorizimet për shumën 26.475.251 lekë në total 333.510.975 lekë.”

Qëndrim i grupit të auditimit të KLSH:

Merret në konsideratë shpenzimi i kryer për sponsorizimet për vitin 2018 dhe do të vijojnë të trajtohen në raportin përfundimtar të auditimit diferencat e tjera të përmbledhura në gjetje.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Viti 2019

Pasqyrat financiare të vitit 2019 janë dërguar në degën e thesarit me shkresën nr. 1556, datë 31.03.2020 “Dërgimi i pasqyrave financiare për vitin 2019”, të firmosura nga Drejtori i Financës dhe Menaxhimit financiar.

Formatet e miratuara që shoqërojnë llogarinë vjetore të aparatit të vitit 2019, janë plotësuar si më poshtë:

Në këtë pasqyrë përfshihen të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2019, në vlerën 307,082,269 lekë, analizuar si më poshtë:

- Në postin 71 “Të ardhura jo tatimore” shuma 31,113,252 lekë dhe përfshihen (7109) të ardhura nga sponsorizimet për mirëmbajtje në shumën 4,387,144 lekë dhe grante nga organizata ndërkombëtare, Projekti Hamlet në shumën 26,726,107 lekë.

- Në postin 72 “Grante Korrente” shuma 275,969,017 lekë paraqet transfertat nga buxheti i shtetit (7200) për MK në vlerën 248,448,022 lekë, Financimi i pritshëm nga buxheti (7206) në vlerën 8,681,270 lekë përputhet me llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, (7207) sponsorizime nga ORD në vlerën 18,839,725 lekë.

Pasqyra 2 “Performanca financiare” është plotësuar si më poshtë:

Tabela nr. 7: “Pasqyra e performancës financiare të ushtrimit 2019 për aparatën e MK”

Në lekë

Nr. Llogarie	P E R S H K R I M I i OPERACIONEVE	Viti 2019	Viti 2018	Ndryshimi	Në %
A	TE ARDHURAT	307,082,269	355,243,250	-48,160,981	-14%
71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	31,113,252	23,617,801	7,495,451	32%
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore	31,113,252	23,617,801	7,495,451	32%
76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	0	77,835	-77,835	-100%
766	Nga kembimet valutore	0	77,835	-77,835	-100%
72	V.GRANTE KORENTE	275,969,017	331,547,614	-55,578,597	-17%
720	1.Grant korent i Brendshem	275,969,017	331,547,614	-55,578,597	-17%
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	248,448,022	298,871,456	-50,423,434	-17%
7206	Financim i pritshem nga buxheti	8,681,270	9,071,173	-389,903	-4%
7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)	18,839,725	23,604,985	-4,765,260	-20%
B	SHPENZIMET	292,032,414	329,486,105	-37,453,691	-11%
600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	84,172,657	79,719,941	4,452,716	6%
6001	Paga, personel i perhershem	84,172,657	79,719,941	4,452,716	6%
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	13,607,393	12,693,748	913,645	7%
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqerore	13,607,393	12,693,748	913,645	7%



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	52,554,858	59,857,841	-7,302,983	-12%
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	1,946,820	4,344,502	-2,397,682	-55%
6022	Sherbime nga te trete	8,524,741	7,438,904	1,085,837	15%
6023	Shpenzime transporti	6,639,711	4,995,068	1,644,643	33%
6024	Shpenzime udhetimi	8,226,792	12,920,458	-4,693,666	-36%
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	559,680	1,977,720	-1,418,040	-72%
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	6,194,216	9,516,940	-3,322,724	-35%
6029	Shpenzime te tjera operative	20,462,898	18,664,249	1,798,649	10%
	V.TRANSFERIME KORENTE	143,070,097	185,094,366	-42,024,269	-23%
604	1.Transferime korente te brendshme	118,712,116	154,889,121	-36,177,005	-23%
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	118,712,116	154,889,121	-36,177,005	-23%
605	2.Transferime korente me jashte	22,915,713	29,925,245	-7,009,532	-23%
6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare	22,915,713	29,925,245	-7,009,532	-23%
606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	1,442,268	280,000	1,162,268	415%
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	1,442,268	280,000	1,162,268	415%
63	VIII.NDRYSHIMI i GJENDJES SE INVENTARIT	-1,372,591	-7,879,791	6,507,200	-83%
85	TEPRICA OSE DEFICITI i PERIUDHES	15,049,855	25,757,145	-10,707,290	-42%

Burimi: MK, Përpunuar nga grupi i auditimit

Shpenzimet e konstatuara gjatë vitit 2019 kapin vlerën 292,032,414 lekë. analizuar si më poshtë:
Llog. 600 “Paga e shpenzime personeli” për 84,172,657 lekë, në këtë post janë paraqitur pagat e personelit, gjatë vitit ushtrimor 2019.

Llogaria 601 “Kontribute të Sigurimeve Shoqërore” për 13,607,393 lekë,që paraqet shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi.

Llogaria 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” për 52,554,858 lekë që paraqet shpenzimet për blerje mallrash dhe shërbimesh të analizuar si më poshtë:

Llog. 6020 “Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme” për 1,946,820 lekë e cila paraqet shpenzimet që institucionet kanë kryer për blerje tonerash, materialesh pastrimi, materialesh elektrike dhe kancelari gjatë vitit 2019.

Llog. 6022 “Shërbime nga të tretët”për shumën 8,524,741 lekë përfaqëson shpenzimet që institucionet tona kryejnë realizuar me shërbime nga të tretët energji elektrike, ujë, postë, komunikim, komisione bankare dhe shërbim roje.

Llog. 6023 “Shpenzime transporti” për shumën 6,639,711 lekë përfaqësojnë shpenzime për automjetet e institucioneve si karburant, pjesë këmbimi dhe riparime mjetesh, sigurim i automjeteve dhe shërbime të ndryshme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Llog. 6024 “Shpenzime udhëtimi” për shumën 8,226,792 lekë përfaqësojnë shpenzimet për pagesën e biletave të udhëtimit të punonjësve që largohen me punë jashtë vendbanimit dhe dietave dhënë punonjësve.

Llog. 6025 “Mirëmbajtje të zakonshme” për shumën 559,680 lekë janë shpenzimet që janë bërë për mirëmbajtje dhe riparime të zakonshme të AQT-ve dhe mirëmbajtje.

Llog. 6027 “Shpenzime për detyrime për kompensime legale” për shumën 6,194,216 lekë janë shpenzimet që janë bërë për shpenzimet gjyqësore dhe likujduar përgjatë vitit 2019.

Llog. 6029 “Shpenzime të tjera Operative” për shumën 20,462,898 lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kriterëve të klasifikimit buxhetor.

Llog. 604 “Transferime korrente të brendshme” paraqitet në vlerën 118,712,116 lekë, përfaqëson transfertat korrente në Organizatat jo fitimprurëse dhe është zvogëluar rreth 23% krahasuar me vitin e mëparshëm.

Llogaria 605 “Transferime korrente me jashtë” paraqitet në vlerën 22,915,713 dhe përfaqëson tarifat e pjesëmarrjes së MK në organizma, konferenca etj dhe është zvogëluar rreth 23% krahasuar me vitin e mëparshëm.

Llogaria 606 “Transferime për buxhetet familjare dhe individë” paraqitet në vlerën 1,442,268 dhe është rritur në shumën 1,162,268 lekë krahasuar me vitin e mëparshëm.

Llog. 63 me vlerën – 1,372,591 lekë, ndikon në Fondin Bazë, dhe në rezultatin e MK.

c. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të bilanceve rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Pasqyra e pozicionit financiar me tregues të reduktuar për grupet e llogarive të aktivit paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 8: “Gjendja e aktivit në fund të vitit 2019, krahasuar me vitin 2018 për aparatën e MK”
Në lekë

Nr. Llog	Përshkrimi	Viti 2019	Viti 2018	Ndryshimi	Ndry. në %
A	A K T I V E T	3,284,315,616	2,660,802,054	623,050,601	23%
	I. Aktivët Afat shkurtër	201,474,099	192,592,881	8,881,218	5%
	1. Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	102,570,057	87,057,109	15,512,948	18%
520	Disponibilitete ne Thesar	102,570,057	87,057,109	15,512,948	18%
	2. Gjendje Inventari qarkullues	25,150,992	23,778,401	1,372,591	6%
31	Materiale	15,350,324	18,401,713	-3,051,389	-17%
32	Inventar i imet	9,800,668	5,376,688	4,423,980	82%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	3.Llogari te Arketueshme	41,220,042	42,252,577	-1,032,535	-2%
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	10,244,322	10,028,556	215,766	2%
468	Debitore te ndryshem	23,152,848	23,152,848	0	0%
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	7,822,872	9,071,173	-1,248,301	-14%
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	32,533,008	39,504,794	-6,971,786	-18%
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	32,533,008	39,504,794	-6,971,786	-18%
	II.Aktivet Afat gjata	3,082,841,517	2,468,209,173	614,169,383	25%
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	77,995,581	91,759,507	-13,763,926	-15%
202	Studime dhe kerkime	77,995,581	91,759,507	-13,763,926	-15%
21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,168,678,627	1,229,642,071	-60,963,444	-5%
210	Toka, Troje, Terrene	261,298,634	261,298,634	0	0%
212	Ndertesa e Konstruksione	843,019,011	861,657,448	-18,638,437	-2%
214	Instalime teknike, makineri e paisje	14,229,683	17,847,104	-3,617,421	-20%
215	Mjete Transporti	8,637,547	6,838,286	1,799,261	26%
218	Inventar ekonomik	41,493,752	82,000,599	-40,506,847	-49%
	4.Investime	1,836,167,309	1,146,807,595	689,359,714	60%
231	Per Aktive Afatgjata materiale	1,836,167,309	1,146,807,595	689,359,714	60%
B	PASIVET(DETYRIMET)	161,625,304	149,875,815	11,749,489	8%
	I.Pasivet Afat shkurtra	161,625,304	149,875,815	11,749,489	8%
	1. Llogari te Pagueshme	161,625,304	149,875,815	11,749,489	8%
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	19,673,654	24,633,654	-4,960,000	-20%
42	Detyrime ndaj personelit	5,234,393	6,123,261	-888,868	-15%
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	563,375	626,577	-63,202	-10%
435	Sigurime Shoqerore	1,795,777	2,051,555	-255,778	-12%
436	Sigurime Shendetesore	229,327	269,780	-40,453	-15%
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	87,872,254	68,118,445	19,753,809	29%
467	Kreditore te ndryshem	12,859,354	14,871,140	-2,011,786	-14%
4341	Operacione me shtetin(detyrime)	33,397,170	33,181,403	215,767	1%
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	3,122,227,351	2,471,421,445	650,805,906	26%
D	FONDI i KONSOLIDUAR :	3,122,227,351	2,510,926,239	611,301,112	24%
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,262,572,817	1,337,300,189	-74,727,372	-6%
12	Rezultatet e mbartura	8,900,331	1,061,310	7,839,021	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

85	Rezultati i Veprimtarise Ushtrimore	15,049,855	25,757,145	-10,707,290	246%
14		1,835,704,348	1,146,807,595	688,896,753	9%
E	TOTALI i PASIVEVE(B+C)	3,283,852,655	2,660,802,054	623,050,601	34%

Burimi: MK, përpunuar nga grupi i auditimit

Sipas pasqyrave financiare vjetore për vitin 2019 në Aktivin e Bilancit Kontabël rezultojn se:

- Më datë 31.12.2019 “Aktivet afatgjata” zënë 93 % të vlerës totale të aktivitetit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 7% të totalit, duke mos ndryshuar raport në krahasim me një vit më parë.

Aktivet e Qëndrueshme sipas zërave të llogarive përbëhen nga:

Tabela nr. 9: “Gjendja e AQT në fund të vitit 2019, krahasuar me 2018 dhe 2017 për aparatet e MK”

Në lekë

Nr.	Përshkrimi	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Pesha specifike 2019
Total	II.Aktivet Afat gjata	3,082,841,517	2,468,209,173	1,838,997,489	100%
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	77,995,581	91,759,507	43,434,714	3%
202	Studime dhe kerkime	77,995,581	91,759,507	43,434,714	
21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,168,678,627	1,229,642,071	747,271,172	37%
210	Toka, Troje, Terrene	261,298,634	261,298,634	248,524,634	
212	Ndertesa e Konstruksione	843,019,011	861,657,448	325,056,865	
214	Instalime teknike, makineri e paisje	14,229,683	17,847,104	22,608,880	
215	Mjete Transporti	8,637,547	6,838,286	11,035,014	
218	Inventar ekonomik	41,493,752	82,000,599	140,045,779	
	4.Investime	1,836,167,309	1,146,807,595	1,048,291,603	60%
231	Per Aktive Afatgjata materiale	1,836,167,309	1,146,807,595	1,048,291,603	

Burimi: MK, përpunuar nga grupi i auditimit

Llogaria 231 “Investime për rritjen e aktiveve afatgjata” në fund të vitit ushtrimor 2019 konstatohet të jetë në vlerën 1,836,167,309 lekë dhe përbën 60% të totalit të aktiveve afatgjata. Kjo llogari përfaqëson aktive të qëndrueshme ende në proces dhe që nuk janë në funksionim dhe nuk janë kapitalizuar deri në fund të vitit 2019. Nga krahasimi i dy viteve financiare 2018 dhe 2019 konstatohet se ky zë ka pësuar një rritje në shumën 689,359,714 lekë, si rezultat i realizimit të investimeve në TOB në vlerën 448,217,453 për vitin 2019 dhe blerjeve të pajisjeve në shumën 269,270,600 lekë dhe transferimit të sistemit të biletarive bërë Muzeve në shumën 10,499,211 dhe sistemit të dixhitalizimit në shumën 17,629,128 lekë përgjatë vitit 2019.

Llogaria 202 “Studime dhe kerkime” ka pësuar një rënie përgjatë vitit 2019 në vlerën 13,763,926 lekë, si rezultat i amortizimit vjetor 2019 në masën 15%.

Llogaria 210 “Toka, Troje dhe Terrene” paraqitet në shumën 261,298,634 lekë, pa ndryshuar prej vitit 2018.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione” paraqitet në shumën 843,019,011 lekë dhe është ulur me vlerën 18,638,437 lekë kundrejt vitit 2018, si rezultat i amortizimit vjetor. Sipas regjistrimit të aktiveve rezulton se ky amortizim nuk është llogaritur për gjithë zërat e kësaj llogarie, mungon llogaritja për Skenën e re (Turbina), me një diferencë 24,444,435 lekë më pak. Në këtë zë është bërë blerje në vitin 2019 në shumën 462,961 lekë, duke deduktuar se vlera e amortizimit nuk është llogaritur e plotë.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” paraqitet në shumën 14,229,683 lekë dhe është ulur në vlerën -3,617,420 lekë, si rezultat i amortizimit të vjetor 2019 në vlerën 3,569,421 lekë. Konstatohet një diferencë prej 48,000 lekë më e lartë në raportimin e vlerës neto dhe amortizimit të akumuluar të këtij zëri.

Llogaria 215 “Mjete transporti” paraqitet në shumën 8,637,547 lekë dhe është rritur në vlerën 1,799,261 lekë krahasuar me një vit më parë, si rezultat i blerjeve pa pagesë së një automjeti në shumën 5,102,269 lekë, amortizimit vjetor në vlerën 1,048,617 lekë dhe transferimit kapital në njësi të varësisë të një automjeti me kosto historike 1,994,000 lekë dhe amortizim të akumuluar 398,800 lekë. Konstatohet se në pasqyrat financiare është llogaritur amortizim vjetor 2019 më i lartë në shumën 659,190 lekë, duke ulur vlerën e raportuar neto të kësaj llogarie me këtë shumë.

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” paraqitet në shumën 41,493,752 lekë dhe është ulur në vlerën 40,506,847 lekë, si rezultat i blerjeve pa pagesë në shumën 423,613 lekë, amortizimit vjetor në vlerën 2,477,167 lekë dhe transferimeve kapitale në njësitë e varësisë në vitin 2019, në vlerën 38,453,293 lekë, që janë projekti I sistemit të dixhitalizimit dhe një pjesë e sistemit elektronik të biletarive.

Aktivet Afatshkurtra në fund të vitit 2019, rezultojnë me gjendje në vlerën 201,474,099 lekë dhe sipas zërave paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 10: “Gjendja e Aktive afatshkurtra në fund të vitit 2019 për aparatën e MK”

Në lekë

Nr.	Përshkrimi	Viti 2019	Viti 2018	Ndrysh 2019-2018	Pesha specifike 2019
A	A K T I V E T	3,284,315,616	2,660,802,054	623,513,562	7%
	I. Aktivet Afat shkurtra	201,474,099	192,592,881	8,881,218	100%
	1. Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	102,570,057	87,057,109	15,512,948	
520	Disponibilitete në Thesar	102,570,057	87,057,109	15,512,948	51%
	2. Gjendje Inventari qarkullues	25,150,992	23,778,401	1,372,591	12%
31	Materiale	15,350,324	18,401,713	-3,051,389	
32	Inventar i imet	9,800,668	5,376,688	4,423,980	
	3. Llogari te Arketueshme	41,220,042	42,252,577	-1,032,535	20%
423,429	Personeli, paradhanie, deficite, gjoba	10,244,322	10,028,556	215,766	
468	Debitore te ndryshem	23,152,848	23,152,848	0	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	7,822,872	9,071,173	-1,248,301	
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	32,533,008	39,504,794	-6,971,786	16%
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	32,533,008	39,504,794	-6,971,786	

Burimi: MK, përpunuar nga grupi i auditimit

Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet në shumën 102,570,057 lekë dhe rakordon me sponsorizimet nga ORD të cilat trashëgohen në vitin në vazhdim në vlerën 5,797,472 lekë, duke mos rakorduar me vlerën 14,697,803 lekë, që përfaqëson fondet e trashëguara nga sponsorizimet dhe nga gjendja e mjeteve në ruajtje sipas llogarisë 466 që rezulton në vlerën 87,872,254, dhe 8,900,331 lekë sponsorizimet e përdorura nga viti 2018.

Për llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është mbajtur aktrakordim me thesarin, llogari e cila në pozicionin financiar të datës 31.12.2019 reflekton vlerën 87,872,254 lekë. Rritja prej vitit 2018 konsiston në vlerën 19,753,809 lekë, për mbajtjen e garancisë së punimeve të kryera gjatë vitit 2019.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet në vlerën 7,822,872 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka MK ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2019, përkatësisht për pagat në vlerën 5,234,393 lekë, për tatim taksa në vlerën 563,375 lekë, për sigurime shoqërore në vlerën 1,795,777 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 229,327 lekë, të cilat paguhen në vitin në vijim. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 421, 431, 435 dhe 436.

Klasa 3 “Gjendja e inventarit”, në fund të vitit 2019, rezulton në vlerën 25,150,992 lekë dhendaj totalit të Aktiveve Qarkulluese zë 12%. Në krahasim me vitin 2018, është rritur në vlerën 1,372,591lekë, nga rritja e zërit “Materiale”si rezultat i blerjeve dhe hyrjeve në magazinë në vlerën -3,051,389lekë më pak se një vit më parë dhe nga rritja e zërit “Inventar i imët”si rezultat i blerjeve në vlerën 4,423,980lekë më shumë se një vit më parë. Diferenca 1,372,591 përkon me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit.

Llog 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 10,244,322 lekë, përbëhet nga paradhënie në euro dhe \$ punonjësve, të pambyllura ende edhe në 2019, që mbarten në 2020. Këto pasqyrojnë detyrimet e punonjësve përgjatë viteve 2002-2012 për paradhëniet në valutë dhe ende të pambyllura.

Llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 23,152,848 lekë përfaqëson detyrime të subjekteve private dhe ish punonjësve. Kjo llogari në vitin 2019 ka qëndruar e pandryshuar kundrejt vitit 2018.

Llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në vlerën 32,533,008 lekë përfaqëson detyrime për fatura të palikujduara për blerjet materiale, shërbime dhe investime të kryera. Ka si kundërparti llogaritë 401-404 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, 467 “Kreditorë të ndryshëm”, përkatësisht në vlerat 19,673,654 lekë dhe 12,859,354 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Nga auditimi i gjendjes debitore të llogarive 2019 rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogarinë sintetike dhe ato analitike.

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2019, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 161,625,304 lekë, rritur në vlerën 11,749,489 lekë kundrejt vitit 2018. Në këtë rritje ndikimin më të lartë e ka krijuar llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Fondi i konsoliduar përbëhet nga llogaritë 101 “Fondi bazë” në vlerën 1,262,572,817 lekë, nga llogaria 12 “Rezultati i mbartur” në vlerën 8,900,331 lekë që paraqet sponsorizimet e mbartura nga vitet e kaluara, dhe llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 15,049,855 lekë, që paraqet sponsorizimet e vitit 2019 dhe ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 1,372,591 lekë.

Tabela nr. 11: “Fondi i konsoliduar për vitin 2019”

Në lekë

D	FONDI i KONSOLIDUAR :	Viti 2019	Viti 2018	Ndryshimi 2019-2018
	Totali	3,122,227,351	2,510,926,239	611,301,112
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,262,572,817	1,337,300,189	-74,727,372
12	Rezultatet e mbartura	8,900,331	1,061,310	7,839,021
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	15,049,855	25,757,145	-10,707,290
14		1,835,704,348	1,146,807,595	688,896,753
E	TOTALI i PASIVEVE(B+C)	3,283,852,655	2,660,802,054	623,050,601

Burimi: MK

Rakordimi me pasqyrat e tjera financiare:

Formati 4- “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto”;

Sipas rreshtave, në këtë pasqyrë financiare për vitin 2019 janë evidentuar:

Në rubrikën I, evidentohen shumat përkatëse për gjendjen e fondeve/aktiveve neto në fillim të periudhës ushtrimore, për çdo zë të pasqyruar në kolonat nga 1 deri në 5, në shumën totale 1,337,300,189 lekë i përbërë nga fondi bazë dhe grantet kapitale.

Në rubrikën II, evidentohen për çdo zë të pasqyruar në kolonat nga 1 deri në 5, ndryshimet në aktivet/fondet neto, që rrjedhin nga: burime të brendshme në shumën 1,173,626,050 lekë nga fondi bazë dhe 611,764,073 lekë nga teprica e rezultati të i ushtrimit.

Në fund të pasqyrës, pasqyrohet totali i fondeve të veta (si shumë e rubrikës I dhe rubrikës II), për çdo zë të pasqyruar në kolonat nga 1 deri në 5 në shumë fillestare 2,510,926,239 lekë dhe shumë në fund të vitit 2018 prej 3,122,690,312 lekë.

Totali i fondeve të vet të kësaj pasqyre është i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Formati 5- “*Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore*”.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme përmbajnë informacion sqarues, përveç atij që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve neto/fondeve neto. Dhënia e tyre është bërë sipas formatit të përcaktuar nga Ministria e Financave dhe krahas tij pasqyrat shoqërohen dhe me një relacion tjetër shpjegues.

Sipas pikës 85 të UMFE nr. 8 ... “Shënimet shpjeguese japin informacion në lidhje me:... problemet e ndryshme që mund të kenë rezultuar gjatë përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave financiare”, por në asnjë nga këto shënime shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra nuk ka detaje në lidhje me problematikën që ka shoqëruar inventarin ekonomik të MK, për të cilin janë kryer veprime kontabël në lidhje me amortizimin e akumuluar, i cili tejkalonte koston historike.

Formati 6- “*Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre*”;

Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre për vitin 2019, sipas rreshtave, përbëhet nga:

Rubrika I “Shpenzimet për investime”, përbëhet nga zëra si: shpenzime për aktive afatgjata materiale, me gjendje fillestare në shumën 1,146,807,595 lekë dhe gjendje në fund të vitit me vlerën 1,836,167,309 lekë.

Rubrika II “Burimet për investime” përbëhet nga grante të huaja kapitale për pjesëmarrje në investimet në të tretë në shumën fillestare 1,146,807,595 lekë dhe vlerë përfundimtare 1,845,067,640 lekë.

Rubrika III “Balanca” përfaqëson diferencën mes rubrikës II dhe rubrikës I në shumën 8,900,331 lekë, që përputhet me rezultatin e mbartur të vitit 2018.

Formati 7- “*Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto*”.

Pasqyra statistikore e Formatit 7/a mbi gjendjen dhe ndryshimet e AAGJ me kosto historike është plotësuar si më poshtë:

Gjendja fillestare e AAGJ rezulton në vlerën 1,448,771,759 lekë

Shtesat përgjatë vitit 2019 kanë ardhur si rezultati blerjeve me pagesë në shumën 5,988,843 lekë, ku blerjet kryesore rezultojnë në Llog 215 ‘Mjete transporti’ blerje pa pagesë në shumën 5,102,269 lekë, Llog 218 “Inventarin ekonomik” ka pësuar rritje në shumën 423,613 lekë, Llog 212 “Ndertime e Konstrukione” ka pësuar rritje prej marrjes në dorëzim të punimeve të projektit të dixhitalizimit tek zyra e serverit në shumën 462,061 lekë.

Pakësimet kanë ndodhur në Llog 218 “Inventarin ekonomik” për shumën 38,453,293 lekë për transferimet kapitale të bëra në institucionet e varësisë, dhe në Llog “215” Mjete transporti. Në lidhje me transferimet kapitale të inventarit ekonomik nuk ka shpjegime informuese në shënimet shpjeguese.

Gjendja në fund të periudhës ushtrimore të mbyllur, paraqitet në shumën 1,414,313,309 lekë.

Tabela nr. 12: Formatit 7/b Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (me vlerën neto) për vitin 2019:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Në lekë

E M E R T i m i	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
I. AAGJ/JO MATERIALE	98,274,714	6,515,207	91,759,507	0	13,763,926	0	0	98,274,714	20,279,133	77,995,581
Studime dhe kerkime	98,274,714	6,515,207	91,759,507		13,763,926			98,274,714	20,279,133	77,995,581
II. AAGJ/ MATERIALE	1,350,497,045	120,854,974	1,229,642,071	5,988,843	26,903,794	40,447,293	398,800	1,316,038,595	147,359,968	1,168,678,627
Toka,troje, Terene	261,298,634		261,298,634					261,298,634	0	261,298,634
Ndertime e Konstruksione	940,844,749	79,187,301	861,657,448	462,961	19,101,398			941,307,710	98,288,699	843,019,011
Instalime teknike,makineri,paisje,v egla pune	32,062,054	14,214,950	17,847,104		3,617,421			32,062,054	17,832,371	14,229,683
Mjete transporti	14,092,418	7,254,132	6,838,286	5,102,269	1,707,808	1,994,000	398,800	17,200,687	8,563,140	8,637,547
Inventar ekonomik	102,199,190	20,198,591	82,000,599	423,613	2,477,167	38,453,293		64,169,510	22,675,758	41,493,752
T O T A L i (i + II)	1,448,771,759	127,370,181	1,321,401,578	5,988,843	40,667,720	40,447,293	398,800	1,414,313,309	167,639,101	1,246,674,208

Burimi: MK

Formati 7/b Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (me vlerën neto), sipas rreshtave, përfaqëson:

Rubrika i “aktive afatgjata jomateriale”, e cila përfshin studime dhe kërkime paraqitet me tepricë në fillim në shumën 91,759,507 lekë dhe tepricë në fund në shumën 77,995,581 lekë, me amortizim të akumuluar në shumën 20,279,133 lekë.

Rubrika II “aktive afatgjata materiale”, e cila përfshin zëra si: toka, troje, pyje, ndërtime e konstruksione, mjete transporti, dhe inventar ekonomik, paraqitet me Tepricë fillestare 1,229,642,071 lekë dhe Tepricë përfundimtare në shumën 1,168,678,627 lekë. Në të konstatohet se amortizimi i akumuluar kap vlerën 147,359,968, ku peshën specifike më të lartë e ka zëri “Ndërtime dhe Konstruksione” në shumën 98,288,699 lekë, ose 67%.

Formati 8- “Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave”

Kjo pasqyrë ka të reflektuar informacionin në total, për çdo kategori të punonjësve, në lidhje me fondin e pagave bruto gjithsej në shumën 84,172,657 lekë, kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në shumën 13,607,393 lekë, dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi në shumën 6,874,233 lekë. Numri mesatar i punonjësve ka qenë 84 punonjës dhe në fund të periudhës 82 punonjës. Kjo pasqyrë është e rakorduar me të dhënat e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

f. Auditimi i pasqyrës së fluksit të mjeteve financiare.

Formati Nr. 3 “Pasqyra e flukseve monetare” tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të ministrisë, të shkaktuar nga kryerja e aktivitetit financiar të një viti ushtrimor.

Në *Rubrikën I*, që pasqyron flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e shfrytëzimit të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, totali i flukseve të mjeteve monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e shfrytëzimit është i barabartë me shumën e totalit të zërave: akordim fondesh buxhetore për shpenzime korrente, arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor dhe pagesa për detyrime e shpenzime korrente, në vlerën 82,732,762 lekë.

Nënrubrika “*Akordim fondesh buxhetore për shpenzime korrente*” që përfaqëson flukset monetare hyrëse që rrjedhin nga akordimet e fondeve buxhetore për shpenzime korrente, është e rakorduar me të dhënat e thesarit në shumën 315,353,634 lekë.

Nënrubrika “*Arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor*” përbëhet nga shuma e zërave si: sponsorizime nga të tretë në shumën 43,368,809 lekë dhe të hyrat nga mjetet në ruajtje në shumën 35,467,115 lekë.

Nënrubrika “*Pagesa për detyrime e shpenzime korrente*” përbëhet nga shuma e zërave si: pagesa për detyrime e shpenzime të vitit ushtrimor në shumën 297,743,492 lekë, dhe pagesat për mjetet në ruajtje në shumën 15,713,304 lekë.

Rubrika II, që pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e investimeve përbëhet nga zëra si: akordim fondesh buxhetore për shpenzime kapitale në shumën 725,000,000 lekë dhe pagesa për detyrime dhe investime të vitit ushtrimor në shumën 722,448,053 lekë.

Rubrika III, që pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga transfertat dhe transaksionet e tjera përbëhet nga zëra si: transferime në buxhet të fondeve të papërdorura në shumën 57,516,204 lekë dhe derdhje e transferime të të ardhurave në buxhet në shumën 12,255,557 lekë.

Teprica e likuiditeteve në fund të vitit rakordon me llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” të pasqyrës së pozicionit financiar në shumën 102,570,057 lekë.

Titulli i gjetjes nr. 1	Mungesë përkatësie në amortizimin e akumuluar
Situata:	1. Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2018 konstatohet se është bërë një pakësim në amortizimin e akumuluar të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione” në vlerën 60,369,399 lekë, më shumë se amortizimi vjetor që i përket kësaj llogarie. Në kushtet e detyrimit për zbatim të UMFE nr. 8/2018 për përgatitjen e pasqyrave financiare 2018, MK duhet të raportonte zërat e aktiveve me vlerën neto, por në një situatë ku amortizimi i akumuluar i përmbledhur deri në fund të periudhës raportuese 2017 rezultonte në shumën 150,975,320 lekë, me një diferencë 60,369,999 lekë nga amortizimi që duhet ti përkonte analitikisht secilit aktiv, të pasqyruar në regjistrin e aktiveve. Si rezultat nga sektori i financës është bërë një sistemim i kësaj difference të amortizimit të llogaritur tepër, vetëm në zërin 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione”, duke i zvogëluar atij amortizimin e akumuluar, dhe duke i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	rritur jetën e dobishme, me një normë amortizimi më të ulët se norma e lejuar/ e detyrueshme për zbatim. Sipas Sektorit të Financës amortizimi i akumuluar i gjithë aktiveve përpara vitit 2018, ka patur pasaktësi si rezultat i mosreflektimit të saktë të aktiveve që përbënin llogarinë 218 “Inventarit ekonomik” për shkak të mungesës dokumentare të mbajtjes së tyre përpara vitit 2012, nga kryerje të transferimeve kapitale të aktiveve pa u shoqëruar me amortizimin përkatës dhe me ndonjë mungesë në llogaritjen e amortizimit të vjetor deri në fund të vitit 2017. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me parimin kontabël të përkatësisë, me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, Pika 36, SKK5 “AAGJ materiale dhe jomateriale”, Pika 7. Amortizimi në shumën 60,369,399 lekë rrit jetën e dobishme/ periudhën që aktivi “Ndërtesa dhe Konstruksiione” do të përdoret nga MK. 2. Në shënimet shpjeguese shoqëruese të pasqyrave financiare të vitit 2018 flitet vetëm për amortizimin vjetor 2018 dhe nuk jepet asnjë informacion në lidhje me pakësimin e amortizimit të akumuluar në shumën 60,369,999 lekë, as për mënyrën e përllogaritjes dhe as problematikën që ka shoqëruar raportimin në vlerën neto të aktiveve në administrim nga MK. Veprimi i mësipërm çënon besueshmërinë në reflektimin e vlerës neto të llogarisë 218 “Inventar ekonomik” dhe të shënimeve shpjeguese dhe bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, Kreu 3.7 Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale. Pika 85.
Kriteri:	SKK5 “AAGJ materiale dhe jomateriale” Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”
Ndikimi/Efekti:	Mungese raportimi të saktë dhe përkatës të zërit 212 dhe 218 në pasqyrat financiare
Shkaku:	Mungesë e akumuluar e raportimit në pasqyra dhe regjistër të aktiveve dhe amortizimit përkatës në vite.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	MK, në linjë hierarkike, Nëpunësi Autorizues (NA), Nëpunësi Zbatues (NZ) dhe personeli i përfshirë, të marrin masa: 1. për evidentimin e saktë aktiveve, që nuk janë amortizuar sipas normave të lejuara kontabël, duke u analizuar arsyet dhe lidhur rezultatet e nxjerra me aktivet përkatëse, konform parimeve kontabël dhe dispozitave ligjore në fuqi;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	2. për evidentimin e gjithë problematikave që shoqërojnë raportimin financiar në shënimet shpjeguese të tij, duke shmangur praktika të mbartjes të tyre në vitet në vazhdim.
--	--

Titulli i gjetjes nr. 2	Pasaktësi në pasqyrën e flukseve monetare 2018
Situata:	Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2018, konstatohet se në pasqyrën e flukseve monetare ka një raportim të pasaktë për sa i përket: - transferimit të fondeve të papërdorura përgjatë vitit 2018, i cili sipas aktrakordimit me thesarin rezulton të jetë 12,260,484 lekë, - të ardhurave dytësore të MK të transferuara në buxhet, me një raportim më të ulët në shumën 32,729,684 lekë, si dhe - mospasqyrim në nënrubrikën “Arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor” për të hyrat nga mjetet në ruajtje në shumën 32,729,687 lekë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, Seksioni 3.5.
Kriteri:	UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”
Ndikimi/Efekti:	Mospasqyrim i saktë në disa transaksione të MK
Shkaku:	Ndryshimi i formatit të pasqyrës së flukseve monetare në vitin 2018
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Financës dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat për sistemimin e diferencave të konstatuara, në zërat e pasqyrës së flukseve monetare të vitit 2018, duke reflektuar në mënyrën e duhur bazën krahasimore midis periudhave kontabël.

5. PROKURIMET E FONDEVE PUBLIKE

Gjatë auditimit, mbi procedurat e prokurimeve të realizuara në Institucionin e Ministrisë së Kulturës për vitet, 2018 dhe 2019, në bazë të Programit të Auditimit nr. 62/1prot, datë 20.01.2020, me objekt auditimi “Auditim financiar dhe përputhshmërie” për periudhën 01.01.2018 deri në 31.12.2019.

Grupi i audituesve, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore, ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, VKM nr.918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, udhëzim e APP-së nr. 2 datë 27.01.2015 “Për hartimin e



KONTROLI I LARTË I SHETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

regjistrin të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrin të realizimeve të prokurimit publik”, udhëzim e APP-së nr.2 datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike” i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.”, urdhërin nr.348 datë 18.09.2015 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të brëndshëm, të Ministrisë të Kulturës” si dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Për vitin 2018, Ministria e Kulturës në cilësinë si Autoritetet Kontraktor ka zhvilluar (45) procedura me vlerë realizimi prej 77,569,361 lekë me tvsh.

Nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Sasia e procedurave	Vlera e kontratës në lekë me tvsh
1	Blerje me emergjencë	3	41,640 lekë
2	Procedurë prokurimi me vlerë të vogël	22	10,063,300 lekë
3	Sistem dinamik (marrëveshje kuader/bileta)	6	367,700 lekë
4	Marëveshjekuadër(Rojet, karburant, blerje tonera)	4	8,011,537 lekë
5	Negocim pa shpallje	3	57,350,586 lekë
6	Blerje nën 100,000 leke +ceremony zyrtare	7	1,734,586 lekë
	TOTALI	45 Procedura	77,569,361 lekë

Grupi i auditimit, ka audituar 8 procedura, me vlerë të kontratës me tvsh 58,009,020 lekë, ose 75% e vlerës së prokuruar, duke përzgjedhur procedura prokuruese, në bazë të vlerës së lartë të kontratës, duke u mbështetur në metodën e gjurmimit të dokumentacionit si dhe çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjes për procesin e prokurimit të audituar.

Për vitin 2019, nga auditimi në bazë të Rregjistrin të Realizimit të Prokurimeve Publike, publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, Ministria e Kulturës, ka realizuar procedura tenderuese në (zëri 602) dhe shpenzime kapitale (231), te prokurueshme si më poshtë vijon:

Nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Sasia e procedurave	Vlera e kontratës në lekë me tvsh
1	Blerje me emergjencë	3	254,309 lekë
2	Procedurë prokurimi me vlerë të vogël	19	8,031,907 lekë
3	Sistem dinamik (marrëveshje kuader/bileta)	31	2,798,122 lekë
4	Marëveshjekuadër(Rojet, karburant, blerje tonera)	6	17,772,635 lekë
5	Negocim pa shpallje	1	941,374 lekë
6	Blerje nën 100,000 leke +ceremony zyrtare	15	799,300 lekë
7	Procedurë e hapur	1	320,250,004 lekë
	TOTALI	79 Procedura	351,891,250 lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Pra në total janë zhvilluar (79) procedura me vlerë realizimi prej 351,891,250 lekë me tvsh. Grupi i auditimit, ka audituar 10 procedura, me vlerë të kontratës me tvsh 324,405,069 lekë, ose 92% e vlerës së prokuruar, duke përzgjedhur procedura prokuruese, në bazë të vlerës së lartë të kontratës, duke u mbështetur në metodën e gjurmimit të dokumentacionit si dhe çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjës për procesin e prokurimit të audituar.

Audituesit, kanë përzgjedhur procedura prokuruese, në bazë të vlerës së lartë të kontratës, duke u mbështetur në metodën e gjurmimit të dokumentacionit, në hartimin dhe njoftimin e regjistrit të prokurimit publik, llogaritjen e fondit limit dhe procedurat e shpalljes së prokurimit; hartimi i kërkesave për kualifikim, miratimi i dokumentave standarte të tenderit; paraqitja dhe shqyrtimi i ofertave; vlerësimi i ofertave dhe klasifikimi i ofertuesve, verifikimi në sistemin prokurimit elektronik (SPE); menaxhimi i procesit të ankimit, pjesëmarrësit në proces; njoftimi, hartimi dhe nënshkrimi i kontratës me operatorin fitues dhe zbatimi i saj, si dhe çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjës për procesin e prokurimit të audituar.

Më poshtë po paraqesim, mangësitë dhe problematikat e konstatuara, si vijon:

1) Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të procedurave me objekt

- 1. “Blerje pajisje teknologjisë së skenës dhe material ne funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP”;*
- 2. “Mbikëqyrje e punimeve për objektin “Blerje e pajisjeve të teknologjisë së skenës dhe material në funksion të projektit rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor”;*
- 3. “Kolaudimi i punimeve për objektin “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Asamblit Popullor”, viti 2019 realizuar në MK*

1.Procedurë e hapur me objekt “Blerje pajisje teknologjisë së skenës dhe material ne funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP” me fond limit 353,972,094 lekë pa tvsh, e fituar nga BOE “....”shpk, “.....”shpk& “.....”shpk, me vlerë kontrate prej 266,875,003(dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tre) lekë pa tvsh, duke u lidhur Kontratë nr.2304 datë 04.04.2019.

Kjo kontratë është ende në ekzekutim, afati i mbarimit sipas detyrimit kontraktor neni 8 pika 1 ka qënë data 20.12.2019, por ka pësuar amendime kohore, si kërkesë e mbikëqyrësittë punimeve, me shkresën nr.2777 prot, datë 02.12.2019, administruar pranë Ministrisë së Kulturës nr.7019 prot, datë 03.12.2019.

Kështu, AK bazuar në pikën 7.3, gërma “ç”, të VKM nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Durrës dhe Tiranë”, ka kërkuar ndërprerje të përkohshme të afatit të kontratës për shkak të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, duke e ndryshuar afatin e përfundimit më datë 29.02.2020, sipas Aneks Kontrate nr.1, me shkresë nr.7019/2 prot datë 03.12.2019.

1).Nga auditimi, u konstatua se, projekti për këtë objekt është siguruar nëpërmjet procedurave ligjore të prokurimit shërbim konsulence, ku Autoritet Kontraktor ka qënë Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe operatori ekonomik fitues “....” shpk,sipas Kontratë Shërbimi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

nr.2685/1, datë 05.10.2015 me objekt “Projekti i zbatimit të Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Asamblit Popullor”.

Nga autoriteti kontraktor i MK, më datë 28.09.2016 është realizuar procedura e hapur, kontratë zbatimi punimesh me objekt *“Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor”* me fond limit 998,862,862 lekë pa tvsh, duke lidhur Kontratë Zbatimi Punimesh nr.5349 datë 31.10.2016 me BOE “....” sh.p.k & “....”shpk me vlerë kontratë 1,112,105,000 lekë (Kjo procedurë është audituar nga grupi i mëparshëm në bazë të Programit nr.1264/2 datë 14.12.2017.)

Në Kontratë Zbatimi Punimesh nr.5349 datë 31.10.2016, nuk janë përfshirë kapitulli (III “F.V. Ashensor dhe IV “Pajisje të skenës dhe sallës”), pasi nga Ministria e Kulturës, është argumentuar në atë kohë, që burimi i financimit do të sigurohej nga fonde të huaja të vëna në dispozicion nga Qeveria e Republikës Popullore të Kinës dhe Qeveria Greke, si dhe fonde nga Bashkia e Tiranës për punime që ndërthuren me projektin me objekt: “Rivitalizim i Sheshit Skënderbej”.

Këto fonde nuk u përthithën nga qeveritë e huaja, kështu burimi i vetëm financiar u sigurua nga Buxheti i Shtetit në bazë të shkresës nr.9080 prot datë 06.12.2018 të MK, ku është planifikuar “Pajisje për TKOB me kod projekti 18AE602 me vlerë 425,000,000 lekë”.

II). Nisur sa më sipër, Titullari i AK ish-Ministri (zj.Mirela Kumbaro), ka miratuar urdhërin nr.854 datë 18.12.2018 me shkresë nr.9209/3 “Për ngritjen e komisionit për llogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje pajisje të teknologjisë së skenës dhe materiale në funksion të projektit “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansambli Popullor”, ku në pikën 2 të urdhërit, thuhet *“Komisioni bazuar në preventivin e miratuar të projektit “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansamblit Popullor” specifikimet teknike përkatëse, si dhe çmimet e tregut, të përlllogarisë vlerën e zërave të detajuar për seksionet III-F.V Ashensorë dhe IV- “Pajisje të skenës dhe të sallës”*

Nga auditimi, sipas procesverbalit për llogaritjen e fondit limit, me shkresë nr.9209/4 prot datë 20.12.2018, mbajtur nga komisioni me përbërje (A. O, A. A dhe M. H) argumentohet se *“...pas kontrollit të preventivit të detajuar, të pikave III- “F.V. Ashensorë “ dhe IV-“Pajisje të skenës dhe sallës”, nga kontraktuesi “.....”sh.p.k sipas kontratës nr.2685/1, datë 05.10.2015, komisioni përcakton vlerën e fondit limit prej 353,826,366 (treqinde pesëdhjetë e tre milionë e tetëqind e njëzetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh”.*

Nga auditimi i zërave të preventivit për 2 kapitujt e mësipërm, u konstatua, se 170 zëra janë me analizë çmimi, por bashkëlidhur nuk u evidentua një listë e hollësishme çmimesh me analizë të detajuar të çmimit ku futet (vlera e mallit/pajisja + pagesa e sigurimeve shoqërore + pagesa e puntorisë + transport, etj), kjo në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimeve.

Në shtesë të arsyetimit, grupi i auditimit, vlerëson se, krahas projektit të zbatimit, pjesë e detyrimeve kontraktuale të OE “....”shpk në bazë të Kontratë Shërbimi nr.2685/1, datë 05.10.2015 me objekt “Projekti i zbatimit të Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Asamblit Popullor”, ka qenë edhe përcaktimi i fondit limit e hartimi i preventivit për këtë objekt.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Meqënëse, nga AK është përdorur preventivi i hartuar nga “....”shkp, është kompetencë dhe përgjegjësi e “Atelier 4”shpk, zbatimi i legjislacionit përkatës që përcakton strukturën apo çmimet e përdorura të preventivit dhe të tjera detaje teknike.

Procedura e Kontratë Shërbimi nr.2685/1, datë 05.10.2015, është zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të territorit (AKPT) në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ndërsa Ministria e Kulturës është në cilësinë e përfituesit.

AKPT ka pasur detyrimin ligjor për ta marrë në dorëzim këtë projekt dhe për ta përcjellë pranë Institutit të Ndërtimit, në mbështetje të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, të VKM-së nr.363, datë 18.7.2002 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e ndërtimit të objekteve”, dhe të VKM-së nr.514 datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, kërkohet metodologjia e llogaritjes së kostos së preventivit në mënyrë të detajuar si dhe miratimin nga Këshilli Teknik i Institutit të Ndërtimit si dhe miratimin nga Ministria e Infraskturës dhe Energjisë, duke e rregjistruar projektin së bashku me preventivin. AK, Ministria e Kulturës, nuk i ka këto miratime.

Kështu, marrja në dorëzim e projektit të zbatimit nga ana e AK (sipas procesverbalit me shkresë nr.9209/4 prot datë 20.12.2018, nga “.....”, konsiston në verifikimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale sipas detyrës së projektimit që i është dhënë OE, mes të cilave edhe përputhshmëria e vlerës së preventivit shoqërues me atë që është deklaruar në ofertën ekonomike të OE, duke e shoqëruar me një listë të hollësishme të çmimeve me analizë të detajuar të çmimit ku futet (vlera e mallit/pajisja +pagesa e sigurimeve shoqërore+pagesa e puntorisë+ transport, etj)

Për sa më sipër, në bazë të auditimit të170 zërave të preventivit të paraqitur në DT, grupi i auditimit nuk mund të përlllogarisë saktë, vlerën e saktë reale të çmimeve, ku në këto zëra përshihen (sisteme teknike, punë civile, pajisje teknologjike, mallra mobilim, etj) pasi preventivi mbi të cilin është përlllogaritur fondi limit nga Ministria e Kulturës, është pa analizë çmimesh të detajuar, ku futet (vlera e mallit/pajisja +pagesa e sigurimeve shoqërore+pagesa e puntorisë+ transport, etj) .

Në këtë rast, është përgjegjësia e hartuesit të preventivuesit OE “.....”, titullarit të AK-së, komisioni për hartimin e fondit limit me përbërje (A. O, A. A dhe M.H) si dhe njësia e prokurimit me përbërje (E. A, B. H dhe S. Sh).

Këto veprime, kanë bërë të mundur që paraqitja e Formulari i Ofertës Ekonomike, nga BOE fitues “.....”sh.p.k, “.....”sh.p.k & “.....”sh.p.k, është e pashoqëruar me analizë –listë e hollësishme e çmimeve, e pa kërkuar dhe nga KVO me përbërje (A. D, E. K, A. C, A. O, S. J dhe G. D), kjo në kundërshtim me ligjin nr.VKM nr. VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 17

III.) Nga auditimi, në DT dhe process verbalit për hartimin e dokumentave të tenderit, datë 07.01.2019 hartuar nga njësia e prokurimit, në rubrikën 2.3 (Kapaciteti teknik) pika2 thuhet:

- “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Licensë profesionale të shoqërisë (?????)”.(Nga auditimi i këtij kriteri, u konstatua se, njësia e prokurimit është e paqartë në lidhje



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

me Licencë profesionale të shoqërisë, ky fakt ka bërë të mundur që BOE fitues nuk ka paraqitur asnjë licencë profesionale e lëshuar nga institucionet zyrtare pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për shkak të paqartësisë së vendosjes së kërkesave nga njësia e prokurimit).

Njësia e prokurimit, ka kërkuar që : “*Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë Certifikatat e mëposhtme të standarteve në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim:*

- Certifikatë ISO 9001:2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë;
- Certifikatë OHAS 18001:2007 për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë;
- Certifikatë ISO 28001:2007 për sistemin e menaxhimit të sigurisë mbi kontrollin e zinxhirit të furnizimit për laisjet dhe materialet që janë prodhuar dhe/ose kanë përbërje druri;
- Certifikatë ISO 50001:2011 për sistemin e menaxhimit të energjisë për pajisjet dhe materialet e instalimeve eletriike;
- Certifikatë ISO 27001:2011/27001:2013 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit.

Ndërsa, në bazë të proces-verbalit për llogaritjen e fondit limit të datës 20.12.2018, referuar dokumentacionit bashkëlidhur të paraqitur nga hartuesi i project zbatimit operatori “.....” sh.p.k, bashkë me preventivin i bashkëlidhur ky material në DT pranë sistemit të app.gov.al REF 003208-01-07-2019), në kapitullin Mekanika e Teatrit A(Standartet e aplikuara dhe legjislacioni) thuhet se;

“*Instalimi i mësipërm do të kryhet në përputhje me ligjin ndërkombëtar, në veçanti, në përputhje me standartet IEC, EN dhe standartet kombëtare (NBN). Në rast konflikti, standartet ndërkombëtare prevalojnë mbi ato kombëtare (NBN ose të tjera). Përveç standarteve dhe ligjeve të sipër përmendura, projektim, prodhim, testimi dhe pranimi i pajisjeve të skenës do të plotësojnë(jo në mënyrë ekskluzive) standartet dhe ligjet e mëposhtme në lidhje me pajisjet e teatrit dhe standartet e tjera të përgjithshme ndërkombëtare. Në rast se asnjë nga standartet e mëposhtme nuk do të respektohet nga kontraktori, standartet që ai do të plotësojë duhet të dorëzohen me shkrim për t’u aprovuar nga klienti dhe punonjësi i tij. Për më tepër, kontraktori duhet të përfshijë në dokumente, në mënyrë të detajuar, standartet që ka plotësuar për pajisjen.*

Standartet dhe rregulloret

-Specifikimet e kategorisë nr.400.

Kontraktimi I instalimeve dhe strukturave eletriike dhe mekanike duke përfshirë (.....):

- EN 418 Siguria emakinerive.Pajisjet e ndalimit në rast emergjence, aspekti funksional, etj.
- EN 984-1 Siguria e makinerive.Kriteret ergonomike për projektimin e informacionit dhe mjetet e operimit- burimet e informacionit.
- EN 984-2 Siguria e makinerive.Kriteret ergonomike për projektimin e informacionit dhe mjetet e operimit- mjetet e kontrollit.
- EN 984-3 Siguria e makinerive.Kriteret ergonomike për projektimin e informacionit dhe mënyra e operimit.
- EN 954-1Siguria e makinerive. Pjesët e sistemeve të kontrollit me funksion sigurie.
- EN 954-2Siguria e makinerive. Pjesët e sistemeve të kontrollit me funksion sigurie.Miratimi.
- EN 1050 Siguria e makinerive. Parimet përvlerësimin e rrezikut.
- EN 1037 siguria e makinerive.Parandalimi i aktivizimit të pavullnetshëm.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

- EN 60073 Parimet bazë dhe ata të sigurisë për bashkëveprimin njeri-makineri .Etiketimi dhe identifikimi. Parimet e kodifikimit për identifikimin e pajisjeve dhe mjeteve.
- EN 60204 Siguria e makinerive.Pajisjet eletrike të makinerive.
- EN 61508 kapër qëllim zëvendësimin e standartit gjërman DIN 19 250 dhe DIN VDE 0801
- EN 50081-2 Përputhshmëria eletromagnetike (EMC) standarti Emetim i Përgjithshëm Pjesa 2;Mjedisi industrial
- EN 50082-2 Përputhshmëria eletromagnetike (EMC) standarti Imunitetit i Përgjithshëm Pjesa 2;Mjedisi industrial.
- 73/23/EËG pajisje elektrike të projektuara për përdorim Brenda limiteve të përcaktuara të voltazhit.
- 89/336/EËG Përputhshmëria eletromagnetike.
- 89/392/EËG Makineritë
- 95/16/EG Direktivat e makinerive.
- IEC 62061; Siguria funksionale e qarqeve të sigurisë elektrike, elektronike dhe të programacionit në sektorin e malinerive.”

Grupi i auditimit, bën me dije se, duke krahasuar kriteret e vecanta të kualifikimit KVK dhe certifikatat e kërkuara nga njësia e prokurimit në DT Shtojca nr.9, me kriteret dhe standartet e kërkuara nga projektuesi “Atelier 4”sh.p.k tregojnë që, AK (njësia e prokurimit) nuk ka kërkuar specifikisht licencat/ certifikatat, ka minimizuar ndjeshëm vendosjen e kriterëve në pikën 2.3 specifikisht në vendosjen e certifikatave, duke ulur standartet të realizimit të objektit të Teatrit Operas dhe Baletit si vepër multidimensionale dhe multifunksionale (paraqitur në Akt-konstatimin nr.3).

Ky veprim, është në kundërshtim me LPP neni 23 (Specifikimet teknike) dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 30 (kërkesat e cilësisë) neni 61(hartimi dhe publikimi i dokumentave të tenderit).

Gjithashtu, nga auditimi i thelluar, në bazë të procedurës së prokurimit me objekt “Kolaudimi i punimeve për objektin “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Asamblit Popullor”, në ftesën për ofertë me shkresë nr.8732/5 prot datë 15.11.2019, në kriteret e veçanta të kualifikimit në pikën 3, nga titullari i AK(sekretari i përgjithshëm E.C) me të drejtë është kërkuar për operatorët ekonomikë (Licensa profesionale e OE për kategoritë kryesore) midis të tjerave ,janë kërkuar:

NS-3 Impiante ngritese dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues);

NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese;

NS-8c Struktura druri

Këto KVK nuk janë kërkuar nga njësia e prokurimit, objektin tenderues “Blerje pajisje teknologjisë së skenës dhe material ne funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP”,por janë kërkuar në Fazën e 3. Ky fakt tregon që detyrimisht njësia e prokurimit duhet të kishte kërkuar këto licensa profesionale.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

IV). Nga auditimi u konstatua se, njoftimi i kontratës dhe hartimi i DT, me shkresë nr.68/1 prot datë 07.01.2019 me REF-03208-01-07-2019, kjo kontratë është miratuar si Kontratë Mallrash, si rrjedhojë dhe informacioni për kontrata duhej të procedohej sipas VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 27 (kontrata e mallrave), por në DT, nuk është kërkuar sipas nenit 27 (Kontratat e mallrave) pika 2 “AK në dokumentat e tenderit parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave”, të cilën nuk e ka paraqitur. Nga auditimi, u konstatua se, zërat e preventivit, nuk janë vetëm “mallra të mirëfillta” por dhe zëra “Furnizim-vendosje”, sipas Tab nr.1.

Tab.nr.1

Nr	analizë	Emërtimi i Punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi/lekë	Shuma/lekë
1	analizë	Ore pune; Instalimi bëhet nga 4 persona për javë	orë	640.0	120	76,800
2	analizë	Instalimi i ashensorëve gershërë	copë	3.0	397,500	1,192,500
		Instalimi i ndricimit				
1	analizë	Ndricues led i levizshëm	copë	24.0	78,080	1,873,920
2	analizë	Led Zoom Par	copë	40.0	29,900	1,196,000
3	analizë	Spot Led RGBEA për ndricim horizontal	copë	16.0	48,450	775,200
		Montimi i Cetralit të Audios, skena majtas				
1	analizë	Centrali	copë	1.0	1,302,400	1,302,400
2	analizë	Kuadri i Audios A	copë	1.0	462,000	462,000
3	analizë	Kuadri i Audios B	copë	1.0	462,000	462,000
4	analizë	Kuadri i Audios C	copë	1.0	503,122	503,122
5	analizë	Kuadri i Audios D	copë	1.0	503,122	503,122
6	analizë	Kuadri i Audios E	copë	1.0	265,000	265,600
7	analizë	Kuadri i Audios F	copë	1.0	265,600	265,600
8	analizë	Kuadri i Audios G	copë	1.0	265,600	265,600
9	analizë	Kuadri i Audios H	copë	1.0	306,000	306,000
10	analizë	Kuadri i Audios I	copë	1.0	503,000	663,200
11	analizë	Ndërfaqësi i Transformatorit të Kontrollerit 400/400V,63A	copë	1.0	663,200	663,200
12	analizë	Montimi në mure i dimerave 24x3KË	copë	13.0	794,740	10,331,620
		SHUMA				20,947,684
1	analizë	F.V.Ashensorë për 9 persona	copë	2.0	12,169,080	24,338,160
		SHUMA PËRBLEDHESE				45,285,844

Në bazë të preventivit të mësipërm, është bërë shkak që, Autoriteti Kontraktor i Ministrisë së Kulturës, ka realizuar procedurën me blerje të vogël në vlerë prej 681,461.38 lekë pa tvsh me objekt “Mbikëqyrje e punimeve për objektin “Blerje e pajisjeve të teknologjisë së skenës dhe material në funksion të projektit rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor”, ku sipas proces-verbalit të datës 09.04.2019 me shkresë nr.2187/3 prot, komisioni i përlogaritjes së fondit limit me përbërje (A. O, I. C dhe M. H) , ngritur në bazë të urdhërit të titullarit të AK nr.182 datë 03.04.2019 argumentojnë se, “...Komisioni evidentoi dhe nxorri nga preventive total i projektit me object “Blerje e pasisjeve të teknologjisë së skenës dhe materialeve në funksion të projektit rehabilitimi i Tlatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Asambllit Popullor”, vlera totale e investimit është 266,875,003 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tre) lekë pa tvsh, ndërsa vlera e zërave që përmbajnë punime



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

ndërtimi/montimi (kosto e llogaritshme) është 45,285,844(dyzet e pesë million e dyqind e tetëdhjetë e pesë mijë e tetë qind e dyzet e katër) lekë pa tvsh”. Në përfundim të procedurës është lidhur kontrata mbikqyrje nr.2826/7 datë 06.05.2019 me bashkimin operatorëve e ekonomik “....“sh.p.k dhe “.....”.

V) Gjithashtu nga AK, në të njëjtën datë të miratimit të Kontratës nr.2826/7 prot datë 06.05.2019, nga Ministri i Kulturës zj.Elva Margariti me shkresë nr.2304/2 prot datë 06.05.2019, i ka bërë kërkesë për bashkëpunim (BOE) “..... “sh.p.k dhe “.....”, ku midis të tjerave thuhet “...Vështirësitë konsistojnë në mbikëqyrjen e pajisjeve të teknologjisë të skenës dhe pajisjeve të cilat janë pjesë e furnizimit dhe vendosjes së tyre në objekt, të kontratës nr.2304, datë 04.04.2019 midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE “...”shpk, “.....”shpk & “.....”shpk.

Me BOE “.....”shpk dhe “.....”shpk, Ministria e Kulturës ka nënshkruar kontratën nr.prot 2826/7 datë 06.05.2019 me objekt “Mbikqyrje e punimeve për objektin “Blerje pajisje të teknologjisë së skenës dhe material në funksion të projektit “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansamblit Popullor”. Objekti kësaj kontrate është mbulimi i disa zërave të furnizimit dhe vendosjes të pajisjeve të parashikuara në kontratën me BOE “.....”shpk, “.....”shpk & “.....”shpk.

Parashikimi për nevojën e mbikqyrjes nuk është bërë konform përcaktimeve në legjislacionin në fuqi, e më konkretisht VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territory, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, pasi një pjesë e pajisjeve, bazuar në vlerësimin e bërë në përlllogaritje, kanë mbetur jashtë procesit të mbikëqyrjes.

Të ndodhur në këto kushte, bazuar në pikën 2 të nenit 18 të kontratës nr.prot 2826/7, datë 06.05.2019, me object: “Mbikqyrje e punimeve për objektin “Blerje pajisje të teknologjisë së skenës dhe material në funksion të projektit “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansamblit Popullor”, ku parashikohen “Negociatat dhe ndryshimet”, kërkojmë:

-bashkëpunimin tuaj që me ekspertizën e kërkuar të mbulon procesin e mbikqyrjes për ato zëra të cilat nuk mbulohen në kontratën e lidhur nga ju, sipas Ftesës për Ofertë dhe mbikqyrjen në total të punimeve sipas preventivit të (BOE) “.....”shpk, “.....”shpk & “.....”shpk, sipas kontratës nr.prot 2304, datë 04.04.2019.

-Aneks kontrata nuk duhet të ketë efekte financiare, pasi zërat që do të jenë pjesë e aneks kontratës nuk janë përfshirë në përlllogaritjen e bërë nga Ministria e Kulturës, referuar kontratës bazë të mbikqyrjes nr.prot 2826/7, datë 06.05.2019....”

Kjo kërkesë është finalizuar me miratimin dhe nënshkrimin e aneks kontrate në zbatim të nenit 18 të kontratës nr.prot 2826/7, datë 06.05.2019 me object “Mbikqyrje e punimeve për objektin “Blerje pajisje të teknologjisë së skenës dhe material në funksion të projektit “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansamblit Popullor”, me operatorin ekonomik “Atelier 4”shpk, pa efekt financiar si “Kontratë gentleman”.

Nga auditimi, u evidentua se, përfaqësuesi i MK (zj.D. P) është caktuar nga titullari i AK, për adminisdrimin e Kontratës nr.2304 prot, datë 04.04.2019.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Vlent të theksohet se veprimi i Ministrisë së Kulturës, në cilësinë e AK, nuk duhej të përcaktonte “administrator” të kontratës zj. P, pasi në atë moment ka qënë në cilësinë e këshilltarit të Ministrit, ky veprim kundërshtim MK nuk është në përputhshmëri me me aktet ligjore dhe nënligjore të aplikuara, pasi në referim ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” i ndryshuar, neni 11 (Ministritë) pika 4 thuhet “*Struktura e kabinetit mbështet drejtëpërdrejtë ministrin në ndjekjen e politikave përkatëse, realizimin e objektivave, si dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike të ministrisë. Funksionarët e kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror.*”

Gjithashtu, meqënëse, vetë titullari i Ministrisë së Kulturës (Ministri zj.Elva Margariti), në bazë të kërkesës së mësipërme ka konstatuar që mbikëqyrja nuk është bërë konform përcaktimeve në legjislacionin në fuqi, duhej që të analizoheshin arsyet dhe shkaqet, e mos ekzekutimin e kontratës në mënyrë të sukseshme, e për rrjedhojë të aplikoheshin dhe marrja e masave administrative/ disiplinore, të personave, subjekteve, të cilat kanë shkaktuar, shkelje të rregullave të ligjit të prokurimeve publike, të ligjit nr.152/2013 01.10.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, duke krijuar risqe ekonomike në disfavor të Buxhetit të Shtetit.

VI) Nga auditimi, u konstatua se në Memo me shkresë nr.6066 prot datë 14.10.2019 me objekt “Përlllogaritja e fondit limit dhe praktika e kolaudimit të objektit “Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor” hartuar nga përfaqësues i Drektorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit dhe Projekteve të Kulturës, A. O dhe zj.D. P këshilltare e Ministrit, është kërkuar inicimi i realizimit të procedurës për kolaudimin e punimeve dhe dorëzimin paraprak, pjesor të ambjenteve të përfunduara të TKOBAP.

Për sa më sipër, është miratuar Urdhëri i Titullarit (tashmë kompetencë e titullarit të AK është marrë nga sekretari i përgjithshëm i sapo emëruar zj.Etleva Çipa) me nr.669, datë 13.11.2019 “Për ngritjen e komisionit për llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt kolaudimit të objektit të TKOBAP”.

Komisioni sipas shkresës nr.6732/1 prot datë 15.11.2019. midis të tjerave argumenton se:

“Kosto totale e parakalkuluar dhe e zbatuar deri në këto momente për objektin “Rehabilitimi TKOBAP” është prokuruar në disa faza dhe kontrata të ndryshme zbatimi, përkatësisht;

- Faza 1, në të cilën përfshihen punimet ndërtimore, sistemet eletrike, hidroteknike dhe mekanike për “Rehabilitimin e TKOBAP” sipas Kontratës nr.5349 prot, datë 31.10.2016 të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe BOE “.....”shpk & “.....”shpk;
- Faza 2, Rehabilitimi i punimeve mekanike dhe eletrike për spostimin e ambientit teknik të objektit TKOBAP” vlera 7,702,000 lekë me tvsh
- Faza 3, në të cilën parashikohet furnizimi edhe vendosja e sistemeve të teknologjisë së skenës në funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP” sipas Kontratës nr.2304 prot, datë 04.04.2019 të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe BOE “.....”shpk, “.....”shpk & “.....”shpk.

Kolaudatori i punimeve do të jetë përgjegjës për kontrollin e dokumentacionit të tre kontratave të mësipërme të cilat të marra së bashku bëjnë të mundur realizimin e veprës sipas projektit. Në këtë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

kuadër përlllogaritja e fondit limit të Kolaudit të objektit është bazuar në preventive/ofertat e kontratave të mësipërme.....

3.Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Asamblit Popullor” sipas Kontratës nr.2304 prot datë 04.04.2019

Nr	Përshkrim Zërat Kryesor të Preventivit- Ofertës	Shuma në lekë pa tvsh
1	Potronat e sallës	21,337,020
2	Perde akustike sipër rreshtave c dhe d, në muret anësore dhe në murin e pasme	2,866,640
3	Instalimet në tavane dhe në mure	76,800
4	Tekstili teatrit	11,323,674
5	Tavane akustike	16,740,402
6-A	Makineritë e skenës (zërat 1-4)	9,009,954
6-B	Makineritë e skenës (zërat 5-8)	26,651,700
7	Ashensori i orkestrës	11,867,636
8	Instalimi i anshensorëve gërshtë	1,192,500
9	Konstruksionet e çelikut, makineritë, skena lëvizëse, galeritë	4,104,000
10	Konstruksionet e çelikut, makineritë, skenat levizëse, galeritë	205,200
11	Njësia e menaxhimit të skenës	98,640
12	Sistemi kompjuterit për ngritjen e kapriatave	6,710,666
13	Ndricuesit	4,528,345
14	Spote dhe kapllo	23,643,220
15	Ndricues pl me mbulesë	6,369,620
16	Ndricimi i sallës	4,441,280
17	Materialet e projektorit për sallën kryesore	5,266,400
18	Instalimi i ndricimit	3,845,120
19	Data netëork	2,204,313
20	Kuadrot, audio-video/montimi i centralit të audios, skena majtas	15,833,264
21	Stage video (communication betëeen stagemanages and orchestra, dancers etcetera)	1,595,780
22	Instalimi i fonisë	12,554,098
23	Reparti i pajisjeve	3,319,245
24	Instrumentat e repartit të punës	3,319,245
25	Pajisjet e ounimit të skenës	18,553,611
26	Materiale pastrimi	3,798,070
27	Reparti rrobaqepsisë	8,394,100
28	Reparti i këpucarëve	6,879,200
29	Depo	5,807,100
30	F.V ashensorë për 9 persona	24,338,160
	VLERA TOTALE E OFERTËS PA TVSH	266,875,003

Sa për sipër, si kosto e llogaritshme, në bazë të argumentimit të komisionit, do të llogaritet vlera totale e simeve teknike (duke mos përfshirë mobilimin (????) ,zërat: 1,2,4,17,23,24,25,26,27,28,29)(nga përlllogaritja e grupit të auditimit, kjo vlerë është 110,542,689 lekë pa tvsh, sipas preventivit të mësipërm), ku mbikqyrsi i punimeve “Atelier 4”shpk, është bërë “marrësi në dorëzim të mobilimit”.

Ndërsa kostoja mbi të cilën është llogaritur kolauidimi,i takon sistemeve teknike që në këtë rast janë zërat:3,5,6A,6B,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,18,19,20,21,22,30 (nga përlllogaritja e grupit të auditimit, kjo vlerëështë 156,332,314 lekë pa tvsh, sipas preventivit të mësipërm).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Pra, dhe në këtë rast është e dukshme që preventivi i tenderuar si “kontratë mall”, ka më shumë vlerë të sistemeve teknike, se sa mallra.

Kolaudimi, është lidhur kontrata nr.6732/11 prot datë 02.12.2019 midis AK dhe operatorit ekonomik “Infratech”shpk, me vlerë kontrate 652,234 lekë pa tvsh.

Nisur nga më sipër, grupi i auditimit nuk mund të përlllogarisë saktë, vlerën e saktë të çmimeve, ku përshihen 170 zëra të preventivit (sisteme teknike, punë civile, pajisje, mobilim, etj) pasi preventivi mbi të cilin është përlllogaritur fondi limit nga Ministria e Kulturës, është pa analizë çmimesh të detajuar, ku futet (vlera e mallit/pajisja +pagesa e sigurimeve shoqërore+pagesa e puntorisë+ transport, etj) .

Në lidhje mbi problematikat e konstatuara është mbajtur Aktkonstatimi nr. 3 (on-line), në bazë VKM nr.243 datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore”, për shkak të situatës të karantinës nga VIRUSI COVID-19 .

Nga ana e institucionit të MK , në datë 26.03.2020, pranë KLSH është dërguar në mënyrë elektronike kërkesë për shryrje e afatit për shqyrtimin e akt-konstatimeve dhe përgatitjen e observacionet përkatëse, për shkak të situatës së COVID-19, e cila është miratuar nga Kryetari i KLSH-së me shkresë nr.62/3 prot datë 02.04.2020 me lëndë “Shryrje afati të observacioneve deri në datë 20.04.2020”

Në lidhje mbi konstatimet e grupit të auditimit, nga autoriteti kontraktor i MK janë përgatitur observimet respektive , me shkresë nr.1787 prot datë 21.04.2020 dhe në mënyrë elektronike, si dhe me shkresë nr.1916/1 prot datë 28.05.2020 /me nr.61/7 prot datë 29.05.2020 të KLSH, mbi projekt-raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës. Grupi i auditimit, në vlerësim të observimeve të dërguar ka rishikuar materialin, duke e paraqitur në formën përfundimtare në Raportin Përfundimtar.

Grupi i auditimit pasi i shqyrtoi observimet e paraqitura, mban këtë qëndrim si më poshtë vijon.

1.Në observimet faqe 7 & 8 citohet se “.....Përsa i përket pretendimit tuaj për mangësitë e projektit (analiza e çmimeve etj). Siç është konstatuar edhe nga ana juaj gjatë auditimit, procedura e prokurimit për hartimin e projektit “Rehabilitimi i teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit popullor” është zhvilluar nga Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në vitin 2015, ndërsa MK është vetëm në cilësinë e përfutjesit të këtij projekti. Është AKPT e cila ka pasur detyrimin ligjor për ta marrë në dorëzim këtë projekt dhe për ta përcjellë pranë Institutit të ndërtimit për kryerjen e oponencës teknike.”

-Argumentimi i MK nuk është në përputhshmëri me me aktet ligjore dhe nënligjore të aplikuara, pasi në referim të procesverbalit nr. 9209/4 prot, datë 20.12.2018, të vënë në dispozicion nga grupi i punës për llogaritjen e fondit limit, mbajtur nga komisioni me përbërje (A.O, A. A dhe M. H) argumentohet se “...pas kontrollit të preventivit të detajuar, të pikave III- “F.V. Ashensorë “ dhe IV- “Pajisje të skenës dhe sallës”,nga kontraktuesi “Atelier 4”sh.p.k sipas kontratës nr.2685/1, datë 05.10.2015, komisioni përcakton vlerën e fondit limit prej 353,826,366 (treqinde pesëdhjetë e tre milionë e tetëqind e njëzetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh si edhe preventivit bashkëlidhur tij.”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Pra jemi në situatë që preventivi i “dorëzuar” në AKPT dhe i “miratuar” nga Instituti i Ndërtimit, nuk është i shoqëruar me analizë të detajuar të çmimit ku futet (vlera e mallit/ pajisje + pagesa e sigurimeve shoqërore + pagesa e punëtorisë), për rrjedhojë nga AK në këtë rast Ministria e Kulturës, duhej të kërkohej si dhe të mos harrojmë faktin që AK në mënyrë sistematike ka pasur marrëdhënie konsultime dhe diskutime me projektuesin “.....”, pasi jemi në kohën e realizimi i projektit të plotë.

- Kështu për pasojë, në shpalljen e kësaj procedure prokurimi është përdorur preventivi i hartuar nga “Atelier 4” pa analizë të detajuar, duke sjellë që oferta ekonomike e shpallur fituese që përmban 170 zëra, janë me analizë çmimi, por bashkëlidhur nuk u evidentua një listë e hollësishme çmimesh.

- Grupi i auditimit nuk mund të përllogarisë saktë, vlerën e saktë të çmimeve, ku përshihen 170 zëra të preventivit (sisteme teknike, punë civile, pajisje, mobilim, etj) pasi preventivi mbi të cilin është përllogaritur fondi limit nga Ministria e Kulturës, është pa analizë çmimesh të detajuar, ku futet (vlera e mallit/pajisja + pagesa e sigurimeve shoqërore + pagesa e punëtorisë + transport, etj) .

Sa më sipër, grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë .

2. Në observimet faqe 9 citohet se “Njësia e prokurimit ka vendosur kriteret e nevojshme të kualifikimit për të testuar kapacitetet teknike dhe financiare të ofertuesve. Në zbatim të paragrafit të dytë, të pikës 2, të nenit 61, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kriteret e kualifikimit janë argumentuar jo vetëm ligjërisht, por edhe teknikisht. Në vendosjen e këtyre kriterëve është mbajtur parasysh natyra dhe përmasat e kontratës që prokurohen, si edhe qëllimin dhe parimet mbi të cilat bazohet ligji për prokurimin publik. Jo rastësisht, asnjë operator ekonomik nuk paraqiti ankesë për kriteret e kualifikimit....”

- Grupi i auditimit, bën me dije se, duke krahasuar kriteret e vecanta të kualifikimit KVK dhe certifikatat e kërkuara nga njësia e prokurimit në DT Shtojca nr.9, me kriteret dhe standartet e kërkuara nga projektuesi “...”sh.p.k tregojnë që AK, ka minimizuar ndjeshëm vendosjen e kriterëve në pikën 2.3 specifikisht në vendosjen e certifikatave, në kundërshtim me LPP neni 23 (Specifikimet teknike) dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 30 (kërkesat e cilësisë) neni 61 (hartimi dhe publikimi i dokumentave të tenderit), duke ulur standartet të realizimit të objektit të Teatrit Operas dhe Baletit si vepër multidimensionale dhe multifunksionale (paraqitur në Akt-konstatimin nr.3).

- Në bazë të procedurës së prokurimit me objekt “Kolaudimi i punimeve për objektin “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Asamblit Popullor”, në ftesën për ofertë me shkresë nr.8732/5 prot datë 15.11.2019, në kriteret e veçanta të kualifikimit në pikën 3, nga titullari i AK (sekretari i përgjithshëm) me të drejtë është kërkuar për operatorët ekonomikë (Licenca profesionale e OE për kategoritë kryesore) midis të tjerave, janë kërkuar:

NS-3 Impiante ngritese dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues);

NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese;

NS-8c Struktura druri



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Këto KVK nuk janë kërkuar nga njësia e prokurimit, si rrjedhojë, grupi i auditimit, vlerëson që për Fazën e 3, që përkon me objektin tenderues “Blerje pajisje teknologjisë së skenës dhe material ne funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP”, detyrimisht njësia e prokurimit duhet të kishte kërkuar këto licensa profesionale.

Sa më sipër, grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë.

3. Në bazë të njoftimit të kontratës dhe hartimi i DT, me shkresë nr.68/1 prot datë 07.01.2019 me REF-03208-01-07-2019, kjo kontratë është miratuar si Kontratë Mallrash, si rrjedhojë dhe informacioni për kontrata duhej të procedohej sipas VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 27 (kontrata e mallrave), por në DT, nuk është kërkuar sipas nenit 27 (Kontratat e mallrave) pika 2 “AK në dokumentat e tenderit parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë si dhe grafikin e lëvrimin të mallrave”.

4. Nëse AK, do të kishte prokuruar dhe këta dy kapituj në fazën e parë me (Kontratë Zbatimi Punimesh nr.5349 datë 31.10.2016), e gjithë kontrata do të ishte Kontratë Zbatimi Punimesh, por pamundësia e burimit financiar në atë kohë, nuk mund të justifikohet që vazhdimësia e saj të quhej një kontratë e mirëfilltë mallrash, realizimi i investimit është shumë multi kompleks, për rrjedhojë është detyrim ligjor i AK Ministrisë së Kulturës, që realizimin e këtij qëllimi ta arrijë duke mirë menaxhuar fondet të siguruara nga Buxheti i Shtetit, duke respektuar bazën ligjore në përputhshmëri të plotë dhe në mënyrë sa më transparente.

5.

Si përfundim, për procedurën me objekt “Blerje pajisje teknologjisë së skenës dhe material ne funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP”, në lidhje mbi përputhshmërinë e realizimit prej MK në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, është vepruar në kundërshtim, me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 23, 46, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 17, 27, 30 dhe 61.

Titulli i Gjetjes nr.1:	Vlerësimi i përputhshmërisë të realizimit të procedurës me objekt, “Blerje pajisjeve të teknologjisë së skenës dhe material në funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP” realizuar në vitin 2019.
Situata:	Nga auditimi i përputhshmërisë së procedurës me objekt “Blerje pajisje të teknologjisë së skenës dhe materiale ne funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP”, u konstatua se: -Kjo procedurë është në vazhdimësi të investimit për rehabilitimin e TKOBAP, ku autoriteti kontraktor i MK, më datë 28.09.2016 ka realizuar procedurën e hapur, kontratë zbatimi punimesh me objekt “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor”, me fond limit 998,862,862 lekë pa tvsh ¹¹ . Në këtë kontratë punimesh, nuk u përfshinë kapitulli III “F.V. Ashensor

¹¹ audituar nga KLSH në bazë të Programit nr.1264/2 datë 14.12.2017 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	dhe IV “Pajisje të skenës dhe sallës”, me argumentin që fondet, që pritej të siguroheshin nga granti i Qeverisë së Kinës, Qeverisë Greke dhe nga Bashkia e Tiranës, nuk arritën të përthithen e për rrjedhojë fondet për implementimin e mëtejshëm të rehabilitimitin u financuan nga Buxheti i Shtetit, vetëm në vitin 2019; - Nisur sa më sipër, në rolin e Titullarit të AK, ish-Ministri, zj. M. K, miratoi urdhrin nr. 854 datë 18.12.2018, me shkresën nr. 9209/3, “Për ngritjen e komisionit për llogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit”, ku argumentohet dhe aprovohet, që preventivi i detajuar, për kapitujt III “F.V. Ashensorë “ dhe IV “Pajisje të skenës dhe sallës”, është bazuar në produktin e kontratës shërbimi nr.2685/1, datë 05.10.2015 me OE “.....”shpk, me objekt prokurimi për hartimin e projektit “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor”. Procedura është zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të territorit (AKPT) në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ndërsa Ministria e Kulturës, në cilësinë e përfituesit. Në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi¹², AKPT ka pasur detyrimin ligjor për ta marrë në dorëzim këtë projekt dhe për ta përcjellë pranë Institutit të Ndërtimit. <u>Nga auditimi u konstatua se, MK nuk ka miratimet përkatëse nga Këshilli Teknik i Institutit të Ndërtimit si dhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi¹³</u> -Në referim të procesverbalit nr. 9209/4 prot, datë 20.12.2018, për llogaritjen e fondit limit, ngritur në bazë të urdhërit të ministrit nr. 854 datë 18.12.2018, me përbërje A.O, A.A dhe M.H, është argumentuar se “...pas kontrollit të preventivit të detajuar, të pikave III- “F.V. Ashensorë “ dhe IV-“Pajisje të skenës dhe sallës”, nga kontraktuesi “.....”sh.p.k sipas kontratës nr.2685/1, datë 05.10.2015, komisioni përcakton vlerën e fondit limit prej 353,826,366 lekë pa tvsh.” Nga auditimi i zërave të preventivit për 2 kapitujt e mësipërm, u konstatua, <u>se 170 zëra janë me analizë çmimi, por bashkëlidhur nuk u evidentua një listë e hollësishme çmimesh me analizë të detajuar të çmimit ku futet (vlera e mallit/pajisja +pagesa e sigurimeve shoqërore+pagesa e puntorisë+ transport, etj), në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”. Në shtesë të arsyetimit, grupi i auditimit, vlerëson se, krahas projektit të zbatimit, pjesë e detyrimeve kontraktuale të OE“.....”shpk, ka qenë edhe përcaktimi i fondit limit e hartimi i preventivit për këtë objekt.</u>
--	--

¹² Ligji nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, VKM nr.363, datë 18.7.2002 “Për vendosjen e opioncës teknike për projektet e ndërtimit të objekteve”.

¹³ Në bazë të VKM-së nr. 514 datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, kërkohet metodologjia e llogaritjes së kostos së preventivit në mënyrë të detajuar si dhe miratimi nga Këshilli Teknik i Institutit të Ndërtimit si dhe miratimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke e regjistruar projektin së bashku me preventivin.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	<u>Meqënëse, nga AK është përdorur preventivi i hartuar nga “.....”shkp, është kompetencë dhe përgjegjësi e “.....”shpk, zbatimi i legjislacionit përkatës që përcakton strukturën apo çmimet e përdorura të preventivit dhe të tjera detaje teknike.</u> Marrja në dorëzim e projektit të zbatimit nga ana e AK, <u>duhet të konsistonte në verifikimin e përputhshmërisë së vlerës së preventivit shoqërues me atë që është deklaruar në ofertën ekonomike të OE, duke e shoqëruar me një listë të hollësishme të çmimeve me analizë të detajuar të çmimit ku futet (vlera e mallit/pajisja +pagesa e sigurimeve shoqërore+pagesa e puntorisë+ transport, etj)¹⁴</u> Për sa më sipër, <u>grupi i auditimit nuk mund të përlllogarisë saktë</u>, vlerën reale të çmimeve, për shkak të mungesës së analizave të çmimeve, pasi projektuesi “.....”shpk, ka hartuar çmimet të pareferuara në studimin e tregut, në çmimet e marra në internet, apo në çmimet e miratuara nga INSTAT (psh, ku është bazuar për llogaritjen e çmimit të poltroneve të sallës, të mobiljeve, të pajisjeve, etj). Gjithashtu, <u>shkakut të mësipërm, iu mbivendos dhe situata e krijuar nga Covid-19</u>, duke diktuar kështu edhe ndërprerjen e auditimit në terren, dhe si pasojë grupi i auditimit nuk arriti të bënte verifikimin e çmimeve me metodën krahasimore dhe në të tilla kushte nuk arriti të vlerësojë saktë risqet potenciale me të cilat mund të përballlet MK. Në këtë rast, është përgjegjësi e hartuesit e preventivit OE “.....”, titullarit të AK-së, komisionit për hartimin e fondit limit me përbërje (A.O, A.A dhe M.H) si dhe njësisë së prokurimit me përbërje (E.A, B.H dhe S. Sh). - Nga auditimi u konstatua se, duke krahasuar kriteret e vecanta të kualifikimit KVK dhe certifikatat e kërkuara nga njësia e prokurimit në DT (Shtojca nr.9), me kriteret dhe standartet e kërkuara nga projektuesi “.....” sh.p.k, vihet re që AK, ka minimizuar ndjeshëm vendosjen e kriterëve në pikën 2.3, specifiku në vendosjen e certifikatave, në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi¹⁵. -Kjo mangësi është suprimuar, në procedurën e prokurimit me objekt “Kolaudimi i punimeve për objektin “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Asamblit Popullor”, ku vihet re se, në ftesën për ofertë me shkresë nr.8732/5 prot datë 15.11.2019, në kriteret e veçanta të kualifikimit në pikën 3, nga AK (njësia e prokurimit) me të drejtë është kërkuar Licensa profesionale e OE për kategoritë kryesore për operatorët ekonomikë, duke kërkuar: -NS-3 “Impiante ngritese dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)”;
--	---

¹⁴ sipas procesverbalit me shkresë nr.9209/4 prot datë 20.12.2018

¹⁵ me LPP neni 23 (Specifikimet teknike) dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 30 (kërkesat e cilësisë) neni 61 (hartimi dhe publikimi i dokumentave të tenderit), duke ulur standartet e realizimit të objektit të Teatrit Operas dhe Baletit, si vepër multidimensionale dhe multifunksionale (paraqitur në Akt-konstatimin nr.3).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	-NS-4 “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese”; dhe -NS-8c “Struktura druri”. Ndërsa në fazën e 3-të, që përkon me objektin tenderues “Blerje pajisje teknologjisë së skenës dhe materiale në funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP”, këto KVK nuk janë kërkuar nga njësia e prokurimit, në një kohë që grupi i auditimit, vlerëson së është e rëndësishme kërkesa e këtyre licencave profesionale në këtë fazë. -Nëse AK, do të kishte prokuruar dhe këta dy kapituj që në fazën e parë (me Kontratën Zbatim-Punimesh nr. 5349 datë 31.10.2016), e gjithë kontrata do të konsiderohej si Kontratë Zbatim- Punimesh; pamundësia e burimit financiar në atë kohë, nuk mund të përdoret si argument që vazhdimësia e një kontrate ekzistuese, të konsiderohet si kontratë e mirëfilltë mallrash. Qëllimi i realizimit të investimit rezulton të jetë multi-kompleks, dhe për rrjedhojë është detyrim ligjor i AK-së (Ministrisë së Kulturës) që realizimin e këtij qëllimi ta arrijë duke mirë menaxhuar fondet e buxhetit të shtetit, dhe duke respektuar bazën ligjore në përputhshmëri të plotë dhe në mënyrë sa më transparente.
Kriteri:	ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 23, 46, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”nenet 17, 27, 30 dhe 61, si dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit. .



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Ndikimi/Efekti:	-Autoriteti Kontraktor i MK, ka pranuar preventivin me vlerë prej 353,826,366 lekë pa tvsh, i cili nuk është i shoqëruar me analizë të detajuar të çmimit ku futet (vlera e mallit/ pajisje + pagesa e sigurimeve shoqërore + pagesa e punëtorisë+ transport, etj). Grupi i auditimit nuk mund të përllogarisë saktë, vlerën e saktë reale të çmimeve, ku në këto zëra përshihen (sisteme teknike, punë civile, pajisje teknologjike, mallra mobilim, etj) pasi preventivi mbi të cilin është përllogaritur fondi limit nga Ministria e Kulturës, është pa analizë çmimesh të detajuar, ku futet (vlera e mallit/pajisja +pagesa e sigurimeve shoqërore+pagesa e punëtorisë+ transport, etj) . - Nga njësia e prokurimit nuk janë vendosur KVK, duke ulur standartet të realizimit të objektit të Teatrit Operas dhe Baletit si vepër multidimensionale dhe multifunkionale (paraqitur në Akt-konstatimin nr.3). - Nga vetë titullari i Ministrisë së Kulturës (Ministri zj.Elva Margariti),janë konstatuar që disa segmente të prokurimit si, vlera që do të mbikqyret, ndonëse është kontratë mallrash, pasi me të drejtë ka zëra të cilat janë punë civile, nuk është bërë konform <u>përcaktimeve në legjislacionin në fuqi</u> . Kështu MK, duhej të kishte analizuar arsyet dhe shkaqet,e mospërputhshmërisë ligjore të për të pasur një kontratë të suksesshme, e për rrjedhojë të aplikohet dhe marrja e masave administrative/ disiplinore,të personave, të cilat kanë shkaktuar, shkelje të rregullave të ligjit të prokurimeve publike, të ligjit nr.152/2013 01.10.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar , në mënyrë që mos krijohen risqe ekonomike në disfavor të Buxhetit të Shtetit.
Shkaku:	Mos përputhshmëri me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenet 23, 46, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenet 17, 27,29,30 dhe 61.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandime:	Ministria e Kulturës, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune të veçantë me specialistë të fushës dhe në bashkëpunim me projektuesin “Atelier 4” shpk, të hartojnë edhe njëherë analizat e çmimeve të çdo zëri të preventivit, bazuar në VKM- në nr. 514 datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.” Nëse pas analizës së grupit rezulton se, çmimet e preventivit të hedhur në DT, janë llogaritur më të larta nga rezultatet e ri llogaritjes te dala nga ky grup pune, atëherë të bëhet korrektimi i tyre me çmimet e preventivit fitues, që janë më të larta se fondi limit dhe diferenca e konstatuar të arkëtohet në Buxhetin e Shtetit.

II.Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të procedurave me objekt “Projekti i restaurimit dhe riformulimi i linjës Muzeore në Muzeun Historik Kombëtar”dhe “Projekti i restaurimit dhe rehabilitimit të hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve” viti 2018 realizuar në MK



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Në bazë të auditimit për procedurat e mësipërme kemi konstatuar si vijon :

1.Procedurë negociim pa shpallje me objekt “Projekti i restaurimit dhe riformulimi i linjës Muzeore në Muzeun Historik Kombëtar”, me vlerë të fondit limit prej 33,333,333 lekë(pa tvsh), lidhur kontratë me vlerë prej 39,960,000 lekë(me tvsh).

Të dhënat e përgjithshme të tenderit

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Projekti i restaurimit dhe riformulimi i linjës Muzeore në Muzeun Historik Kombëtar		
1. Urdhër Prokurimi nr. 481 prot datë 19.07.2018 ,titullari i AK(ish-Ministri M.K) ka miratuar Njësinë e prokurimit në cilësinë e Hartuesit të Dokumenteve Tenderit 1.E.A, jurist (Drej i Prokurime MK) 2. E. M specialist në IMK 3.B. H specialist IMK	3.Përgatitja e termave të references, fondin limit për hartimin e projektit të restaurimit, rikonstruksionit dhe rehabilitimit të Galerisë Kombëtare të Arteve.”sipas Urdhër të ish-ministrit të kulturës në cilësinë e titullarit të AK-së nr.8 datë 08.01.2018, me përbërje grupi (E.T, D.P, K.A, S.J, M.J, L. Ll dhe G. B)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave , i ngritur në bazë të urdhër nr.482, datë 19.07.2018 1.L.L kryetar (me formim shkenca politike, master turizëm dhe marëdhënie ndërkombëtare) 2.D.K, Anëtar (me formim historian, Drejtor i MHK) 3.A. S (specialist në IMK, arkitekt); 4.A. K (specialist në MK, me formin akademik histori-mesuesi) 5.D. K (ing ndërtimi specialist në MK)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 33,333,333 (tridhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e tre mijë e tridhjetë e tre) lekë.	6. Oferta fituese (pa tvsh) 31,968,000 (tridhjetë e një million e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,365,333 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë.
8. Data e hapjes së tenderit Data 17.09.2018	9.Burimi Financimit Nga të ardhurat e Buxhetit të Shtetit	10. Operatoret Ekonomike 1 (një) BOE “....”shpk & “.....”shpk &”.....”shpk
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Shërbime		
14. Lidhja e kontratës Kontratë shërbimi nr.5983/13 prot datë 27.08.2018.Afati deri në 17.12.2018	15. Vlëra e kontratës me tvsh 39,960,000 (tridhjetë e nëntë million e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) leke me tvsh.	
16.Komisioni i marrjes në dorëzim:	17.Afati i kontratës në dite 111 ditë është realizuar brenda afatit.	

2.Procedurë negociim pa shpallje me objekt “Projekti i restaurimit dhe rehabilitimit të hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve” me fond limit 12,500,000 lekë(pa tvsh), lidhur kontratë me vlerë ofertë prej 14,880,000 lekë (pa tvsh).

Të dhënat e përgjithshme të tenderit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Projekti i restaurimit dhe rehabilitimit të hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 565 prot datë 31.08.2018 ,titullari i AK(ish-Ministri M.Kumbaro) ka miratuar Njësinë e prokurimit në cilësinë e Hartuesit të Dokumenteve Tenderit 1.E.A, jurist 2. E. M 3.B. H	3.Përgatitja e termave të references, fondin limit për hartimin e projektit të restaurimit, rikonstruksionit dhe rehabilitimit të Galerisë Kombëtare të Arteve.”sipas Urdhër të ish-ministrit të kulturës në cilësinë e titullarit të AK-së nr.8 datë 08.01.2018, pe përbërje grupi (D. P, K. A, S. J, M. J, L. Ll dhe G. B)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave , i ngritur në bazë të urdhër nr.566, datë 31.08.2018 1.V. Sh kryetar (zv/ministër, me formim akademik histori arti & dizajn grafik) 2.R.Xh (drejtor i përgj, me formin akademik jurist) 3.A. S. (specialist në IMK, arkitekt); 4.A. K (specialist në MK, me formin akademik histori-mesuesi) 5.L.D (specialist në MK, me formin arkitekt)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 12,500,000 (dymbëdhjetë million e pesëqindmijë) lekë.	6. Oferta fituese (pa tvsh) 12,400,000 (dymbëdhjetë milione katërqindmijë) lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 100,000(njëqind mijë)
8. Data e hapjes së tenderit Data 17.09.2018	9.Burimi Financimit Nga të ardhurat e Buxhetit të Shtetit	10. Operatorët Ekonomike 1 (një) BOE “....”shpk & “....”shpk &”.....”shpk
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Shërbime		
14. Lidhja e kontratës Kontratë shërbimi nr.6855/16 prot datë 27.09.2018.	15. Vlera e kontratës me tvsh 14,880,000 (katërmëdhjetë million e tetëqind e tetëdhjetë mijë) leke me tvsh.	
16.Komisioni i marrjes në dorëzim:	17.Afati i kontratës në dite 81 ditë është realizuar brenda afatit.	

Të dyja procedurat e mësipërme, janë realizuar nga AK, në kuadër të zbatimit të programit të Qeverisë Shqiptare 2017-2021, ku Ministria e Kulturës ka përcaktuar në listën e prioriteteve në fushën e trashëgimisë dhe kulturës hartimin e projekteve me objekte “Restaurimi, rikonstruksioni dhe riformulimi i linjës muzeore për Muzeun Historik Kombëtar dhe Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Artve).

-Grupet e punës të miratuara sipas urdhërit të Ministrit të Kulturës (zj.Mirela Kumbaro) në cilësinë e titullarit të AK me nr.8 datë 08.01.2018 *“Për zhvillimin e prokurimit publik, miratimin e grupit të punës, miratimin e pjesëmarrjes së një eksperti-konsulent të huaj në grupin e punës që do të përgatisë termat e referencës dhe fondin limit që do të vihet në dispozicion për hartimin e projektit të rikonstruksionit dhe rikonceptimit të Muzeut Historik Kombëtar dhe Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Artve)”*, kanë hartuar relacionet, termat e referencave dhe përcaktimet e fondit limit për hartimin e projekt zbatimit të objekteve të mësipërme.

-Në lidhje mbi këtë, u konstatua se në Udhërin nr.8, datë 08.01.2018 , pika 4,5,6,7, është urdhëruar që :



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

4. “Pjesë e grupit të punës së Ministrisë së Kulturës për këtë qëllim të bëhet gjithashtu znj. Elisabeta Terragni, eksperte e jashtme, e cila do të asistojë dhe këshillojë këtë grup në përgatitjen e këtij **konkursi**”

5. “Anëtarët e grupit të negocimit dhe monitorimit të kontratave të këtij projekti të kryejnë negociatat me znj. Elisabeta Terragni për detyrat dhe çmimin e kontratës për këtë qëllim.”

6. Drejtorja e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse procesverbalin e mbajtur nga grupi negociator për detyrat dhe çmimin e kontratës së znj. E.T.”

7. Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për përgatitjen më tej të procedurës për lidhjen e kontratës së punës me përfaqësuesit të Ministrisë së Kulturës dhe znj. E.T.”

Sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH-së, ka kërkuar në mënyrë të përsëritur, mbi mënyrën e përzgjedhjes së ekspertit të huaj dhe zbatimin e pikave të urdhërit të mësipërm, të cilat deri në momentin e hartimit të materialit ende nuk na janë venë në dispozicion (Drejtorja e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve dhe Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, kanë argumentuar se pikërisht me këto pika janë marrë këshilltarët e ish- Ministrit). Nga auditimi i shpenzimeve të viteve 2018 & 2019, nuk rezultoi të jetë bërë pagesa për ekspertin e huaj, ndonëse sipas urdhërit të mësipërme, flitet për “kontratë”.

-Sipas Relacioneve mbi gjendjet ekzistuese të objekteve muzeale, grupet e punës për hartimin e Termave referencës dhe përcaktimin e fondit limit të projektit, shprehen se “Gjendja e përgjithshme e objekteve shfaqen të rënduar dhe të amortizuar në kohë, konkretisht gjendja e konstruksionit, gjendja e sistemit elektrik, gjendja e sistemit mekanik, gjendja e fasadave, e për rrjedhojë, Muzeu Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve), janë të vetmit objekte të këtij lloji në vend, kështu kanë nevojë të ndërhyhet rrënjësisht në të gjithë elementët përbërës të tij, me qëllim funksionimin komod të aktiviteteve që zhvillohen në këtë objekt dhe të përmirësojë në mënyrë cilësore hapësirat duke sjellë një risi edhe në aktivitetin artistik e kulturor.”

-Për përcaktimin e fondit limit të hartimit të projekteve –zbatimi të mësipërme, grupet e punës janë bazuar në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territory, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, ku sipas përcaktimeve objektet janë klasifikuar në (Grupin e III tarifor-Kërkesa të larta të projektimit).

Kështu përlllogaritja dhe vlerësimet paraprake të vlerës së investimit janë kryer bazuar në vlerën e investimeve të mëparshme për objekte të të njejtës tipologji ndërtimi, si dhe nga analiza e tregut për punime të ngjashme/m². Nga auditimi, u konstatua se, në përbërjen e grupeve të punës janë vendosur 2 këshilltar të ministrit (zj. D.P dhe z. S.J), në kundërshtim, me Urdhërin nr.348 datë 18.09.2015 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të brëndshëm, të Ministrisë të Kulturës” neni 9(Kabineti i Ministrit), e cila është strukturë ndihmëse, e cila shërben si organ këshillimor pranë Ministrit, duke ushtruar të gjitha funksionet e parashikuara në ligjin nr.90/2012.

Gjithashtu, ftesat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë, mbajnë siglën e Kabinetit të Ministrit, kjo në kundërshtim me LPP si dhe me faktin që në bazë të VKM nr.164 datë 05.10.2017 “Për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Kulturës”, është Drejtoria e prokurimit, koncesionit dhe PPP (me 2 sektorë).

Ky fakt tregon për mbivendosje të strukturës ekzistuese dhe ato ndihmëse, të cilat në detyrat funksionale dhe në përshkrimin e vendeve të punës, kanë detyrim ligjor të bëjnë testimin e tregut në lidhje me procedurat e prokurimeve publike.

- Nga auditimi, për të dyja objektet janë realizuar dy procedura të hapura “Shërbim konsulencë”, nga AK i MK, duke mos dhënë asnjë argument pse është përzgjedhur “shërbim konsulencë” ndonëse në Urdhërin nr.8 datë 01.01.2018, shprehet për konkurs.

Kështu, për të njëjtin objekt prokurimi, për të dy (Muzeu Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Artve), kanë dështuar procedurat “shërbim konsulencë”, pasi nuk është arritur konkurrenca minimale me 2 (dy) kandidatë të kualifikuar për vazhdimin e mëtejshëm të kësaj procedure prokurimi.

Në referim të parashikimit të gërmës “dh”, të pikës 4 të nenit 37 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, procedurat janë anuluar.

-Për sa më sipër, në bazë të UP nr.565 datë 31.08.2018 “Për prokurimin e objektit “Hartimi i projektit, restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve), dhe UP nr.481 datë 19.07.2018 “Për prokurimin e objektit “Hartimi i projektit restaurimi, rikonstruksioni dhe riformulimi i linjës në Muzeun Historik Kombëtar”, të titullarit të AK ministrit të MK, me propozim të njësisë së prokurimit, janë përzgjedhur procedura “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit”, në mbështetje të ligjit LPP, neni 33, pika 2 gërma (a) si dhe në mbështetje të udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2 datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike” i ndryshuar, ku njësia e prokurimit me të drejtë ka vendosur të mos bëjë ndryshime thelbësore në dokumentat e tenderit dhe në fondin limit si dhe kriteret e përcaktuara do të jenë po ato kriteret të vendosura në procedurat e mëparshme të prokurimit “Shërbim Konsulencë”, për të njëjtin objekt .

Për sa më sipër dhe mënyra e vlerësimit të propozimeve teknike dhe ekonomike, realizohet në bazë të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” neni 37 pika 4 nënpika (i; ii;gj;h;).

-Nga auditimi, u konstatua se, KVO-të caktuar nga titullari i AK me urdhër nr.566, datë 31.08.2018 dhe urdhër nr.482, datë 19.07.2018, për të dyja procedurat, KVO, ka bërë vlerësimin e propozimit teknik, vetëm duke e paraqitur në formë tabelare totalin e pikëve, kjo në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” neni 37 pika (ii) “secili prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të shpjegojë në detaje vlerësimin e tij”.

KVO-ja është marrë më shumë, me ofertën e paraqitur, nëse përban ose jo gabime aritmetike si dhe nëse është ofertë me çmim anomalisht e ulët, duke vendosur më pas kualifikimin e BOE “.....”shpk & “....”shpk &”.....”shpk,për të dyja procedurat, duke lidhur kontrata si më poshtë:

1. Kontratë shërbimi nr.6855/16 prot datë 27.09.2018 me object “Hartim projekti për objektin “Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Artve) me vlerë kontrate prej 12,400,000 lekë pa tvsh me afat ekzekutimi deri në 17 dhjetor 2018;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

2. Kontratë shërbimi nr.5983/13 prot datë 27.08.2018 me objekt “Hartim projekti për objektin “Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Historik Kombëtar me vlerë kontrate prej 39,960,000 lekë me tvsh me afat ekzekutimi deri në 17 dhjetor 2018.

-Në përfundim të realizimit të kontratave të mësipërme, BOE“.....”shpk & “.....”shpk &”.....”shpk, në përmbushje të detyrimit kontraktor, duke përllogarit sumen totale të investimit për objektet;

1. Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Artve) me vlerë totale të investimit prej 1,356,395,879 lekë.
2. Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Historik Kombëtar me vlerë totale të investimit prej 1,923,924,367 lekë ose 15,796,872 Euro.

Si konkluzion, grupi i auditimit, vlerëson se, nga Autoriteti Kontraktor (Ministria e Kulturës) :

1). Në PBA e viteve në vazhdim, 2019, 2020, 2021, nuk janë planifikuar fonde për të realizuar restaurimin, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e hapësirave të Muzeut Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Artve), ndonëse janë përcaktuar në listën e prioriteteve , për të zbatuar programin e Qeverisë Shqiptare.

2).Duke marrë në konsideratë që gjendjet aktuale të objekteve, të cilat janë të rënduara (sipas Termave të referencës të hartuara në vitin 2018 për secilin), të cilat me kalimin e kohës, do të degradojnë më shumë, si pasojë e kushteve si dhe të fatkeqësive natyrore (siç ndodhi dhe termenti i 26 Nëntorit 2019).

3).Këto janë objekte të trashgimisë kulturore kategoria II,si dhe ndryshimi teknologjive të restaurimit, të rehabilitimit kohë mbas kohë, përbën element risku për implementimin e project-zbatimit.

Sa më sipër, mos planifikimi i fondeve buxhetore, mund krijojnë risqe ekonomike në disfavor të Buxhetit të Shtetit të vlerës prej 45,700,000 lekë pa tvsh ose 54,840,000 lekë me tvsh, të financuara për hartimin e projekteve për restaurimin, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e hapësirave të Muzeut Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Artve).

Në lidhje mbi problematikat e konstatuara është mbajtur Aktkonstatimi nr. 3 (on-line), në bazë VKM nr.243 datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore”, për shkak të situatës të karantinës nga VIRUSI COVID-19 .

Nga ana e institucionit të MK , në datë 26.03.2020, pranë KLSH është dërguar në mënyrë elektronike kërkesë për shryrje e afatit për shqyrtimin e akt-konstatimeve dhe përgatitjen e observacionet përkatëse, për shkak të situatës së COVID-19, e cila është miratuar nga Kryetari i KLSH-së me shkresë nr.62/3 prot datë 02.04.2020 me lëndë “Shryrje afati të observacioneve deri në datë 20.04.2020”

Në lidhje mbi konstatimet e grupit të auditimit, nga autoriteti kontraktor i MK janë përgatitur obserivimet respektive , me shkresë nr.1787 prot datë 21.04.2020 dhe në mënyrë elektronike, si dhe me shkresë nr.1916/1 prot datë 28.05.2020 /me nr.61/7 prot datë 29.05.2020 të KLSH, mbi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

projekt-raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për auditimin e ushtruar në Ministrinë e Kulturës Grupi i auditimit, në vlerësim të observimeve të dërguar ka rishikuar materialin, duke e paraqitur në formën përfundimtare në Raportin Përfundimtar.

Grupi i auditimit pasi i shqyrtoi observimet e paraqitura, mban këtë qëndrim si më poshtë vijon:

1.Në observimet faqe 15 & 16 citohej se “...përsa i përket pretendimit se ftesat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë, mbajnë siglën e Kabinetit të Ministrit, ofertat për studimin e tregut janë dërguar nga Këshilltari i Ministrit znj.D.P, në cilësinë e kryetarit të grupit të punës të ngritur me Urdhër të ministrit të Kulturës nr.8 datë 08.01.2018 “Për zhvillimin e prokurimit publik, miratimin e grupit të punës, miratimin e pjesëmarrjes së një eksperti –konsulent të huaj në grupin e punës që do të përgatisë termat e referencës dhe fondin limit që do të vihet në dispozicion për hartimin e projektit të rikonstruksionit dhe rikonceptimit të Muzeut Historik Kombëtar dhe Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve)”. Në pikën 1, të nenit 59, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet: “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.”

-Argumentimi i MK nuk është në përputhshmëri me me aktet ligjore dhe nënligjore të aplikuara, pasi në referim ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” i ndryshuar, neni 11 (Ministritë) pika 4 thuhet “Struktura e kabinetit mbështet drejtëpërdrejtë ministrin në ndjekjen e politikave përkatëse, realizimin e objektivave, si dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike të ministrisë. Funkionarët e kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror”, në përbërjen e grupeve të punës nuk duhej të vendoseshin 2 këshilltar të ministrit (zj, D.P dhe z. S.J).

-Gjithashtu, ftesat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë, mbajnë siglën e Kabinetit të Ministrit, kjo në kundërshtim me LPP si dhe me faktin që në bazë të VKM nr.164 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Kulturës”, është Drejtoria e prokurimit, koncesionit dhe PPP (me 2 sektorë). Ky fakt tregon për mbivendosje të strukturës ekzistuese dhe ato ndihmëse, të cilat në detyrat funksionale dhe në përshkrimin e vendeve të punës, kanë detyrim ligjor të bëjnë testimin e tregut në lidhje me procedurat e prokurimeve publike.

Sa më sipër, grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë.

2.Në observimet faqe 17 & 18 , grupi i auditimit i kundërshton me argumentimin si më poshtë: Nga auditimi për vitin 2019 rezultoi se, në **PBA e viteve 2019-2021** në programin Art dhe Kulturë, Ministria e Kulturës ka planifikuar sipas tabelës së mëposhtme investimin për projektin “Restaurimi, rikonstruksioni, riformulimi i Linjës muzeore në Muzeun Historik” vlera totale e të cilit është 1,929,924,367 lekë nga ku diferenca e mbetur do të mbulohej me tavanet e viteve në vazhdim të miratuar rishtazi.

në lekë

Emertimi i projektit te investimit	Parashikimi per v.2019	Parashikimi per v.2020	Parashikimi per v.2021
------------------------------------	------------------------	------------------------	------------------------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Restaurimi, rikonstruksioni, riformulimi i Linjes muzeore ne Muzeun Historik		258,063,000	492,500,000

Ajo që vihet re është se në fakt ky projekt është lënë mënjanë dhe në PBA 2020-2022, referuar edhe tavaneve të miratuara tre vjecare 2020-2022, Ministria e Kulturës hoqi nga plani afatmesëm projektin e investimit të Muzeut Historik Kombëtar dhe vendosi në PBA e viteve 2020-2022 planifikimin e investimit për “Restaurimin, Rikonstruksionin e Galerisë Kombetare të Arteve” me argumentin që vlera për këtë investim prej 1,366,280,000 lekë ishte relativisht më e ulët se ajo për Muzeun, konkretisht sipas tabelës më poshtë :

ë lekë

Emertimi i projektit te investimit	Parashikimi per v.2019	Parashikimi per v.2020	Parashikimi per v.2021
Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapsirave ne Muzeun e Arteve te bukra (Galerisë Kombetare të Arteve)	271,280,000	492,500,000	492,500,000

Përsa më lart, për diferencën e mbetur pa u mbuluar me tavanet e miratuara 2020-2022 janë kërkuar fonde shtesë prej 110,000,000 lekë. Vëmë re se në total vlera e projektit është 1,336,289 mijë lekë për të cilat janë parashikuar për të tre vitet e njëpasnjëshëm në PBA-së. Nisja e investimeve (madje likuiduar fondet e projektit) dhe më pas ndërprerja e tyre për tu zëvendësuar me të tjera projekte, tregon për planifikimi të pa sakta, jo të shëndosha dhe që rrezikojnë të mbartin pasoja më efekt menaxhim jo efektiv të fondeve të buxhetit të shtetit.

Titulli i Gjetjes nr. 2:	Aktivizimit të anëtarëve të kabinetit të Ministrit të Kulturës, në grupet e punës, komisionet e strukturave për realizimin e prokurimeve publike.
Situata:	Nga auditimi i përputhshmërisë të procedurave tenderuese të zhvilluara nga Ministria e Kulturës, në cilësinë si autoritet kontraktor , për vitet buxhetore 2018 dhe 2019, konkretisht në procedurat me objekte: 1. “Projekti i restaurimit dhe riformulimi i linjës Muzeore në Muzeun Historik Kombëtar”, viti 2018. 2. “Projekti i restaurimit dhe rehabilitimit të hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve” viti 2018.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	3.“Blerje pajisje teknologjisë së skenës dhe material ne funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP”; 4.“Mbikëqyrje e punimeve për objektin “Blerje e pajisjeve të teknologjisë së skenës dhe material në funksion të projektit rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor”; 5.“Kolaudimi i punimeve për objektin “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Asamblit Popullor”, viti 2019 realizuar në MK, <i>u konstatua se</i>, në përbërjen e grupeve të punës për hartimin e fondit limit, në përcaktimin e termave të referencës, në hartimin e Memo për të iniciuar procedura prokurimi, në monitorimin e kontratave si dhe në miratimin e pagesave, janë vendosur 2 këshilltar të ministrit (zj, D.P dhe z. S.J), në kundërshtim, me Urdhërin nr.348 datë 18.09.2015 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të brëndshëm, të Ministrisë të Kulturës” neni 9 (Kabineti i Ministrit), e cila është strukturë ndihmëse, e cila shërben si organ këshillimor pranë Ministrit, duke ushtruar të gjitha funksionet e parashikuara në ligjin nr.90/2012. Këto veprime janë në kundërshtim me LPP si dhe me faktin që në bazë të VKM nr.164 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Kulturës”, është Drejtoria e prokurimit, koncesionit dhe PPP (me 2 sektorë). Ky fakt tregon për mbivendosje të strukturës ekzistuese dhe ato ndihmëse, të cilat në detyrat funksionale dhe në përshkrimin e vendeve të punës, kanë detyrim ligjor të bëjnë testimin e tregut në lidhje me procedurat e prokurimeve publike.
Kriteri:	Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , me Urdhërin nr.348 datë 18.09.2015 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të brëndshëm, të Ministrisë të Kulturës” , me ligjin nr.90/2012 dhe VKM nr.164 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Kulturës.”
Ndikimi/Efekti:	Tejkalim të kompetencave duke krijuar struktura paralele me strukturat ekzistuese dhe ato ndihmëse, të cilat në detyrat funksionale dhe në përshkrimin e vendeve të punës, kanë detyrim ligjor të jenë të përfshirë në realizimin e procedurave të prokurimeve publike.
Shkaku:	Mos përputhshmëri me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , me Urdhërin nr.348 datë 18.09.2015 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të brëndshëm, të Ministrisë të Kulturës” , me ligjin nr.90/2012 dhe VKM nr.164 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Kulturës.”
Rëndësia:	I lartë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Rekomandime:	Nga ana e Titullarit të MK, të merren masa që për realizimin e procedurave të prokurimeve, në komisione të përfshihen persona kompetente, në përshtatje me detyrat funksionale të përcaktuara, si dhe të trajnuar në mënyrë të vazhdueshme në bashkëpunim me/nga Agjencia e Prokurimeve Publike dhe Departamenti i Administratës Publike dhe jo ndryshe, sikundër ka ndodhur me përfshirjen në komision të këshilltarëve të kabinetit të Ministrit.
Titulli i Gjetjes nr. 3:	Vlerësimi i përputhshmërisë të realizimit të procedurave me objekte “Projekti i restaurimit dhe riformulimi i linjës Muzeore në Muzeun Historik Kombëtar” dhe “Projekti i restaurimit dhe rehabilitimit të hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve” viti 2018 realizuar në MK (efekte negative në menaxhimin me efecience, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike)
Situata:	Të dyja procedurat e mësipërme, janë realizuar nga AK me procedurë “Negocim pa shpallje”, në dështim të procedurave “shërbim konsulence”, për shkak pasi nuk është arritur konkurrenca minimale. Hartimi për realizimin e projekteve, është në kuadër të zbatimit të programit të Qeverisë Shqiptare 2017-2021, ku Ministria e Kulturës ka përcaktuar në listën e prioriteteve në fushën e trashëgimisë dhe kulturës hartimin e projekteve me objekte “Restaurimi, rikonstruksioni dhe riformulimi i linjës muzeore për Muzeun Historik Kombëtar dhe Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Artve). Sipas Relacioneve mbi gjendjet ekzistuese të objekteve muzeale, grupet e punës për hartimin e termave referencës dhe përcaktimin e fondit limit të projektit, shprehen se gjendja e përgjithshme e objekteve shfaqen të rënduar dhe të amortizuar në kohë, konkretisht gjendja e konstruksionit, gjendja e sistemit elektrik, gjendja e sistemit mekanik, gjendja e fasadave, duke kërkuar, të ndërhyhet rrënjësisht në të gjithë elementët përbërës të tij, me qëllim funksionimin komod të aktiviteteve që zhvillohen në këtë objekt dhe të përmirësojë në mënyrë cilësore hapësirat duke sjellë një risi edhe në aktivitetin artistik e kulturor. AK, ka shpallur fitues BOE “.....”shpk & “.....”shpk & “.....”shpk, për të dyja procedurat, duke lidhur kontrata si më poshtë: 1.Kontratë shërbimi nr.6855/16 prot datë 27.09.2018 me objekt “Hartim projekti për objektin “Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Artve) me vlerë kontrate prej 12,400,000 lekë pa tvsh me afat ekzekutimi deri në 17 dhjetor 2018; 2.Kontratë shërbimi nr.5983/13 prot datë 27.08.2018 me objekt “Hartim projekti për objektin “Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	hapësirave në Muzeun Historik Kombëtar me vlerë kontrate prej 39,960,000 lekë me tvsh me afat ekzekutimi deri në 17 dhjetor 2018. Në përfundim të realizimit të kontratave të mësipërme, BOE“.....”shpk & “.....”shpk &”.....”shpk, në përmbushje të detyrimit kontraktor, duke përllëgarit shumën totale të investimit për objektet; 1. Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve) me vlerë totale të investimit prej 1,356,395,879 lekë. 2. Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Historik Kombëtar me vlerë totale të investimit prej 1,923,924,367 lekë ose 15,796,872 Euro. Për më sipër, nga auditimi u evidentua se: -Në PBA e viteve në vazhdim, 2019, 2020, 2021, <u>nuk janë planifikuar fonde për investimin</u> për të realizuar restaurimin, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e hapësirave të Muzeut Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve), ndonëse janë përcaktuar në listën e prioritetëve, për të zbatuar programin e Qeverisë Shqiptare. -Duke marrë në konsideratë që gjendet aktuale të objekteve, të cilat janë të rënduara (sipas Termave të referencës të hartuara në vitin 2018 për secilin), të cilat me kalimin e kohës, do të degradojnë më shumë, si pasojë e kushteve si dhe të fatkeqësive natyrore (siç ndodhi dhe termenti i 26 Nëntorit 2019). -Këto janë objekte të trashëgimisë kulturore kategoria II, si dhe ndryshimi teknologjik të restaurimit, të rehabilitimit kohë mbas kohë, përbën element risku për implementimin e project-zbatimit. Planifikimi i fondeve vetëm për realizimin e projekteve dhe jo për implementimin e tyre, e vendos MK-në përballë riskut potencial të keqmenaxhimit të fondeve buxhetore për shumën mund <u>prej 45,700,000 lekë pa tvsh ose 54,840,000 lekë me tvsh</u>, që është vlera e financuar vetëm për hartimin e projekteve për restaurimin, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e hapësirave të Muzeut Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve).
Kriteri:	Në referim të ligjin nr 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 33, pika 2 gërma (a) të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 37, pikave “dh” dhe “ii”, udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2 datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike” i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Mos planifikimi i fondeve buxhetore, mund krijojë risqe ekonomike në disfavor të Buxhetit të Shtetit të financuara për hartimin e projekteve për restaurimin, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e hapësirave të Muzeut Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Shkaku:	Mosplanifikim të fondeve publike, për të realizuar në kohë implementimin e projekteve të hartuara. Në PBA e viteve në vazhdim, 2019, 2020, 2021, <u>nuk janë planifikuar fonde</u> për të realizuar restaurimin, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e hapësirave të Muzeut Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Artve), ndonëse janë përcaktuar në listën e prioriteteve , për të zbatuar programin e Qeverisë Shqiptare.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandime:	Me qëllim menaxhimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve në disfavor të Buxhetit të Shtetit, nga Autoriteti Kontraktor i Ministrisë së Kulturës, të merren masa që vecanërisht për projekte me rëndësi të lartë për publikun, të tregohet kujdes maksimal përgjatë planifikimit por edhe sigurimit në kohë të fondeve të nevojshme, për realizimin deri në implementim të plotë, dhe jo pjesor të tyre.

Nga auditimi, u konstatua se më datë 28.09.2016 është realizuar procedura e hapur me objekt **“Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor”** me fond limit 998,862,862 lekë pa tvsh, duke lidhur Kontratë Zbatimi Punimesh nr.5349 datë 31.10.2016 me BOE “.....” sh.p.k & “.....”shpk me vlerë kontratë 1,112,105,000 lekë.

Afati i zbatimit të kontratës është 30 muaj, ku përllogaritja fillon me datën e fillimit të punimeve. Kjo procedurë është audituar nga grupi i mëparshëm në bazë të Programit nr.1264/2 datë 14.12.2017.

Kontrata Zbatim Punimesh nr.5349 datë 31.10.2016, është duke u ekzekutuar, pasi ka pësuar amendime kohore si më poshtë vijon:

1.Aneks Kontrate nr.1 me shkresë 1435/3 prot datë 06.06.2019 “Supervizion punimesh për zbatimin e punimeve të rehabilitimit të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Asamblit Popullor”, me arsyetimin sipas nenit 3/3 të kontratës nr.5976 prot datë 07.12.2016 ku thuhej **“Afati maksimal i përfundimit të supervizionit është 30 muaj nga data e lidhjes së kontratës.”**

Në Aneks bëhet neni 1”Afati i përfundimit të supervizionit është deri në përfundimin e punimeve dhe marrjen e përkohshme të tyre në dorëzim”.

2.Aneks Kontrate nr.1 me shkresë 4349/3 prot datë 12.09.2019 “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor” me arsyetimin se AK dhe Kontraktuesi BOE “E.....” sh.p.k & “.....”shpk , me arsyetimin se :

-Pamundësitë të aksesit në zona të ndryshme të kantierit që si rrjedhojë kanë sjellë ndryshime në planin e organizimit të kantierit dhe proceset e ndryshme të punimeve. Në këto raste sikurse kërkohet prej kontratës së firmosur, Kontraktori ka njoftuar me shkrim si AK ashtu dhe mbikqyrsin e punimeve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

-Ripozicionimin e ambjentit teknik me kërkesë të Bashkisë së Tiranës.Kjo ka sjellë ndryshime në planin e organizimit të kantierit dhe proceset e ndryshme të punimeve.Kontraktori ka njoftuar me shkrim si AK dhe mbikqyrsin e punimeve.

-Projekti i sistemit akustik të skenës dhe auditorit si edhe mungesa e Pajisjeve të skenës. Për efekte konstruktive dhe akustike lindi nevoja e rishikimit të sistemit të akustikës. Pajisjet e skenës nuk ishin pjesë e tenderit të fituar nga BOE“.....” sh.p.k & “.....”shpk, për rrjedhojë ishte e nevojshme tenderimi që kërkoi kohën e vet për tu realizuar.Kontraktorit iu desh të ndërpriste punimet në zonën në fjalë duke njoftuar me shkrim si AK dhe mbikqyrsin e punimeve.

3. Aneks Kontrate nr.2 me shkresë 7018/4 prot datë 03.12.2019 “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor” me arsyetimin se AK dhe Kontraktuesi BOE“.....” sh.p.k & “.....”shpk , me arsyetimin se :

-Mbikëqyrsi i punimeve, me shkresën nr.2776 prot datë 02.12.2019, bazuar në pikën 7.3, gërma “ç”, të VKM nr.750 datë 27.11.2019 “për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, ka kërkuar ndërpreje të përkohshme të afatit të kontratës për shkak të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë, ku afati i realizimit të kontratës është deri në datë 29.02.2020.

Më poshtë po parqesim analizën me te detajuar të procedurës së ndjekur për shtesën e kontratës:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion **për shtesën e kontratës së "Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor " 2020**, konstatohet:

- Kontrata Bazë e zbatimit të punimeve nr. 5349 datë 31.10.2016¹⁶, është nënshkruar midis Ministrisë së Kulturës përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm znj. E.K BOE “.....” sh.p.k & “.....”shpk, përfaqësuar nga administratorët z. A. C dhe A.ZH. Vlera e kontratës është 926,754,355 lekë pa TVSH ose **1,112,105,000** lekë me TVSH. Supervizioni i punimeve të zbatimit është shoqëria “.....” shpk, përfaqësuar nga administratori A.E.

- Kushtet e vecanta të kontratës kanë përcaktuar, kushtet prioritare të kontratës, ku përcaktohet afati i zbatimit të kontratës në nenin 1 “Objekti i kontratës dhe afati i saj” me 30 muaj të panegociushëm, që nga data e fillimit të punimeve. Në nenin 11 “Rastet e shkarkimit nga përgjegjësia”, specifikon zgjatjet e afatit të kryerjes së punimeve vetëm nga forca madhore, ku bëjnë pjesë lufrat, zjarret, përmbytjet, tërmetet. Janë realizuar disa amendime për shtyrje të afateve për shkak të pamundësitë të aksesit në zona të ndryshme të kantierit dhe bazuar në VKM nr.750 datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, është kërkuar ndërpreje të përkohshme të afatit të kontratës për shkak të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë, ku afati i realizimit të kontratës është deri në datë 29.02.2020.

- Bazuar në nenin 7 të KVK “Zbatimi i kontratës dhe Preventivi”, parashikohet lloji i kontratës si më poshtë :

1. Zbatimi i kontratës do të bëhet me çelsa në dorë dhe me cmime të pandryshueshme.

2. Preventivat përfshijnë të gjitha zërat e punimeve për ndërtimin, instalimin dhe provat duhet të kryhen nga sipërmarrësi që përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës dhe e cila është vlerë fikse

¹⁶“Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor” me fond limit 998,862,862 lekë pa tvsh. Procedura e tenderimit është audituar nga grupi i mëparshëm në bazë të Programit nr.1264/2 datë 14.12.2017.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

që nuk mund të tejkalohet. Sipërmarrësi paguhet për sasinë e punës së kryer sipas projektit bazuar në cmim për cdo zë pune të preventivit.

Në dispozitat e fundit të Kushteve të Vecanta të Kontratë (KVK) neni 16, citohet se kushtet e përgjithshme të kontratës të Dokumenteve Standarde të Tenderit janë pjesë e kësaj kontrate. Në nenin 1 të kushteve të përgjithshme të kontratës (KPK), pika 1.5 citohet në mënyrë eksplicite :

Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Vecanta të Kontratës. Në rast se ka konflikt midis KPK dhe KVK, *KVK do të mbizotëzojnë mbi KPK.*

- Më datë 05.12.2019, është mbikqyrësi në bashkëpunim me kontraktorin kane filluar përgatitjen e procedurave për rritjen e vlerës së kontratës si dhe zgjatjen e afatit të punimeve, duke marrë shkak nga disa mospërputhje midis projektit dhe preventivit edhe nga kërkesat e TKOBAP me shkresën nr. 6641/3 datë 15.11.2019.

Nisur nga kjo u pa nevojshme rishikimi i projektit duke cuar në kërkesën e datës 05.12.2019, për shtesë kontrate. Shtesa e kontratës përfshin vetëm rritje të volumeve të punës për punët ndërtimore dhe kryesisht për instalimet elektrike e mekanike (*zëra të cilat kanë qenë të përfshira në preventivin bazë të kontratës bazë*).

Me shkresën e mbikëqyrësit të punimeve nr. 1100 prot. Datë 25.02.2020, propozohet zgjatje e afatit, ku citohet se kontraktori me shkresën nr. 263 prot. Datë 24.02.2020 citon listën e punimeve që nuk do të përfundonin sipas afatit duke qenë se janë të varura nga punimet që do të kryhen nga kontrata shtesë.

- Me aneksin nr.1 nr. 4349/3 prot datë 12.09.2019, citohet pamundësia e aksesit në zona të ndryshme të kantierit që si rrjedhojë kanë sjellë ndryshime në planin e organizimit të kantierit dhe proceset e ndryshme të punimeve.

- Me aneksin nr. 2, nr. 7018/4 datë 03.12.2019, nënshkruhet amendimi për shtyrje të afatit të punimeve deri më 29.02.2020. Aneksi 2 ka ardhur si rezultat i shkresës nr. 7018 prot. Datë 03.12.2019 të mbikëqyrësit të punimeve, me objekt ndërprerje e përkohshme e afatit të kontratës për shkak të shpalljes së gjendjes së fatkeqësive natyrore.

- Me aneksin nr. 3, nr. 1100/2 datë 28.02.2020, nënshkruhet amendimi për shtyrje të afatit të punimeve deri më **31.05.2020**, shtesë e cila i përket shtesës së kontratës, ku listohet 14 procese pune të cilat janë pjesë e kontratës shtesë (të pamiratuara), të cilat pengojnë proceset e punimeve në kontratën bazë. Pra sipërmarrësi kërkon patjetër shtesë kontrate, për të përfunduar kontratën bazë. *Preventivi i kontratës shtesë përfshin 11 kapituj të cilat ishin të përfshira plotësisht në kontratën bazë, ku janë përdorur të njëjtat cmime dhe vetëm rriten volumet e punimeve.*

- Kontrata shtesë e zbatimit të punimeve nr. 626/10 datë 02.03.2020, është nënshkruar midis Ministrisë së Kulturës përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm znj. E.C dhe BOE “.....” sh.p.k & “.....”shpk, përfaqësuar nga administratorët z. A.C dhe A.ZH. Vlera e kontratës është 165,083,333 lekë pa TVSH ose 198,099,999lekë me TVSH ose 18 % e kontratës bazë.

Shtesa e kontratës është bazuar në **nenin 36** të KPK “*Ndryshimi i porosisë*” ku citohet:

36.1. Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Cdo amendim i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga AK dhe kontraktori.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

36.2. Ndërtime shtesë mund të porositen vetëm në rrethana të përcaktuara në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos kalojë 20 % të cmimit origjinal të kontratës.

Në kushtet e kontratës dhe në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.80, datë 14.2.2018), Neni 26, Pika 2 “Kontratat për punë publike” Punët publike mund të prokurohen:

a) me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuara në projekt mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar. Kur punët prokurohen me anë të punimeve me matje, vëllimi i punëve jepet me hollësi dhe përmban të gjitha çmimet dhe përqindjet që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme (si për shembull: fondi rezervë, të ardhurat minimale, shpenzimet minimale).

b) me kontratë me çelësa në dorë, ku vëllimi i punëve i parashikuar në projekt, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit. Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi

Titulli i gjetjes nr. 1	Shtesa e kontratës për "Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor "
Situata:	Nga auditimi i shtesës së kontratës për "Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor " rezultoi se, kontrata bazë e zbatimit të punimeve nr. 5349 datë 31.10.2016, është nënshkruar midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE “.....” sh.p.k & “.....”shpk. Vlera e kontratës është 1,112,105,000 lekë me TVSH. Supervizioni i punimeve të zbatimit është shoqëria “Atelier-4” shpk. Bazuar në nenin 7 të KVK “Zbatimi i kontratës dhe Preventivi”, parashikohet lloji i kontratës, i cili do të bëhet me çelsa në dorë dhe me cmime të pandryshueshme. Preventivat përfshijnë të gjitha zërat e punimeve për ndërtimin, instalimin dhe provat dhe duhet të kryhen nga sipërmarrësi që përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës, e cila është vlerë fikse që nuk mund të tejkalohet. Në nenin 1, të kushteve të përgjithshme të kontratës (KPK), pika 1.5 citon në mënyrë eksplicite se, kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu “Kushtet e Vecanta të Kontratës (KVK)” dhe se në rast se ka konflikt midis KPK-ve, dhe KVK, atëherë KVK do të mbizotëzojnë mbi KPK. Më datë 05.12.2019, është përgatitur procedura për rritjen e vlerës së kontratës si dhe zgjatjen e afatit të punimeve, duke marrë shkak nga disa mospërputhje midis projektit dhe preventivit edhe nga kërkesat e TKOBAP. Me shkresën nr. 6641/3 datë 15.11.2019 u pa i nevojshëm rishikimi i projektit, duke cuar në kërkesën për shtesë kontrate më datë 05.12.2019. Shtesa e kontratës përfshin vetëm rritje të volumeve të punës për punët ndërtimore dhe kryesisht për instalimet elektrike e mekanike (zëra të cilat kanë qenë të përfshira në preventivin bazë të kontratës bazë). Për shkak të Covid-19, grupi i auditit nuk arriti të bënte



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	verifikim në terren, mbi përputhshmërinë ose jo të volumeve të punimeve dhe në të tilla kushte, duke vlerësuar risqet potenciale me të cilat mund të përballlet MK, si pasojë e keqmenaxhimit të fondeve, vlerësojmë nevojën emergjente që MK të verifikojë dhe shprehet për rastin e shtesës së kësaj kontrate. Kontrata shtesë e zbatimit të punimeve nr. 626/10 datë 02.03.2020, është nënshkruar midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE “.....” sh.p.k & “.....”shpk. Vlera e kontratës është 198,099,999 lekë me TVSH ose 18 % e kontratës bazë. Në kushtet e kontratës nuk parashikohet shtesa në vlerë dhe bazuar LPP në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.80, datë 14.2.2018), Neni 26, Pika 2 “Kontratat për punë publike”. Në observacionet e dërguara nga Autoriteti Kontraktor, konstatohet se Projektit ishte parashikuar të financohej me donatore të tjere. Burimi i financimit do të sigurohej nga fonde të huaja të vëna në dispozicion nga Qeveria e Republikës Popullore të Kinës dhe Qeveria Greke, si dhe fonde nga Bashkia e Tiranës për punime që ndërthuren me projektin me objekt: “Rivitalizim i Sheshit Skënderbej”. Pra, Autoriteti Kontraktor ka tenderuar vetëm një pjesë të punimeve të ndërtim-montimit për të cilat u shpall fitues BOE “.....” sh.p.k & “.....” sh.p.k Kjo gjë për arsye që nuk varen dhe janë në kontroll të AK u bë e pamundur, ndaj duhej që këto punime shtesë të kryheshin në mënyrë që të përfundojnë të gjitha punimet në vepër dhe kjo e fundit të vihet në funksion. Gjithashtu, ka patur shumë propozime e kërkesa shtesë nga Përfituesi “(TKOBAP)”, të cilat i janë percjelle Sipermarresit nga Autoriteti Kontraktor me shkresën Nr. 6641/3 Prot., dt. 15/19/2019. Në lidhje me ligjshmërinë e lidhjes së kontratës shtesë, grupi i auditimit, merre në konsideratë observacionet sepse rregullat e prokurimit publik lejojnë lidhjen kontratave shtesë kur vlera e punës dhe/ose shërbimeve shtesë nuk e tejkalon 20 për qind të vlerës së kontratës fillestare, në pikën 5 të neni 33 të LPP. Në lidhje me përputhshmërinë e zërave, volumeve dhe çmimeve të preventivit të punimeve të përcaktuara në kontratën shtesë dhe rakordimin e tyre me zërat, volumet dhe çmimet e preventivit të punimeve të përcaktuara në kontratën fillestare, nuk u krye auditim për përputhshmërinë e tyre: -<i>Jo vetëm</i> për faktin se, punimet deri në momentin e auditimit ishin në proces dhe sipas kontratës shtesë të datës 02.03.2020 përfundojnë në datë 31.05.2020, që është periudhë tej periudhës së përcaktuar në programin e auditimit i cili afatin e ushtrimit të auditimit e kishte deri në datën 31.12.2020; -<i>Por edhe</i> për faktin e fatkeqësisë natyrore të ndodhur gjatë muajit mars-prill 2020, për shkak të pandemisë shkaktuar prej Covid 19.
--	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Kriteri:	Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.80, datë 14.2.2018),
Ndikimi/Efekti:	Shtesa financiare dhe kohorepër përfundimin e veprës
Shkaku:	Mos koordinim i projektit fillestar në fazën tenderuese
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	- Ministria e Kulturës dhe TOB në bashkëpunim me projektuesin, mbikëqyrësin dhe sipërmarrësin e punimeve, të ngrejë një grup pune të veçante për të verifikuar përputhshmërinë e volumeve të punimeve sipas kontratës bazë dhe sipas shtesës së kontratës. - Ministria e Kulturës, në të ardhmen, për projektet e përbashkëta të marrë masa për koordinimin dhe bashkërendimin sa më të mirë të veprimeve midis Bashkisë Tiranë dhe donatorëve të ndryshëm, me qëllim realizimin dhe përfundimin e projekteve brenda afateve të përcaktuara, duke shmangur në cdo rast shtesat e kontratave, të cilat rrezikojnë të përballin institucionit dhe si pasojë buxhetin e tij me riske të keqmenaxhimit të fondeve.

6. MBI VLERËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Bazuar: VKM nr. 507 dt.13.09.2017 “Per percaktimin e Pergjegjesise Shteterore te Ministrise se Kultures”, Misionit “Për përmirësimin, konceptimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore për çështjet e sistemit të artit dhe kulturës”; Vizionit “Artet dhe trashëgimia kulturore e Shqipërisë, si forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit” si dhe referuar Ligjit nr.10296 dt.08.07.2010, sipas kreut III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19, në të cilin citohet: “Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetri: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informacioni dhe komunikimi, Monitorimi”, Ministria e Kulturës (MK), ka përgatitur pyetësorin e vetëvlerësimit për dy vite (2018, 2019) dhe më poshtë po i analizojmë në mënyrë të detajuar, duke përcaktuar mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. Mjedisi i Kontrollit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”



Sipas nenit 20 të Ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Nga auditimi u konstatua se, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, Kreu II, neni 8, pika 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit”; neni 9 pika 4/a “Përgjegjshmëria menaxheriale e Nëpunësit Autorizues”, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4,2,10/a “Roli i nëpunësit autorizues të njësive”, është hartuar “**Vizioni i Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025**” (Plani Strategjik) i cili përmban objektivat strategjike për periudhën 2019 – 2025¹⁷: Prioritet e

Institucionit, Skenarët e zhvillimit dhe Linjat strategjike, Planet e veprimit në Funksion të Objektiveve dhe Inisiativave strategjike, Plani Financiar dhe afatet kohore, duke e trajtuar Ministrinë e Kulturës (MK) me një dimension të ri: si burim të ardhurash, ku të ulen ndjeshëm investimet nga buxheti i shtetit dhe rritjen e tyre nga të ardhurat që do sigurohen nga vet institucioni (përfshirë edhe njësitë e varësisë).

1.1 Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues.

a. MK ka miratuar një Rregullore (bazë) me Urdhër Nr.348 dt.18.09.2015 shoqëruar me disa ndryshime të neneve “41” dhe “43” në zbatim të Urdhërit të Ministres Nr.282/1 dt.05.11.2015 mbi “Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në Raportin e KLSH”, e cila ka shfuqizuar Rregulloren e mëparshme miratuar me Urdhër të Ministres nr.293 dt.17.10.2014. Rregullorja përmban rregullat e organizimit dhe funksionimit të MK (të vlefshme deri në 2016 me daljen e Urdhërit të Kryeministrit nr.66 dt.07/04/2016) bazuar te VKM nr.844 dt.27.09.2013 “Për përcaktimin e Fushës së përgjegjësisë shtetërore të MK” dhe Urdhërit të Kryeministrit nr.187 dt.18.10.2013 Pas miratimit të ndryshimeve në Rregulloren e MK të vitit 2015, kanë dalë akte të reja nënligjore: Urdhëri i Kryeministrit nr.66 dt.07.04.2016, VKM nr.507 dt.13.09.2017 “Për përcaktimin e Fushës së përgjegjësisë shtetërore të MK”, Urdhër nr.164 dt.05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MK”, Struktura e re dhe Organigrama, *nuk janë shoqëruar me hartimin e një Rregulloreje të re ku të gjejnë pasqyrim këto ndryshime.*

b. MK disponon Manualin e Procedurave ku: **b/1. përshkruhen** procedurat e përgjithshme administrative, financiare dhe teknike për veprimtarinë e përgjithshme që duhet të kryhen në MK; **b/2. përcaktohen** politikat, standartet dhe procedurat që duhet të ndiqen nga strukturat e MK, veprimtaria e të cilave është subjekt i përmbushjes së përgjegjësisë shtetërore, në ushtrimin e shërbimeve në fushën e kulturës e të trashëgimisë kulturore; **b/3. si rregullator** të aktivitetit

¹⁷ Buxheti deri në vitin 2022 është llogaritur sipas PBA-së, ndërsa për vitet 2023-2025 është me një trend rritjeje prej 5 %.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

funksional të saj, ku përfshihen: Struktura Organizative (e datajuar), Procedurat specifike të cdo drejtorie, Baza ligjore (deri në fund të vitit 2014), Shkresat tip si dhe disa Seksione të tjera plotësuese të tyre (procedurave).

Konstatim 1: *Rregullorja dhe Manuali I Procedurave përmbajnë rregullat e organizimit dhe funksionimit të MK hartuar mbi akte ligjore e nënligjore dalë deri në vitin 2015 dhe janë të vlefshme deri në prill të 2016 (me daljen e Urdhërit të Kryeministrit nr.66 dt.07.04.2016). Atonuk përshtaten me ndryshimet në Strukturë dhe Organikë të institucionit. Kjo pasqyron një mos përshtatje të funksionimit të procedurave me përshkrimet e tyre të cdo pozicioni në strukturë e organigramë. Pra MK deri në 31.12.2019 periudhë të cilën ne po auditojmë, ka operuar me **Rregullore të brendshme dhe Manual të Procedurave të paazhornuara**, në kundërshtim me Ligjin nr.9000/2003 “Per organizimin dhe funksionimin e keshillit te ministrave” neni 7 pika 4 “ Rregullat e hollësishme te organizimit dhe funksionimit te ministrisë përcaktohen ne rregulloren e brendshme, qe miratohet nga ministri”, Ligjin nr.90/2012 “Per Oganizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore ” neni 29 pika 2 “ Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij.” Pika 3. “Rregulloret e brendshme publikohen në mënyrë të përshtatshme”;*

c. Në lidhje me respektimin e etikës nga punonjësit e institucionit, MK deri në fund të vitit 2019 nuk ka funksionuar me Kod Etike të vecantë, por bazuar në Ligjin nr.9131 dt.08.0.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”, Ligjin nr.10296, Kreu III, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2/a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Kodi i Etikës”, gjendet e formuluar tek Rregullorja ekzistuese (e paazhornuar) Kreu XIII neni 54;

d. MK deri në dt.15.12.2019 nuk ka patur të miratuar një rregullore të posaçme për Konfliktin e Interesit, por kjo çështje ka qenë e trajtuar në nenin 58, Kreu XIII i Rregullores së Brendshme (të paazhornuar) të Institucionit.

Konstatim 2: *MK deri në fund të vitit 2019 nuk ka patur “Kod Etike Personale dhe Profesionale” dhe deri në dt.15.12.2019 “Rregullore të Konfliktit të Interesit”, duke pasqyruar mungesë vëmendjeje në rritjen e performancës së Institucionit (sjellim në vëmendje se është institucion me 91 punonjës në strukturë).*

* Nga ana e institucionit na u bë me dije dhe na u vu në dispozicion: “Rregullore e Konfliktit të Interesit” miratuar nga Sekretare e Përgjithshme e MK me nr.prot.7358/1 dt.16.12.2019; “Rregullorja e Re” miratuar me Urdhër të Ministres nr.92 dt.19.02.2020 dhe nr.prot.998 dt.19.02.2020; “Kodi i Etikës” u miratua me Urdhër nr.93 dt.19.02.2020 dhe nr.prot.999 dt.19.02.2020.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

1.2. Politika menaxheriale dhe stili i punës.

Punësimi në MK bëhet në mbështetje të legjislacionit: Ligji nr.152/2013, ndryshuar nr.178/2014 ndryshuar 41/2017 “Për nëpunësin civil” dhe “Kodi i Punës” në Republikën e Shqipërisë.

Kjo procedurë rregullohet nga DAP-i: MK raporton në fillim të vitit tek DAP-i nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, duke detajuar pozicionet përkatëse në strukturë, përshkrimin e punës të pozicionit si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët. Dap-i nga ana e tij pasi merr njoftimin nga institucioni, shpall njoftimin në ëeb e tij duke përcaktuar dhe afatet për secilën etapë të procedurës.

a.Në Strukturën e re të MK (pozicione të ndryshme), qysh prej janarit të 2018 e deri më sot ka vende vakante, për të cilat DAP-i është vënë në dijeni sipas procedurës në fuqi dhe situata nuk ka ndryshuar. Në mënyrë të detajuar ky proces trajtohet tek “Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave”.


Pasqyrim i vendeve vakante në MK për vitet 2018 e 2019, është si mëposhtë:

Nr.	Viti	Raportuar DAP (fillim viti)	Gjendja fund viti
1	2018	21	11
2	2019	17(6+11)	13

b. Referuar Pyetësorit të Vetvlerësimit për vitin 2018 dhe 2019 (për vitin 2019, MK konfirmon te Parimi 3/28,29,30 “delegohen përgjegjësitë brenda njësisë nga ana e menaxherëve dhe detyrat ndahen sipas fushave të caktuara” (përcaktimi i qartë i detyrave dhe përgjegjësiqe që delegohen), konform kjo ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

1.3. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga auditimi konstatohet se MK për vitet 2018 e 2019 (periudhë të cilën auditojmë), funksionon sipas Strukturës dhe Organikës së përcaktuar me Urdhër të Kryeministrit nr.164 dt.05.10.2017 me 91 persona, pozicionuar si më poshtë:



A. Funksione Politike- Ministër, Asistent Ministër (2 persona), Kabineti (7 persona), Zv/Ministër (1 person)

B. Funksione Administrative- Sekretar i Përgjithshëm (1 person), Drejtor i Përgjithshëm (3 persona), Drejtor Drejtorie (3dr x3 / 9 persona), Përgjegjës Sektori (10 persona), specialistë dhe të tjerë (57). Kjo VKM dhe ky Urdhër kanë shfuqizuar Urdhërin nr.66 dt.07.04.2016 me 80 persona.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Pra rristurimi i MK është shoqëruar me zgjerim të numrit të pozicioneve në strukturë me 11 persona dhe krijimin e dy Drejtorive - “Drejtoria e Prokurimit, Koncesioneve dhe PPP” (1+6 persona) si dhe “Drejtoria e të Drejtës së Autorit” (1+5)


Nr.	Loji i Klasifikimit	U.66/2016	U.164/2017	DIFERENCA(+)
1	Funksion Politik	10(1+9)	11(1+10)	1
2	Funksion Administrativ	70(1+69)	80(1+79)	10
	TOTALI	80	91	11

Gjithë këto ndryshime në formë dhe përmbajtje nuk gjejnë pasqyrimin e tyre në Rregullore dhe Manualin e Procedurave të MK për vitet 2018 e 2019, aktivitetin e të cilës po auditojmë.

Sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.164 dt.05.10.2017 Struktura e Re është e organizuar dhe ndarë si më poshtë:

Nr	Drejtoria në Strukturë	Deri në 2017	2018/2019/e vazhdim
1	Drejtori të Përgjithshme	3	3
	Drejtori varësie	6(2x3)	9(3x3)
	Sektor varësie	9	20
2	Drejtori	3	1
	Sektor varësie	4	-

Nga analiza që i bëmë strukturës, vërehet një përqëndrim i burimeve njerëzore te ato drejtori ku qëndron filozofia (misioni & vizioni) e aktivitetit të MK dhe e ***lënë në plan të dytë Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve njerëzore , Aseteve dhe Shërbimeve → Sektori i Mirëadministrimit të Aseteve dhe Shërbimeve. Zgjerimi në numër i kapaciteteve njerëzore për shërbime të përditshmërisë së njësisë, do sillte planifikim dhe përdorim më me ekonomicitet të fondeve buxhetore (duke ulur numrin e prokurimeve për ato shërbime që mund të realizohen edhe nga personel mirëmbajtës i strukturuar në MK për shërbime teknike, mekanike, hidraulike, etj)***






KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

1/C- “Drejtoria e Prokurimit , Konkencioneve dhe PPP” aktivitetin e saj e mbështetet në Ligjin nr.9643/2016 “Prokurimi Publik” ndryshuar Ligjin nr.9800/2017, për aktivitetin e së cilës grupi do shprehet tek kjo çështje.



3/C- “Drejtoria e së Drejtës së Autorit” (DDA) struktura e së cilës përmban 5 specialistë, aktivitetin e saj e mbështet: në Ligjin 10325/2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”; Ligjin nr.35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera lidhur me to”, neni 18; VKM nr.34 dt.18.01.2017 “Për Procedurat e Rregjistrimit, Organizimit dhe Klasifikimit të Veprave të të Drejtave të Autorit”, si dhe Ligjin 9154/2003 “Për Arkivat” dhe Ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Konstatim 3: 3/1.DDA nuk ka Rregjistër Dokumentar (manual) pas vitit 2016, ku të mbahen sipas numrit rendor progresiv rritës të dhënat e të gjitha aplikimeve, rregjistrimeve, depozitave, pajisjeve me Çertifikata dhe Pulla Artistike, por disponon vetëm Rregjistër elektronik (ku u konstatua mungesa e rregullshmërisë së rregjistrimit sipas numrit rendor progresiv rritës) në kundërshtim kjo me Ligjin nr.35/2016 neni 18 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to” si dhe VKM nr.34 dt.18.01.2017 “Për Procedurat e Rregjistrimit, të Organizimit dhe Klasifikimit të veprave të të Drejtave të Autorit” Kreu I pika 2,3,4.

Çertifikata e lëshuar për Rregjistrimin e të Drejtave të Autorit [RDA] dëshmon:

a. Rregjistrimin e “një të drejte autori”, që gëzon mbrojtje, në zbatim të ligjit nr.35/2016 por nuk provon autorësinë e saj;

b. Dëshmon ndaj të tretëve të drejtat e tyre të rregjistruara.

c. Tarifat janë përcaktuar me VKM nr.33 dt.18.01.2017.

d. Për cdo pretendim të një pale të tretë mbi autorësinë e një veprë të pajisur më parë me RDA, shprehet vetëm Gjykata. Vendimi Gjyqësor i Formës së Prerë zbatohet për çrregjistrimin e autorit të parë, ndërsa rregjistrimi i autorit të ri (njohur me Vendim Gjykatë) bëhet vetëm në rast se ai paraqitet për aplikim.

Kjo procedurë është e thjeshtë dhe me vullnet të lirë, ku praktika e saj përmban dokumentacionin e plotësuar dhe dorëzuar nga vet aplikanti (pretenduesi i autorësisë së krijimit) si më poshtë:

a. formularin-tip, ku kërkohet rregjistrimi/paisja me RDA dhe Pullë Artistike (për veprat fonografik/videogrami)

b. deklaratë me shkrim nga aplikuesi

c. fotokopje pasaporte ose ID

ç. Mandatin e pagesës (sipas VKM nr.33 dt.18.01.2017)


d. kopje e veprës në formë të shkruar dhe CD, sa më e detajuar për mbrojtjen e të drejtave të autorit krijues

e. çdo dokument tjetër shtesë, të nevojshëm për vërtetimin e të drejtave objekt rregjistrimi.




KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”



Viti	Nr.RDA
2010	55
2011	46
2012	58
2013	53
2014	93
2015	83
Totali	388



Viti	Nr.RDA
2016	67
2017	56
2018	98
2019	81
Totali	302

Me emailin e datës 01.06.2020, janë dërguar observacionet e Drejtorisë së të Drejtës së Autorit ku MK shprehet si vijon:

Së pari, mbi konstatimin e pikës 3:3/1, sqarojmë se mungesa e regjistrimit dokumentar (manual) sipas numrit rendor progresiv rritës për të gjitha aplikimet, regjistrimet, depozitat etj, nuk ka krijuar pasoja financiare apo të evidentimit të të drejtave të autorit dhe të drejta të tjera të lidhura të regjistruar. Çdo vepër e regjistruar në Drejtorinë e të Drejtës së Autorit (DDA), është e pasqyruar me të dhëna të sakta në këtë regjistër. Gjithashtu, DDA për çdo kërkesë nga subjekte të ndryshme i referohet sikundër regjistrimit elektronik edhe Arkivës së Ministrisë së Kulturës për të patur informacion të saktë.

Duke qenë se çertifikata e të drejtës së autorit është akt administrativ me karakter të përhershëm, dokumentat ruhen për një kohë të gjatë në arkivë.

Megjithatë, në vijim të konstatimit për të organizuar punën e regjistrimeve edhe në regjistrin dokumentar (manual) DDA do të organizojë punën për të kryer dokumentimet përkatëse në këto regjistra në bazë të rekomandimit të dhënë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Së dyti, në lidhje me pullat artistike DDA nëpërmjet një memoje shkrese zyrtare nr. prot., datë ka vënë në dijeni eprorët dhe titullarët përkatës për blerjen e pullave, duke propozuar hapjen e procedurës së prokurimit me objekt “Blerja e pullave artistike” si një detyrim që rrjedh nga ligji. Gjithashtu është njoftuar dhe Drejtoria e Prokurimeve, për përfshirjen e kësaj procedurë në prokurimet e çdo viti.

Referuar eksperiencës së mëparshme, të gjatë, të DDA për procedurën e blerjes së pullave artistike, është vlerësuar se pullat nuk të blihen me shumicë për shkak të numrit të serisë dhe vitit të prodhimi dalin jashtë përdorimi dhe kanë kosto financiare. Megjithatë këto pulla janë vënë në dispozicion të subjektit në çdo rast.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Ju sjellim në vëmendjen tuaj se:

1. Konstatimi ynë është bazuar tek moszbatimi i procedurës së RDA konform Ligjit nr.35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to”, VKM nr.33 dt.18.01.2017 “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”, VKM nr.34 dt. 18.01.2017 “Për Procedurat e Rregjistrimit, të Organizimit dhe Klasifikimit të veprave të të Drejtave të Autorit”
2. Referuar argumentit tuaj se moszbatimi i procedurës së përcaktuar qartësisht në ligj “...nuk ka krijuar pasoja financiare apo të evidentimit të të drejtave të autorit dhe të drejta të tjera të lidhura të regjistruar...” zhvlerëson objektin dhe rëndësinë e ligjit nr.35/2016 dhe akteveve nënligjore që shoqërojnë atë.
3. Ndërsa lidhur me Pullat artistike grupi ynë auditues nuk ka patur dhe nuk ka shprehur konstatim të ndonjë parregullsie. Ndaj nisur nga sa më lart, observacioni juaj ***nuk merret parasysh nga grupi i auditimit.***

Konstatim 3/2. Nga analiza e grafikëve dhe tabelave, konkludojmë se dalja e Ligjit 35/2016 ***nuk ka ndikuar në rritjen e numrit të rregjistrimeve RDA***, ndonëse me tarifa modeste rregjistrimi, nisur nga çka ofron ky ligj nga njëra anë dhe procedura shumë e thjeshtë nga ana tjetër; Grafikët dhe tabelat e mëposhtëme pasqyrojnë qartë rregjistrimet e [RDA] në DDA e MK para dhe pas Ligjit nr.35/2016ky ligj nga njëra anë dhe procedura shumë e thjeshtë nga ana tjetër;

Observacioni i Projekt Raportit (vazhdim):

Së treti, për sa i takon konstatimit të pikës 3.2, shprehem se kjo drejtori nuk kryen vetëm regjistrimin e veprave të të drejtës së Autorit, por edhe regjistrimin e të gjitha kontratave/marrëveshjeve, në formë ekskluzive të kalimit të të drejtave me objekt të drejtën e autorit referuar nenit 103/4 të ligjit 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", regjistrime këto në rritje vit pas viti.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Bazuar ligjit organik për të drejtën e autorit ju informojmë se Shtëpitë Botuese kanë detyrimin ligjor të regjistrojnë çdo kontratë në DDA, referuar nenit 60 pika 4, të ligjit 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", ku këto kontrata fillojnë efektet juridike pas regjistrimit në DDA.

Gjithashtu, rezulton se regjistrimet e kontratave me një numër progresiv rritës kanë qenë në vitin 2018-2020.

Për kontratat e përmendura më lart, Drejtoria e të Drejtës së Autorit disponon një databazë elektronike të veçantë, ku pasqyrohen të gjitha veprat e regjistruara për çdo shtëpi botuese. Në vijim statistikave për të matur rritjen ose jo të regjistrimit të veprave duhet të mbështeten në të gjithë të dhënat e disponueshme

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Ju sjellim në vëmendjen tuaj se konstatimi ynë iu referua auditimit të Rregjistrimit Elektronik (në mungesë të Rregjistrimit Manual) dërguar nga ana e DDA-së, ku po ju ritheksojmë se tek rregjistrimi elektronik nuk ishte respektuar rregjistrimi i RDA-ve sipas numrit rendor rritës të tyre, duke cënuar rregullshmërinë e rregjistrimit por edhe mundësinë e rrezikut të mos rregjistrimit të një RDA-je si gabim i mundshëm njerëzor, në mungesë kjo të Rregjistrimit Manual. (moszbatim i përcaktimeve në Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, kjo përsa i përket rregjistrimit në rregjistrin përkatës “model..”). Nga sa më sipër observacioni juaj **nuk merret në konsideratë dhe konstatimi i grupit auditues qëndron.**

Konstatim 3/3. Gjithashtu theksojmë se pozicioni i Drejtorit të DDA-së dhe pozicioni i një specialisti të Sektorit të Monitorimit, janë deklaruar vakantë gjatë periudhës janar të vitit 2018 e në vazhdim, dhe vazhdojnë të jenë të tillë deri më dt.20.03.2020 afati i fundit i periudhës audituese. Duke patur parasysh se krijimi i kësaj drejtorie në strukturë enkas për këtë procedurë, sjell si pasojë që krijimi i vakancave të saj të mbart risqe të cenimit të performancës së aktivitetit të saj. Struktura organike duhet të konceptohet dinamike, në zhvillim paralel me vizionin dhe strategjinë e institucionit. Në këto kushte vlerësojmë nevojën e plotësimit të vendeve vakante me qëllim përmbushjeje të objektivave të Drejtorisë.

Observacion (vazhdim)

Së katërti, në lidhje me konstatimin 3.3 theksojmë edhe një herë se referuar nenit 157 të ligjit nr. 35/2016, detyrat e DDA-së janë përtej regjistrimit të veprave të autorit, ndër të tjera përmendim:

1. DDA është një strukturë politike bërëse e cila në zbatim të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare propozon, harton dhe zbaton strategjinë dhe politikën e duhur për mbrojtjen, ushtrimin dhe zbatimin e së drejtës së autorit, të drejtave të lidhura me të dhe të drejtave të tjera që mbrohen nga ky ligj, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, legjislacionin vendas dhe interesat përkatës kombëtarë të Republikës së Shqipërisë;
2. Mbikqyr sistemin e menaxhimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejta të tjera të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

lidhura me to;

3. Krijon bashkëpunime të ndërsjella me zyrat, agjencitë qeveritare e institucionet kërkimore dhe organizma të vendeve të tjera që merren me të drejtën e autorit, të drejtat e lidhura dhe të drejta të tjera që mbrohen nga ky ligj;

4. Kryen procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit të organizatave për licencim, si AAK, dhe i paraqet ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit, kur është e mundur, dy propozime për mira tim licencimi dhe ministri miraton një nga kandidaturat;

5. Krijon, administron dhe përditëson regjistrin e të dhënave, të hapur për publi kun, dokumentar dhe elektronik;

6. Përgatit, promovon, shpërndan materiale informuese, organizon fushata të ndërgjegjësimit të institucioneve, gru peve të interesit dhe publikut, nëpërmjet medias elektronike dhe asaj të shkruar, si edhe aktiviteteve të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, si seminare, konferenca dhe trajnime etj., lidhur me rëndësinë dhe aspektet politike, ligjore dhe praktike të mbrojtjes, ushtrimit dhe zbatimit të së drejtës së autorit;

7. DDA-ja funksionon si sekretariat teknik i KKDA-së dhe Bordit të Arbi trazhit, në zbatim të dispozitave të këtij ligji.

Gjithashtu, informojmë se në kuadër të procesit të integritetit evropian, kapitulli kryesor që Ministria e Kulturës raporton është Kapitulli 7: Pronësia Intelektuale i cili ndahet me Ministrinë e Financave që raporton për Pronësinë Industriale. Në këtë proces DDA në ndihmë të Drejtorisë së Integritetit, raporton për të gjitha hapat e marrë në fushën e të drejtës së autorit si dhe organizon punën për harmonizimin e direktivave të BE-së në legjislacionin vendas.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Grupi i auditimit vlerësoi argumentat e mësipërme dhe gjykon se qëndrojnë pjesërisht për pjesën e detyrave dhe përgjegjësi të kësaj drejtorie. Grupi i auditimit i qëndron konstatimit të përmbushjes së vendeve vakante të Drejtorisë në përputhje me bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi, me qëllim mos cenimin e objektivave të njësië.

3/4. Nga ana e Institucionit na u bë me dije se nuk ka patur Vendime Gjyqësore të formës së prerë ardhur në MK, për ndryshimin e një RDA-je ekzistuese.

Për shkak të mosreflektimit të ndryshimeve ligjore në Rregulloren e Brendshme të Institucionit, **ëshërë riskuar mos garantimi i ndarjes qartë të detyrave dhe pozicioneve**, rrjedhimisht dhe **llogaridhënies sipas shkallës hierakike**. Kjo pasi MK pas ristrukturimit me Urdhërin e Kryeministrit nr.164 dt.05.10.2017, ka funksionuar pa patur një bazë rregullatore konform ligjeve në fuqi të miratuar për përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi sipas pozicioneve të ristrukturuara të punës, për shkak të mos azhornimit të Rregullores ekzistuese dhe Manualit të Procedurave ekzistues me ndryshimet e reja.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

** Nga ana e institucionit na u bë me dije se u miratuan “Rregullorja e Re” me Urdhër të Ministres nr.92 dt.19.02.2020 dhe nr.prot.998 dt.19.02.2020; “Kodi i Etikës” u miratua me Urdhër nr.93 dt.19.02.2020 dhe nr.prot.999 dt.19.02.2020.*

1.4.Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Institucioni për vitet 2018, 2019 **nuk disponon një Rregullore të Re të miratuar nga Ministria e MK dhe Manualin e Proçedurave (baza rregullatore)** ne kundërshtim kjo me Ligjin nr.9000/2003 neni 7 pika 4 “Rregullat e hollësishme të organizimit dhe funksionimit të ministrisë përcaktohen në rregulloren e brendshme, që miratohet nga ministri”, Ligjin nr.90/2012 neni 29 pika 2,3, “Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij.” “Rregulloret e brendshme publikohen në mënyrë të përshtatshme”, ku të jenë pasqyruar ndryshimet ligjore (dhe nënligjore) si dhe struktura e re për organizimin, funksionimin dhe përkrahjet e punës; ku të jenë përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, të përshkruara respektivisht: Në Kreun II të Rregullores së MK nenet 3-6 “Organizimi i Brendshëm, Funksionet Politike dhe Funksionet Administrative”; Kreu III nenet 7-21 “Detyrat sipas Klasifikimi të pozicioneve”; Kreu VI nenet 34-38 “Marrëdhëniet ndërmjet Strukturave të Ministrisë dhe Institucioneve të Varësisë, Bashkëpunimi Institucional”. Në to janë përcaktuar: Pozicionet, Kategoritë për çdo pozicion (II,III,IV-a; I,II,III,IV-b), baza ligjore për Funksionet Politike Ligji nr.9000 dt.30.01.2003 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave” si dhe Ligji nr.90/2012, për Funksionet Administrative Ligji 152/2013 “Për Nënpunësin Civil”, procedurat e rekrutimit për ato pozicione që funksionojnë me Kod Pune (kriteret, fazat e procedurës), të drejtat dhe detyrat e personelit , trajnimet,shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, etj.

✱✱ Pasqyrim i Strukturës së Re dhe Organigramës së MK – Aneks RPA ✱✱

1.5.Aftësitë profesionale të punonjësve.

Për të audituar dosjet e personelit përzgjedhëm në mënyrë rastësore nga emërimet e viteve 2018 e 2019 nga kategoritë: Kabinet, TND, pranim në shërbimin civil, ekzekutim vendimi gjyqësor, Kod pune etj. Emërimet për të dy vitet i janë nënshtruar Ligjit nr.90/2012, Ligjit 152/2013 i ndryshuar, Ligjit nr.7961/1995 i ndryshuar dhe paraqiten si mëposhtë:

Viti	KABINETI I MINISTRES	ADMINISTRATA		KOD PUNE
		TND	TË TJERË	
2018	4	2	19	3
2019	11	4	11	4
Totali	15	6	30	7

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Konstatim 4: **Nga testimi* me zgjedhje rastësore të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm) emëruar në 2018-2019, u vu re se përgjithësisht dosjet janë të plotësuar 80% me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

dokumentacionin e domosdoshëm, si dhe Formulari Tip (Fletë Inventari) nuk është i unifikuar me të gjithë emërtesat e dokumentacionit domosdoshmërisht përbërës të dosjes. Në këto dosje u konstatuan këto mangësi: dokumentat e arsimimit dhe kualifikimeve kryesisht fotokopje të panoterizuara; mungesë e Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore (Dëshmia e Penalitetit); mungesë e Certifikatës së gjendjes civile; mungesë e vlerësimit 6 dhe 12 mujor; formular i Vetdeklarimit me mungesë të firmës së dytë (marrësit të vetdeklarimit) etj. *Për të gjitha këto parregullsi të konstatuara, nuk janë zbatuar: Ligji nr.152/2013 i ndryshuar “Për nëpunësin civil” neni 17 pika 1,4; VKM nr.117, datë 5.3.2014 Lidhja 1 e 2.*

* Stafi administrativ ka zhvilluar rregullisht trajnime sipas programeve (të detyrueshëm dhe fakultativ) nga ASPA, për njohuritë e tyre në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për Procedurat e Prokurimit Publik, Auditi i Brendshëm etj, konfirmuar kjo edhe nga auditimi që iu bëm dosjeve të personelit. Rezultoni që dy prej specialistëve të Drejtorisë së Prokurimit, Konkencioneve dhe PPP nuk kanë marrë pjesë në seanca trajnimi për prokurimin publik për vitet 2018, 2019

Personeli i burimeve njerëzore dhe protokoll arkivës duhet të rishikojë cdo dosje të personelit rekrutuar edhe para vitit 2018, për ti plotësuar me dokumentacionin përkatës (në rast mungese) konform standarteve të përcaktuara në Ligjin 152/2013 neni 17 pika 1,4 ku citohen: “Çdo institucion shtetëror, institucion i pavarur dhe njësi e qeverisjes vendore krijon dhe administron dosjen e personelit të çdo të punësuarit të institucionit (dosja individuale). Dosja individuale përmban të dhënat profesionale për çdo të punësuar dhe nëpunës civil, si dhe çdo të dhënë tjetër, lidhur me marrëdhëniet e punës” dhe “Këshilli i Ministrave përcakton rregulla të hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe Regjistrin Qendror të Personelit, të dhënat që mbahen në to, si dhe mënyrën e mbajtjes, të hedhjes, të përditësimit dhe të përdorimit të të dhënave”; si dhe VKM nr.117 dt.05.03.2014 Lidhja 1 e 2.

2. Menaxhimi i riskut.

Në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 11, “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 2, si dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III, pika 2.5.2 “Menaxhimi i Riskut”, si dhe neni 10 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 specifikohet se koordinatori i riskut, duhet të jetë Nënpunësi I Autorizues (ose kjo detyrë të delegohet).

2.1. Procesi i Menaxhimit të Riskut rezulton të jetë dokumentuar me urdhërat përkatës dhe shkresërisht rezulton të jetë realizuar për dy vite radhazi: Regjistri i Riskut për 2018 menr.6857 prot.dt.31.08.2018 dhe Regjistri i Riskut për 2019 me nr.694 prot. dt.28.02.2019 konform Ligjit 10296 dt.08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr.110/2015 si dhe Udhëzimit nr.16 dt.20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut njësitë publike”. Ky regjistër është i konsoliduari, bazuar në analizën e riskut të cdo drejtorie dhe ka për bazë Vizionin “Artet dhe trashëgimia kulturore e Shqipërisë, si forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit”- Misionin “Krijimi i mjedisit të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese në sektorin publik dhe privat” si dhe Synimin “Planifikimi dhe Përdorimi me efikasitet, efikasitet dhe transparencë të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

*fondeve buxhetore në përputhje me misionin e MK, për arritjen e objektivave”. Në këtë Rregjistër është paraqitur përshkrimi i risqeve për çdo drejtori, niveli i risqeve, kontrollet ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit, por **nuk është pasqyruar mënyra apo rrugëzgjdhja e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë (katastrofës).***

2.2. Për Vitin 2018 bazuar në Ligjin 10296 dt 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 27, në zbatim të Udhëzimit nr.16 dt.20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK në Njësitë Publike” pika 2/2,4 me shkresën nr.prot.1680 dt.09.03.2018, është krijuar **Grupi i Menaxhimit Strategjik [GMS] dhe Ekipi i Menaxhimit të Projekteve [EMP]** me 8 anëtarë dhe përbërja e tyre është si më poshtë vijon:

a. zj.M. K	- Ministër	- Kryetar - ndryshuar - E.M
b. zj.V.SH	- Zv/Ministër	- Nën/Kryetar
c. zj.O,M	- Sekretar i Përgjithshëm	- Koordinator - ndryshuar - E. Ç
d. zj.R.XH	- Dr.Përgjithshëm	- Anëtar
e. zj.H.D	- Dr.Arti	- -//-
f. zj.K.A	- Dr.Trashëgimisë	- -//-
g. z.A.A	- Dr.Trashëgimisë	- -//-
h. z.Sh. Sh	- Dr.Finance	- -//-

Konstatim 5 i Grupit të Auditimit :

a. MK nuk ka miratuar Plan Pune Vjetor lidhur me funksionimin e *Grupit për Menaxhimin Strategjik*” - **GMS**; aktivitetet dhe çështjet që do të analizohen dhe diskutohen, si dhe grafiku i mbledhjeve që do të zhvillohen nga ana e këtij grupi.

b. Për Vitin 2018 ka vetëm një gjurmë - procesverbal i mbajtur për Projekt Buxhetin e vitit 2019, dhe nga ana e institucionit nuk na u vu në dispozicion asnjë dokument tjetër, ku të pasqyrohet aktiviteti funksional i GMS së MK për njohjen, prezantimin dhe direktivat e funksionimit të GMS;

c. Nuk është bërë asnjë trajnim për anëtarët e GMS në fushën e Menaxhimit të Riskut.

d. Ndryshimet e ndodhura në strukturë (emërime të reja) nuk rezultojnë të jenë dokumentuar në GMS dhe EMP të MK.

2.3.Duke audituar rregjistrat e riskut për dy vite të njëpasnjëshëm (2018, 2019), rezultoi se risqet e parashtruara në këto dokumente janë kryesisht të përgjithshëm, kanë të njëjtin koeficient vlerësimi (i njëjtë për të dy vitet), konfirmuar si procedohet por *nuk janë parashikuar masa konkrete për t’u ndërmarrë nga personat përgjegjës sipas drejtorive, në mënyrë që të bëhet dhe ndjekja e tyre (gjurmimi).*

Në Strukturën e re Organizative të MK (pozicione të ndryshme), qysh prej janarit të 2018 e deri më sot **ka vende vakante**, për të cilat DAP-i është vënë në dijeni sipas procedurës në fuqi dhe situata nuk ka ndryshuar. Situata e vendeve vakante në MK Për vitet 2018 e 2019, është si më poshtë (përfshijë kabinetin):

Nr.	Viti	Raportuar DAP (fillim viti)	Gjendja fund viti
-----	------	-----------------------------	-------------------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

1	2018	21	11
2	2019	17(6+11)	13

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

a. Nga auditimi i regjistrit të Riskut të MK u konstatua numri i lartë i vendeve vakante (edhe ne nivelet e larta menaxheriale **1** Drejtor i Pergj, **2** Drejtor Drejtorie) ku specifikohet **me Risk te Lartë, vendet vakante në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm**, por që për të dy vitet 2018, 2019 e vazhdim është situatë e pandryshuar në kundërshtim kjo me Ligjin 114/2015 “Mbi Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”

MK në zbatim të Ligjit 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Kap.III “Planifikimi i Veprimtarisë së AB” të “Manualit të AB në Sektorin Publik” miratuar me Urdhërin nr.100 dt.25.10.2016 të MFE, ka miratuar Strukturat e Kontrollit dhe Veprimtaritë e tyre në Planin Strategjik 2018-2020 dhe Vjetor 2018 me nr.prot.6646/1 dt.20.10.2017 si dhe Planin Strategjik 2019-2021 dhe Vjetor 2019 me nr.prot.7136/2 dt.19.10.2018 ku përfshihen: Objektivat e DAB, Planifikimi i Auditimeve, Frekuenca e tyre (parashikimi i zonave me risk te lartë), Llogaritja e burimeve të kërkuara për auditim, Plani i Zhvillimit Profesional për audituesit dhe trajnimet shtesë, Kufizimet e mundshme të qëllimit të auditimit. Konform Ligjit 114/2015 në MK janë miratuar dy njësi përgjegjëse për kontrollin:

a/1. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm [DAB] ushtron funksionet e veta bazuar në Ligjin nr.114/2015. Veprimtaria e auditit mbulohet nga tre (3) auditues duke përfshirë dhe drejtuesin e njësisë, të cilët duhet të jenë të certifikuar si Audit të Brendshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm të Sektorit Publik. Anëtarët e kësaj drejtorie janë trajnuar rregullisht sipas planifikimit vjetor. *Situata e kësaj drejtorie për vitet 2018 e 2019 paraqitet e tillë: Pozicioni I Përgjegjës të AB ka qenë vakant për periudhën Janar 2018 - 23 Tetor 2019; Aktiviteti I AB është realizuar vetëm nga dy specialistët në mungesë të përgjegjës të Sektorit, në kundërshtim kjo të Ligjit nr.115/2014 neni 11.* Informacioni përmbledhës për [DAB] e MK paraqitet si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër - AB	Pozicioni	Periudha kohore	Situata e Pozicionit
1	S. G	Përgjegjëse/ekon.adm	24.10.2019 ...vazhdim	Vakant Janar 2018- 23.10.2019
2	T.R	Specialist/ekon.ind	Janar 2018-31.10.2019	Pension
3	A.T	Specialist/ekon.bujs	Janar 2018-03.11.2019	Largim me dëshirë

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

a/2. Komiteti i Auditit të Brendshëm [KAB] ushtron funksionet e veta bazuar në Ligjin nr.114/2015, VKM nr.160/2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e KAB në Njësitë Publike”, VKM nr.437 dt.08.06.2016 mbi disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.418 dt.27.06.2012 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve dhe komisioneve të Njësisë së Qeverisjes Qëndrore” ndryshuar për mandatin në vazhdim me VKM nr.656 dt.31.10.2018 pika b/4.

Komiteti i Auditit të Brendshëm përbëhet nga këta anëtarë:

Nr	Emër Mbiemër	Profesioni	Kualifikimi
1	S.P	Jurist	Certifikuar në Fushën e Legjislacionit/Avokat



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

2	E. Sh	Ekonomiste	Certifikuar si Audituese/Drejt.qëndrore MFE
3	A. L	Ekonomiste	Certifikuar si Audituese/Drejt.qëndrore MFE

Nga kontrolli i dokumentacionit të njësisë së Auditimit të Brendshëm rezulton se janë respektuar kërkesat e Manualit të Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik në hartimin e Planeve Strategjike dhe Vjetore përkatësisht: 2018-2020 me Nr.prot.6646/1 dt.20.10.2017 dhe 2019-2021 me nr.prot.7136/2 dt.19.10.2018 si dhe “Raporti i Veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm” të MK, të cilët janë dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ky Raport përmban: *Veprimtarinë e DAB në MK, *Pasqyrat përkatëse (format tip), *Pyetësin e Vetvlerësimit.

Për vitin 2018 nr.prot.207/2 dt. 15.02.2019; për vitin 2019 nr.prot.144/3 dt.30.01.2020.

Nr	Viti	Auditme		Rekomandime
		Planifikuar	Realizuar	
1	2018	14	11	150
2	2019	Ishte 15, u bë 10, u miratua 8	8	136
	Totali	22	19	286

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Ndryshimi i Planit të Auditimeve është bërë referuar Kërkesës nr.6195/6 dt.04.11.2019 së përgjegjëses së SAB drejtuar Ministres së MK, për pamundësi të realizimit të tyre, pasi Njësia e Auditit të Brendshëm deri në dt.22.10.2019 funksiononte me dy specialistë pa përgjegjës dhe në dt.03.11.2019 mbeti pa dy specialistë vetëm me përgjegjës. Situata e SAB për vitet 2018, 2019 dhe në vazhdim është në kundërshtim të Ligjit 114/2015 neni 11.

Kjo situatë rrezikon të ndikojë negativisht për arritjen e objektivave të institucionit, në moszbatimin e detyrave funksionale të [NjAB] si mbikqyrës të menaxherit të njësisë, përcaktuar qartë në nenin 20 të Ligjit nr.10296/2010.

Konstatim 6: Struktura në vetvete duhet të jetë në funksion të realizimit të objektivave të njësisë. Si e tillë, vakancat në strukturë rrezikojnë të çënojnë funksionimin me efektivitet të proceseve dhe procedurave në Institucion. Në linjë me sa më sipër madje referuar edhe rregjistrin të Riskut të MK rezultoi se, janë vlerësuar me “Risk Lartë” vendet vakante në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm [DAB], por që për të dy vitet 2018, 2019 e në vazhdim është situatë e pandryshuar në kundërshtim kjo me Ligjin 114/2015 “Mbi Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”. Kjo ka çuar në Ndryshim të Planit të Auditimeve, referuar Kërkesës nr.6195/6 dt.04.11.2019 së përgjegjëses së DAB drejtuar Ministres së MK, për pamundësi të realizimit të tyre, pasi Njësia e Auditit të Brendshëm [NJAB] deri në dt.22.10.2019 ka funksionuar me vetëm me dy auditues (specialistë) dhe pa përgjegjës; në dt.03.11.2019 e në vazhdim mbeti pa dy auditues (specialistë) dhe vetëm me përgjegjësin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Situata e DAB në MK për vitet 2018, 2019 dhe në vazhdim është në kundërshtim me Ligjin 114/2015 neni 11.

2.4. Lidhur me Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemeve IT në MK, konform VKM 673 dt.22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” si dhe nenet 680 -704 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, është lidhur një Marrëveshje e Nivelit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Shërbimit [SLA] me nr.prot.236/2 dt.24.01.2018. Në Rregjistrin e Riskut ky Objektiv është përshkruar me nivel të njëjtë vlerësimi për të dy vitet para kontrollit→ [i Lartë, i Mesëm] dhe pas kontrollit→ [i Mesëm i Ulët], por nuk është pasqyruar asnjë masë për parandalimin e problematikave madhore. Për këtë :

Konstatim 7: 7/a. Referuar paragrafit 1-“Përcaktimet” pikës 4-“Personel i Autorizuar” [pika e kontaktit] të “Përfituesit të Shërbimit” [MK] të SLA-së, nga ana e MK nuk është autorizuar me shkrim (dokumentuar) asnjë punonjës në cilësinë e “Personit të Autorizuar”, moszbatim i paragrafëve 1/4 dhe 5/1,2,3. Kjo ka sjellë cënim në realizimin e etapave të procedurës përcaktuar qartë tek Aneksi 1→ Protokoll i Shërbimeve të Përqëndruara→ < Paraqitja me Skemë dhe Hapat që ndiqen >

Konstatim 7/b. Referuar Objektivit të SLA-së “...kjo marrëveshje synon në ofrimin e shërbimeve me qëllim rritjen e efektivitetit, kohëzgjatjes, kufizimin e risqeve teknike, pra në ruajtjen e integritetit, konfidencialitetit dhe vazhdueshmërisë së punës”. Lidhur me këtë Shërbimet e Suportit të Nivelit të Shërbimit [shërbime të natyrës proaktive dhe reaktive] që kontraktin AKSHI me MK janë si më poshtë: ¹Administrimi i Incidenteve, ²Administrim i Problemeve, ³Administrim i Disponueshmërisë.

Për këtë:

* *Nuk ka asnjë axhendë periodike kontrollesh krijuar mes “Ofruesit të Shërbimit” dhe “Përfituesit të Shërbimit” të cilat janë të cilësuara në SLA - [javore dhe mujore]* .

* *Nuk ka tregues të matshëm, që do të thotë nuk mat (në sasi e lloj) problematikën dhe shërbimet e kryera;*

* *Nuk analizohet dhe vlerësohet cilësia e shërbimeve të kryera, e cila verifikon dhe konkludon nëse fondet e buxhetit të shtetit planifikuar e miratuar për aktivitetin e AKSH-it janë përdorur me efektivitet, por që shërbejnë edhe si indikator për planifikim të investimeve në IT.*

▪ Nga auditimi u konstatua se, ambjenti i dhomës së serverave në institucion është në përputhje me rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverave miratuar nga Këshilli i Ministrivave/ AKSHI në 02.12.2008, konkretisht:

- Hyrja në dhomën e serverit realizohet në mënyrë manuale (me celës) si edhe e siguruar me anë të një sistemi elektronik; është i pajisur me sistem alarmi në rast thyerje të saj dhe kamer sigurie **e realizuar**

- Dhoma e serverit nuk ka ndricim natyral (dritare), **e realizuar**

- Dhoma e serverit është e veshur me materiale që e ruajnë nga lagështira, ruajtjen e temperaturës konstante si edhe me veti zjarrëduruese. **e realizuar**

- Në ambjentet e serverit gjendeshin sende të cilat janë lehtësisht të djegshme, ndërkohë që materialet e ndërtimit të dhomës duhet të jene zjarrduruese ose të mos ndihmojnë përhapjen e zjarrit. **e përealizuar**

- Rack-u i kompjuterëve duhet të jetë i mbrojtur kundër lëkundjeve sizmike dhe të ketë një bazament të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm, **e realizuar**

- Dhoma duhet të jetë e pajisur me sistem kundër zjarrit, pajisja MKZ. **e realizuar**

Aktualisht dhoma e serverave mban serverat që bëjnë shpërndarjen e internetit në cdo zyrë

▪ Referuar marrëveshjes së lidhur mes MK e AKSHI-t me Urdhërin e Ministres nr.512 dt.10.09.2019 “Për Dhënie në Ruajtje të Sistemit të Biletarisë Elektronike nga MK tek AKSHI” prot.nr.5263/2



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

dt.10.09.2019, konstatuam se kjo procedurë është realizuar konform Udhëzimit nr.30 dt.27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu III, neni 35/a,b,c; neni 36, neni 42, neni 49, neni 50, neni 51. Praktika e saj përmban: Urdhërin e titullarit të Njësisë (Dokumentin Autorizues), Akt Dorëzimi - Procesverbal & Memo (Dokument Vërtetues) dhe Fletë Daljen me të gjitha specifikimet (Dokument Kontabiliteti). Vlera e paisjeve që kaluan tek AKSHI janë si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera /lekë
1	Server Inspur S/N: CZJ7490774	Copë	1	337,156	337,156
2	Server HP S/N: CZJ7490774	#	1	302,092	302,092
3	Kontrolli dhe Monitorimi i Sistemit të biletarisë	#	1	1,796,369	1,796,369
4	Kontrolli dhe Monitorimi i Sistemit të biletarisë	#	1	311,802	311,802
5	Licencë Interneti API Program Egalaxy	#	1	809,175	809,175
6	Licencë Administrator Eorkstation Galaxy	#	1	226,569	226,569
7	UPS	#	1	84,154	84,154
8	Router Operator CISCO 2900	#	1	116,521	116,521
	TOTALI	-	8	3,983,838	3,983,838

Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Në MK operohet me këto Sisteme Informatikë: Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit, në kuadër të mirëmenaxhimit të punonjësve të sistemit të MK, aktualisht përdor sistemet online sa vijon:

- Sistemi online i Regjistrimit Qëndror të Personelit (HRMIS)

Rregjistër online në të cilin pasqyrohen të dhënat e punonjësve të Ministrisë së Kulturës, por edhe raporte me të dhënat e punonjësve të institucioneve të varësisë. Nëpërmjet këtij sistemi gjenerohet edhe listpagesa mujore për punonjësit e MK-së.

- Portali i brendshëm (Intranet) ADMINISTRATA.GOV.AL

Sistem për punonjësit e burimeve njerëzore për të komunikuar së brendshmi, shkëmbyer dokumentacione, raportime mujore periodike të numrit të punonjësve, si dhe hedhja online e të dhënave për shpalljen e vendeve vakante në DAP.

- Share-Folder Google Drive për Përshkrimet e Punës

Platformë online që shërben në procesin e hartimit të përshkrimeve të punës për të gjithë nëpunësit civilë të MK-së.

Për të gjitha keto Sisteme duhet një rregullore përdorimi (manual përdorimi) për personelin përdorues me qëllim aplikimin e cdo procedure sipas standarteve dhe udhëzimeve të përcaktuara por edhe në publikimin e cdo informacioni rregullisht në EEB-in e MK. Në Raportin e Monitorimit dhe vetvlerësimit është vlerësuar si e realizuar ky tregues.

▪ **Lidhur me** procedurën e korrigjimit të të dhënave apo të riformulimit (plotësimit me të dhëna të reja apo saktësimin e atyre ekzistuese) të një informacioni për Sistemin HRMIS, procedohet në këtë mënyrë:

Ministria e Kulturës është pjesë e institucioneve shtetërore të cilat përdorin sistemin elektronik qëndror të institucioneve (HRMIS) për regjistrimin e punonjësve. Akses në këtë sistem kanë vetëm punonjës të njësisë së burimeve njerëzore të cilët janë të autorizuar nga AKSHI nëpërmjet DAP-it



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

dhe që janë të pajisur me kredencialet unike për akses. Në këtë sistem pasqyrohen të dhënat personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar.

1- Të dhënat personale bazë të punonjësit, emër mbiemër, mosha, etj. gjenerohen në mënyrë automatike nga regjistri elektronik i gjendjes civile dhe nuk mund të modifikohen nga përdoruesi.

2- Të dhënat profesionale që kanë të bëjnë me arsimin, përvojën e punës, certifikime të ndryshme profesionale etj. plotësohen manualisht nga punonjësi që është i autorizuar të përdorë sistemin, në bazë të dokumenteve që janë pjesë e dosjes personale të punonjësit. Modifikimi i këtyre të dhënave mund të kryhet në sistem vetëm nga personi i autorizuar duke e shoqëruar këtë ndryshim me ngarkimin e dokumentit të ri që korrigjon dokumentin e parë. Gjithashtu çdo korrigjim i të dhënave që kanë të bëjnë me përvojën e punës, duhet të kenë arsyen përkatëse të ndryshimit si dhe reflektohen në historikun e ndryshimeve që kanë pësuar këto të dhëna në sistem.

Konstatim 7/c: Duke analizuar nga sa me sipër: procedura në sistem realizohet manualisht që do të thotë *ekziston mundësia e gabimit njerëzor*, u vu re se kjo procedure nuk ka siguri të plote, pasi filtri i saj duhet të ketë një gjurmim të etapave pra nuk ka shtrirje vetikale të kontrolluar, që do të thotë linja e korrigjimit është e shkurtër **[Drejtore i Bur.Njerëzore -> Person i Autorizuar]**. Procedura duhet të ketë një praktikë të plotë, të qartë dokumentare që të garantojë shmangien e keqpërdorimit apo dhe të abuzimit.

c. Lidhur me gjurmët specifike të auditit, MK nuk ka një dokument të unifikuar dhe nga ana e Institucionit na u bë me dije se: *”Me fillimin e marrëdhënieve të punës pranë Sektorit të Auditimit të Brendshëm e në vazhdim, nuk është ndërmarrë angazhim auditimi pranë Aparatit të Ministrisë së Kulturës, lidhur me vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, sipas komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të kësaj Njësie Publike. Referuar edhe raportimit të vitit 2018, rezulton se nuk është kryer angazhim auditimi në Ministrinë e Kulturës mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të MK”*

Konstatim 8: Nga auditimi rezultoi se, gjurmët standarte të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e MK, në kundërshtim me ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16; Udhëzimit nr.30 dt.27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 e 122; Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr.8980, dt. 15.07.2010 dhe ai (i ri) miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016

3. Veprimtaritë e Kontrollit

3.1. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm [DAB] ushtron funksionet e veta bazuar në Ligjin nr.114/2015. Trajtuar me hollësi më lart.

3.2.Komiteti i Auditit të Brendshëm [KAB] për vitet ushtrimore 2018 dhe 2019 është miratuar me Urdhërin e Ministres nr.16 dt.10.01.2018, përbëhet nga 3 anëtarë dhe ka mandat dy vjeçar.[KAB] ushtron funksionet e veta bazuar në Ligjin nr.114/2015, VKM nr.160/2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e KAB në Njësiti Publike”, VKM nr.437 dt.08.06.2016 mbi disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.418 dt.27.06.2012 “ Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve dhe komisioneve të Njesisë së Qeverisjes Qëndrore”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

ndryshuar për mandatin në vazhdim me VKM nr.656 dt.31.10.2018 pika b/4. Trajtuar me hollësi më lart.

3. Ekzistojnë dhe përdoren manuale për proceset kryesore operacionale dhe financiare të cilët specifikojnë qarkullimin e dokumentacionit: Manuali për klasifikimin ekonomik të shpenzimeve dhe të ardhurave, Manuali për MFK miratuar me Urdhër të MF Nr.8980 dt.15.07.2010; Manuali i procedurave të MK.

a. Ekzekutimi dhe rregjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person (NA-NZ) / **e realizuar**

b. Të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA&NZ (sistemi i 2 firmave) / **e realizuar**

d. Cdo dalje e Aktiveve afatgjata autorizohet dhe monitorohet nga NA / **e realizuar**

e. Ka rregullore për Sistemet funksionale/ **e realizuar**

f. Parashikuar procedura të qarta mbi komunikimin e shkresave brenda dhe jashtë MK: hyrja, trajtimi, mbajtja e dokumentacionit lidhur me depozitimin e protokollimin, komunikimin e brendshëm elektronik/ **e realizuar**

g. Komunikimi dhe trajtimi i urdhërave të brendshëm dhe udhëzimeve përshtatur sipas përgjegjësi individuale të cdo pozicioni / **e realizuar**

i. Cdo dokument i brendshëm në funksion të procedurave duhet të jetë e firmosur nga të gjithë personat përgjegjës **pjesërisht e realizuar**

h. Institucioni ka parashikuar politika të ruajtjes së dokumenteve, por nuk ka një plan masash për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin gjatë punës / **pjesërisht e realizuar**

Konstatim 9: Problematikë ka në ndarjen e detyrave dhe realizimin e tyre për shkak të mungesave në strukturë, ekziston mundësia (rreziku) që një person ngarkohet të bëjë edhe detyrë tjetër.

Nga sa më sipër po japim një pasqyrë të përmbledhur të treguesve të Veprimtarive të Kontrollit.

Treguesit	Realizuar	Pjesërisht realizuar	Pa realizuar
Viti			
2018	7	2	0
2019	7	2	0

4. Informacioni dhe Komunikimi

Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë mjaftueshëm informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit; si dhe kanë kryer trajnime mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Kjo ka bërë që në mënyrë të vazhdueshme të ruhet komunikimi ndërmjet MK dhe strukturave të varësisë së saj. Informacioni shkëmbehet në nivel Horizontal dhe Vertikal. MK për vitet 2018 e 2019 ka funksionuar me një rregullore të shkruarsis dhe Manualin e Procedurave të paazhornuara, ku nuk janë pasqyruar ndryshimet në Strukturë dhe Organikë sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.164 dt.05.10.2017 “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së MK”. Cdo informacion dhe njoftim publikohen rregullisht në ËEB-in e MK. Mungesa



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

e Rregullores së Re dhe Manualit të Procedurave konform Ligjit për MFK sjell një komunikim jo shumë efektiv e harmonik ndërmjet drejtorive apo sektorëve brenda MK; Paqartësi në ndarjen e detyrave. Në MK funksionojnë 4 Sisteme Informatikë aktivë: Sistemi online i Regjistrat Qëndror të Personelit (HRMIS), Portali i brendshëm (Intranet) ADMINISTRATA.GOV.AL, Share-Folder Google Drive për Përshkrimet e Punës, Microsoft Office (Excel & Word 2010).

a. Buxheti diskutohet në të gjitha nivelet e Institucionit (edhe ato të varësisë rezultuar nga Regjistrat e riskut)

b. Zhvillohen analiza vjetore të arritjeve të objektivave të MK

c. Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve është përgjegjëse për komunikimin me Subjektet kryesore të jashtme (ka korrespondencë shkresore zyrtare) si dhe e cdo dokumenti administrativ (operacional e financiar) në Institucion; ajo përzgjedh formën e komunikimit (shkresor të protokolluar apo elektronik) sipas rastit. Aplikohet komunikimi elektronik (komunikim i brendshëm) në MK, duke shmangur komunikimin verbal dhe minimizuar atë shkresor pasi sjell forcimin e gjurmës së auditimit.

d. Cdo muaj bëhet akt rakodimi me Degën e Thesarit dhe raportimi i bëhet Titullarit të MK (NA) .

e. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për cdo problem apo parregullësi, në rrugë elektronike.

5. Monitorimi

Sekretari i Përgjithshëm si autoriteti më i Lartë Administrativ merr raporte katër mujore nga drejtuesit e programeve buxhetore për ecurinë dhe realizimin e produkteve, masën e realizimit të shpenzimeve, si dhe identifikimin e fushave të cilat nuk janë realizuar në masën e pritshme, duke analizuar dhe shkaqet përkatëse. Ky raportim bëhet nga personeli përgjegjës i cdo drejtorie tek eprori dhe eprorët ia përcjellin titullarit. Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti vjetor i monitorimit i cili i dërgohet Ministrisë së Financave. Ky Raportim është dërguar në MFE: për vitin 2018 me shkresën përcjellëse nr.284/7 DT.26.02.2019; për vitin 2019 me shkresën përcjellëse nr.1178 dt.28.02.2020 (brenda afatit të përcaktuar në Manualin e MFK). Këto Raporte Monitorimi përmbajnë: Pyetësin e Vetvlerësimit, Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Regjistrin e Menaxhimit të Riskut, Raporti për Funksionimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm, Plani i Veprimit për MFK. Duke analizur me kujdes të gjitha procedurat që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të këtij Institucioni, konstatojmë se rregullorja e brendshme është e paplotë për rrugët që duhen ndjekur në konturimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit, duke e parë si sistem dinamik (të jetë koherent me cdo akt ligjor apo nën ligjor që del). Kjo arrihet duke forcuar aktivitetin e GMS që është rregullator për mbarrëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për cdo drejtori dhe njësi varësie, që të mund të kontrollojë, të konstatojë dhe të sistemojë në kohë reale edhe parregullësinë më të vogël të procedurave të përditshme, duke minimizuar riskun e kthimit të tyre në fenomen.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Titulli i Gjetjes 1	Mbi sistemet e Kontrollit të Brendshëm në MK
Situata:	Nga auditimi mbi vlerësimin dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, u konstatua se: 1. Për periudhën objekt auditimi, kanë munguar takimet e dokumentuara të veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS); 2. Edhe pse është miratuar Rregullorja e re, me Urdhër të Ministres nr. 92 dt.19.02.2020, e cila reflekton ndryshimet e ndodhura në strukturë, rezultoi se këto ndryshime ende nuk janë reflektuar në Manualin e Procedurave, i cili ka për qëllim ndër të tjera përcaktimin dhe ndarjen e qartë të detyrave si dhe pershkrimin e punës për çdo pozicion, në përputhje me sa dikton Ligji nr. Nr.10 296, datë 8.7.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe në funksion të realizimit të aktivitetit të ministrisë në përputhje me objektivat dhe misionin e saj. 3. “Drejtoria e së Drejtës së Autorit” (DDA) nuk ka Rregjistër Dokumentar (manual) që pas vitit 2016, për regjistrimin e të gjitha aplikimeve, rregjistrimeve, depozitimeve dhe pajisjeve me Çertifikata dhe Pulla Artistike, në kundërshtim me ligjin nr. 35/2016, neni 18 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to”, si dhe VKM nr.34 dt.18.01.2017 “Për Procedurat e Rregjistrimit, të Organizimit dhe Klasifikimit të veprave të të Drejtave të Autorit” Kreu I pika 2,3,4. Aktualisht DDA disponon vetëm Rregjistër elektronik (ku u konstatuan problematika të renditjes sipas numrit rendor progresiv rritës). 4. Nga auditimi rezultoi se, për dy vitet e njëpasnjëshme, objekt auditimi, MK ka vijuar të ushtrorë aktivitetin me struktura të paplotësuar me burime njerëzore, konkretisht: gjatë vitit 2018 nga 91 vende të paarshikuara, ka operuar me mesatarisht me 73 punonjës; ndërsa gjatë vitit 2019 nga 91 vende të paarshikuara ka operuar me mesatarisht me 77 punonjës. Struktura organizative në vetvete duhet t’i shërbejë përmbushjes së objektivave të njësisë. Duke qenë se, funksionimi i saj në përputhje me këto objektiva është element i rëndësishëm i kontroleve të brendshme, rrjedhimisht mungesa e vazhdueshme e burimeve njerëzore rrezikon të çënojë përmbushjen e objektivave të vetë institucionit. 5. MK nuk ka strategji trajnimi për GMS, në kundërshtim me sa dikton Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. 6. Rezultoi se, gjurmët e auditimit nuk janë të miratuara nga titullari si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e punës së MK 7. Nga testimi me përzgjedhje i kampionit të dosjeve të personelit, emëruar në vitet 2018 e 2019, rezultuan disa parregullsi dhe mangësi si vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	- dosjet shoqërohen me fletë inventari të pa unifikuar sipas formatit që diktohet nga Ligji nr.152/2013 i ndryshuar “Për nëpunësin civil” neni 17 pika 1,4; VKM nr.117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Lidhja 1 e 2; si dhe Manuali i Procedurave të MK-së, me Urdhër të Ministrit nr. 108/2016 neni 22 pika 3 c,c. 8. Ministria e Kulturës dhe AKSHI veprojnë në bazë të një marrëveshjeje nivel shërbimi (SLA), sa i përket sistemeve IT të ministrisë. Kjo marrëveshjeje synon ofrimin e shërbimeve me qëllim rritjen e efektivitetit, kohëzgjatjes, kufizimin e risqeve teknike, pra në ruajtjen e integritetit, konfidencialitetit dhe vazhdueshmërisë së punës. Nga auditimi rezultoi se, nuk është autorizuar me shkrim (dokumentuar) asnjë punonjës në cilësinë e “Personit të Autorizuar”, në kundërshtim me sa parashikuar në paragrafët 1/4 dhe 5/1,2,3 të marrëveshjes SLA, duke vënë nën pyetje përparatërisht të mos-realizimit të etapave të procedurës së parashikuar, për realizimin e tre shërbimeve të kontraktuara, duke bërë që të mos hartohet as raporti i monitorimit mbi cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të ofruara nga AKSHI. 9. Lidhur me procedurën e korrigjimit të të dhënave në sistemin HRMIS (Sistemi online i Regjistrat Qendror të Personelit) evidentuam se kjo e fundit realizohet manualisht, që do të thotë se ekziston mundësia e gabimit njerëzor e cil rrit riskun e qenesishëm të subjektit dhe kërkon forcimin e kontrolleve të brendshme.
Kriteri:	Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave Nr.8980, dt. 15.07.2010, Manuali i Ri me Urdhrin e ministrit të financave nr.108/2016
Ndikimi	Dokumentet dhe proceset e lidhura me MFK nuk janë sipas detyrimeve ligjore.
Shkaku	Mos zbatimi i bazës ligjore në fuqi, e cila rregullon proceset e punës në fushën e MFK-së.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi	1. Me qëllim evidentimin e të metave, mangësive dhe menaxhimit të risqeve për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike, GMS nevojitet të planifikojë dhe dokumentojë të gjitha takimet e kryera në funksion të objektivave të saj. Gjithashtu nevojitet që GMS të kontrollojë si janë menaxhuar risqet, me qëllim parandalimin e krijimit të situatave të paparashikuara, si dhe marrja e masave për parandalimim e tyre si dhe përgatitjen e një raport vjetor lidhur me këtë. 2. Me qëllim përcaktimin dhe ndarjen e qartë të detyrave si dhe pershkrimin e punës për çdo pozicion, në funksion të realizimit të objektivave të MK-së, MK të marrë masa për reflektimin e gjithë ndryshimeve të ndodhura në strukturë dhe organikë, në Manualin e Procedurave. 3. Drejtoria e së Drejtës së Autorit të marr masa për hartimin dhe ruajtjen e Regjistrat Dokumentar (manual) për regjistrimin e të gjitha aplikimeve, rregjistrimeve,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	depozitave, pajisjeve me Çertifikata dhe Pulla Artistike ku t ëtregohet kujdes në vendosjen e numrave rendor si element të rëndësishëm të kontrolleve të brendshme, por edhe në përtmbushje të bazës ligjore dhe rregullatore në fuqi. 4. MK në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse DAP, të marrin masa të menjëhershme për hartimin dh endjekjen e gjithë procedurave të nevojshme për plotësimin e vendeve vakante. 5. MK të marr masa për hartimin e strategjisë së trajnimit për GMS, në funksion të realizimit të detyrave të parashikuara për këtë grup, në kuadrin ligjor dhe rregullator 6. Të merren masa për hartimin dhe miratimin e gjurmëve të auditimit, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e punës së MK 7. Dosjet e personelit në cdo rast, të plotësohen dhe shoqërohen me fletë inventari dhe fletë prezantuese të të dhënave teknike ku të listohen te gjitha dokumentat e domosdoshme që lidhen me e arsimimin, kualifikimet dhe cdo kërkesë tjetër që buron nga kuadri ligjor dhe rregullator. 8. MK të marr masa për emërimin e personit të autorizuar, sipas marrëveshjes nivel shërbimi (SLA), me qëllim respektimin e etapave të parashikuara në procedurë për shërbimet e kontraktuara nga AKSHI. 9. Me qëllim forcimin e kontrolleve, nga pikëpamja e plotësisë së sigurisë së informacionit, nevojitet që filtri i procedurës së ndjekur nga sistemi HRMIS (Sistemi online i Regjistrat Qëndror të Personelit) të ketë një gjurmim të etapave ku kalon procedura, pra të ketë shtrirje vertikale të kontrolluar. Procedura duhet të ketë një praktikë të plotë, të qartë, dokumentare në mënyrë që të garantohet shmangien e keqpërdorimit dhe të abuzimit.
Afati i Zbatimit	Menjëherë

7. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË MËPARSHME

KLSH ka kryer edhe një verifikim mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve, në bazë të autorizimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.450/20 prot. datë 26.06.2019, me objekt: Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në Ministrinë e Kulturës, i evaduar në 3 mujorin e dytë të vitit 2018. Auditimi i mëparshëm në subjektin “Ministria e Kulturës” është kryer sipas programit të auditimit nr. 1264/2 datë 14.12.2017 për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2017. Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes të miratuara me Vendimin nr. 49, datë 12/06/2018, të Kryetarit të KLSH-së i janë dërguar subjektit të audituar me shkresën nr. 1264/8 prot. datë 19.06.2018. Pavarësisht rekoamdnimeve të ri lëna nga KLSH për zbatim, pas këtij verifikimi, përsëri na rezultoi se statusi i këtyre rekomandimev enuk ka ndryshuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i projekteve në art-kulturë dhe trashëgimi kulturore për vitet 2015, 2016 dhe 2017 konstatohet se në disa raste, tarifa për financimin e zërave të tillë si “orkestrantë kategoria e parë”, “spala”, “koncert maestër i orkestrës”, “regjisor”, “prodhimi i videoklipeve në monumentet e trashëgimisë kulturore shqiptare”, “drejtor artistik”, “koordinator artistik”, “skenograf” etj. i referohet çmimeve të tregut dhe eksperiencave të mëparshme, pasi nuk ka tarifa të miratuara për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike. Ministria e Kulturës, si organ qendror nuk ka një Bord Artistik sikurse kanë organet e saj të varësisë bazuar në nenin 10, të Ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” me ndryshime, në të cilat ajo ka përfaqësuesit e saj, pasi në bazë të detyrimit që përcakton neni 11 i këtij Ligji, Bordet miratojnë kriteret dhe masën e shpërblimit të krijimtarisë artistike.

Në lidhje me zbatimin e këtij neni dhe referuar nenit 34, pika 1 të ligjit “Për artin dhe kulturën” me ndryshime, ligjvënësi ka ngarkuar Këshillin e Ministrave për përcaktimin e masës së shpërblimit të gjinive artistike, sipas fushave të artit dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike. Ky instrument ligjor ende nuk është miratuar dhe pse në nenin 35 të tij, afati ligjor i parashikuar ka qenë 6 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit. Në kushtet e mungesës së rregullimit ligjor për tarifat, për vlerësimin e projekteve, krijohen mundësi për abuzime/shpenzime të paargumentuara gjatë realizimit të tyre (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 24-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Të kërkohet nga Këshilli i Ministrave përmirësim ligjor (shtesa dhe ndryshime), në Ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” me ndryshime, në nenin 10 dhe neni 35. Ministria e Kulturës si organ përgjegjës për artin dhe kulturën, të ketë pranë saj Bordin Artistik Bordet të civilitetit ligji i njeh të drejtën e miratimit të kriterëve dhe masës së shpërblimit të krijimtarisë artistike.

Gjithashtu, bazuar në nenin 35 të ligjit Ministria e Kulturës të kërkojë nga Këshilli i Ministrave, sipas detyrimit që rrjedh nga neni 34 i ligjit, nxjerrjen e vendimit për masën e shpërblimit të gjinive artistike, sipas fushave të artit dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike.

Afati për zbatimin e rekomandimit **Menjëherë**

Me shkresën nr. 9304 datë 18.12. 2018, MK ka pranuar zbatimin e Rekomandimit.

Përgjigja e institucionit

Në zbatim të Ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, ndryshuar me ligjin nr. 25/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, neni 27/1, a citojmë miratimi i projekteve artistike e kulturore për artin dhe kulturën bëhet nga ministri përgjegjës artin dhe kulturën , me propozimin e kolegjiut të përbërë nga personalitete të gjinive të ndryshme të artit , të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.

P.sh. Urdhër nr.298, datë 09.05.2018 “Për ngritjen e kolegjiut që do të ndjekë procedurat mbi aktivitetet që do të zhvillohen në kuadër të 60 vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë , në UNESCO”.(bashkëngjitur Urdhëri)

I.PROCEDURA



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

1.Ministria e Kulturës ka iniciuar procedurat për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar si më poshtë:

2. Ministria ka filluar këtë procedurë si kërkesë e grupeve të ineteresit dhe kërkesave të institucioneve të saj të varësise dhe ka ndërmarrë hapat:

Ka nënshkruar memorandum i bashkëpunimit mes Ministrisë së Kulturës dhe Skenës së Pavarur Kulturore për bashkëpunimin dhe konsultimin paraprak për ndryshimet në ligjin “Për Artin dhe Kulturën” .

a) Ministria e Kulturës në përputhje me parashikimet e ligjit nr146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ka dërguar për mendim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar” grupeve të interesit. Gjithashtu, Ministria e Kulturës ka për mendim projektligji, me shkresën me Nr. 384 Prot, datë 18.1.2018, të gjitha bashkive të Republikës së Shqipërisë.

Projektligji është publikuar në Ëëbsite-in ëë.konsultimipublik.gov.al, si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës. Gjatë procesit të konsultimit publik ka pasur komente dhe sugjerime nga palët e interesit, një pjesë e të cilave janë marrë në konsideratë.

c) Ministria e Kulturës nëpërmjet shkresës nr. 6571 Prot, datë 15.8.2018, institucioneve të mëposhtme:

- i. Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- ii. Ministria e Drejtësisë
- iii. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- iv. Ministria e Mbrojtjes
- v. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- vi. Ministria e Brendshme
- vii. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- viii. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- ix. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- x. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- xi. Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
- xii. Ministër Shteti për Diasporën

Në përfundim të bashkërendimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar” Ministria e Kulturës ka dërguar për miratim projektaktin tek Ministri përgjegjës për kulturën.

Ndërkohë, në zbatim të vendimt nr.584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave” të ndryshuar, Ministria e Kulturës është duke hartuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit për këtë projektligj. Projektligji është përfshirë në Planin Analitik të Akteve dhe pritët miratimi nga Ministri.

Risitë e projektligjit: “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar” ne raport me gjetjet:

1.Një ndryshim i parashikuar në këtë projektligj është ai i marrëdhënieve financiare me artistët dhe cilësinë artistike. Në parashikimet e reja të propozuara nga Ministria e Kulturës, theksohet që marrëdhëniet financiare për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

artistin jashtë sistemit të institucioneve publike të artit dhe kulturës rregullohen me kontratën e lidhur mes artistit dhe institucionit publik financues.

Kjo bëhet për disa arsye të cilat lidhen specifikisht me fushën e artit dhe kulturës:

a) ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën nuk mund të vlerësojë suksesin që një artist ka ndaj një tjetri. Vlerësimin e suksesit për një artist e bën publiku, si vlerësuesi real i talentit.

b) në shumë vepra artistike është regjizori apo figura të tjera të cilët vlerësojnë talentin artistik dhe cilësinë e artistit i cili do të angazhohet në një vepër.

c) marrja përsipër nga ana e Ministrisë përgjegjëse e ngurtësimit të cilësisë artistike nëpërmjet burokracisë do të pengonte zhvillimin natyral të fushës së artit dhe kulturës në Shqipëri. Në këto kushte neni 34 është parashikuar të ndryshohet në

Neni 34

Marrëdhëniet financiare me artistët

Marrëdhëniet financiare për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike me artistin jashtë sistemit të institucioneve publike të artit dhe kulturës rregullohen me kontratën e lidhur mes artistit dhe institucionit publik financues nëpërmjet negocimit.”.

2. Në ligj është parashikuar se miratimi i veprimtarive artistike e kulturore të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën bëhet nga ministri, me propozim të kolegjiut, të përbërë nga nëpunës të nivelit të mesëm dhe të lartë, drejtues të strukturave përgjegjëse që mbulojnë secilën nga gjinitë e artit. Ministria është institucion publik dhe financon apo harton projekte kulturore artistike dhe si e tillë nuk mund të ketë bord artistik. Duhet pasur parasysh ndryshimi midis këtyre organeve kolegjiiale nga ku Bordi Artistik është organi kolegjiial vendimmarrës për miratimin e projekteve/aktiviteteve ndërsa kolegjiutet e institucioneve të artit dhe kulturës zbatojnë procedurën për realizimin e këtyre projekteve/aktiviteteve. Në këto kushte janë vëtëm institucionet publike të artit dhe kulturës ato të cilat realizojnë aktivitete të kenë bord dhe Ministria si institucion publik qëndror administate për realizimin e procedurës së financimit e projekteve si administruese e fondit publik të artit dhe kulturës.

Komenti i grupit të Auditimit

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar, **në proces zbatimi.**

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, konkretisht mbi hartimin e Dokumenteve të Tenderit, konstatohet se vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit për të vërtetuar përvojën e mëparshme përmes paraqitjes së kontratave për “punë të ngjashme të së njëjtës natyrë për një objekt të vetëm...”, në shumicën e rasteve nuk i referohet vlerës në përqindje të vënë nga ligjvënësi e cila “nuk duhet të jetë më e madhe se 50% e vlerës së objektit që prokurohet” sipas VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, neni 26, pika 6/a. Autoriteti Kontraktor (MK) vendos një vlerë dysheme, që në disa raste varion “në një vlerë prej 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet” ose “në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së objektit që prokurohet”. Megjithëse ligjvënësi nuk ka vendosur vlera minimale dhe as nuk ka ndaluar vendosjen e tyre, Autoriteti Kontraktor në asnjë rast nuk duhet të anashkalojë detyrimin ligjor vlerës maksimale të shprehur në përqindje për “kontratat për punë të ngjashme”, pasi shmang



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

konkurrencën dhe trajton në mënyrë jo të barabartë operatorët (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 69-71, 74-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Të kërkohet nga Agjencia e Prokurimit Publik si organ që ka tagrin ligjor në përputhje me nenin 13, pika 2/a, g, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” me ndryshime, të paraqesë pranë Këshillit të Ministrave propozime për rregullat e prokurimit, në mënyrë që të bëhen përmirësime ligjore në VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, neni 26, pika 6/a, duke përcaktuar në mënyrë eksplicite përveç vlerës maksimale dhe vlerën minimale të kontratës për “punë të ngjashme”, të shprehur në përqindje duke vendosur në këtë mënyrë kufij të qartë të vlerës së kontratës në përmbushje të kriterit për përvojën e mëparshme, të realizuar nga operatorët gjatë 3 viteve të fundit.

Neni 26, pika 6/a VKM nr. 914, datë 29.12.20014 e ndryshuar, të riformulohet:

Ishte

Për të provuar përvojën mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Të bëhet

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% dhe jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Afati për zbatimin e rekomandimit

Menjëherë

Me shkresën nr. 9304 datë 18.12. 2018, MK ka pranuar zbatimin e Rekomandimit.

Përgjigja e institucionit

Me draft-shkresë nr...prot. Korrik 2019 “Mbi ndryshimin e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, drejtuar APP. Propozimi është:

Neni 26, pika 6/a e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, të riformulohet:

Ishte

Për të provuar përvojën mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Të bëhet

Për të provuar përvojën mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% dhe jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.”

Komenti i grupit të Auditimit

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar, **në proces zbatimi.**

3. Gjetje nga auditimi Në kuadrin legjislativ që normon kuptimin, mbrojtjen, administrimin dhe ndërhyrjen në pasuritë trashëgimi kulturore dhe zonat e mbrojtura janë bërë ndryshime të shpeshta,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

edhe nga Ministrat përgjegjës për kulturën ndër vite. Ajo çka evidentohet nga aktet juridike në fuqi, sidomos ato të nxjerra nga vetë Ministri i Kulturës me apo pa autorizim ligjor, është fakti që ky Ministër gëzon kompetenca tepër të zgjeruara, mjaftueshëm për të ndikuar edhe në vendimmarrjen e atyre organeve të cilat në ligje dhe/ose akte nënligjore përcaktohen si kolegjiale dhe me rol vendimmarrës në gjithë procesin e administrimit dhe ndërhyrjes në këto zona/objekte të mbrojtura në mënyrë specifike.

Ne rekomandojmë se duhet të bëhen parashikime ligjore, ose të paktën me Vendime të Këshillit të Ministrave (të dala në bazë të autorizimeve ligjore, të cilat të kenë përcaktuar çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto VKM) më specifike dhe të detajuara. Rekomandimet nuk duhet të konsistojnë vetëm në qartësimin e kuadrit rregullator, qartësimin për ushtruesit e detyrave publike lidhur me hierarkinë e akteve dhe domosdoshmërinë e nxjerrjes së akteve nënligjore vetëm nëse ligji në kuptimin formal autorizon nxjerrjen e tyre, qartësimin dhe përkufizimin e termave juridik në kuptim të akteve të ndryshme, por veçanërisht bërjen e parashikimeve të cilat krijojnë balancë mes kompetencave/pushtetit vendimmarrës të Ministrit të Kulturës dhe atyre të organeve kolegjiale, me qëllim shmangien e ndikimit dominues të Ministrit të Kulturës në këto procedura sensitive dhe me impakt për ekzistencën e objekteve/zonave me mbrojtje të veçantë, për opinionin publik, si dhe për buxhetin e shtetit.

Një gjë e tillë duhet bërë veçanërisht për parashikimet lidhur me krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, organ vendimmarrës shumë i rëndësishëm në procesin e miratimit të projekteve për restaurim dhe dhënien e licencave për projektim dhe restaurim në fushën e monumenteve të kulturës. Kjo për shkak se, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9048/2003 *“Për trashëgiminë kulturore”*, i ndryshuar, përforcuar dhe nga Urdhri i Ministrit të Kulturës nr. 8, datë 17.01.2014, *“Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve”*, KKR është një organ në duart e Ministrit të Kulturës dhe gjithë procesi për miratimin e projekteve për restaurim dhe dhënien e licencave për projektim dhe restaurim është “një qark i mbyllur”, ku çdo parashikim direkt ose indirekt të çon te Ministri i Kulturës.

Më konkretisht, bazuar në ligjin nr. 9048/2003, KKR krijohet me Urdhër të Ministrit të Kulturës dhe organizimi dhe funksionimi i tij përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Kulturës. KKR miraton kriteret për licencimin e subjekteve në fushën e projektimit apo të restaurimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, dhe pas plotësimit të kriterëve të miratuara për këtë qëllim, i propozon Ministrit të Kulturës licencimin e tyre. Ky i fundit ka kompetencë ta miratojë atë. Çdo projekt për restaurim i paraqitet për miratim KKR-së, e cila përcakton kriteret dhe kategorinë e projekteve, që miratohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Në çdo rast, shfrytëzimi i monumenteve të kulturës bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i KKR-së për lidhjen e kontratës së shfrytëzimit ndërmjet palëve. Bazuar në Urdhrin nr. 8/2014 të nxjerrë nga Ministri i Kulturës, KKR përfaqësohet në cilësinë e Kryetarit nga vetë Ministri i Kulturës dhe në përbërje ka përfaqësues të institucioneve të specializuara, si dhe specialistë të fushës jashtë sistemit të Ministrisë së Kulturës, numri i të cilëve, element ky ndër vendimtarët në vendimmarrjen e organeve kolegjiale, përcaktohet po nga Ministri i Kulturës, është numër tek dhe mund të jetë i ndryshueshëm. Ligji nr. 9048/2003 ka një qasje tjetër lidhur me pesë organet e tjera të reja që krijon, për të cilat parashikon përcaktimin e përbërjes dhe funksionimit të tyre, kriterëve të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

vlerësimit dhe shpërblimit me Vendim të Këshillit të Ministrave. Për njërin prej këtyre organeve, Komitetin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore, që në ligj parashikohet kryesimi i tij nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe nuk i lihet Ministrisë të vetëshpallet Kryetar. Pra, në këtë situatë juridike, KKR e drejtuar nga Ministri i Kulturës, me numër anëtarësh të përcaktuar nga Ministri i Kulturës, përcakton kriteret dhe kategorinë e projekteve për restaurim dhe miraton lidhjen e kontratës së shfrytëzimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe shfrytëzuesve të monumentit; miraton kriteret për licencim të subjekteve e të personave juridik në fushën e restaurimeve, licencat për projektim dhe restaurim të të cilëve miratohen Ministri i Kulturës; bën inspektime për zbatimin e projekteve të miratuara nga vetë ajo dhe ka të drejtën të vlerësojë ekzistencën e shkeljeve që mund të sjellin pasoja në objekt dhe t’i propozojë Ministrisë të Kulturës heqjen e licencës së shoqërisë restauruese dhe/ose drejtuesit teknik restaurator. Si rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, pa asnjë ekuivok mund të thuhet se të gjitha parashikimet që rregullojnë këtë proces të çojnë në vendimmarrjen e Ministrisë të Kulturës.

Problematika me këtë karakter evidentohen edhe lidhur me normimin e përbërjes, kompetencave dhe funksionimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës, i cili miraton kriteret dhe kategorinë e objekteve për restaurim.

Në këtë kuadër, ne rekomandojmë që me ligj të miratuar nga Kuvendi duhet të përcaktohen të paktën numri i anëtarëve, përbërja, mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit, afati i mandatit, arsyet e përfundimit para kohe, kompetencat, si dhe rregullimi i raportit të tyre dhe Ministrisë përgjegjës për kulturën. Minimalisht, marrëdhënia mes Ministrisë dhe këtyre organeve kolegjiale duhet të përcaktohet me VKM, nxjerrja e së cilës të jetë autorizuar nga ligji, i cili të ketë të përcaktuar çështjet që VKM-ja duhet të rregullojë, si dhe parimet në bazë të të cilave do të nxirret kjo VKM. S’mund të jetë Ministri rregullator i raportit të tij me këto organe kolegjiale dhe i procedurës së funksionimit të tyre, për sa kohë implikohen raportet e tij me këto organe dhe akti i nxjerrë prej tij, qoftë Urdhër apo Udhëzim, shërben për dhënien e kompetencave për vetë Ministrinë i cili e nxjerr. Akte me të tilla parashikime nxirren në kushtet e konfliktit të interesit mes detyrave të Ministrisë dhe interesit që ai ka në shtimin e kompetencave të tij.

Kushtetuta, në nenin 102, parashikon se Ministri nxjerr Urdhra dhe Udhëzime vetëm në zbatim të kompetencave të tij, si rrjedhojë, nuk mund të shërbejnë këto akte nënligjore të nxjerrja nga vetë Ministri si burim për marrjen e kompetencave që ai nuk i ka. Ministri i Kulturës, me Urdhrin nr. 8/2014 i jep vetes kompetenca në lidhje me përcaktimin e numrit të anëtarëve të KKR, “vetëshpallet” Kryetar i KKR-së, si dhe përcakton funksionimin dhe vendimmarrjen e KKR-së.

Me shkresën nr. 9304 datë 18.12. 2018, MK ka pranuar zbatimin e Rekomandimit.

Përgjigja e institucionit

Në lidhje me kuadrin legjislativ të fushës së trashëgimisë kulturore ka pasur zhvillime të cilat lidhen me miratimin nga ana e kuvendit të ligjit të ri të trashëgimisë kulturore nr. 27/2018 i cili reflekton rekomandimet e propozuara nga KLSH lidhur me parashikimet për organet kolegjiale. Për këtë është ngritur grupi i punës i cili po harton aktet nënligjore të ligjit të trashëgimisë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Ministria e Kulturës ju bën me dije se, në zbatim edhe të rekomandimeve të lëna si dhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, shfuqizohet ligji nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar si dhe ligji nr.9386, datë 4.5.2005 “Për muzetë”.

Ministria e Kulturës në bazë të autorizimit ligjor në fuqi për trashëgiminë kulturore, përkatësisht në përputhje me pikën 2 të nenit 37 të ligjit nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, ka nxjerrë aktet nënligjore për krijimin organeve të reja kolegjiale në fushën e trashëgimisë kulturore nëpërmjet të cilave përcaktohet numri i anëtarëve, përbërja, mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit, afati i mandatit, arsyet e përfundimit para kohe.

Gjithashtu, në këto akte nënligjore parashikohet edhe mënyra e organizimit dhe funksionimit, kompetencat si dhe shpërblimi i anëtarëve të organeve kolegjiale.

Aktet nënligjore në fuqi për krijimin e organeve të reja kolegjiale janë si vijon:

- a) Këshillin Kombëtar të Muzeve, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.788, datë 26.12.2018 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Muzeve”;
- b) Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.208, datë 10.4.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”.
- c) Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.209 , datë 10.4.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”;
- d) Këshillin Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.279, datë 2.5.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore”.

Komenti i grupit të Auditimit

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet, **i zbatuar**.

4. Gjetje nga auditimi: Ndërsa në Udhëzimin nr. 5110/2015, Ministri i Kulturës parashikon kriteret e vlerësimit, si dhe organet për vlerësimin e dhënies me qira dhe administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi, krijimin ose jo të të cilave, si dhe përbërjen e tyre e ka në diskrecion vetë Ministri i Kulturës (si për shembull Komisionin për Menaxhimin e Pasurive Kulturore) dhe në fund, pavarësisht ngritjes ose jo të tyre, vendimmarrës sërish mbetet nxjerrësi i këtyre akteve nënligjore, Ministri i Kulturës.

Ne rekomandojmë gjithashtu se Ministria duhet të tregohet shumë e kujdesshme lidhur me monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate, sidomos për sa i përket zgjidhjes së njëanshme të saj, e cila do të sillte pasoja financiare të larta për buxhetin e shtetit, për shkak të njohjes së vlerës së (lartë) të investimit. Për më tepër që, të njëjtin person juridik i cili do të kryejë punimet restauruese për rijetëzimin e objektit të ndodhur në Parkun Kombëtar të Butrintit, sh.p.k., Ministria e Kulturës e ka shpallur fitues si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik edhe për rehabilitimin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

e Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor (trajtuar më hollësisht në faqen 113-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Me shkresën nr. 9304 datë 18.12. 2018, MK ka pranuar zbatimin e Rekomandimit.

Përgjigja e institucionit

Ministria e Kulturës, ju bën me dije se bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.279, datë 2.5.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore” është Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore, organi kompetent që vendos për dhënien në administrim të pasurive kulturore personave fizikë ose juridikë publikë ose privatë sipas procedurave publike të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore, është organi kompetent që përcakton mënyrën e përdorimit dhe destinacionin e pasurive kulturore dhe shqyrtimi i kërkesave për ndryshimin e destinacionit të përdorimit të pasurive kulturore.

Ministria e Kulturës, bazuar në pikën 3 të nenit 178, dhe pikës 2 të nenit 186 të ligjit nr. 27/2018, datë 17/05/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, është duke hartuar projektvendimin “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të konkurrimit, formën e kohëzgjatjes së kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore dhe kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të kontratës së rijetëzimit.” nëpërmjet të cilit përcaktohen kriteret e konkurrimit, procedurat publike për dhënien në përdorim të pasurive kulturore si dhe metodologjinë e caktimit të tarifave.

Me hyrjen në fuqi të projektaktit të sipërcituar, shfuqizohet udhëzimi nr. 5110/2015 i Ministrit të Kulturës.

Komenti i grupit të Auditimit

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar, **në proces zbatimi.**

B. Masa organizative

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2016, u konstatua se në aktiv të bilancit kontabël, posti C “Llogari të tjera aktive”, është paraqitur llogaria “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në vlerën 55,991,568 lekë, që përfaqëson shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në vitin e ardhshëm, pagesa të kryera në avancë. Po kjo vlerë në shumën 55,991,568 lekë është paraqitur në pasiv të bilancit kontabël llogaritë 401-408 të cilat përfaqësojnë detyrimet e institucionit ndaj furnitorëve për fatura të pa likuiduara dhe që si kundërparti në aktiv të bilancit duhet të kenë llogarinë “Operacione më shtetin debitor” (trajtuar më hollësisht në faqet nr. 6-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Ministria e Kulturës, Nëpunësi Zbatues të marrë masa për kryerjen e sistemimit kontabël, pasqyrimin e drejtë të kundërpartisë së llogarisë pasive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në aktiv të bilancit kontabël.

Afati për zbatimin e rekomandimit

Menjëherë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Me shkresën nr. 9304 datë 18.12. 2018, MK ka pranuar zbatimin e Rekomandimit.

Përgjigja e institucionit

Në zbatim të Udhëzimit nr.8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “, është bërë sistemimi kontabël sipas pikës 42, ku theksohet se nga pikpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura të bëhen si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse 486 “Shpenzime për periudhat e ardhëshme për detyrime të prapambetura”

- Kreditohet llogaria përkatëse 467 “Kreditorë të Ndryshëm”

Veprimet janë kryer në mbyllje të bilancit të vitit 2018.

Komenti i grupit të Auditimit

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet, **i zbatuar**.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2016, u konstatua se, vlera prej 1,090,851 lekë si pakësim i AQT nga nxjerrjet jashtë përdorimi është përfshirë dy herë në pasqyrën nr. 8 “Lëvizja e fondeve”, njëherë llog. 1015 në shumën 1,090,851 dhe njëherë si pjesë e llog. 1016 në shumën 40,529,437 lekë e cila është e përbërë nga “pakësime të tjera” në 39,438,586 lekë dhe “pakësim nga nxjerrje jashtë përdorimi” në shumën 1,090,851 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet nr. 6-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Ministria e Kulturës, Nëpunësi Zbatues të marrë masa për kryerjen e sistemimit kontabël, pasqyrimin e drejtë Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara (AQT) në pasqyrën nr. 8 “Pasqyra e lëvizjes së fondeve”.

Afati për zbatimin e rekomandimit

Menjëherë

Me shkresën nr. 9304 datë 18.12. 2018, MK ka pranuar zbatimin e Rekomandimit.

Përgjigja e institucionit

Është kryer sistemimi kontabël për pasqyrimin e drejtë të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (AQT) në pasqyrën nr 8 “Paqyra e Lëvizjes së fondeve “ për vitin 2017 dhe vitin 2018, në mbyllje të bilancit të vitit 2018.

Komenti i grupit të Auditimit

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet, **i zbatuar**.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i disa praktikave mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë viteve objekt auditimi ka rezultuar se kërkesat për rishpërndarje të fondeve buxhetore (shpenzime korente) jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me analiza. Gjithashtu, kjo mangësi është evidentuar edhe përsa i përket rishpërndarjes së fondeve në nivel projekti ku është konstatuar se: rialokimet e fondeve buxhetore gjatë vitit për një projekt, kanë pësuar ndryshime (shitesa e pakësime), të pa argumentuara (trajtuar më hollësisht në faqet nr. 96-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Ministria e Kulturës, si njësi e qeverisjes së përgjithshme, të rrisë kërkesën për llogaridhënie, deri në mosmiratim të kërkesave për rishpërndarje fondesh të njësive shpenzuese të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

varësisë, nëse këto të fundit nuk paraqesin analizë të detajuar, ku të argumentojnë nevojën për shtim fondesh, si dhe arsyet e mos planifikimit në masën e duhur, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë, me qëllim minimizimin e numrit të rishpërndarjes të fondeve gjatë vitit buxhetor.

Afati për zbatimin e rekomandimit

Menjëherë

Me shkresën nr. 9304 datë 18.12. 2018, MK ka pranuar zbatimin e Rekomandimit.

Përgjigja e institucionit

Sektori i Buxhetit ka marrë masa në lidhje me rekomandimin mbi rritjen e kërkesës për llogaridhënie, për, sa më poshtë:

- *miratimin e kërkesave për rishpërndarje fondesh kur njësitë shpenzuese të varësisë i shoqërojnë këto kërkesa me analizë të detajuar.*
- *miratimin e kërkesave shtesë të njërive shpenzuese të varësisë kur në këto kërkesa argumentohet arsyeja e mosplanifikimit të tyre në masën e duhur.*

Kërkesat janë të arsyetuara me një analizë të detajuar sëbashku me nevojën për shtimin e fondeve apo mosplanifikimin e duhur..

Komenti i grupit të Auditimit

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet, **i zbatuar.**

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit të Ministrisë së Kulturës, është evidentuar fenomeni i përqendrimit të likuidimit të shpenzimeve në fund të vitit buxhetor (nëntor-dhjetor), ku në vitin 2015 likuidimet në fund-vitit zënë 34.5 % të shpenzimeve vjetore, në vitin 2016 zënë 39.3 % të shpenzimeve vjetore dhe në vitin 2017 zënë 40 % të shpenzimeve vjetore. Ky trend, i cili shoqërohet me ndryshim të herëpashershëm të planit të arkës, tregon për një performancë të ulët të zbatimit të buxhetit (*trajtuar më hollësisht në faqet nr. 106-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Ministria e Kulturës, si njësi e qeverisjes së përgjithshme të marrë masa për realizimin e procedurave të investimeve, për realizimin faktik të kontratave të punimeve, shërbimeve apo mallrave, si dhe për likuidimin e tyre në mënyrë periodike, brenda limitit mujor të arkës, si nga ana e saj edhe e njërive shpenzuese që ka në varësi, me qëllim realizimin dhe likuidimin e tyre në kohë, minimizimin e ndryshimit të limitit të arkës gjatë vitit buxhetor, me qëllim rritjen e performancës buxhetore të saj.

Afati për zbatimin e rekomandimit

Menjëherë

Me shkresën nr. 9304 datë 18.12. 2018, MK ka pranuar zbatimin e Rekomandimit.

Përgjigja e institucionit

Ministria e Kulturës dhe njësitë e varësisë kanë zbatuar për periudhën në vazhdim rekomandimin për likuidimin e kontratave në mënyra periodike brenda limit mujor të arkës gjatë vitit buxhetor dhe brenda afatit kohor 30 ditë, me qëllim rritjen e performancës buxhetore të saj.

Komenti i grupit të Auditimit

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet, **i zbatuar.**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

5. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2016 – 2017 Ministria e Kulturës dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” kanë shqyrtuar/miratur projektzbatimin “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit”, mbështetur në “Propozim të pakërkuar” të bërë nga subjekti “.....” sh.p.k. për marrjen me qira të një objekti ndërtimi, magazinë (e cila nuk është monument kulture), pranë Qytetit Antik të Butrintit me qëllim vënien e saj në shfrytëzim për aktivitet tregtar bar - kafe- restorant. Vendndodhja e këtij objekti është në Parkun Kombëtar të Butrintit (PKB), në nënzonën “A”, në të cilën zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes.

Në përgjithësi arsyetimi për miratimin e projektzbatimit “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit”, bie ndesh me:

Ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”:

- nenin 30 në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se Zonat arkeologjike, në varësi të intensitetit dhe rëndësisë së gjetjeve arkeologjike, kategorizohen në zona “A” dhe zona “B”. Zonifikimi miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipa spropozimit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. **Në zonat arkeologjike “A” është e ndaluar çdo lloj ndërhyrjeje me karakter ndërtimor.**

- nenin 38 në të cilin është përcaktuar se ... Çdo vendim i marre nga këshillat e rregullimit të territoreve për ndërhyrje ose ndërtim në zonat e shpallura monumente kulture ose në zonën e mbrojtur pranë një monumendi kulture, pavarësisht nga pronësia, është i pavlefshëm.

- VKM nr. 693, datë 10.11.2005 “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “Park Kombëtar” i ndryshuar me VKM nr. 134, datë 20.12.2013, në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se ... Nënzona qendrore e shënuar në hartë me shkronjën “A” me sipërfaqe prej 3,980 ha, që përcaktohen si nënzona me vlera të mëdha për natyrën dhe biodiversitetin. **Në këtë zonë zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes ... etj.**

- Kombinimin e përcaktimeve të bëra midis nenit 4, pika 1, shkronja “b”, neni 5, 6 ... të ligjit 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar, VKM nr. 693, datë 10.11.2005 “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “Park Kombëtar” ndryshuar me VKM nr. 134, datë 20.12.2013 sipas të cilit ... në PKB nënzona qendrore (në të cilin ndodhet dhe objekti) zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes ... janë të ndaluara ndërtimet të çdo lloji ... etj.

Referuar Ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, ndërtimi “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit”, nuk përbën trashëgimi kulturore etj, në kuptim të Ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, për rrjedhojë, Ministria e Kulturës (me parë IMT dhe KKR), duhet ta refuzonin kërkesën e subjektit “.....” sh.p.k.

Rekomandimi: Ministria e Kulturës të kërkojë/anulojë kontratën eenfiteozës nr. 360, datë 2.6.2017 me objekt “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Parkun Kombëtar të Butrintit” lidhur me subjektin “.....” sh.p.k. me argumentet e paraqitur hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit. Me realizimin e anulimit të kontratës marrin përgjigje,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

gjejnë zgjidhje dhe pasaktësi të tjera të evidentuara/trajtuar më hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit.

Me shkresën nr. 9304 datë 18.12. 2018, MK ka konstatuar pamundësi në zbatimin e Rekomandimit.

Përgjigja e institucionit

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 5110, datë 13.10.2015 “Për dhënien me qira dhe mënyrën e administrimit të monumenteve të kulturës me qëllim rijetëzimi; u procedua si vijon me:

- Miratimin e marrëveshjes së datës 26.05.2017 ndërmjet grupit të negocimit, të autorizuar me urdhrin nr. 165, datë 10.04.2017 të Ministrit të Kulturës, dhe investitorit sh.p.k.
- Njohjen e të drejtës së pagesës së detyrimit në shumën e certifikuar sipas parashikimeve të kontratës së bashkëpunimit në restaurim dhe miratuar me urdhër ministri, në formën e vlerës së investimit të trupëzuar në zbatim të projektit të miratuar me vendim nr. 149, datë 12.05.2017 të Këshillit Kombëtar të Restaurimit.

Në lidhje me masën organizative ku propozohet zgjidhja e kontratës ju informojmë:

- Së pari procedura e ndjekur nga Ministria e Kulturës është konform legjislacionit në fuqi sa argumentuar më sipër.
- Së dyti, në zbatim të kontratës investimi është realizuar me fonde private, bashkëlidhur do të gjeni foto të objektit si ishte përpara investimit dhe si është pas investimit.
- Së treti, në rast se do të zgjidhnim kontratën do shkaktohej dëm në buxhetin e shtetit pasi zgjidhja e kontratës nënkupton kthimin e investimit në gjendjen e mëparshme. Investimi në gjendjen e mëparshme nuk mund të realizohet fizikisht pasi ky investim është i lidhur ngushtesisht me objektin. Për këtë arsye Ministria e Kulturës duhet t’i kthejë vlerën e investuar kontraktorit.

Ky rekomandim nuk mund të realizohet.

Komenti i grupit të Auditimit

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet **i (pa pranuar).**

C. Masa për shpërblim dëmi

Dëmi ekonomik i shkakuar është **2,633,039 lekë** gjithsej, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin elektronik të APP të tenderit me objekt “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor” me fond limit 998,862,862 lekë i zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se në preventivin e punimeve është përfshirë si zë punimi (më vete) “Punime për ngritje kantjeri”. Në preventivin e bashkimit të operatorëve ekonomikë (BOE) “....” sh.p.k. & “.....” sh.p.k. fitues, punimet për ngritje kantieri janë paraqitur me vlerë 1,841,942 lekë, ose 1,934,039 lekë gjithsej (1,841,942 lekë x 1.05 fondi rezervë). Në preventiv/situacion (ndarja e punimeve) ky punim është parashikuar/realizuar nga OE “.....” sh.p.k.

Përfshirja si zëra punimi me vete në preventiv/situacion i sa më sipër është në kundërshtim me germën B/3 të “Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi” të UKM nr. 2, datë 8.5.2003 në të cilën



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

është përcaktuar se në shpenzimet e përgjithshme përfshihen Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, **skelat**, makineritë, tabelat sinjalizuese etj. Nën këtë arsyetim **vlëra** prej 1,934,039 **lekë gjithsej përbën dëm ekonomik**, e cila është përfituar padrejtësisht nga OE “.....” sh.p.k. (trajtuar më hollësisht nr. 36-67të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **1,934,039 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyimit, përfituar nga OE “.....” sh.p.k.

Afati për zbatimin e rekomandimit

Menjëherë

Me shkresën nr. 9304 datë 18.12. 2018, MK ka konstatuar pamundësi në zbatimin e Rekomandimit.

Përgjigja e institucionit

Përfshirja e zëri “Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj” në preventiv është bazuar në parashikimet e VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, e cila përcakton qartësisht se si analizohet struktura e kostos për punimet e ndërtimit, duke ndarë vlerën për çdo zë në: Punëtori, transport, makineri, material, shpenzimet e përgjithshme 8% dhe fitimi 10%.

Ndërkohë që pretendimet e KLSH janë mbështetur në UKM nr. 2, datë 8.5.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

- Nga një lexim i të dy akteve të cituara (vkm dhe ukm) vihet re se të dy aktet kanë dalë në zbatim dhe mbështetje të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Për hierarkinë e akteve dhe për kohën e miratimit të tyre, parashikimet e VKM marrin prioritet në zbatim në krahasim me parashikimet e UKM.

- Në çdo rast dhe në mbështetje të argumentimit të grupit të auditit edhe nëse analizohen parashikimet e cituara referuar, Kapitulli B, Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, pika 3, parashikohet se “Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj., për mbrojtjen në punë si trajtimi me veshmbathje, ushqime, antidodë, ndihmë e shpejtë etj”, i referohet në mënyrë të qartë se çfarë mund të konsiderojmë në mënyrë të përmbledhur, për çdo punim në ndërtim “Shpenzime të përgjithshme”. Vazhdon më tej legjislatori duke parashikuar se shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, janë shpenzimet që nuk mund të llogariten e të vlerësohen me zëra pune, sepse ndryshojnë sipas llojit të ndërtimit, konstruksionit, rifiniturave, kohëzgjatjes së punimeve dhe strukturës organizative të sipërmarrësit etj, por llogariten me përqindje. Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, që përfshihen në çmimet njësore të zërave të punës, për punimet e ndërtimit dhe punimet teknologjike llogariten me përqindje mbi shpenzimet e drejtpërdrejta, ndërsa për punimet e montimit të pajisjeve dhe makinerive, me përqindje mbi pagat bazë e shtesë të fuqisë punëtore, që merret me punimet e montimit.

Komenti i grupit të Auditimit

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet **i papranuar**).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin elektronik të APP të tenderit me objekt *“Rikonstruksioni i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijët/Teatri i Kukullave dhe Qendrës Kombëtare të Veprimtarive të Folklorit”*, me fond limit 47,835,830 lekë i zhvilluar në vitin 2015 me OE fitues “.....” sh.p.k., u konstatua se në preventivin e punimeve të objektit janë përfshirë dhe zërat e punimeve “Rrethim i përkohshëm” me vlerë 120,000 lekë dhe “Rrethim rruge me rrjetë teli” me vlerë 20,000 lekë, ose *147,000 lekë gjithsej* (përfshirë dhe fondin rezervë përkatës në masën 5 për qind), në kundërshtim me pikën 3 të germës B “Shpenzimet e përgjithshme” të UKM nr. 2, datë 5.2.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostot së punimeve të ndërtimit” në të cilën është përcaktuar se ... *Në shpenzimet e përgjithshme përfshihen ... Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj., për mbrojtjen në punë si trajtimi me veshmbathje, ushqime, antidot, ndihmë e shpejtë etj, e cila nën këtë arsyetim përbën dëm ekonomik (trajtuar në faqe nr. 64-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi: Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **147,000 lekë gjithsej**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, përfituar nga OE “.....” sh.p.k.

Afati për zbatimin e rekomandimit

Menjëherë

Me shkresën nr. 9304 datë 18.12. 2018, MK ka konstatuar pamundësi në zbatimin e Rekomandimit.

Përgjigja e institucionit

Në lidhje me konstatimet e bëra në auditin e procedurës me objekt: “Rikonstruksioni i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijët”, për sa i përket punimeve të kryera në preventivin e objektit dhe zërave: “Rrethim i përkohshëm” në vlerë 120.000 lekë dhe “Rrethim rruge me rrjetë teli”, në vlerë 20.000 lekë, ju sqarojmë si më poshtë:

Bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, përcaktohet qartë se si analizohet struktura e kostos për punimet e ndërtimit, duke ndarë vlerën për çdo zë në: Puntori, transport, makineri, material, shpenzimet e përgjithshme 8% dhe fitimi 10%.

Referuar UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kapitulli B, Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, pika 3, parashikohet në mënyrë të qartë se çfarë mund të konsiderohet në mënyrë të përmblodhur, për çdo punim në ndërtim “Shpenzime të përgjithshme”. Konkretisht janë “Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj., për mbrojtjen në punë si trajtimi me veshmbathje, ushqime, antidodë, ndihmë e shpejtë etj”.

Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, janë shpenzimet që nuk mund të llogariten e të vlerësohen me zëra pune, sepse ndryshojnë sipas llojit të ndërtimit, konstruksionit, rifiniturave, kohëzgjatjes së punimeve dhe strukturës organizative të sipërmarrësit etj., por llogariten me përqindje.

Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi, që përfshihen në çmimet njësores të zërave të punës, për punimet e ndërtimit dhe punimet teknologjike llogariten me përqindje mbi shpenzimet e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

drejtpërdrejta, ndërsa për punimet e montimit të pajisjeve dhe makinerive, me përqindje mbi pagat bazë e shtesë të fuqisë punëtore, që merret me punimet e montimit.

Punimet e përmendura nga audituesit i referohen zërave: “Rrethim i përkohshëm me kollona b/a + rrjete teli” dhe “Rrethim rruge me rrjete teli”, të dyja këto masa të nevojshme (punime të pakthyeshme) për zgjidhjen e aksesueshmerisë për në objekt, për shkak të ndërtimeve pa leje që impaktonin zhvillimin e ndërtimit.

Në asnjë rast këto zëra nuk mund të konsiderohen si shpenzime të përgjithshme plotësuese mbi shpenzimet e drejtpërdrejta të punimeve të tjera....

Komenti i grupit të Auditimit

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet **i papranuar**.

3.Gjetje nga auditimi: Në tenderin me emërtim “Blerje pajisje të teknologjisë dhe informacionit dhe pajisje të tjera për strukturat e Vettingut”, për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontratë me vlerë kontrate 552,000 lekë me subjektin “.....” sh.p.k.

Sipas AK, ky veprim është i mbështetur në UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

Sa më sipër është në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 i ndryshuar, pasi ky udhëzim parashikon mbikëqyrje, për kontratat e zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe jo për blerje mallra etj, të kësaj natyre (trajtuar më hollësisht nr. 79-85të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **552,000 lekëgjithsej**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimin, përfituar padrejtësisht nga OE “.....”shpk.

Afati për zbatimin e rekomandimit

Menjëherë

Me shkresën nr. 9304 datë 18.12. 2018, MK ka konstatuar pamundësi në zbatimin e Rekomandimit.

Përgjigja e institucionit

Lidhur me kontratën me objekt: “Mbikëqyrje e kontratës për Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni + Pajisjet e sistemeve”, zerrat e preventivit dhe specifikimet teknike të projektit argumentojnë saktë që përveç kapitullit të parë, atij të blerjes së pajisjeve elektronike dhe telekomunikacionit, është edhe kapitulli i dytë ku janë specifikuar edhe punimet për pajisjet e sistemeve, punimet për furnizim vendosje të sistemit telefonik dhe kompjuterik, të sistemit të sinjalizimit të zjarrit, sistemit të monitorimit CCTV, sistemit të furnizimit të rezervuar me energji elektrike, sistemit të lajmërimit zanor, sistemit të hyrjes së kontrolluar dhe alarmit për hyrje të padëshiruara. Në këto kushte, në mënyrë të pakontestueshme, bazuar në Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, kapitulli I, pika 1, “Mbikëqyrja e punimeve bëhet për çdo projekt dhe ka për qëllim kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij”, është detyrim ligjor që punimet me financim publik të mbikëqyren. Po ashtu, vlen të theksohet që nuk jemi përpara një dëmi ekonomik të mundshëm, pasi shërbimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor është realizuar nga operatori ekonomik, për sa më sipër vlera e kontratës nuk mund të kërkohej. Dëmi ekonomik kërkohej vetëm në rastet kur kemi një punë apo një shërbim të porealizuar dhe që për të cilin operatori ekonomik është paguar..



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Komenti i grupit të Auditimit

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet **i pa pranuar**.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes është si më poshtë:

- ✓ “Propozime për ndryshime apo përmirësime të legjislacionit” janë lënë **4 (katër)** rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht, nga këto është zbatuar 1, dhe janë në proces zbatimi, 3.
- ✓ “Masa organizative” janë lënë **5(pesë)** rekomandime, janë pranuar plotësisht 4 (katër), te cilat janë zbatuar, ndërsa rezulton pa pranuar 1.
- ✓ “Masa për shpërbllim dëmi” janë lënë **3(tre)** rekomandime për shumën 2,663 mijë lekë, të cilat nuk janë pranuar dhe nuk janë zbatuar nga subjekti i audituar.

6.1 Rekomandimi:

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e plotë të rekomandimeve të mëposhtme:

- Ministria e Kulturës të kërkojë/anulojë kontratën eënfiteozës nr. 360, datë 2.6.2017me objekt “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Parkun Kombëtar të Butrintit” lidhur me subjektin “.....” sh.p.k. me argumentet e paraqitur hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit. Me realizimin e anulimit të kontratës marrin përgjigje, gjejnë zgjidhje dhe pasaktësi të tjera të evidentuara/trajtuar më hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit;
- Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **1,934,039 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyimit, përfituar nga OE “.....” sh.p.k
- Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **147,000 lekë gjithsej**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyimit, përfituar nga OE “.....” sh.p.k

Titulli i gjetjes:	Mbi zbatimin e rekoamndimeve të lëna në auditimin e mëparshëm
Situata:	Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes është si më poshtë: ✓ “Propozime për ndryshime apo përmirësime të legjislacionit” janë lënë 4 (katër) rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht, nga këto është zbatuar 1, dhe janë në proces zbatimi, 3. ✓ “Masa organizative” janë lënë 5(pesë) rekomandime, janë pranuar plotësisht 4 (katër), te cilat janë zbatuar, ndërsa rezulton pa pranuar 1.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

	✓ “Masa për shpërblim dëmi” janë lënë 3(tre) rekomandime për shumën 2,663 mijë lekë, të cilat nuk janë pranuar dhe nuk janë zbatuar nga subjekti i audituar.
Rekomandimi:	Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e plotë të rekomandimeve të mëposhtme: - Ministria e Kulturës të kërkojë/anulojë kontratën eenfiteozës nr. 360, datë 2.6.2017me objekt “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Parkun Kombëtar të Butrintit” lidhur me subjektin “.....” sh.p.k. me argumentet e paraqitur hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit. Me realizimin e <i>anulimit të kontratës</i> marrin përgjigje, gjejnë zgjidhje dhe pasaktësi të tjera të evidentuara/trajtuar më hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit; - Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 1,934,039 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, përfituar nga OE “.....” sh.p.k - Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 147,000 lekë gjithsej, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, përfituar nga OE “.....” sh.p.k
Afati i zbatimit:	Menjëherë

IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI AUDITIMIT

Ndër konkluzionet e këtij auditimi po listojmë sa më poshtë vijon:

1. Të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit përgjithësisht janë sipas formateve të përcaktuara në paragrafin 49, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016
- Përgjithësisht janë respektuar afatet e paraqitjes së raporteve të monitorimit të përcaktuar në udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016
 - Raporti i Monitorimit për vitin 2018, është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës.
 - Nëaneksin nr.4 “Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit”, të përcaktuar në udhëzimin e mësipërm, niveli i treguesve të performancës/produkteve nuk është plotësuar në sasi sipas njësive të tyre të matjes



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

2. Nga auditimi rezultoi se, përgjatë vitit 2018, për Ministrinë e Kulturës, janë çelur projekte të reja në vlerën 175,201,525 mijë leke, të cilat duke u detajuar nën titullin “pa përshkrim projekti”, **nuk** kanë kaluar në procedurat e miratimit të investimeve publike si dhe nuk rezultojnë të jenë në listën e investimeve të miratuara në projektbuxhetin e vitit 2018¹⁸

3. Nga kryerja e testimeve rezultoi shkelje e disiplinës buxhetore pasi **janë likudiuar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor sipas** Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” respektivisht:

-**gjatë vitit 2018**, 122 fatura, **mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit**, me një vlerë totale prej 31,739,503 lekë, dhe

-**gjatë vitit 2019**, 647 fatura **mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit**, me një vlerë totale prej 198,740,330 lekë,

4. Nga auditim rezultoi se është shkelur disiplina buxhetore në 4 rastetë procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, **pasi urdhrat e prokurimit janë regjistruar në SIFQ mbi 5 ditë vonesë**, në kundërshtim me bazën ligjore në fuqi. Koncretisht rezultoi se, 4 urdhra prokurimi¹⁹ në shumën totale prej 2,598,194 lekë, nga të cilat 1 urdher prokurimi në shumën 817,754 lekë për

¹⁸ Sipas VKM nr. 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve, projektet e investimeve duhet të paraqiten si pjesë përbërëse e kërkesave buxhetore, në kuadër të përgatitjes së PBA-së. NJQQ përgatisin propozimet për projektet e mëdha të investimeve, në cdo kohë dhe i paraqesin për vlerësim në Ministrinë përgjegjëse për financat, Brenda muajit dhjetor dhe jo më vonë se një muaj përpara fillimit të procesit buxhetor, sipas përcaktimit në nenin 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar.

¹⁹

Kontrata	Vlera me TVSH	Nr (Urdher Prokurimi)	Data (Urdhet Prokurimi)	Data e kontrates	Data në SIFQ	Tejkaluar afati (ditë)
kontrata nr.2826/4.d.06.05.2019,Mbikqyrje punime per objektin Blerje paisjeve te teknologjise se skenes TOB	817,754	228	26-Apr-19	06-May-19	10-May-19	9
Kontrata nr. 3602/7, dt 04.06.2018, Sherbimi I mirembajtjes se godines se MK"	780,000	324	24-May-18	04-Jun-18	04-Sep-18	98
Kontrata nr. 2449/9, dt 10.05.2018 "Shërbimi I mirmbajtjes së printerave dhe fotokopjeve të Ministrisë së Kulturës për vitin 2018"	454,680	218	11-Apr-18	10-May-18	28-Aug-18	134
Kontrata nr. 3057/6, dt 10.05.2018 "Blerje pjese kembimi per automjetet ne perdorim te MK"	545,760	284	03-May-18	10-May-18	06-Aug-18	90
Total vlera nga te cilat:	2,598,194					
Viti 2018	817,754					
Viti 2019	1,780,440					



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

vitin 2019 dhe 3 urdhra në shumën 1,780,440 lekë për vitin 2018, janë dorëzuar me vonesë në Struktura e zbatimit të buxhetit në varesi të Nepunësit Zbatues të MK-së, përtej afatit 5 ditor të parashikuar në Udhëzim, **dhe si pasojë është bërë gjithashtu me vonesë:**

- regjistrimi i tyre në SIFQ, nga struktura e zbatimit të buxhetit të varësi të NZ; si dhe
- miratimi përfundimisht i transaksionit në librin e kontabilitetit nga struktura përgjegjëse e thesarit në degë, e cila njëkohësisht inicion bllokimin e fondeve për shpenzim (regjistrimin e angazhimit në SIFQ).

5. Nga auditimi rezultoi shkelje e disiplinës buxhetore për vitin 2019, sa i takon marrjes së një angazhimi prej 199,659,817 lekë me tëpër, pa pasur fonde buxhetore në dispozicion.

6. Gjatë procesit të ristrukturimit nuk është treguar vëmendje dhe përgjegjshmëri për të planifikuar dhe punësuar personel nga kategori sociale të cilësuar si “Grupe të vecanta”.

7. Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2018 (mbartur si pasojë edhe në pasqyrat e vitit 2019) konstatohet se është bërë një pakësim llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione” në shumën 60,369,399 lekë për një amortizim që nuk i përket kësaj llogarie. Në kushtet e detyrimit për zbatim të UMFE nr. 8/2018 për përgatitjen e pasqyrave financiare 2018, MK duhet të raportonte zërat e aktiveve me vlerën neto, si rezultat është gjendur në situatën e vlerës së mbetur negative, për shkak të një amortizimi të akumuluar të zërit 218 “Inventar ekonomik” më të lartë se kosto historike. Në shënimet shpjeguese shoqëruese të pasqyrave financiare të vitit 2018 nuk ka asnjë informacion në lidhje me këtë pakësim, as për mënyrën e përlllogaritjes së tij dhe as problematikën që ka shoqëruar raportimin. Veprimi i mësipërm cënon besueshmërinë në reflektimin e vlerës neto të llogarisë 218 “Inventar ekonomik” dhe të shënimeve shpjeguese dhe bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, Kreu 3.7 Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale. Pika 85.

8. Gjatë auditimit u konstatua se në zbatim të Urdhrit përkatës të Ministrit për vitin 2018/ 2019, janë ngritur Komisionet e Inventarizimit. Për vitin 2018 procesi i inventarizimit të gjithë aktiveve të MK ka përfunduar jashtë datës së përcaktuar, dhe përtej raportimit të pasqyrave të aparatit të MK në Degën e Thesarit. Për vitin 2019 është kryer vetëm inventarizim i aktiveve në magazinë. Rezultatet e inventarizimit në dy vitet nën auditim nuk janë formuluar në një relacion.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”.

Në mënyrë më të detajuar po japim opinionin si dhe gjetjet dhe rekomandimet:

A. OPINIONI I AUDITIMIT



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Opinion mbi përputhshmërinë (i pakualifikuar me theksim të çështjes)

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrisë së Kulturës, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të MK-së, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

Nga auditimi u rezultoi se, në opinionin tonë, aktiviteti i MK-së, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme, por për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes”.

Baza për opinionin e përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur gjithashtu mbi gjykimin profesional të audituesit. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes.

Theksimi i çështjes:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave në MK nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë hallkat e përfshira, dhe strukturat e varësisë në mënyrë që:

- praktika të çeljes së projekteve “pa përshkrim” të mos përsëriten në të ardhmen dhe MK në çdo rast, për projektet e mëdha të investimeve, të përgatis propozimet dhe t’i paraqes për vlerësim në Ministrinë përgjegjëse për financat, brenda muajit dhjetor dhe jo më vonë se një muaj përpara fillimit të procesit buxhetor

- të merren masa që të respektohet disiplina buxhetore dhe të shmangen risqet për krijimin e detyrimeve të prapambetura, duke treguar kujdes të mos tejkalohet afati 30 ditor i likuidimit të faturave, në përputhje me kërkesat e nenit 52 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”;

- të merren masa që të respektohet disiplina buxhetore, duke u treguar kujdes maksimal në mos çeljen e angazhimeve buxhetore në mungesë të fondeve të parashikuara, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura në përputhje me VKM nr.50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe të planit të veprimit” si dhe me Udhëzimin nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për NJQP që përdorin SIFQ”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

- theksojmë nevojën që Ministria e Kulturës në rolin e Autoritet Kontraktor, në çdo procedure prokurimi, të tregojë kujdesin e duhur në përllogaritjen e fondit limit, në përcaktimin e procedurës, në tipin e kontratës së përzgjedhur, në hartimin e dokumentave standarde të tenderit, në vendosjen e kriterëve për kualifikim dhe kriterëve të veçanta, në zbatimin dhe ekzekutimin e kontratës, në funksion të përmbushjes së parimit të konkurrencës dhe parimeve të eficiencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit të fondeve publike.

Opinion mbi pasqyrat financiare (i pakualifikuar me theksim të çështjes)

Ne audituam pasqyrat financiare të MK-së, më datë 31.12.2019, të cilat përbëhen nga Pozicioni Financiar, Performanca Financiare, Pasqyra e Fluksit të Arkës, Fondet neto, Investimet e Aktivitet Afatgjatë si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit, por për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes”.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 1700 “Standardi i Auditimit Financiar”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar të auditimit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes”.

Theksimi i çështjes:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i MK-së i përfshirë, sa i takon procesit të inventarizimit pasi rezultoi se, në kushtet e detyrimit për përgatitjen e pasqyrave financiare, MK është gjendur përpara reflektimit të një gabimi të mbartur ndër vite në lidhje me amortizimin e akumuluar të aktiveve, si pasojë më së shumti e mos regjistrimit fillestar të aktiveve të inventarit ekonomik bazuar në dokumentacionin e duhur kontabël përpara vitit 2012; reflektuar kjo në mungesën e llogaritjes së amortizimit për disa vite. Si pasojë nga auditimi rezultoi se, vlera e amortizimi të akumuluar e inventarit ekonomik, është më e lartë se vetë kosto historike e tyre (në shumën 60,369,999 lekë). Për të bërë sistemimin, MK ka pakësuar llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione” në shumën 60,369,399 lekë për një amortizim që nuk i përket kësaj llogarie, duke rritur kështu me pa të drejtë jetën e dobishme të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

këtij aktivi dhe duke rrezikuar të çënojë besueshmërinë e pasqyrave financiare në lidhje me vlerën neto të aktiveve.

Për këtë, theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e MK-së, në linjë hierarkike për evidentimin e saktë të arsyeve dhe aktiveve, që nuk janë amortizuar sipas normave të lejuara kontabël dhe të lidhin rezultatet e nxjerra me aktivet përkatës, konform parimeve kontabël dhe dispozitave ligjore. Gjithashtu theksojmë nevojën që në proceset e radhës së inventarizimit të përfundohet numërimi sasior dhe cilësor i të gjithë aktiveve, brenda afatit të raportimit të pasqyrave financiare.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i MK-së është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MK-së me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë të procedurave tenderuese të zhvilluara nga Ministria e Kulturës, në cilësinë e AK-së, për vitet buxhetore 2018 dhe 2019, konkretisht në procedurat me objekte:

1. “Projekti i restaurimit dhe riformulimi i linjës Muzeore në Muzeun Historik Kombëtar”, viti 2018.
2. “Projekti i restaurimit dhe rehabilitimit të hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve” viti 2018.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

3. “Blerje pajisje teknologjisë së skenës dhe material ne funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP”;

4. “Mbikëqyrje e punimeve për objektin “Blerje e pajisjeve të teknologjisë së skenës dhe material në funksion të projektit rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor”;

5. “Kolaudimi i punimeve për objektin “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Asamblit Popullor”, viti 2019,

u konstatua se, në përbërjen e grupeve të punës për hartimin e fondit limit, në përcaktimin e termave të referencës, në hartimin e Memo-s për të iniciuar procedura prokurimi, në monitorimin e kontratave si dhe në miratimin e pagesave, janë vendosur 2 këshilltarë të kabinetit të ministrit: zj. D. P dhe z. S. J, në kundërshtim me ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” i ndryshuar, neni 11 (Ministritë) pika 4, ku parashikohet se: “*Struktura e kabinetit mbështet drejtëpërdrejtë ministrin në ndjekjen e politikave përkatëse, realizimin e objektivave, si dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike të ministrisë. Funksionarët e kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror*”, si dhe me Urdhërin nr.3 48 datë 18.09.2015 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të brëndshëm, të Ministrisë të Kulturës” neni 9/ Kabineti i Ministrit.

Këto veprime janë në kundërshtim me LPP si dhe me faktin që në bazë të VKM nr.164 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Kulturës”, në MK ekziston një strukturë e dedikuar që është “Drejtoria e prokurimit, koncesionit dhe PPP”, me 2 sektorë varësie.

Ky fakt tregon për mbivendosje të strukturave ekzistuese me ato ndihmëse, të cilat në detyrat funksionale dhe në përshkrimin e vendeve të punës, kanë detyrim ligjor të bëjnë testimin e tregut në lidhje me procedurat e prokurimeve publike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 102 – 134, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandim: Nga ana e Titullarit të MK, të merren masa që për realizimin e procedurave të prokurimeve, në komisione të përfshihen persona kompetente, në përshatje me detyrat funksionale të përcaktuara, si dhe të trajnuar në mënyrë të vazhdueshme në bashkëpunim me/nga Agjencia e Prokurimeve Publike dhe Departamenti i Administratës Publike dhe jo ndryshe, sikundër ka ndodhur me përfshirjen në komision të këshilltarëve të kabinetit të Ministrit, pasi vlerësojmë se përfshirja e tyre në këto komisione është tërësisht e gabuar.

Menjëherë dhe në vazhdim

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shtesës së kontratës për "Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor " rezultoi se, kontrata bazë e zbatimit të punimeve nr. 5349 datë 31.10.2016, është nënshkruar midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE “E...” sh.p.k & “A...”shpk. Vlera e kontratës është 1,112,105,000 lekë me TVSH. Supervizioni i punimeve të zbatimit është shoqëria “A...” shpk. Bazuar në nenin 7 të KVK “Zbatimi i kontratës dhe Preventivi”, parashikohet lloji i kontratës, i cili do të bëhet me çelsa në dorë dhe me cmime të pandryshueshme. Preventivat përfshijnë të gjitha zërat e punimeve për ndërtimin, instalimin dhe provat dhe duhet të kryhen nga sipërmarrësi që përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës, e cila është vlerë fikse që nuk mund të tejkalohet.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Në nenin 1, të kushteve të përgjithshme të kontratës (KPK), pika 1.5 citon në mënyrë eksplicite se, kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu “Kushtet e Vecanta të Kontratës (KVK)” dhe se në rast se ka konflikt midis KPK-ve, dhe KVK, atëherë KVK do të mbizotëzojnë mbi KPK. Më datë 05.12.2019, është përgatitur procedura për rritjen e vlerës së kontratës si dhe zgjatjen e afatit të punimeve, duke marrë shkak nga disa mospërputhje midis projektit dhe preventivit edhe nga kërkesat e TKOBAP. Me shkresën nr. 6641/3 datë 15.11.2019 u pa i nevojshëm rishikimi i projektit, duke cuar në kërkesën për shtesë kontrate më datë 05.12.2019. Shtesa e kontratës përfshin vetëm rritje të volumeve të punës për punët ndërtimore dhe kryesisht për instalimet elektrike e mekanike (zëra të cilat kanë qenë të përfshira në preventivin bazë të kontratës bazë). Për shkak të Covid-19, grupi i auditit nuk arriti të bënte verifikim në terren, mbi përputhshmërinë ose jo të volumeve të punimeve dhe në të tilla kushte, duke vlerësuar risqet potenciale me të cilat mund të përballlet MK, si pasojë e keqmenaxhimit të fondeve, vlerësojmë nevojën emergjente që MK të verifikojë dhe shprehet për rastin e shtesës së kësaj kontrate.

Kontrata shtesë e zbatimit të punimeve nr. 626/10 datë 02.03.2020, është nënshkruar midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE “E.....” sh.p.k & “A....” shpk. Vlera e kontratës është 198,099,999 lekë me TVSH ose 18 % e kontratës bazë.

Në kushtet e kontratës nuk parashikohet shtesa në vlerë dhe bazuar LPP në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Ndryshuar me VKM nr.80, datë 14.2.2018), Neni 26, Pika 2 “Kontratat për punë publike”.

Në observacionet e dërguara nga Autoriteti Kontraktor, konstatohet se Projektit ishte parashikuar te financohej me donatore të tjere. Burimi i financimit do të sigurohej nga fonde të huaja të vëna në dispozicion nga Qeveria e Republikës Popullore të Kinës dhe Qeveria Greke, si dhe fonde nga Bashkia e Tiranës për punime që ndërthuren me projektin me objekt: “Rivitalizim i Sheshit Skënderbej”. Pra, Autoriteti Kontraktor ka tenderuar vetëm një pjesë të punimeve të ndërtim-montimit për të cilat u shpall fitues BOE “E....” sh.p.k & “A....” sh.p.k Kjo gjë për arsye që nuk varen dhe janë në kontroll të AK u bë e pamundur, ndaj duhej që këto punime shtesë të kryheshin në mënyrë që të përfundojnë të gjitha punimet në vepër dhe kjo e fundit të vihet në funksion. Gjithashtu, ka patur shumë propozime e kërkesa shtesë nga Përfituesi “(TKOBAP)”, të cilat i janë percjelle Sipermarresit nga Autoriteti Kontraktor me shkresën Nr. 6641/3 Prot., dt. 15/19/2019. Në lidhje me ligjshmërinë e lidhjes së kontratës shtesë, grupi i auditimit, merre në konsiderate observacionet sepse rregullat e prokurimit publik lejojnë lidhjen kontratave shtesë kur vlera e punës dhe/ose shërbimeve shtesë nuk e tejkalon 20 për qind të vlerës së kontratës fillestare, në pikën 5 gërmen b të neni 33 të LPP. *Në lidhje me përputhshmërinë e zërave, volumeve dhe çmimeve të preventivit të punimeve të përcaktuara në kontratën shtesë dhe rakordimin e tyre me zërat, volumet dhe çmimet e preventivit të punimeve të përcaktuara në kontratën fillestare, nuk u krye auditim për përputhshmërinë e tyre:*

-*Jo vetëm* për faktin se, punimet deri në momentin e auditimit ishin në proces dhe sipas kontratës shtesës të datës 02.03.2020 përfundojnë në datë 31.05.2020, që është periudhë tej periudhës së përcaktuar në programin e auditimi i cili afatin e ushtrimit të auditimit e kishte deri në datën 31.12.2020;

-*Por edhe* për faktin e fatkeqësisë natyrore të ndodhur gjatë muajit mars-prill 2020, për shkak të pandemisë shkaktuar prej Covid 19.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 102 – 134, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi:

- Ministria e Kulturës dhe TOB në bashkëpunim me projektuesin, mbikëqyrësin dhe sipërmarrësin e punimeve, të ngrejë një grup pune të veçante për të verifikuar përputhshmërinë e volumeve të punimeve sipas kontratës bazë dhe sipas shtesës së kontratës.
- Ministria e Kulturës, në të ardhmen, për projektet e përbashkëta të marrë masa për koordinimin dhe bashkërendimin sa më të mirë të veprimeve midis Bashkisë Tiranë dhe donatorëve të ndryshëm, me qëllim realizimin dhe përfundimin e projekteve brenda afateve të përcaktuara, duke shmangur në cdo rast shtesat e kontratave, të cilat rrezikojnë të përballin institucionit dhe si pasojë buxhetin e tij me risqe të keqmenaxhimit të fondeve.

Menjëherë dhe në vazhdim

3. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi rezultoi se, përgjatë vitit 2018, për Ministrinë e Kulturës, janë çelur projekte të reja në vlerën 175,201,525 mijë leke, të cilat duke u detajuar nën titullin “pa përshkrim projekti”, nuk kanë kaluar në procedurat e miratimit të investimeve publike si dhe nuk rezultojnë të jenë në listën e investimeve të miratuara në projektbuxhetin e vitit 2018.

Konstatohet se, këto projekte, nuk janë përfshirë as në Listën e Investimeve Publike 2019-2021 si projekte investimi të miratuara me projektbuxhetin e vitit 2019, ku duhet të ishin paraqitur si projekte investimi në vazhdim.

Konkretisht, rezultoi se, me shkresën nr. 7105/2, datë 18.04.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, me subjekt “Çngurtësim fondi”, është miratuar çngurtësimi i fondeve në vlerën 181.200 mijë lekë dhe duke u çelur projekte, pa iu nënshtruar procedurave të investimeve publike në programin 8220 “Trashëgimia kulturore dhe muzetë” si më poshtë:

- 1-Projekti me kod M120781 “Projekti i restaurimit dhe riformulimi I linjës muzeale në Muzeun Historik Kombëtar” Tiranë në vlerën 40,000 mijë lekë
- 2-Projekti me kod M120782 “Projekti i restaurimit dhe rehabilitimit të hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve” në vlerën 15,000 mijë lekë.
- 3-Projekti me kod M120783 “Ura e Kollorces 4 km në juglindje të Gjirokastrës” në vlerën 5,000 mijë lekë
- 4-Projekti me kod M120784 “Restaurim banesa e vëllezërve Frashri” në vlerën 6,000 mijë lekë
- 5- Projekti me kod M120785 “Restaurim muzeu i Sinjës Dibër” në vlerën 1,500 mijë lekë
- 6- Projekti me kod M120786 “Restaurim Kisha e Shën Mërisë Gjirokastrë” në vlerën 22,500 mijë lekë
- 7- Projekti me kod M120787 “Restaurim Kisha e Shën në vlerën 20,000 mijë lekë
- 8- Projekti me kod M120788 “Restaurim Kisha e Shën në vlerën 33,300 mijë lekë
- 9- Projekti me kod M120790 “Restaurim Kisha e Shën në vlerën 11,000 mijë lekë
- 10-Projekti me kod M120791 “Restaurim Kisha Manastiri i Shën Mërisë Faza 1- Sarandë”, në vlerën 26,900 mijë lekë.

Sa më sipër në kundërshtim me VKM nr. 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve”, ku projektet e investimeve duhet të paraqiten si pjesë përbërëse e kërkesave



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

buxhetore, në kuadër të përgatitjes së PBA-s; dhe nenin 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13 – 15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi:

Ministria e Kulturës të marr masa që praktika të tilla të celjes së projekteve “pa përshkrim” të mos përsëriten më në të ardhmen. Në cdo rast projektet e investimeve duhet të paraqiten si pjesë përbërëse e kërkesave buxhetore, në kuadër të përgatitjes së PBA-ve përkatëse. Institucioni duhet të përgatis propozimet për projektet e mëdha të investimeve, në cdo kohë dhe t’i paraqes ato për vlerësim, në Ministrinë përgjegjëse për financat, brenda muajit dhjetor dhe jo më vonë se një muaj përpara fillimit të procesit buxhetor.

Në vazhdim

4. Gjetje nga auditimi

Nga kryerja e testimeve në Modulin e Pagesave të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave që tejkalojnë afatin e parashikuar ligjor prej 30 ditësh, në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”. Konkretisht:

-gjatë vitit 2018, janë likuiduar 122 fatura, mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit, me një vlerë totale prej 31,739,503 lekë, dhe

-gjatë vitit 2019, janë likuiduar 647 fatura mbi 30 ditë nga lëshimi i faturës së furnitorit, me një vlerë totale prej 198,740,330 lekë, duke sjellë :

a. Tejkallim të afateve që parashikon Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar, neni 52, ku specifikohet se: *Nëpunësi zbatues i njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së), dhe si pasojë*

b. Duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (të prapambetura)

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13 – 15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi:

Me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura, në cdo rast NZ duhet të paraqes në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së, dhe jo ndryshe. Për cdo rast në vijim, që do të konstatohet ndryshe, të evidentohen përgjegjësitë dhe për personat përgjegjës për shkaktimin e vonësive të aplikohen sanksionet e parashikuara në Kreun IX, neni 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, I ndryshuar.

Në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Nga auditim rezultoi se është shkelur disiplina buxhetore në 4 raste të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, pasi urdhrat e prokurimit janë regjistruar në SIFQ **mbi 5 ditë vonesë**, në kundërshtim me:

a. nenin 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

b. nenin 144 të udhëzimit nr. 2, datë 06/02/2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; si dhe

c. paragrafin 17 të Udhëzimit nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme që përdorin Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë”.

Konkretisht, rezultoi se janë dorëzuar përtej afatit 5 ditor të parashikuar 4 urdhra prokurimi në shumën totale prej 2,598,194 lekë, nga të cilat: për vitin 2019, 1 urdher prokurimi në shumën 817,754 lekë; dhe për vitin 2018, 3 urdhra në shumën 1,780,440 lekë, dhe si pasojë është bërë gjithashtu me vonesë regjistrimi i tyre në SIFQ, nga struktura e zbatimit të buxhetit të varësi të NZ.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13 – 15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi:

Me qëllim disiplinimin e shpenzimeve buxhetore, Ministria e Kulturës si njësi qeverisjes së përgjithshme, që operon direkt në SIFQ, gjatë ekzekutimit të buxhetit dhe raportimit financiar duhet të regjistrojë në këtë sistem kontratën ose urdhrin e prokurimit (në rastet e blerjeve me vlerë të vogël), brenda 5 ditëve pune nga data e nënshkrimit të tij. Për cdo rast në vijim, që do të konstatohet ndryshe, të evidentohen përgjegjësitë dhe për personat përgjegjës për shkaktimin e vonesave të vlerësohen dhe në varësi të vlerësimit, të aplikohen sanksionet e parashikuara në Kreun IX, neni 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar

Në vazhdim

6. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi rezultoi se MK ka kryer rialokime fondesh mes njësive shpenzuese, **pas datës 15.11.2018**, në kundërshtim me sa parashikon neni 48, i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ku parashikohet se e drejta e njësive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të cdo viti buxhetor. Kështu nga auditimi rezultoi se, janë bërë rialokimet e mëposhtme:

- duke u kredituar llogaria e Aparatit me total prej 2,061 mijë lekë me debitime njësitë e varësisë, si dhe
- duke kredituar llogaria e MHK për 230 mijë lekë dhe debituar njësitë e varësisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13 – 15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi:

Në kushtet kur e drejta e njësive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të cdo viti buxhetor, Ministria e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Kulturës të tregojë kujdesin e duhur ndaj rialokimit të fondeve pas kësaj date, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore.

Në vazhdim

7. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi rezultoi shkelje e disiplinës buxhetore për vitin 2019, sa i takon marrjes së një angazhimi prej 199,659,817 lekë me tepër, nga sa miratuar fonde buxhetore në dispozicion. Konkretisht, më datë 20.08.2019 është celur në SIFQ, angazhimi për kontratën nr. 5349, datë 31.10.2016 (në vazhdim) me A.... shpk, për rikonstruksimin e TOB (projekti me kod M120763) në shumën 350,000,000 lekë.

Grupi i auditimit përllogariti tepërcën e fondeve të angazhuara për këtë projekt, pas cdo likuidimi, ku rezultoi se, pas likuidimit të datës 09.07.2019 për shumën prej 50,909,699 lekë, për llogari të furnitorit, tepërcja e celur për projektin në fjalë, ishte 157,377,307 lekë. Pas kësaj, më datën 20.08.2019, MK ka celur në SIFQ angazhimin për diferencën e kontratës prej 350,000,000 lekë në një kohë kur tepërcja e celur ishte 157,377,307 lekë (sa përllogaritur më lart), pra celja tejkalon angazhimin me 192,622,693 lekë.

Grupi i auditimit kërkoi informacion me të detajuar për sa më sipër, ku në përfundim rezultoi se angazhimi prej 350,000,000 lekë në fakt është celur në dy transhe si vijon:

- Transhi i parë për shumën 150,340,183 lekë²⁰ (angazhim për vitin korent pasi vetëm kaq ka pasur gjendje); ndërsa

- Transhi i dytë për diferencën prej 199,659,817 lekë (350,000,000 lekë – 150,340,183 lekë), është celur me **pa të drejtë** si angazhim për vitin 2021, pa ndjekur procedurat standarte të buxhetit deri sa “është legjitimuar” me Aktin Normativ nr. 2, datë 02.10.2019, ku u miratua shtesë fondi prej 200,000,000 lekë. Ky angazhim ka qëndruar në SIFQ, me statusin “i rezervuar” deri me datën 06.11.2019 dhe më pas është ç’rezervuar.

Kjo procedurë e ndjekur, është në kundërshtim me procedurat e zbatimit të buxhetit të shtetit (miratuar kontrata pa pasur fonde buxhetore) si dhe në kundërshtim me sa dikton Udhëzimi nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për NJQP që përdorin SIFQ”, si dhe VKM nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjise për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të planit të veprimit”, pasi duke u gjetur mënyra (qoftë edhe teknike) të ndërmarrjes së angazhimeve pa pasur fonde buxhetore, angazhime këto të cilat në rastin konkret **janë legjitimuar** më pas me akt normativ, rrezikohet vendosja e institucionit përpara riskut të krijimit të detyrimeve të prapambetura.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13 – 15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi:

Në vijim, të shmanget plotësisht përdorimi i praktikave të celjes së angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, për më tepër duke përdorur mënyra jo të duhura teknike dhe ligjore, si **transferimin e perkohshëm** të një **angazhimi aktual**, në një periudhë të ardhshme.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Në kushtet kur, sa më sipër është sistemuar brenda periudhës objekt auditimi, theksojmë nevojën që për të gjitha rastet e konstatuara në të ardhmen, të vlerësohen dhe në varësi të vlerësimit, të aplikohen sanksionet e parashikuara në Kreun IX, neni 71 të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në vazhdim

8. Gjetje nga auditimi:

8.1. Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2018 konstatohet se është bërë një pakësim në amortizimin e akumuluar të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” në vlerën 60,369,399 lekë më shumë se amortizimi vjetor që i përket kësaj llogarie. Në kushtet e detyrimit për zbatim të UMFE nr. 8/2018 për përgatitjen e pasqyrave financiare 2018, MK duhet të raportonte zërat e aktiveve me vlerën neto, në një situatë ku amortizimi i akumuluar, i përmbledhur deri në fund të periudhës raportuese 2017, rezultonte në shumën 150,975,320 lekë, me një diferencë 60,369,999 lekë nga amortizimi që duhet t’i perkonte analitikisht secilit aktiv, të pasqyruar në regjistrin e aktiveve. Si rezultat nga sektori i financës është bërë një sistemim jo i drejtë i kësaj difference, vetëm në zërin 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, duke i zvogëluar atij amortizimin e akumuluar, dhe duke i rritur jetën e dobishme, me një normë amortizimi më të ulët se norma e lejuar, e detyrueshme për zbatim. Sipas Sektorit të Financës amortizimi i akumuluar i gjithë aktiveve përpara vitit 2018, ka patur pasaktësi si rezultat i mosreflektimit të saktë të aktiveve që përbënin llogarinë 218 “Inventarit ekonomik” për shkak të mungesës dokumentare të mbajtjes së tyre përpara vitit 2012, si dhe nga kryerje të transferimeve kapitale të aktiveve pa u shoqëruar me amortizimin përkatës dhe me ndonjë mungesë në llogaritjen e amortizimit të vjetor deri në fund të vitit 2017. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me parimin kontabël të përkatësisë, me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, Pika 36, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit SKK5 “AAGJ materiale dhe jomateriale”, Pika 7.

8.2. Në shënimet shpjeguese shoqëruese të pasqyrave financiare të vitit 2018 trajtohet vetëm amortizimi vjetor 2018 dhe nuk jepet asnjë informacion në lidhje me pakësimin e amortizimit të akumuluar në shumën 60,369,999 lekë; nuk trajtohet as mënyra e përlllogaritjes dhe problematika që ka shoqëruar raportimin në vlerën neto të aktiveve, në administrim nga MK. Veprimi i mësipërm cënon besueshmërinë e pasqyrave financiare sa i takon reflektimit të vlerës neto të llogarisë 218 “Inventar ekonomik” dhe të shënimeve shpjeguese, si edhe bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, Kreu 3.7 Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale. Pika 85. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13 – 15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1 Rekomandimi:

MK, në linjë hierarkike, Nëpunësi Autorizues (NA), Nëpunësi Zbatues (NZ) dhe personeli i përfshirë, të marrin masa:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

3. për evidentimin e saktë aktiveve, që nuk janë amortizuar sipas normave të lejuara kontabël, duke u analizuar arsyet dhe lidhur rezultatet e nxjerra me aktivet përkatëse, konform parimeve kontabël dhe dispozitave ligjore në fuqi;
4. për evidentimin e gjithë problematikave që shoqërojnë raportimin financiar në shënimet shpjeguese të tij, duke shmangur praktika të mbartjes të tyre në vitet në vazhdim.

Brenda datës 31.03.2021

9. Gjetje nga auditimi

Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2018, konstatohet se në pasqyrën e flukseve monetare ka një raportim të pasaktë për sa i përket:

- transferimit të fondeve të përdorura përgjatë vitit 2018, i cili sipas aktrakordimit me thesarin rezulton të jetë 12,260,484 lekë,
- të ardhurave dytësore të MK të transferuara në buxhet, me një raportim më të ulët në shumën 32,729,684 lekë, si dhe
- mospasqyrim në nënrubrikën “Arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor” për të hyrat nga mjetet në ruajtje në shumën 32,729,687 lekë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, Seksioni 3.5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe74 – 101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1 Rekomandimi:

Drejtoria e Financës dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat për sistemimin e diferencave të konstatuara, në zërat e pasqyrës së flukseve monetare të vitit 2018, duke reflektuar në mënyrën e duhur bazën krahasimore midis periudhave kontabël.

Brenda datës 31.12.2020

10. Gjetje nga auditimi

Gjatë auditimit u konstatua se në zbatim të Urdhrit përkatës të Ministrit për vitin 2018/ 2019, në MK janë ngritur Komisionet e Inventarizimit. Për vitin 2018 procesi i inventarizimit të gjithë aktiveve të MK ka përfunduar jashtë datës së përcaktuar në urdhër, dokumentuar në Memon drejtuar Nëpunësit Autorizues me nr. 3393, datë 23.05.2019, si dhe përtej afatit të raportimit të pasqyrave të aparatit të MK, në Degën e Thesarit.

Për vitin 2019 është kryer vetëm inventarizim i aktiveve në magazinë dhe përfundimet janë dokumentuar në Memon drejtuar NA me nr. 7525/1, datë 17.01.2019.

Nga auditimi u konstatua se, rezultatet e inventarizimit në dy vitet nën auditim nuk janë formuluar në një relacion përkatës.

Gjithë sa më sipër është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar Neni 7, Pika 1, Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, Kreu 3.1, Pika 30 dhe me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli II , Pika 1.1. *(Më hollësisht*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

trajtuar në pikën 3, faqe 63 -74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi:

MK, në linjë hierarkike, NA, NZ dhe personeli i përfshirë, të marrin masat që në proceset e inventarizimit të rradhës, të përfundohet numërimi sasior dhe cilësor i të gjithë aktiveve, brenda afatit të raportimit të pasqyrave financiare në funksion kjo edhe të rritjes së saktësisë dhe besueshmërisë së pasqyrave financiare. Rezultatet e inventarizimit në cdo rast duhet të dokumentohen me një relacion përkatës.

Brenda datës 31.12.2020

11. Gjetje nga auditimi

11.1 Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve për vitin 2018 u konstatua se, likuidimi I urdhër shpenzimeve është kryer në masën 35%, në muajin dhjetor, ndërsa në muajt e tjerë konstatohet një ekzekutim në masën mesatare 6%. Për vitin 2019, likuidimet e kryera në muajin dhjetor përbëjnë rreth 23% të shpenzimeve të gjithë vitit, me një mesatare të muajve të tjerë prej rreth 11%. Nga 108 urdhër shpenzime të audituara për të dy vitet objekt auditimi, 19 prej tyre, ose 18% nuk kanë dokumente të plotë bashkëlidhur, në kundërshtim me UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Pika 34 dhe Pika 36.

11.2 Ministria e Kulturës për periudhën në auditim, ka kryer transferta bankare në shumën 6,486,395 lekë, në Ambasadën e RSH në Romë, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur midis MK dhe MEPJ me nr. 77, datë 11.02.2016. Në të është parashikuar përfshirja e një punonjësi në personelin e misionit diplomatik, si koordinator i MK-së për çështjet kulturore. Gjatë auditimit u konstatua se, në MK nuk ka raporte të punës së punonjësit në fjalë, apo produkte të tjera, si dokumente justifikues, në kundërshtim me UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Pika 34, por dhe me Marrëveshjen e lidhur midis dy ministrive, Seksioni “Komunikimi” ku qartësisht parashikohet se: *“Punonjësi do të ushtrojë funksionin e saj në bazë të detyrave të marra nga titullari i përfaqësisë diplomatike dhe nga Titullari i MK, si dhe raporton në MEPJ dhe MK. Çdo anashkalim i këtij detyrimi përbën shkelje të disiplinës”*.

Në vijim konstatohet se, rinovimi i Marrëveshjes me nr. 697/3, datë 05.02.2019 është në kundërshtim me paragrafin e Marrëveshjes nr. 77, datë 11.02.2016 ku parashikohet se: *“Pas mbarimit të periudhës 3 vjeçare, bazuar në rezultatet e punës dhe më pëlqimin e palëve, marrëveshja mund të rinovohet edhe për një mandat tjetër”*, pasi në MK nuk ka të dhëna dokumentare mbi rezultatet e punës së këtij punonjësi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 63 -74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi:

Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar/ Sektori i Financës të marrë masa në plotësimin e të gjithë dokumentacionit shoqërues të çdo urdhër shpenzimi, në funksion të justifikimit të plotë të librave të ditarëve, duke lejuar kontrollin e mëvonshëm.

Në vazhdim

11.2 Rekomandimi:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Për shpenzimet e kryera në drejtim të Ambasadës së RSH në Romë, MK të marrë masa në lidhje me verifikimin dhe dokumentimin e punës së kryer nga përfaqësuesi i saj, dhe vetëm në bazë të rezultateve të dokumentuara, të vijoje vazhdimësinë ose jo të marrëveshjes së lidhur. Në kushtet e mungesës së tyre, të vijoje menjëherë me ndërprerjen e vazhdimësisë së marrëveshjes.

Menjëherë dhe në vazhdim

12. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi mbi vlerësimin dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, u konstatua se:

1. Për periudhën objekt auditimi, kanë munguar takimet e dokumentuara të veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS);

2. Edhe pse është miratuar Rregullorja e re, me Urdhër të Ministres nr. 92 dt.19.02.2020, e cila reflekton ndryshimet e ndodhura në strukturë, rezultoi se këto ndryshime ende nuk janë reflektuar në Manualin e Procedurave, i cili ka për qëllim ndër të tjera përcaktimin dhe ndarjen e qartë të detyrave si dhe pershkrimin e punës për çdo pozicion, në përputhje me sa dikton Ligji nr. Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe në funksion të realizimit të aktivitetit të ministrisë në përputhje me objektivat dhe misionin e saj.

3. “Drejtoria e së Drejtës së Autorit” (DDA) nuk ka Rregjistër Dokumentar (manual) që pas vitit 2016, *për regjistrimin* e të gjitha aplikimeve, rregjistrimeve, depozitimeve dhe pajisjeve me Çertifikata dhe Pulla Artistike, në kundërshtim me ligjin nr. 35/2016, neni 18 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to”, si dhe VKM nr.34 dt.18.01.2017 “Për Procedurat e Rregjistrimit, të Organizimit dhe Klasifikimit të veprave të të Drejtave të Autorit” Kreu I pika 2,3,4. Aktualisht DDA disponon vetëm Rregjistër elektronik (ku u konstatuan problematika të renditjes sipas numrit rendor progresiv rritës).

4. Nga auditimi rezultoi se, për dy vitet e njëpasnjëshme, objekt auditimi, MK ka vijuar të ushtrojë aktivitetin me struktura të paplotësuara me burime njerëzore, konkretisht: gjatë vitit 2018 nga 91 vende të paarshikuara, ka operuar me mesatarisht me 73 punonjës; ndërsa gjatë vitit 2019 nga 91 vende të paarshikuara ka operuar me mesatarisht me 77 punonjës. Struktura organizative në vetvete duhet t’i shërbejë përmbushjes së objektivave të njësisë. Duke qenë se, funksionimi i saj në përputhje me këto objektiva është element i rëndësishëm i kontroleve të brendshme, rrjedhimisht mungesa e vazhdueshme e burimeve njerëzore rrezikon të çënojë përmbushjen e objektivave të vetë institucionit.

5. MK nuk ka strategji trajnimi për GMS, në kundërshtim me sa dikton Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

6. Rezultoi se, gjurmët e auditimit nuk janë të miratuara nga titullari si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e punës së MK

7. Nga testimi me përzgjedhje i kampionit të dosjeve të personelit, emëruar në vitet 2018 e 2019, rezultuan disa parregullsi dhe mangësi si vijon:

- dosjet shoqërohen me fletë inventari të pa unifikuar sipas formatit që dikton Ligji nr.152/2013 i ndryshuar “Për nëpunësin civil” neni 17 pika 1,4; VKM nr.117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Lidhja 1 e 2; si dhe Manuali i Procedurave të MK-së, me Urdhër të Ministrit nr. 108/2016 neni 22 pika 3 c,c.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

8. Ministria e Kulturës dhe AKSHI veprojnë në bazë të një marrëveshjeje nivel shërbimi (SLA), sa i përket sistemeve IT të ministrisë. Kjo marrëveshje synon ofrimin e shërbimeve me qëllim rritjen e efektivitetit, kohëzgjatjes, kufizimin e risqeve teknike, pra në ruajtjen e integritetit, konfidencialitetit dhe vazhdueshmërisë së punës. Nga auditimi rezultoi se, nuk është autorizuar me shkrim (dokumentuar) asnjë punonjës në cilësinë e “Personit të Autorizuar”, në kundërshtim me sa parashikuar në paragrafët 1/4 dhe 5/1,2,3 të marrëveshjes SLA, duke vënë nënë njësinë përpara risqeve të mos-realizimit të etapave të procedurës së parashikuar, për realizimin e tre shërbimeve të kontraktuara, duke bërë që të mos hartohet as raporti i monitorimit mbi cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të ofruara nga AKSHI.

9. Lidhur me procedurën e korrigjimit të të dhënave në sistemin HRMIS (Sistemi online i Regjistrimit Qëndror të Personelit) evidentuam se kjo e fundit realizohet manualisht, që do të thotë se ekziston mundësia e gabimit njerëzor e cil rrit riskun e qenesishëm të subjektit dhe kërkon forcimin e kontrolleve të brendshme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 134-156, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1 Rekomandimi:

1. Me qëllim evidentimin e të metave, mangësive dhe menaxhimit të risqeve përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike GMS nevojitet të planifikojë dhe dokumentojë të gjitha takimet e kryera në funksion të objektivave të saj. Gjithashtu nevojitet që GMS të kontrollojë si janë menaxhuar risqet, me qëllim parandalimin e krijimit të situatave të paparashikuara, si dhe marrja e masave për parandalimim e tyre si dhe përgatitjen e një raport vjetor lidhur me këtë.

2. Me qëllim përcaktimin dhe ndarjen e qartë të detyrave si dhe pershkrimin e punës për cdo pozicion, në funksion të realizimit të objektivave të MK-së, MK të marrë masa për reflektimin e gjithë ndryshimeve të ndodhura në strukturë dhe organike, në Manualin e Procedurave.

3. Drejtoria e së Drejtës së Autorit të marr masa për hartimin dhe ruajtjen e Regjistrimit Dokumentar (manual) për regjistrimin e të gjitha aplikimeve, rregjistrimeve, depozitave, pajisjeve me Çertifikata dhe Pulla Artistike ku të tregohet kujdes në vendosjen e numrave rendor si element të rëndësishëm të kontrolleve të brendshme, por edhe në përtmbushje të bazës ligjore dhe rregullatore në fuqi.

4. MK në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse DAP, të marrin masa të menjëhershme për hartimin dhe ndjekjen e gjithë procedurave të nevojshme për plotësimin e vendeve vakante.

5. MK të marr masa për hartimin e strategjisë së trajnimit për GMS, në funksion të realizimit të detyrave të parashikuara për këtë grup, në kuadrin ligjor dhe rregullator

6. Të merren masa për hartimin dhe miratimin e gjurmëve të auditimit, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e punës së MK

7. Dosjet e personelit në cdo rast, të plotësohen dhe shoqërohen me fletë inventari dhe fletë prezantuese të të dhënave teknike, ku të listohen të gjitha dokumentat e domosdoshme që lidhen me arsimimin, kualifikimet dhe cdo kërkesë tjetër që buron nga kuadri ligjor dhe rregullator.

8. MK të marr masa për emërimin e personit të autorizuar, sipas marrëveshjes nivel shërbimi (SLA), me qëllim respektimin e etapave të parashikuara në procedurë për shërbimet e kontraktuara nga AKSHI.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

9. Me qëllim forcimin e kontrolleve, nga pikëpamja e plotësisë së sigurisë së informacionit, nevojitet që filtri i procedurës së ndjekur nga sistemi HRMIS (Sistemi online i Regjistrat Qëndror të Personelit) të ketë një gjurmim të etapave ku kalon procedura, pra të ketë shtrirje vertikale të kontrolluar. Procedura duhet të ketë një praktikë të plotë, të qartë, dokumentare në mënyrë që të garantohet shmangien e keqpërdorimit dhe të abuzimit.

Menjëherë dhe në vazhdim

13. Gjetje nga auditimi

Nga analiza e detajuar mbi Strukturën e re dhe Organigramën e MK, sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.164 dt. 05.10.2017 rezultoi se, as nuk janë planifikuar në strukturë dhe si pasojë as nuk janë punësuar persona me statusin e “Grupit të vecantë” ku të përfshihen: persona me aftësi të kufizuara, jetimë, komunitetit romë etj. si personel administrativ apo të kabinetit të ministrit, sikundër e dikton ligji nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi I Punës I Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 52 – 63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi

MK të analizojë, vlerësojë dhe ri-dimensionojë strukturën e saj edhe në funksion të “grupeve të vecanta”, duke mbajtur në konsideratë sa më sipër që në fazën e planifikimit e deri në punësimin e tyre, pa cënuar në asnjë rast parimet e barazisë meritokracinë, dhe duke eliminuar/minimizuar diskriminimin.

Në vazhdim

14. Gjetje nga auditimi

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, të lëna në auditimin e mëparshëm në MK, sipas programit të auditimit nr. 1264/2, datë 14.12.2017 për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2017, dhe Vendimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 49, datë 12/06/2018, paraqitet si më poshtë:

- ✓ “Propozime për ndryshime apo përmirësime të legjislacionit” janë lënë **4 (katër)** rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht, nga këto është zbatuar 1, dhe janë në proces zbatimi, 3.
- ✓ “Masa organizative” janë lënë **5(pesë)** rekomandime, janë pranuar plotësisht 4 (katër), dhe zbatuar;
- ✓ “Masa për shpërblim dëmi” janë lënë **3(tre)** rekomandime për shumën 2,663 mijë lekë, të cilat nuk janë pranuar dhe nuk janë zbatuar nga subjekti i audituar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 156 176, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e plotë të rekomandimeve të mëposhtme:

- Ministria e Kulturës të kërkojë/anulojë kontratën e enfitozës nr. 360, datë 2.6.2017 me objekt “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Parkun Kombëtar të Butrintit” lidhur me subjektin “HAKO” sh.p.k. me argumentet e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

paraqitur hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit. Me realizimin e *anulimit të kontratës* marrin përgjegje, gjejnë zgjidhje dhe pasaktësi të tjera të evidentuara/trajtuar më hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit;

- Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **1,934,039 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, përfituar nga OE “.....” sh.p.k
- Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **147,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, përfituar nga OE “.....” sh.p.k.

Menjëherë

C. GJETJE ME EFEKTE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN, MENAXHIMIN PA EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë të realizimit të procedurave me objekte “Projekti i restaurimit dhe riformulimi i linjës Muzeore në Muzeun Historik Kombëtar” dhe “Projekti i restaurimit dhe rehabilitimit të hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve” viti 2018 realizuar në MK, u konstatua se:

Të dyja procedurat e mësipërme, janë realizuar nga AK me procedurë “Negocim pa shpallje”, në dështim të procedurave “shërbim konsulence”, për shkak pasi nuk është arritur konkurrenca minimale.

Hartimi për realizimin e projekteve, është në kuadër të zbatimit të programit të Qeverisë Shqiptare 2017-2021, ku Ministria e Kulturës ka përcaktuar në listën e prioritetëve në fushën e trashëgimisë dhe kulturës hartimin e projekteve me objekte “Restaurimi, rikonstruksioni dhe riformulimi i linjës muzeore për Muzeun Historik Kombëtar dhe Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve).

Sipas Relacioneve mbi gjendjet ekzistuese të objekteve muzeale, grupet e punës për hartimin e termave referencës dhe përcaktimin e fondit limit të projektit, shprehen se gjëndja e përgjithshme e objekteve shfaqen të rënduar dhe të amortizuar në kohë, konkretisht gjëndja e konstruksionit, gjëndja e sistemit elektrik, gjëndja e sistemit mekanik, gjëndja e fasadave, duke kërkuar, të ndërhyhet rrënjësisht në të gjithë elementët përbërës të tij, me qëllim funksionimin komod të aktiviteteve që zhvillohen në këtë objekt dhe të përmirësojë në mënyrë cilësore hapësirat duke sjellë një risi edhe në aktivitetin artistik e kulturor.

AK, ka shpallur fitues BOE “A....”shpk & “K....”shpk & “A....”shpk, për të dyja procedurat, duke lidhur kontrata si më poshtë:

1.Kontratë shërbimi nr.6855/16 prot datë 27.09.2018 me objekt “Hartim projekti për objektin “Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve) me vlerë kontrate prej 12,400,000 lekë pa tvsh me afat ekzekutimi deri në 17 dhjetor 2018;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

2. Kontratë shërbimi nr.5983/13 prot datë 27.08.2018 me objekt “Hartim projekti për objektin “Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Historik Kombëtar me vlerë kontrate prej 39,960,000 lekë me tvsh me afat ekzekutimi deri në 17 dhjetor 2018.

Në përfundim të realizimit të kontratave të mësipërme, BOE “A....”shpk & “K...”shpk & “A.....”shpk, në përmbushje të detyrimit kontraktor, duke përllogaritur shumën totale të investimit për objektet;

1. Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Artve) me vlerë totale të investimit prej 1,356,395,879 lekë.

2. Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Historik Kombëtar me vlerë totale të investimit prej 1,923,924,367 lekë ose 15,796,872 Euro.

Për më sipër, nga auditimi u evidentua se:

-Në PBA e viteve në vazhdim, 2019, 2020, 2021, nuk janë planifikuar fonde për investimin për të realizuar restaurimin, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e hapësirave të Muzeut Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Artve), ndonëse janë përcaktuar në listën e prioriteteve, për të zbatuar programin e Qeverisë Shqiptare.

-Duke marrë në konsideratë që gjendjet aktuale të objekteve, të cilat janë të rënduara (sipas Termave të referencës të hartuara në vitin 2018 për secilin), të cilat me kalimin e kohës, do të degradojnë më shumë, si pasojë e kushteve si dhe të fatkeqësive natyrore (siç ndodhi dhe termenti i 26 Nëntorit 2019).

-Këto janë objekte të trashëgimisë kulturore kategoria II, si dhe ndryshimi teknologjive të restaurimit, të rehabilitimit kohë mbas kohë, përbën element risku për implementimin e project-zbatimit.

Planifikimi i fondeve vetëm për realizimin e projekteve dhe jo për implementimin e tyre, e vendos MK-në përballë riskut potencial të keqmenaxhimit të fondeve buxhetore për shumën mund **prej 45,700,000 lekë pa tvsh ose 54,840,000 lekë me tvsh**, që është vlera e financuar vetëm për hartimin e projekteve për restaurimin, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e hapësirave të Muzeut Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 102 – 134, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandim: Me qëllim menaxhimit me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore, dhe shmangien e risqeve në disfavor të Buxhetit të Shtetit, nga Autoriteti Kontraktor i Ministrisë së Kulturës, të merren masa që vecanërisht për projekte me rëndësi të lartë për publikun, të tregohet kujdes maksimal përgjatë planifikimit por edhe sigurimit në kohë të fondeve të nevojshme, për realizimin deri në implementim të plotë, dhe jo pjesor të tyre.

Në vazhdim

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë së procedurës me objekt “Blerje pajisje të teknologjisë së skenës dhe materiale në funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP”, u konstatua se:

-Kjo procedurë është në vazhdimësi të investimit për rehabilitimin e TKOBAP, ku autoriteti kontraktor i MK, më datë 28.09.2016 ka realizuar procedurën e hapur, kontratë zbatimi punimesh me objekt “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor”, me fond



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

limit 998,862,862 lekë pa tvsh²¹. Në këtë kontratë punimesh, **nuk u përfshinë** kapitulli III “F.V. Ashensor dhe IV “Pajisje të skenës dhe sallës”, me argumentin që fondet, që pritej të siguroheshin nga granti i Qeverisë së Kinës, Qeverisë Greke dhe nga Bashkia e Tiranës, nuk arritën të përthithen e për rrjedhojë fondet për implementimin e mëtejshëm të rehabilitimitin u financuan nga Buxheti i Shtetit, vetëm në vitin 2019;

- Nisur sa më sipër, në rolin e Titullarit të AK, ish-Ministri, zj. Mirela Kumbaro, miratoi urdhrin nr. 854 datë 18.12.2018, me shkresën nr. 9209/3, “Për ngritjen e komisionit për llogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit”, ku argumentohet dhe aprovohet, që preventivi i detajuar, për kapitujt III “F.V. Ashensorë “ dhe IV “Pajisje të skenës dhe sallës”, është bazuar në produktin e kontratë shërbimi nr.2685/1, datë 05.10.2015 me OE “A....”shpk, me objekt prokurimi për hartimin e projektit “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor”. Procedura është zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të territorit (AKPT) në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ndërsa Ministria e Kulturës, në cilësinë e përfituesit. Në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi²², AKPT ka pasur detyrimin ligjor për ta marrë në dorëzim këtë projekt dhe për ta përcjellë pranë Institutit të Ndërtimit.

Nga auditimi u konstatua se, MK nuk ka miratimet përkatëse nga Këshilli Teknik i Institutit të Ndërtimit si dhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi²³

-Në referim të procesverbalit nr. 9209/4 prot, datë 20.12.2018, për llogaritjen e fondit limit, ngritur në bazë të urdhërit të ministrit nr. 854 datë 18.12.2018, me përbërje A.O, A. A dhe M. H, është argumentuar se “...pas kontrollit të preventivit të detajuar, të pikave III- “F.V. Ashensorë “ dhe IV- “Pajisje të skenës dhe sallës”, nga kontraktuesi “A....”sh.p.k sipas kontratës nr.2685/1, datë 05.10.2015, komisioni përcakton vlerën e fondit limit prej 353,826,366 lekë pa tvsh.”

Nga auditimi i zërave të preventivit për 2 kapitujt e mësipërm, u konstatua, se 170 zëra janë me analizë çmimi, por bashkëlidhur nuk u evidentua një listë e hollësishme çmimesh me analizë të detajuar të çmimit ku futet (vlera e mallit/pajisja +pagesa e sigurimeve shoqërore+pagesa e puntorisë+ transport, etj), në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”. Në shtesë të arsyetimit, grupi i auditimit, vlerëson se, krahas projektit të zbatimit, pjesë e detyrimeve kontraktuale të OE“A.....”shpk, ka qenë edhe përcaktimi i fondit limit e hartimi i preventivit për këtë objekt.

Meqënëse, nga AK është përdorur preventivi i hartuar nga “A.....”shkp, është kompetencë dhe përgjegjësi e “A.....”shpk, zbatimi i legjislacionit përkatës që përcakton strukturën apo çmimet e përdorura të preventivit dhe të tjera detaje teknike.

²¹ audituar nga KLSH në bazë të Programit nr.1264/2 datë 14.12.2017 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit

²² Ligji nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, VKM nr.363, datë 18.7.2002 “Për vendosjen e oponentëve teknike për projektet e ndërtimit të objekteve”.

²³ Në bazë të VKM-së nr. 514 datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, kërkohet metodologjia e llogaritjes së kostos së preventivit në mënyrë të detajuar si dhe miratimi nga Këshilli Teknik i Institutit të Ndërtimit si dhe miratimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke e regjistruar projektin së bashku me preventivin.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Marrja në dorëzim e projektit të zbatimit nga ana e AK, duhet të konsistonte në verifikimin e përputhshmërisë së vlerës së preventivit shoqërues me atë që është deklaruar në ofertën ekonomike të OE, duke e shoqëruar me një listë të hollësishme të çmimeve me analizë të detajuar të çmimit ku futet (vlera e mallit/pajisja +pagesa e sigurimeve shoqërore+pagesa e puntorisë+ transport, etj)²⁴

Për sa më sipër, grupi i auditimit nuk mund të përlllogarisë saktë, vlerën reale të çmimeve, për shkak të mungesës së analizave të çmimeve, pasi projektuesi “A...” shpk, ka hartuar çmimet të pareferuara në studimin e tregut, në çmimet e marra në internet, apo në çmimet e miratuara nga INSTAT (psh, ku është bazuar për llogaritjen e çmimit të poltroneve të sallës, të mobiljeve, të pajisjeve, etj).

Gjithashtu, shkakut të mësipërm, iu mbivendos dhe situata e krijuar nga Covid-19, duke diktuar kështu edhe ndërprerjen e auditimit në terren, dhe si pasojë grupi i auditimit nuk arriti të bënte verifikimin e çmimeve me metodën krahasimore dhe në të tilla kushte nuk arriti të vlerësojë saktë risqet potenciale me të cilat mund të përballlet MK.

Për sa më sipër, është përgjegjësia e hartuesit e preventivit OE “A....” shpk, titullarit të AK-së, komisionit për hartimin e fondit limit me përbërje (A. O, A. A dhe M. H) si dhe njësisë së prokurimit me përbërje (E. A, B. H dhe S. Sh) pasi preventiv i përdorur në këtë procedurë nuk është shoqëruar me një listë të hollësishme të çmimeve me analizë çmimi të detajuar ku përfshihet vlera e mallit/pajisja +pagesa e sigurimeve shoqërore+pagesa e puntorisë+ transport, etj.

- Nga auditimi u konstatua se, duke krahasuar kriteret e vecanta të kualifikimit KVK dhe certifikatat e kërkuara nga njësia e prokurimit në DT (Shtojca nr.9), me kriteret dhe standartet e kërkuara nga projektuesi “A...” sh.p.k, vihet re që AK, ka minimizuar ndjeshëm vendosjen e kriterëve në pikën 2.3, specifikisht në vendosjen e certifikatave, në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi ²⁵.

-Kjo mangësi është suprimuar, në procedurën e prokurimit me objekt “Kolaudimi i punimeve për objektin “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Asamblit Popullor”, ku vihet re se, në ftesën për ofertë me shkresë nr.8732/5 prot datë 15.11.2019, në kriteret e veçanta të kualifikimit në pikën 3, nga AK (njësia e prokurimit) me të drejtë është kërkuar Licenca profesionale e OE për kategoritë kryesore për operatorët ekonomikë, duke kërkuar:

-NS-3 “Impiante ngritese dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)”;

-NS-4 “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese”; dhe

-NS-8c “Struktura druri”.

Ndërsa në fazën e 3-të, që përkon me objektin tenderues “Blerje pajisje teknologjisë së skenës dhe materiale në funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP”, këto KVK nuk janë kërkuar nga njësia e prokurimit, në një kohë që grupi i auditimit, vlerëson se është e rëndësishme kërkesa e këtyre licencave profesionale në këtë fazë.

²⁴ sipas procesverbalit me shkresë nr.9209/4 prot datë 20.12.2018

²⁵ me LPP neni 23 (Specifikimet teknike) dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 30 (kërkesat e cilësisë) neni 61 (hartimi dhe publikimi i dokumentave të tenderit), duke ulur standartet e realizimit të objektit të Teatrit Operas dhe Baletit, si vepër multidimensionale dhe multifunkionale (paraqitur në Akt-konstatimin nr.3).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

-Nëse AK, do të kishte prokuruar dhe këta dy kapituj që në fazën e parë (me Kontratën Zbatim-Punimesh nr. 5349 datë 31.10.2016), e gjithë kontrata do të konsiderohej si Kontratë Zbatim-Punimesh; pamundësia e burimit financiar në atë kohë, nuk mund të përdoret si argument që vazhdimësia e një kontrate ekzistuese, të konsiderohet si kontratë e mirëfilltë mallrash. Qëllimi i realizimit të investimit rezulton të jetë multi-kompleks, dhe për rrjedhojë është detyrim ligjor i AK-së (Ministritë së Kulturës) që realizimin e këtij qëllimi ta arrijë duke mirë menaxhuar fondet e buxhetit të shtetit, dhe duke respektuar bazën ligjore në përputhshmëri të plotë dhe në mënyrë sa më transparente.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 102 – 134, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandim: Ministria e Kulturës, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune të veçantë me specialistë të fushës, të hartojnë edhe njëherë analizat e çmimeve të çdo zëri të preventivit, bazuar në VKM- në nr. 514 datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.”

Nëse pas analizës së grupit rezulton se, çmimet e preventivit të hedhur në DT, janë llogaritur më të larta nga rezultatet e ri llogaritjes të dalë nga ky grup pune, atëherë të bëhet korrektimi i tyre me çmimet e preventivit fitues, që janë më të larta se fondi limit dhe diferenca e konstatuar të arkëtohet në Buxhetin e Shtetit, me qëllim menaxhimit me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE, ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA

Mbështetur në nenin 15, shkronja c dhe nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Ministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm që, në përputhje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të vlerësojë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të përfshirë, në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe dhe të kërkojë marrjen e masave për personat që vlerësohen me përgjegjësi në këtë raport përfundimtar auditimi.

Menjëherë

Në bazë të programit të auditimit nr. 62/1, datë 21.01.2020, i ndryshuar, auditimi në terren, duhet të përfundonte më 20.03.2020, por për shkak të pandemisë COVID19, u ndërpre dhe si pasojë grupi i auditimit nuk arriti të përmbushë në masën 100% të gjitha drejtimitet e auditimit të përcaktuara në programin e auditimit dhe për këtë shkak nuk u bë i mundur takimi i përfundimit të auditimit në terren, ku të paraqiteshin për subjektin konstatimet nga auditimi deri në këtë fazë. Aktet e konstatimit, hartuar për gjetjet deri më datë 10.03.2020 (përpara shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore) u dërguan me e-mail zyrtar më datë 20.03.2020.

Si pasojë e situatës së krijuar, dhe vështirësive që krijoi të punuarit on-line, veçanërisht fondet për projektet artistike që financohen nga Ministria e Kulturës nuk u audituan plotësisht, çfarë është edhe një mangësi e këtij auditimi, dhe për këtë, në auditimin e ardhshëm që KLSH do të kryejë në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

Ministrinë e Kulturës, auditimi i projekteve artistike për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2019, do të parashikohet specifikisht në një drejtim auditimi të veçantë;

Në lidhje me auditimin e verifikimit të çmimeve me metodën krahasimore në procedurën me objekt *“Blerje pajisje të teknologjisë së skenës dhe materiale ne funksion të projektit “Rehabilitimi i TKOBAP”, që nuk u realizua²⁶, për shkak të ndërprerjes së punës audituese, si pasojë e COVID19, KLSH do të ndjekë me kujdes përmbushjen e rekomandimit të lënë në përputhje me nenin 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe sa më sipër do ta ketë gjithashtu në fokus në auditimin e ardhshëm në Ministrinë e Kulturës.*

Në lidhje me rakordimin e zërave, volumeve dhe çmimeve të preventivit të punimeve të përcaktuara në kontratën fillestare me ato të përcaktuara në kontratën shtesë për "Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor" me nr. 626/10, datë 02.03.2020", nënshkruar midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE “.....” sh.p.k & “.....”shpk, me vlerë 98,099,999 lekë, i cili nuk u realizua për faktin se punimet, deri në momentin e auditimit ishin në proces dhe sipas kontratës shtesë të datës 02.03.2020 përfundonin më datë 31.05.2020, që ishte periudhë tej periudhës së përcaktuar në programin e auditimi, por edhe për shkak të ndërprerjes së auditimit në terren, si pasojë e COVID19²⁷, KLSH do të ndjekë me kujdes përmbushjen e rekomandimit të lënë në përputhje me nenin 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe sa më sipër do ta ketë gjithashtu në fokus në auditimin e ardhshëm në Ministrinë e Kulturës.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

²⁶ Reflektuar në Gjetjen 2/ Rubrika C “Gjetje me efekte negative të konstatuara në administrimin, menaxhimin pa ekonomikitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike

²⁷ Reflektuar në Gjetjen 2/Rubrika B “Masa Organizative”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

ANEKSI 1 - SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

A. Audituesi duhet të shprehë një **opinion të pamodifikuar** mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se, transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.

1. Një **opinion i pakualifikuar** (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
- (b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
- (c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe
- (d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

1.1 Opinioni me rezerve (theksim të çështjes). Opinioni me rezerve do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

B. Audituesi e modifikon opinionin, duke shprehur:

1. Opinioni i kualifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

2. Opinioni negativ (kundërshtues). Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion me rezerve në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinionit qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

3. Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

ANEKSI 2 - QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 1% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, duke marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Thesarin, si dhe dokumentacionin shoqërues (praktikën e urdhërshepeznimit). Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht në pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe
- teste të detajeve.

ANEKSI 3 - Detyrime mbi 30 ditë, më datë 31.12.2017

FURNITORI	SHUMA	DATA_FURNITORIT	31-Dec-17	DATA_URDHER_SHPENZIMIT
.....	3,744	30-Nov-17	31	29-Jan-18
.....	1,574	30-Nov-17	31	29-Jan-18
.....	60,534	15-Feb-11	2,511	23-Mar-18
.....	59,270	30-Nov-17	31	17-Jan-18
.....	32,253	10-Jul-17	174	10-Jul-18
.....	84,440	10-Jul-17	174	10-Jul-18
.....	2,992,077	31-Dec-16	365	12-Apr-18
.....	1,850,000	2-Oct-17	90	30-Jul-18



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”

.....	375,150	27-Sep-17	95	6-Jun-18
.....	(225,030)	22-May-17	223	12-Apr-18
.....	52,995	1-Feb-17	333	1-Feb-18
.....	106,654	30-Nov-17	31	6-Feb-18
.....	543,050	31-Jan-17	334	9-Feb-18
.....	10,440	1-Aug-01	5,996	29-Aug-18
.....	43,583	30-Nov-17	31	4-Jan-18
.....	32,200	26-Apr-16	614	3-May-18
.....	162,455	1-Feb-17	333	1-Feb-18
.....	2,697,506	31-Jan-17	334	12-Apr-18
.....	650,631	29-Jun-17	185	2-Nov-18
.....	132,192	14-Aug-17	139	7-Jun-18
.....	513,315	29-Jun-17	185	2-Nov-18
.....	3,650,241	22-May-17	223	12-Apr-18
.....	4,984	1-Feb-17	333	1-Feb-18
.....	850,362	22-May-17	223	12-Apr-18
.....	495,299	1-Feb-17	333	1-Feb-18
.....	7,449	10-Nov-17	51	28-Mar-18
.....	400,000	30-Nov-12	1,857	1-Nov-18
.....	15,600	24-Nov-17	37	30-Jan-18
.....	281,718	26-Oct-17	66	20-Jun-18
Total	15,884,686			



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Kulturës”